



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 25 DHE 26 TETOR 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 25. I 26. OKTOBRA 2017. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR  
2017**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016.

## **Dnevni red**

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije,
5. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-125 o budžetu Republike Kosova za 2017. godine, i
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja revizije Nacionalne kancelarije revizije za 2016. god.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
Ministrat nuk qenkan që t'i përshëndes,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj,  
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendi të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2017.

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës zgjat 30 minuta, i dini, pesë minuta janë në emër të grupit, tre minuta deputeti ka të drejtë të flasë për çështje që është i interesuar.

Zoti Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, nënkryetar!

Në pikën për deklarim jashtë rendit të ditës unë e marr fjalën sot me kërkesë të 108 punëtorëve të ndërmarrjes së pylltarisë dhe industrisë së drurit "Radusha" në Istog dhe në bisedim që kam pasur edhe me udhëheqësin e kësaj ndërmarrje. më kanë lutur që ta ngre si çështje në Kuvendin e Republikës së Kosovës pagesën e 20%-shit, e cila që nga 21.07.2012, kur është hartuar lista përfundimtare, nuk kanë asnjë përgjigje.

Të mos harrojmë që njerëzit kanë punuar, kanë derdhur djersë me vjet të tëra në atë ndërmarrje, disa nga ta më nuk janë edhe në jetë dhe vërtet është momenti i fundit që Agjencia Kosovare e Privatizimit, ne si Kuvend, të cilët thjesht e monitorojmë punën e tyre, t'u japin përgjigje jo vetëm këtyre punëtorëve, por të gjithë atyre që kanë dhënë kontributin e vetë për vite të tëra.

Andaj, kërkoj që nëpërmjet mekanizmave zyrtarë dhe institucionalë më në fund kjo çështje jo vetëm për ndërmarrjen e pylltarisë dhe industrisë së drurit "Radusha" në Istog, por edhe për të gjithë punëtorët, të cilët presin me vite të tëra mundin dhe kontributin e tyre që u takon kësaj çështjeje njëherë e përgjithmonë t'i jepet zgjidhje.

Mirë që erdh edhe kryeministri i vendit tani në seancë dhe kërkoj personalisht nga kryeministri i vendit që çështjen e pagesës së 20%-shit të punëtorëve të ndërmarrjeve, të cilat i kanë përfunduar të gjitha procedurat ligjore, të ndikojë te Agjencia Kosovare e Privatizimit që thjesht t'u paguhet munda dhe kontributi i tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja ime sot lidhet me grevën e aktorëve të Teatrit Kombëtar, do të thotë ka disa ditë që aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës kanë hyrë në grevë, në kuadër të fushatës për rritjen e pagave. Kështu, do të thotë, aktorët e kanë bllokuar tërësisht repertorin e Teatrit Kombëtar deri në përmbushjen e kërkesave të tyre.

Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës ka kërkuar rritje të pagave qysh në kohën e ministrit Shala dhe i ka drejtuar një kërkesë atij, mirëpo deri më tani kërkesa e aktorëve të Teatrit Kombëtar të Kosovës nuk është përmbushur.

Vlen të theksohet se pakënaqësitë e aktorëve të Teatrit Kombëtar lidhen kryesisht me mospërmbushjen e kërkesës së vazhdueshme të tyre, me që, nëse bëjmë një krahasim me pagat e aktorëve në rajon, do të thotë se aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës e kanë pagën më të ulët në rajon, përfshirë të gjitha vendet ku teatrot veprojnë. Nëse paga e tyre krahasohet me pagën e aktorëve të rajonit, aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës janë dukshëm më ulët të paguar.

Unë kam kontaktuar disa prej tyre dhe më kanë kërkuar që këtë shqetësim të tyre ta bart në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe, me që e kemi ministrin këtu, unë kam informacione që aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës janë takuar edhe me ministrin e Kulturës, zotin Kujtim Gashi, dhe besoj që me që është këtu, edhe ministri i Kulturës do të japë një sqarim para qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Deliu!

Zoti Zafir Berisha e ka fjalën, a është këtu? Zafiri është paraqitur, por nuk qenka. Milaim Zeka në emër të grupit parlamentar, me kartelë të Zafirrit.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë në radhë të parë dëshiroj të paraqes këtu para qytetarëve të Kosovës një shqetësim timin, e jo si deputet, pasi që fatkeqësisht neve Hashim Thaçi, së bashku me Enver Hasanin, na kanë zhveshur komplet nga çdo imunitet i deputetit.

Unë e kuptoj tani çdo ditë e më shumë se ne jetojmë në një shtet policor, ku një polic i thjeshtë mund ta arrestojë pa asnjë argument çdo deputet të Parlamentit të Kosovës dhe ta fyejë e ta poshtërojë atë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Për mua si deputet është tepër shqetësues fenomeni dhe standardi i akuzave që është futur qoftë nëpër institucione të shtetit, qoftë në Parlament, duke e akuzuar njëri-tjetrin me termat si “kriminel” e “vrasës”, por akoma më shqetësues është fakti kur këto akuza bëhen publikisht nëpër studiot e televizioneve tona.

Më ka rastisur këto ditë të shoh në studion e një televizioni nacional, i cili para një kohe bënte thirrje publike për luftë qytetare, ku disa analistë dhe gazetarë ishin ulur në studion e një njeriu dhe akuzonin deputetë të Parlamentit të Kosovës, siç është rasti i Berishës atje, se gjoja kanë dashur të vrasin gazetarë.

Të gjitha këto raporte, të gjitha këto pohime për cilindo deputet, për cilindo parti politike, shkojnë raportet deri në Bruksel dhe atëherë lind pyetja: a jemi ne deputetë, apo jemi vrasarë? Dhe, për turpin më të madh krejt këto akuza bëheshin në studion dhe në praninë e një moderatori, babai i të cilit ka qenë prokurori më famëkeq i ish-Jugosllavisë.

Ai prokuror e ka dënuar më 15 vjet burgim, për shembull, Ramadan Shalën e Pejës, e ka dënuar me burgim familjen e Kujtim Shalës, ndërsa për informacionin tuaj, Ramadan Shala, për Flamur Kelmendin e kam, e ka dënuar familjen e Jusuf Gërvallës, e ka dënuar babanë e nuses së Arban Abrashit, babain e Labeates, e ka dënuar babagjyshin e ministres së Albena Reshitaj, e ka dënuar bacin Destan dhe e ka rrahur dhe e ka torturuar deri në maksimum, e ka dënuar Rifat Birinxhikun dhe fëmijët e këtyre faqezinjve, fëmijët e këtyre kriminelëve, të cilët na kanë dënuar dje, na kanë ndjekur, na kanë persekutuar, sot po na bëjnë nëpër studiot e televizionit neve gjyqe publike. Dhe, këtë unë si deputet i Parlamentit të Kosovës nuk do ta toleroj. Edhe unë do t'u bëj këtyre gjyq publik minimumin nga foltorja e këtij Parlamenti. Këta nuk janë gazetarë, këta janë mercenarë, këta janë kriminelë dhe përdhunues të fjalës së lirë në Kosovë.

Por, për çudinë më të madhe dhe për shokimin tim, e pashë që në studio njëri prej këtyre gazetarëve e lexonte mesazhin e zëvendëskryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Behgjet Pacolli, i cili shkruante dhe i kërkonte falje se njeri prej qytetarëve të Kosovës paska dalë në fushatën e AKR-së.

Imagjinoni sikur Behgjet Pacolli t'i dërgojë një mesazh Qeverisë maqedonase dhe t'i kërkojë falje pse dikur truproja e tij ka qenë Beg Rizaj, që është vrarë heroikisht në Kumanovë.

Unë e kam për nder se Beg Rizajn e kam pasur bashkëluftëtar në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jam krenar që komandant Sokolin e kam pasur shok dhe e kam mik, i cili është i burgosur për rastin e Kumanovës.

Prandaj, gjërat e tilla, zoti Pacolli, unë këtu e kam për Qeverinë një pyetje, zoti kryeministër, të cilën pyetje nëpërmjet jush ia drejtoj zotit Pacolli: A do të ishte më mirë që si

zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës ta tërhiqte kompania e tij akuzën, të cilën ia ka bërë shtetit të vet në Gjykatën e Arbitrazhit, sepse në të gjitha takimet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: E kreve, Milaim! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje!

Sot e morëm një lajm pak shqetësues nga mediet me faktin që kufiri veç po na lëviz, e do të ishte mirë, pasi e kemi edhe ministrin e Punëve të Brendshme, nëse nuk është, atëherë kryeministri të shqyrtojë nëse ky lajm është i vërtetë, sepse siç e dimë, demarkacioni ende nuk është ratifikuar në këtë Kuvend.

Çështja tjetër, të cilën desha ta diskutoj sot me ju, është çështja e betimit të gjyqtarëve nga katër komunat në veri, në fakt, nëse ka pasur betim apo jo.

Për dallim nga raste të tjera të betimit, ku jepen video incizime të dhënies së betimit, dje kemi marrë vetëm foto-lajme dhe në asnjë foto nuk paraqiten gjyqtarët duke dhënë betim. Po nejtë, ti merr me “Vetëvendosjen”, unë po merrem me atë çka është bërë dje.

Kështu që është shumë e rëndësishme që gjyqtarët tanë të betohen se do ta zbatojnë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe shpresoj që edhe ju më bashkangjiteni për ta kërkuar një video-incizim, ku shihet qartë që gjyqtarët e posaçmëruar kanë dhënë betim që do t'i zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, veçanërisht duke pasur parasysh çfarë koncesionesh janë dhënë për t'i pasur ata gjyqtarë të integruar, përfshirë edhe themelimin e Gjykatës të Apelit për Veriun, në kundërshtim, sipas mendimit tim, edhe me ligjet në fuqi, edhe me Kushtetutën, por edhe çështje të tjera që nuk janë as të drejta e as në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Çështja tjetër që është ngritur dje edhe në Komisionin për Legjislacion është çështja e një dokumenti shtojcë për Marrëveshjen e drejtësisë.

Ky dokument, me gjasë, është mbajtur i fshehur, ku potencialisht thuhet se vendimet, aktgjykimet, aktvendimet e tjera të gjykatave ilegale që kanë vepruar në atë pjesën, në katër komunat veriore dhe gjykatat paralele që kanë vepruar në Serbi do të njihen.

Unë ju përkujtoj që i vetmi dokument që ka ardhur në këtë Kuvend për ratifikim ka qenë Marrëveshja, ndërsa kjo shtojcë nuk ka kurrfarë efekti për Republikën e Kosovës, sepse nuk është ratifikuar këtu.

Edhe çështja e fundit ka të bëjë, që do ta ngre edhe në kohën kur diskutojmë për Buxhetin, për diskriminimin e Anamoravës, ku edhe një projekt që planifikuar për atë pjesë të Kosovës, është anashkaluar...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Glauk Konjufca! Në emër personal, në rregull!

GLAUK KONJUFCA: Siç e dinë të gjithë, në shkurt të vitit 2015 në Bruksel u nënshkrua Marrëveshja për drejtësinë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dhe, qysh atëherë ne e kemi ditur fare qartë që kemi të bëjmë me një marrëveshje që është kundër interesave të Kosovës, sepse e ndanë sistemin tonë gjyqësor në dy pjesë.

Pra, Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe Gjykata e Apelit u ndanë vetëm për Mitrovicën e Veriut. Në marrëveshje thuhet që kryetari i gjykatës duhet të jetë serbë, pra caktohet etniciteti i kryetarit të gjykatës ashtu siç caktohet etniciteti i komandantit të Policisë në Marrëveshjen e vitit 2013. Dhe, në fund, me përkatësi etnike ndahen po ashtu, edhe prokurorët edhe gjyqtarët ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ndonëse vetëm kaq është boll e mjaftueshme për të konstatuar se sa e dëmshme është kjo marrëveshje për shtetin tonë, dje e morëm vesh që kjo nuk ka qenë e gjitha, sepse ne kemi zbuluar një aneks, të cilin Qeveria e Kosovës e ka mbajtur të fshehur, nuk e ka botuar, nuk e ka publikuar dhe ky aneks, të cilin ne e kemi siguruar, e kam këtu, është dokument zyrtar i Republikës së Kosovës.

Thuhet kështu: “Aktgjykimet e lëshuara nga gjykatat në Serbi deri më 15 korrik të vitit 2013, që kanë të bëjnë me aktgjykimet apo vendimin nga organet gjyqësore konsiderohen si të vlefshme”.

Do të thotë, këtu me marrëveshjen për drejtësi, një pjesë të së cilës ju e keni fshehur, thuhet që aktgjykimet e Serbisë në Kosovë konsiderohen të vlefshme. Kjo është mbajtur qëllimisht e fshehur nga Qeveria e Kosovës pikërisht për shkak të kësaj përmbajtjeje, për arsye se, në njërin anë, vendimet e Serbisë bëhen të vlefshme në Kosovë, në anën tjetër, për arsye që kjo listë përmban edhe emrat e gjyqtarëve, të cilët i ka caktuar Vuçiqi atje që Këshilli Gjyqësor formalisht veç ta ngrëjë dorën edhe të bëhen gjyqtarë dhe prokurorë të Republikës së Kosovës.

Kjo i demaskon gënjeshttrat dhe mashtrimet e Qeverisë, duke na thënë që gjithçka ka qenë në përputhje me ligjin dhe është krejt në rregull, edhe Qeveria e Kosovës do t'i caktojë këta gjyqtarë e prokurorë, por shihet fare qartë që këta nuk janë emëruar me konkurse e me punën e tyre profesionale, por janë emëruar në negociata ndërmjet qeverisë sonë dhe Aleksandër Vuçiqit. Kjo është e turpshme dhe e pafalshme për mënyrën sesi është zgjidhur kjo çështje.

KRYESUESI: Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Kryeministër, ministra,

Deputetë, kolegë të nderuar,

Medie,

Sot dua ta plasoj një kërkesë timen sigurisht për kryeministrin, për ministrin e Financave dhe ministrin e Punëve të Brendshme.

Sot ne e kemi Policinë e Kosovës, e cila ka nevojë për një shqyrtim jashtëzakonisht të thellë për ata njerëz që punojnë aty, sigurisht për një pastrim apo filtrim të të gjithë atyre që punojnë, posaçërisht është një kërkesë për të ardhur deri aty që të gjithë, Komisioni për Siguri dhe ministri i Punëve të Brendshme ta shqyrtojnë mirë dhe t'i plotësojnë kushtet, kriteret, të cilat kërkohen për Policinë e Kosovës. Nëse ne e konsiderojmë dhe e llogaritim Policinë e Kosovës vetëm në momente të vështira kur është rrezikshmëria, mendoj që ky është një gabim i plotë për arsye që asnjëri prej Policisë nuk i ka kushtet e nevojshme për ta kryer at detyrë.

Ne s' duhet ta harrojmë që çdo polic i Kosovës në çdo moment, në çdo minutë është në gjendje të detyrës. E ka obligim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, çdo polic i Kosovës që sot e merr detyrën shkon në punë, është me një shqetësim jashtëzakonisht të madh për arsye që nuk ka kushte ekonomike, pagat e tyre janë jashtëzakonisht të ulëta. Çdo polic apo 80% e policëve të Kosovës sot i ke në kredi. Pse? Qysh mund të punojë një polic i Kosovës e ta kryejë sot një detyrë kur e ka familjen në vështirësi. Mendon qysh ta dërgojë fëmijën në shkollë, qysh t'ia plotësojë kushtet, prandaj çfarë detyre mund të kryejë?

E dyta, në kushtet e tyre të punës nuk kanë asnjë kriter të mjaftueshëm, me të cilin mund ta kryejnë një detyrë. Prandaj, është një kërkesë nga unë, sigurisht që do ta aprovoni edhe ju, që kjo të shqyrtohet mirë dhe t'u ofrohen kushtet e nevojshme, t'u ngrihen pagat, të dallohet vendi prej vendit të punës. Posaçërisht, e kam edhe një kërkesë këtu, të gjithë ata që janë në detyrë, që sot i kanë bërë nga 3-4 mijë orë, e i kanë rezervë, që nuk u janë paguar deri më sot, as nuk u është dhënë pushim, arsyet pse janë bërë aq...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Pacolli! Fjalën e ka zoti Hoti, në emër personal.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Dëshiroj të shpreh një shqetësim lidhur me çështjen e liberalizimit të vizave, pra kriteret për liberalizimin e vizave. Ne kemi pasur takime, grupi ynë parlamentar, kryesuesit e komisioneve



që grupi ynë i ka me përfaqësuesit e BE-së, e na është thënë qartë në listën e kritereve për liberalizim të vizave ka hyrë edhe çështja e luftimit të korrupsionit.

Në Qeverinë paraprake, nga 94 kritere të përcaktuara për liberalizim të vizave janë plotësuar atëherë 93, me përjashtim të demarkacionit, për arsyet që dihen. Jemi të shqetësuar tash që në listën e këtyre kritereve shtohet edhe njëherë çështja e korrupsionit dhe ne kërkojmë në seancat e ardhshme që këtë temë ta shtrojmë në rend dite, që Qeveria të përgjigjet para Kuvendit të Kosovës se cilat janë përpjekjet tash që duhet t'i bëjmë edhe cilat janë arsyet që ky kriter është kthyer edhe njëherë në listën e kritereve për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë do t'u kthehem disave nga temat shqetësuese, por gjithsesi nuk mund ta tejkaloj atë që është tash informacioni i fundit rreth kryeprokurorit të Shtetit. Në kohën kur është emëruar mediat kanë raportuar, këtu e kam njëfarë të dhëne se kryeprokurori i Shtetit ka qenë i përfshirë ose është dyshuar në përfshirje rreth vrasjeve. Por, ajo që është më shqetësuese dhe që e bën komplet drejtësinë të dyshimtë është se edhe kryeprokurori i Shtetit po del falsifikator.

Çështja qëndron se çfarë drejtësie kemi në Kosovë? Në rast se edhe ky rast tejkalohet sikur rastet kur është emëruar, e që është dyshuar për vrasje, atëherë ku po përfundon drejtësia në Kosovë? Mendoj se kryeprokurori, para se të kërkojë nga EULEX-i që është fajtori kryesor për gjendjen në drejtësi në Kosovë, është dashur që të japë dorëheqje dhe të kërkojë falje para qytetarëve, për të mundur të japë hapësirë që drejtësia dalëngadalë të bjerë në vendin e duhur. Normalisht që drejtësia në Kosovë është e kapur dhe fajtori kryesor natyrisht që janë ndërkombëtarët dhe kërkesa që ndërkombëtarët ta marrin këtë çështje është kërkesë për ta kamufluar edhe këtë rast.

Unë gjithsesi po i kthehem asaj që është jetike për qytetarët dhe nëse kam hapësirë do të flas për dy tema: për temën e energjisë elektrike, meqë nga 6 shkurti ekziston një vendim i ZRRE-së që KEK-u të inkasojë nga qytetarët e Kosovës për energji elektrike dhe për shpenzimet e energjisë elektrike edhe për qytetarët e pandërgjegjshëm të veriut të vendit, që kap një shifër, sipas Avokatit të Popullit, prej 8 milionë euro dhe që nënkupton se diku rreth 40 milionë euro qytetarët e Kosovës kanë paguar për pjesën veriore, në kundërshtim edhe me ligjin sipas raportit të Avokatit të Popullit, i cili ka raportuar në qershor të këtij viti.

Natyrisht, nga qershori ne kemi qenë nën etheet e zgjedhjeve dhe të bërjes së institucioneve, por si deputetë të Parlamentit të Kosovës gjithsesi kemi përgjegjësi që të merremi me çështjet jetike, siç është vjedhja sistematike që u bëhet qytetarëve të Kosovës, veçanërisht në energjinë elektrike. Për këtë çështje unë edhe në legjislaturën e kaluar kam folur rreth matësve elektrikë të

tipit “Cohler”, kur edhe ish-ministrja e ka pranuar se një institut në Holandë ka konstatuar se në mënyrë institucionale dhe sistematike vidhen qytetarët e Kosovës. Unë mendoj se është momenti i fundit që edhe Kuvendi, edhe Qeveria të ndërmarrin hapa që qytetarët e Kosovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Të nderuar kolegë!

Tanimë po bëhen gati dy muaj prej rastit të fundit që ka ndodhur në QKU, e ku janë regjistruar së paku tri raste të vdekjes së dyshimtë dhe 7 raste të tjera me pasoja, por çfarë është bërë deri më tani?

Ne e dimë vetëm një të dhënë, që operatori, do të thotë përfaqësuesi i kompanisë... nga Kaçaniku është arrestuar, faktikisht është në një muaj paraburgim dhe asgjë tjetër nuk dimë deri tani. Kjo ka ndodhur në kohën kur ministri i ri ka qenë në ditët e para të mandatit të tij, mirëpo duhet të shtrohet pyetja: Si ka pasur mundësi që një kompani e palicencuar për prodhimin e oksidulit ta fitojë një tender? Si ka qenë e mundur që ajo kompani, edhe pse nuk ishte fituese fillimisht në tender, të rikthehet si fituese nga OSHP-ja? A ka qenë ajo kompani e përgjegjshme? Ne e dimë cilat janë procedurat e prokurimit, si përzgjidhet operatori ekonomik, i cili do të fitojë një tender. Fillimisht duhet të jenë tri oferta të përgjegjshme dhe pastaj përcaktohet fituesi nëse merret çmimi si kriter.

Cili ishte kriteri i OSHP-së që ta rikthejë kompaninë nga Kaçaniku si furnitor kryesor, jo vetëm i QKU-së, por edhe i Spitalit në Gjilan dhe në Gjakovë. Dihet shumë mirë që atë ditë, pas vdekjeve të para është ndërprerë furnizimi, është ndërprerë futja e oksidulit në sistem. Mirëpo, nuk është lajmëruar askush, tek pasi që mediet e kanë ngrehur si çështje, një javë më vonë janë ngritur dyshimet se në QKU ka vdekje të dyshimta si pasojë e futjes në sistem të një gazi të dyshimtë. Do të thotë që në fillim nuk është konsultuar toksikologu, nuk janë marrë mostrat e gjakut, jo vetëm nga të vdekurit, por ata janë varrosur pa u bërë obduksioni dhe tek pas alarmimit të rastit është bërë zhvarrosja e tyre dhe është bërë autopsia.

Çfarë ka ndodhur me rastet, të cilat, fatmirësisht, pasi u kuptua problemi janë trajtuar dhe sot janë gjallë? Pse nuk janë marrë mostrat që në fillim dhe të konsultohet toksikologu, e të dërgohen ato edhe jashtë vendit? Çfarë ka ndodhur me bombolat e gazit, që është thënë se do të dërgohen për analizë jashtë vendit? A ka rezultate deri në ditën e sotme?

Ne e kemi ftuar ministrin në komision dhe ai është zotuar që do ta shqyrtojë rastin deri në fund. Ju lutem, ky problem e tejkalon edhe vetë Ministrinë e Shëndetësisë. Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet të japë përgjegjësi se si ka pasur mundësi që të anulohet, t'i merret e drejta

fituesit të parë, e t'i jepet fituesit nga Kaçaniku, këtij operatori, i cili nuk e ka pasur licencën, që është kriteri i parë i përgjegjshmërisë kur konkurren në një tender.

Ne si Lëvizja “Vetëvendosje”, por jo vetëm ne, edhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës janë thellësisht të brengosur se si është e mundur që në institucionet tona shëndetësore, që fatkeqësisht janë aq të përfolura dhe edhe vetë imazhi i profesionistëve shëndetësor, fatkeqësisht, është në një shkallë më të ulët se kurdo herë tjetër, të pësojë nga menaxhmenti. A ka pasur tendencë të mbulimit të krimit?

Zonja dhe zotërinj,

Fakti që tek një javë më vonë fillon të trajtohet ky rast serioz, edhe pse është ngritur edhe nga vetë mjekët në QKU, se problemi është aty. Është ndërprerë që të njëjtën ditë furnizimi - futja në sistem dhe është kthyer sistemi tjetër, që tani pothuajse është shumë më pak i kushtueshëm me ajër të komprimuar dhe ai aplikohet në të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian. Pse pra ne shkojmë me metoda më të shtrenjta, përdorim vetë zyrtarët e QKU-së kanë deklaruar se futja me sistem me ajër të komprimuar qenka më e lirë dhe tani është bërë me procedura të përsheptuara. Më 29 shtator është nënshkruar kontrata tremujore prej 257 mijë eurove me një operator tjetër.

Ju lus, tani është futur si kriter në tender që të jetë depo farmaceutike, që do ta furnizojë me një gaz që aplikohet apo prodhohet në BE. Pse këto kritere nuk kanë qenë të futura në tenderin e atëherëshëm, kur është futur ky furnitor pa licencë, që ta furnizojë, paramendoni, QKU-në dhe spitalet regjionale, përdorim e dimë që një fituese tjetër, i pari, që quhet kompania “Mezere” i ka furnizuar spitalet tjera regjionale. Ju lus, që shumë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua të ju kërkoj falje të gjithëve për faktin se zoti kryeministër Haradinaj ka takim me delegacionin nga SHBA. Dua t'ia jap fjalën, që ta thotë atë që ka planifikuar të na e thotë neve në Kuvend dhe pastaj duhet të largohet për shkak të takimit. Zoti Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

Ju kërkoj falje për këtë ndërhyrje!

I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Kabinet qeveritar,

Të gjithë të pranishëm,

E para, jam duke hyrë në temë ende me këto marrëdhëniet Qeveri - Parlament. Një pjesë e pyetjeve po vijnë 24 orë para seancës, jo se është zor për t'u përgjigjur, por është praktikë ndoshta për t'u koordinuar sa më mirë.

Njëkohësisht, unë sot kam ardhur sipas obligimit, sot e kemi një ditë me rëndësi në Parlamentin e vendit, sepse është diskutimi mbi rishikimin e Buxhetit. Ka edhe tema të tjera shumë të rëndësishme, sikur dhe pyetjet e deputetëve. Meqenëse vërtet e kemi pasur një agjendë para disa javësh të caktuar, e kam të pamundur të jem i pranishëm dhe po dua të ju informoj sipas Rregullores, në bazë të resorëve, pyetjet i kam bartur te kolegët e Kabinetit. Po e zëmë, disa i shkojnë ministrit të Financave, ndonjë tjetër i shkon ndonjë kolegu.

Me këtë nuk po u iku përgjigjeve, por desha ta bëj një reflektim për disa gjëra që u thanë këtu. Vërtet që nga ardhja në Qeveri ne kemi bërë kujdes të madh për ta kuptuar gjendjen rreth dialogut, rreth marrëveshjeve, cilado qoftë ajo, rreth të arriturave, dhe në një afat kohor të caktuar do ta informojmë Parlamentin për të gjeturat tona, për gjendjen.

Njëkohësisht e kemi paraparë po ashtu që në një etapë tjetër, e jo fort larg, ta propozojmë një plan për pozicionin e Kosovës në të gjitha këto tema, e t'ia sjellim Parlamentit. Pra, jo të mbetet pronë, as e Qeverisë, as e Presidentit. Jemi të hapur për t'u konsultuar edhe me Presidentin, edhe ne në mes vete, por dëshirojmë ta sjellim në Parlament që të dihet sa më saktë pozicioni i Kosovës, të gjeturat e Kosovës dhe çfarë duam të pasojmë.

Nuk po i shqyrtoj të gjitha ato që u thanë sot, por në afatin e caktuar kohor do të vijmë me të gjitha ato që janë me interes.

Ju kërkoj falje, se më duhet të kërkoj leje! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haradinaj!

Për 3 minuta, sa e zgjati zoti kryeministër, unë e zgjas 30-minutëshin. Fjalën e ka zonja Vjosa Osmani në emër të grupit. Mund ta thoni edhe në mikrofon kur të dilni, s'prish punë.

VJOSA OSMANI: Në emër të Grupit Parlamentar, sepse nuk është shfrytëzuar ajo kohë.

Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Meqenëse Presidenti i vendit zgjidhet po nga ky Kuvend, e kemi jo vetëm të drejtë kushtetuese, por edhe obligim qytetar çdoherë kur ne si deputetë e shohim që ky institucion nuk po e respekton Kushtetutën. Por, mbi të gjitha, ky institucion po tregohet diskriminues në raport me qytetarët e Kosovës dhe nuk po i respekton pra as qytetarët e Kosovës.

Prandaj, e kemi për obligim që po në këtë Kuvend, ku ai është zgjedhur, edhe ta ngremë zërin ndaj shkeljeve të tilla.

Presidenti i Kosovës nuk po e luan rolin e vet si simbol i unitetit dhe përfaqësues i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Këtë e dëshmoi qysh nga shpërbërja e këtij Parlamenti, kur ai mblidhte vota për mocionin kundër Qeverisë së Kosovës dhe e vazhdoi gjatë gjithë kohës së fushatës, duke marrë pjesë drejtpërdrejt dhe duke ndikuar drejtpërdrejtë te qytetarët e Kosovës, përfshirë fatkeqësisht edhe pakicat në qytete të caktuara, pra duke e favorizuar PDK-në dhe duke bërë fushatë për këtë parti, qoftë në Prizren, qoftë në Vushtrri, në Klinë, Drenas e madje edhe sot, duke e pritur në zyrën e tij kandidaten e Partisë Demokratike të Kosovës për Mitrovicë.

Ai, pra, e keqpërdori edhe një herë rolin e tij kushtetues dhe i keqpërdori edhe pakicat e Republikës së Kosovës, duke premtuar gjëra të cilat as sa ka qenë kryeministër, por as tani kur është President, nuk do t'i respektojë. Shpresoj që të gjitha pakicat që e kanë pritur atë dhe kanë biseduar me të, do ta kuptojnë këtë shpejt.

Çështja e dytë në të cilën ai është duke e keqpërdorur rolin e tij është dialogu Kosovë - Serbi. Ky Kuvend i Republikës së Kosovës e ka miratuar jo vetëm një rezolutë në vitin 2011, por edhe rezoluta të tjera, me të cilat e ka përcaktuar rolin e Qeverisë. Presidenti i Republikës së Kosovës në kundërshtim me këto rezoluta mbanë dhjetëra takime me Vuçiqin dhe nuk ka aspak transparencë, as për temat që i bisedon, dhe as për marrëveshjet që i ka arritur atje. Nuk u përgjigjet prandaj as qytetarëve të Republikës së Kosovës për marrëveshjet, që potencialisht mund të jenë në dëm të sovranitetit të vendit.

Fusha e tretë, që u përmend edhe më herët, është dekretimi i gjyqtarëve serbë me një mungesë totale të transparencës e, rrjedhimisht, edhe një potencial tjetër për shkelje të Kushtetutës së Kosovës dhe shkelje të parimit të sistemit unik gjyqësor, i cili kërkohet nga po kjo Kushtetutë.

Dhe, e fundit, deklaratat e tij kundër Bashkimit Evropian dhe kundër shteteve të tjera miken tregojnë që ai po e shkel edhe rolin e tij si përfaqësues i Republikës së Kosovës brenda dhe jashtë vendit, duke rrënuar dhe duke rrezikuar miqësitë që Republika e Kosovës me shumë mundësi e sakrificave i ka ndërtuar me këto shtete dhe me këto organizata.

Prandaj, si përfundim, ky President, lëre që nuk po e përfaqëson unitetin shtetëror, por çdo ditë e më shumë po degradon dhe po e turpëron institucionin e Presidentit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

**DANUSH ADEMI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Desha pak ta informojmë opinionin se me të vërtetë kohën e fundit, sidomos në muajin e fundit, një sëmundje infektuese ka prekur shumë komunitete tonat, të cilët në një komunë, në Fushë Kosovë më së shumti, që quhet me fjalën popullore “fruthi”, kur një fëmijë tashmë ka vdekur, i

kemi mbi 75 raste që janë në spital. Ne kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të kujdeset pak më shumë për komunitetet.

Ne vazhdimisht kemi kërkuar, e edhe në këtë seancë, që t'u kushtohet pak më shumë kujdes komuniteteve, sepse kjo sëmundje, e cila pothuajse nga mjekët me të cilët jemi konsultuar në spital, me drejtorinë e tyre, thonë që është kaluese dhe ka mundësi që secilin qytetar ta prekë. Po pse më shumë te qytetarët tanë, te familjet e varfra, po ndodh kjo?

Ne i kemi mbi 76 raste të cilat vetëm deri më tani janë duke u trajtuar në spital. Disa nga ta e kanë kaluar, janë kthyer në shtëpi, por kjo është si pasojë e kushteve të rënda ekonomike të ato familje, të cilat tërë ditën bredhin nëpër qytet, shkojnë nëpër kontejnerë mbledhin kënaçe për t'i shitur dhe ato familje pothuajse të gjitha janë të prekura nga kjo sëmundje.

Unë mendoj dhe kërkoj nga kjo Qeveri që së paku t'i hapin sytë dhe ta kthejnë pak kahun nga komunitet që jetojnë në Kosovë, të fillohet t'u rregullohet jeta këtyre komuniteteve, se me të vërtetë ka mundësi të vijë ndoshta edhe te një epidemi edhe më e madhe, e kjo do të ishte një pasqyrë e rëndë për tërë Kosovën, jo vetëm për komunitetet.

Është shumë e rëndë ta humbë një fëmijë 15 muajsh nga kjo sëmundje, kur ne menjëherë e kemi kontaktuar ministrin, të cilin e falënderoj që ka intervenuar në spital dhe ai repart është pajisur me barna, por në mungesë të atyre barnave ne kemi kërkuar ndihmë edhe nga Diaspora, nga OJQ-të tona që i kemi në Diasporë. Të gjitha ato familje që kanë qenë të prekura nga kjo sëmundje janë ndihmuar me gjëra ushqimore, dhe janë pajisur me barna të cilat mungonin në spital.

Prandaj, edhe një herë kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të mendohet për këto komunitete, për këtë shtresë të ulët. Ne pas kësaj pike do ta kemi edhe Buxhetin që do të votohet dhe mendoj se duhet të kemi kujdes të veçantë për këto komunitete që pothuajse bukur shumë janë duke mbetur anash, edhe në aspektin e jetës, të punësimit, po ashtu edhe të shëndetësisë. Por, në qoftë se kjo sëmundje është e vazhdueshme, thashë i kemi mbi 77 raste...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Në radhë është Veton Berisha.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që unë ta mbështes diskutimin e fundit të kolegut tim Danush Ademit për gjendjen e fundit të krijuar te fëmijët e komuniteteve tona, e cila vërtet është jashtëzakonisht shqetësuese, sepse pas 37 vjetëve të rikthehet kjo sëmundje në Kosovë, kjo nënkupton që diçka në sistemin e shëndetësisë nuk po funksionon si duhet.

Andaj, e falënderoj ministrin për veprimet e menjëhershme, por mendoj që ky proces duhet të jetë në preventivë dhe jo në shërim. Tani jemi goxha vonë dhe normalisht duhet të shikojmë dhe të mobilizohemi sa më shumë në preventivë, sepse numri i rasteve të tilla është në rritje e sipër. Ne ofrojmë bashkëpunim të plotë, në mënyrë që t'i sensibilizojmë familjet, ta sensibilizojmë opinionin dhe t'i ndërmarrim të gjitha masat për parandalimin e kësaj dukurie, sepse dy fëmijë kanë humbur dhe normalisht duhet të parandalojmë humbjen e të tjerëve. Jemi të gatshëm për bashkëpunim, në mënyrë që të futet në kontroll kjo situatë, që nuk po na bën të ndihemi mirë.

Çështja e dytë që dua ta diskutoj dhe kam të drejtë të diskutoj tani, sepse jemi në përmbyllje të zgjedhjeve lokale dhe normalisht, u referohemi edhe zgjedhjeve qendrore. Këtu paraqes një shqetësim jashtëzakonisht të madh timin dhe të komunitetit tim për pozicionin e tyre elektoral më rastin e zgjedhjes së tyre për atë që ata dëshirojnë.

Jam dëshmitar i një gjendjeje jashtëzakonisht tmerruese, se në çfarë situatë janë votuesit e komuniteteve tona, në çfarë pozite janë ata të cilët vërtet e kanë të pamundur të vendosin për atë që do t'i përfaqësojë më së miri. Kam qenë i pranishëm dhe jam dëshmitar i shumë shantazheve, i shumë blerjeve të votave, i shumë gjërave që vërtet nuk e lejon asnjë shoqëri demokratike dhe kjo ka ndodhur nga të gjitha partitë politike shqiptare, pa asnjë dallim, edhe nga vetë komunitetet.

Po mendoj që edhe KQZ-ja, edhe Prokuroria, edhe Policia ka mjaft hapësirë dhe ka obligim që sidomos në fushatën zgjedhore, e sidomos në ditën e zgjedhjeve të jetë afër atyre që t'u jepet e drejta e deklaramit të votës së tyre.

Paramendoni në komunën e Gjakovës, me 8 000 banorë, komuniteti egjiptian mbetet i papërfaqësuar.

Në komunën e Pejës me 3-4 mijë banorë, komuniteti egjiptian mbetet i papërfaqësuar dhe në komunat e tjera. Pse ndodh kjo? Në komunën e Prizrenit po ashtu dhe në komuna të tjera, vërtet është e papranueshme, vërtet nuk duhet.

Unë tash bëj thirrje që të zgjedhurit e tyre ta kthejnë kokën nga ata njerëz dhe vërtet të merren me hallet e tyre. E sidomos qendrat për punë sociale janë duke luajtur një rol jashtëzakonisht të madh me detyrimin e njerëzve për të votuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Balaj e ka fjalën, e fundit.

ALBULENA BALAJ: I nderuar nënkryetar,  
Kabinet qeveritar,  
Kolegë deputetë,  
Të nderuar qytetarë,

Unë desha të ngre një çështje, për të cilin e ftoj kryeministrin dhe Qeverinë që të gjejnë një formë të duhur, sepse realizimi i saj është shumë i nevojshëm, është shumë e ndjeshme, për të mos thënë e domosdoshme.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë të asaj se nëpër vendet e punës ka punëtorë, të cilët janë në gjendje shumë të rëndë shëndetësore, e të cilët detyrohen të punojnë për shkak se atyre nuk u mundësohet një pensionim i parakohshëm, me të cilin do të mund të merrnin për një kohë të caktuar pagën e plotë, e më pas një 70% të pagës bazë, të cilën e kanë.

Këtu e kam fjalën për punëtorët, të cilët janë me sëmundje malinje ose kanceroze, të cilët nuk janë në gjendje të shkojnë në punë, por që detyrohen, sepse në ato raste kur ata e ndërprejnë punën, ata nuk marrin pagë dhe në këto raste është shumë e nevojshme paga e tyre.

Mendoj dhe dua të besoj se kjo nuk i kushton asgjë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me këtë, nëse Qeveria e realizon, kjo është një punë e madhe që mund ta bëjë.

Pra, po e përsëris dhe po e vë theksin te mësimdhënësit, sidomos ata të cilët janë të detyruar që edhe në atë gjendje të shkojnë në mësim, e të cilët nuk mund as ata e as nxënësit të arrijnë rezultate, të cilat ata vetë i duan, ne i duam dhe të gjithë i duam. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës u shterua.

Para se të hyjmë në pikën e dytë të rendit të ditës, ministri Tahiri e ka kërkuar fjalën dhe unë do t'ia jap.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti kryesues,  
Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimeisht t'ju njoftoj për një nga hapat tejet të rëndësishëm për sistemin tonë të drejtësisë që ka ndodhur dje, më 24 tetor të këtij viti.

Presidenti i Republikës së Kosovës dje i ka dekretuar 53 gjyqtarë dhe prokurorë nga komunitetet joshumicë.



Saktësisht, 40 gjyqtarë dhe 13 prokurorë, pra nga të gjitha nivelet e gjykatave, nga Gjykata Themelore e deri te Gjykata Supreme.

Dekretimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve është bërë në pajtim me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe në pajtim të plotë me legjislacionin e Republikës së Kosovës që është në fuqi.

Ky dekretim paraqet aktin e zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit për drejtësi dhe integrimin përfundimtar të organeve gjyqësore dhe prokuroriale të komuniteteve joshumicë.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje është rezultat i punës dhe koordinimit mes Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, Ministrisë së Drejtësisë dhe gjithashtu dua t'i falënderoj partnerët tanë ndërkombëtarë, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyrën e Komisionit Evropian në Kosovë si dhe EULEX-in për fasilitimin e këtij procesi.

Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, jashtëzakonisht të rëndësishëm, në krijimin e të gjitha kushteve teknike dhe operacionale të mbështetura ngushtë nga mekanizmat e projekteve të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Prej se jam emëruar ministër i Drejtësisë, funksionalizimin e gjykatave në veri të vendit e kam trajtuar me seriozitet dhe përkushtim maksimal.

Kemi mbajtur takime të rregullta javore me të gjithë aktorët e sipërpërmendur për t'i siguruar se çdo hap për implementimin e kësaj marrëveshjeje është duku u ndërmarrë në mënyrë konkrete.

Tash, kur ka ndodhur dekretimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve nga komunitetet joshumicë në mënyrë shumë racionale, më lejoni të them se nga dje shtrirja e sovranitetit në terma juridikë në mbarë vendin ka ndodhur.

Tani e tutje qytetarët e Republikës së Kosovës do të ballafaqohen me një sistem unik të drejtësisë në tërë territorin.

Jam jashtëzakonisht i nderuar që qysh në fillim të mandatit tim jam marrë me një çështje tejet të rëndësishme, jetike për vendin: funksionalizimin e gjyqësorit në katër komunat në veri të Kosovës. Faleminderit!

## 2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 17 pyetje parlamentare. Dihet që kryeministri nuk është këtu gjatë kësaj pike të rendit të ditës, ata që duan t'i lexojnë pyetjet mund t'i lexojnë, por përgjigjet me siguri që në seancat e radhës do t'i japë vetë kryeministri.

Pyetja e parë është nga deputeti Slavko Simiq për ministrin Flamur Sefaj. Zoti Simiq, dëshironi ta bëni pyetjen? Me sa di unë, ministri është jashtë shtetit. E lë për seancën e ardhshme.

Zonja Hykmete Bajrami, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Zonja Bajrami, dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Bajrami e ka fjalën.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kryeministri nuk është hera e parë që nuk po qëndron gjatë sesionit të pyetjeve parlamentare. A u justifikua duke thënë që pyetjet përmbahen në 24 orët e fundit. Unë ju informoj që pyetjen që po e lexoj e kam bërë që 25 ditë, edhe nuk e di se si ka mundësi që gjithmonë kur kemi seanca parlamentare kryeministri ka agjendë. Besoj që duhet të jetë më fleksibil dhe të rrijë këtu, të qëndrojë përballë deputetëve në mënyrë që t'i japë përgjigjet.

Pyetja ime ka të bëjë me çështjen e krijimit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Unë kam dashur të pyes kryeministrin, edhe pse tanimë dihet, po t'i qartësoj më shumë për publikun, pse është krijuar kjo ministri? Në fakt, të gjitha Qeveritë paraprake e kanë evituar krijimin e një ministre të tillë, e cila ka shumë potencial që të shpije drejt rajonalizimit të vendit.

Kam pasur edhe pyetje të tjera, por unë besoj që çfarëdo që ndodh si derivat i kësaj ministrie përgjegjës për qytetarët e Kosovës, para qytetarëve të Kosovës, është pikërisht kryeministri Ramush Haradinaj.

Unë pres që në seancat e ardhshme ai t'i thërrasë mendjes, të bëhet më i përgjegjshëm dhe të vijë këtu dhe të na përgjigjet në pyetjet e deputetëve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Bajrami ka edhe një pyetje për ministrin Dardan Gashi, Dardani nuk qenka këtu, zonja Bajrami, dëshironi ta bëni pyetjen?

**HYKMETE BAJRAMI:** Edhe ministri Gashi nuk është këtu.

Unë prapë dua ta ngre si shqetësim, edhe pse jo në formë të pyetjes. Në fakt, ne të gjithë i dimë pazaret dhe kompromiset e dhimbshme që janë për krijimin e kësaj Qeverie, krejt papritmas, zoti

Gashi, pa pasur ndonjë përfaqësim politik, pa konkurruar fare në zgjedhje na bëhet ministër i Diasporës. Përpos tjerash, Ministrisë së Diasporës i shtohet edhe një kompetencë tjetër, ajo e investimeve strategjike.

Pyetja ka të bëjë me atë se a do të ndryshohet Ligji për investimet strategjike? Sepse na ka marrë shumë kohë, ka pasur shumë kundërshtarë të ligjit, ligji tanimë është në fuqi.

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, respektivisht Agjencia e Investimeve dhe për përkrahje të ndërmarrjeve është përgjegjëse. Kjo agjenci ka filluar punën me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është lista e projekteve tanimë e gatshme. Nuk di pse një kompetencë e tillë të kalohet jashtëligjshëm te Ministria e Diasporës dhe në mënyrë që ministri Gashi të jetë kompetent, komplet duhet të ndërrohet ligji dhe kjo nënkupton që do të kemi edhe një humbje të kohës, sigurisht shumë të gjatë, e kjo është e paarsyeshme.

Andaj, unë i bëj thirrje kryeministrit Haradinaj, por edhe ministrit Gashi që të heqë dorë nga kjo kompetencë, të mos provohet të zbuloni ‘ujin e vakët’ prapë, sepse ligji është, projektet janë, janë institucionet përgjegjëse, të cilat shumë qartë i përcakton ligji dhe asnjë kompetencë nuk është te Ministria e Diasporës sipas ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Unë e kam këtë pyetje për ministrin e Arsimit. Më intereson, zoti ministër, se a jeni të informuar në lidhje me rezolutën për arsimin të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 19 janar të këtij viti dhe a ka ndonjë hap konkret në këtë drejtim në përputhje me këtë rezolutë?

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk është këtu, jashtë shtetit qenka. Faleminderit!

Zonja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Dëshironi ta lexoni pyetjen?  
Po!

SHQIPE PANTINA: Shpresojmë se kjo Qeveri nuk do ta ndjekë shembullin e Qeverisë së mëhershme të mungojë në seancat kur diskutohen pyetjet parlamentare.

Ai ditë më parë ka shkarkuar bordet e tri institucioneve të pavarura, është më se e vërtetë se këto borde kanë qenë krejtësisht të politizuara dhe si pasojë, edhe jo profesionale dhe shpeshherë edhe kanë shkelur rregullat dhe procedurat, bile edhe ligjet në fuqi.

Mirëpo, përveç që kanë qenë krejtësisht borde politike, kryeministri nuk ka dhënë arsye se cilat kanë qenë arsyet shtesë për shkarkimin e këtyre bordeve, cilat kanë qenë shkeljet ligjore që i kanë bërë anëtarët e këtyre bordeve, cilat kanë qenë ngecjet në kryerjen e detyrave apo arsyeja kryesore ka qenë zëvendësimi i këtyre anëtarëve, të cilët kanë qenë politikë, me anëtarë të tjerë të partive të koalicionit qeverisës aktual.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Haradinaj.

FATON TOPALLI: Kryeministri tha që mund të përgjigjen ministrat e tjerë në pyetje. Sidoqoftë, unë po e shtroj pyetjen.

Komuna e Ferizajt është shkëputur nga dy autostradat kryesore të vendit, ajo që lidh Kosovën me Shqipërinë dhe autostrada tjetër, e cila e lidh Prishtinën me Shkupin.

Edhe pse autostrada që lidh Kosovën me Shqipërinë ka pasur të kalojë afër Ferizajt, pra diku te Shtimja, ka ndërruar kahun, ndërsa në autostradën që lidh Prishtinën me Shkupin, Ferizaj nuk ka qasje.

Dua t'i përkujtoj Qeverisë edhe kryeministrin që Ferizaj jep për Buxhetin e Kosovës 360 milionë në vit, pra 12 herë më shumë se sa që merr nga ky Buxhet, pra merr gjithsej 28 milionë. Pra, jemi fuqia e dytë ekonomike, investitorët e dytë të autostradës dhe në të njëjtën kohë nuk kemi qasje në autostradë. Qasja në autostradë është tek në Sojevë, që është 8 kilometra larg nga Ferizaj. Më afër e ka qasjen në autostradë Lipjani sesa Ferizaj.

Duke pasur parasysh fuqinë ekonomike të Ferizajt, duke pasur parasysh prodhuesit e Ferizajt, tregtarët, qytetarët, të cilët kanë nevojë për një qasje të afërt, kjo çështje nuk po ndodh dhe autostrada do të shfrytëzohet kryesisht për mallra që vijnë nga Serbia që kalojnë në Kosovë e shkojnë në Maqedoni dhe anasjelltas, por më së pakti nga prodhuesit e Ferizajt nga qytetarët që jetojnë aty.

Pyetja ime është kjo: Cili është projekti i Qeverisë rreth kësaj çështje? Pra, a do të ketë Ferizaj qasje në autostradë, edhe pse qasja për autostradë është krejt 2.9 kilometra dhe nëse po, kur do të fillojë realizimi, respektivisht kyçja drejtpërdrejt e Ferizajt në autostradë.

KRYESUESI: Faleminderit! Përgjigjen do ta japë ministri Pal Lekaj.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotëri,

Faleminderit, i nderuar deputet, për pyetje!

Sa i përket drejtimit rrugor gjashtë, është pjesë e rrjetit bazë të transportit të Evropës Juglindore, e cila i lidh kryeqytetet kryesore të rajonit me portet dhe aeroportet, si Prishtina, Shkupi, Selaniku dhe Sofja.

Për këtë arsye, projekti është i punuar në përputhje me standardet për projektim.

Lokacionet e kyçjes për gjatë trasesë së segmentit C2 të autostradës janë projektuar dhe zgjedhur sipas kriter multidisiplinare, ku përfshihen ato teknike, mjedisore dhe sociale, duke përzgjedhur lokacione të cilat i plotësojnë kërkesat e lidhshmërisë së rrjetit dhe integritit të transportit ndërkombëtar, nacional dhe atij lokal.

Lidhjet e qytetit të Ferizajt me autostradën “Arbën Xhaferi” është e projektuar të jetë në njën e autostradës në Bibaj, në rrugën nacionale Ferizaj-Gjilan.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të rrjetit ekzistues rrugor, Ministria e Infrastrukturës ka ndarë mjete buxhetore për zgjerimin e segmentit nga dalja e qytetit, rruga nacionale N2, deri në Bibaj, i cili pritet të përfundojë gjatë vitit 2018 dhe kjo do t'i mundësojë Ferizajt një qasje më të shpejtë në autostradë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli, dëshironi pyetje shtesë?

FATON TOPALLI: Ajo që kuptova nga zoti Lekaj, mendoj që është shumë e dhimbshme. Pra, jemi investitorët të dytë të kësaj autostrade, paguajmë 360 milionë për Buxhetin e Kosovës, nuk kemi qasje dhe kjo autostradë qenka bërë për ta lidhur kryeqytetin, atëherë pse duhet të investojmë ne?

Unë nuk po dua të them këtë si kërcënim, veç duhet të llogarisni që nëse vazhdoni kështu, autostrada Ferizaj-Shkup mund të përfundojë në Ferizaj dhe të mos kalojë asnjë mjet më tutje.

Pra, është mirë që të mos luani me prodhuesit e Ferizajt, me qytetarët e Ferizajt, kyçja është shumë afër, 2,9 kilometra dhe mendoj është shumë e paarsyeshme arsyetimi që autostrada është bërë për t'i lidhur kryeqytetet, e jo për t'u shërbyer qytetarëve dhe komunave të tjera, edhe të Ferizajt.

Në fakt, nuk kam pyetje, veç jam shumë i mërzitur, shumë i shqetësuar dhe mendoj që...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zoti Lekaj e ka fjalën.

MINISTRI PAL LEKAJ: Të nderuar deputetë,

Prapë po e them se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që çdo kërkesë legjitime të qytetarëve, e sidomos të komunave dhe qyteteve në përgjithësi, do t'i qasemi me profesionalizëm, duke i ruajtur standardet e projektit, por gjithsesi, të jeni të bindur që kjo Qeveri nuk do të stërgjatët me projekte sikur që ka ndodhur deri më sot. Unë kam informacione të bollshme për kërkesat, për qasje në rrugë dhe autostrada edhe nga komuniteti i biznesit, edhe nga qytetarët, edhe nga qytetet, por unë e përmenda sa i përket projektit të mëparshëm. Të jeni të bindur që asnjë qytet nuk do të injorohet sa u përket kycjeve në autostrada, duke e ruajtur standardin, e dihet që është standard që nuk guxojmë ta prishim. Por, do të ketë zgjidhje për qytetarët e Ferizajt, edhe të gjitha qyteteve që kanë qasje në autostrada, edhe për komunitetin e bizneseve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë me ministrin e Shëndetësisë. Pacientët me leukemi akute kanë nevojë imediate për trajtimin e sëmundjes me preparatin 'Glivek', që një kohë ka mungesë të madhe në trajtimin e këtyre pacientëve. Ky preparat kushton qindra euro dhe po e dëmton shumë buxhetin familjar të pacientëve.

Çfarë po ndodh me furnizimin me këtë bar për trajtimin e pacientëve që kohët e fundit ka mungesa dhe çfarë masash janë duke u ndërmarrë që të mos prolongohet furnizimi dhe të mos ketë mungesa, sepse ky bar është shumë vital për trajtimin e pacientëve me leukemi akute? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

URAN ISMAJLI: I nderuar deputet,

Faleminderit për pyetjen!

Realisht ne jemi duke u përballur jo vetëm me mungesë të ilaçit që e cekët, por jemi duke u përballur me një mungesë të madhe të barnave, të cilat, unë si me rishikim të Buxhetit, ashtu edhe me një menaxhim më të mirë jam duke u munduar t'i trajtoj.

Barin, të cilin ju e përmendët, ka qenë në procedurë afro katër muaj dhe si i tillë ka filluar në korrik dhe ende, kur kam qenë aty, ka pasur një zvarritje tepër të madhe.

Dua të njoftoj që kontrata është nënshkruar dhe, kështu që ajo zvarritje katërmujore ka përfunduar dhe shumë shpejt besoj që do t'u përgjigjet nevojave.

Është e vërtetë atë që e thatë se barnat të cilat ne sot nuk kemi arritur t'i furnizojmë i kushtojnë xhepit të qytetarëve dhe unë jam duke bërë çmos që nga viti 2018 të kemi një sistem të menaxhimit dhe të furnizimit më të mirë se sa që e kam gjetur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdyli ka pyetje shtesë.

HAXHI AVDYLI: Pyetja ime shtesë për ministrin Ismajli: A keni plan të ndërmerrni masa që të mos vazhdohet me prolongime të tilla në sistemin e prokurimit dhe cilat janë planet tuaja që këto vonesa në furnizim të zvogëlohen minimalisht, e që pacientët tanë të mos vuajnë nga mungesa e këtyre barnave?

KRYESUESI: Zoti Ismajli e ka fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit, deputet!

Ashtu siç thashë, ky është një ndër prioritetet e mia, për arsye se krijon, ta quaj, një, e para dëmton shëndetin e qytetarëve, e dyta, xhepin e tyre direkt. Si i tillë masat e mia do të jenë: ne kemi filluar me një procedurë për revidimin e listës esenciale, e në anën tjetër, po ashtu, jemi duke i analizuar kapacitetet e brendshme që i kemi, të fillojnë procedurat më herët, të mos i lëmë procedurat në minutë të fundit, sepse ato kërkojnë një afat kohor më pastaj, kështu që ne tani kemi filluar me procedura, kemi filluar me planifikim më të hershëm, në mënyrë që të trajtojmë ato në vitin e ardhshëm buxhetor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Zoti Avdyli, e keni fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar ministër Lekaj,

Rruga për Prevallë që lidh fshatrat e rajonit të Zhupës dhe Brezovicës është një rrezik i vazhdueshëm për banorët e kësaj zone që udhëtojnë çdo ditë në këtë rrugë, si për banorët, por edhe për turistët e shumtë.

Terreni i saj malor ka rrezik të shembjes së gurëve, bllokadës së rrugës që në kohë të dimrit shkakton shumë telashe, por edhe ka rrezik për lëndime edhe të qytetarëve.

Më herët është ndarë një buxhet për fillimin e sanimit të gjendjes së kësaj rruge, por deri më tani nuk është vërejtur që ka filluar diçka.

Çfarë mase ka marrë Ministra e Infrastrukturës për fillimin e punëve të rregullimit të kësaj rruge dhe për mbrojtjen e qytetarëve nga rreziku i shembjes së gurëve?

Ministria e kaluar ka ndarë një buxhet, është planifikuar fillimi i punës, cilat janë planet tuaja për vazhdimin e këtij projekti, rregullimin e kësaj rruge, e cila ka një rëndësi vitale për qytetarët e Zhupës, por edhe për të gjithë turistët, edhe për të gjithë banorët e shumë të qm e frekuentojnë këtë rrugë për qëllime edhe turistike, por edhe qëllime të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lekaj, e keni fjalën.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar koleg deputet!

Faleminderit për pyetjen e shtruar!

Kjo rrugë ka qenë e paraparë të rehabilitohet me Buxhetin e vitit 2017. Buxheti fillestar për këtë rrugë ka qenë 250 mijë euro, për 150 metra rrugë, pas shkurtimeve buxhetore, që janë bërë në qershor të vitit 2017 nga Ministria e Financave, është reduktuar në 50 mijë euro. Sipas vlerësimeve të ekspertëve të Ministrisë së Infrastrukturës, ekziston nevoja për rehabilitim e 2.5 km, kostoja e nevojshme për rehabilitimin e këtij segmenti rrugor është shumë e lartë, e tejkalon shumë prej 5 milionë eurosh.

Ministria planifikon që me shumën e cila është në dispozicion të bëjë hartimin e projektit zbatues. Problem shtesë i rehabilitimit të këtij segmenti rrugor është se me rastin e punimeve në rrugë, rruga duhet të mbyllet në tërësi. Ministria e Infrastrukturës e ka përfunduar në tërësi rrugën Prizren-Zapllushë, me këtë rast duhet të rehabilitohet rruga nga Qafa e Kuzhninit, Struzhë, Reçan, me gjatësi rreth 4 km, e cila do të shërbente si qarkore gjatë punimeve në rrugën Prevallë. Prandaj, të jeni të bindur që ne e kemi marrë me seriozitetin më të madh që të mos stërzgjaten projektet deri më tani, që kanë qenë vetëm fikse buxhetore dhe janë nënshkruar mbi 300 projekte që nuk kanë pasur mbështetje financiare. Ne kështu e kemi gjetur, por unë nuk do të merrem me këto çështje, sepse nuk fillon ministria me mua, as nuk do të mbarojë. Ajo çka është e mirë, unë do ta vazhdoj, ajo që është diçka që nuk ka pasur buxhet, do të dal para Parlamentit dhe t'ju them që paratë nuk e di, ose të kërkoj nga ish-qeveria e t'u them ku i keni lënë këto para, kah janë, a kanë qenë fantom, a çka kanë qenë?

Mirëpo, unë çdo kërkesë legjitime do ta shqyrtoj me seriozitetin më të madh, sepse ka ardhur fundi që të mos i maltretojmë qytetarët apo komunitetet në fjalë që të pësojnë ata për mosprofesionalizmin tonë dhe që kemi bërë buxhet fikse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Jo! Faleminderit! Deputeti Fadil Beka, pyetje për ministrin Skënder Reçica. Zoti Beka! Ministri s'është këtu.

FADIL BEKA: Faleminderit, nënkryetar!

Pasi ministri nuk është ministri këtu, po e lë për seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.



TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Pyetja ime ka të bëjë me punëtorët e arsimit të viteve të '90-ta, në fakt për Ligjin për punëtorët e viteve të '90, ligj i cili ishte në agjendën e harresës së ish-Qeverisë Mustafa. Është edhe një dokument i Kuvendit i vitit 2013 i Parlamentit të Republikës së Kosovës që e ka obliguar qeverinë, por në fakt kanë kaluar 19 vjet dhe ende nuk është bërë kurrëgjë.

Unë do ta parashtroj pyetjen vazhdimisht derisa të vijë në agjendë ky ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lumir Abdixhiku, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Lumir, dëshironi ta bësh pyetjen?

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Unë në fakt e kam pyetjen për kryeministrin, kryeministri nuk është këtu, po e bëj pyetjen me shpresë që përgjigjet në seancën e ardhshme kryeministri, jo ministrat.

Pra, në mbledhjen e Qeverisë të datës 3 tetor 2017, kryeministri ka aprovuar faljen e borxheve të ambalazhuesve të ujit nëpërmjet anulimit të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ 02/2016. Ky nen parashihet strukturimin e pagesave për shfrytëzuesit e ujit në mbarë Kosovën. Kujtoj se pagesat për shfrytëzimin e ujit janë detyrime ligjore që rrjedhin nga Ligji për ujërat dhe se çdokush që shfrytëzon pasurinë ujore të Kosovës është i obliguar dhe i detyruar të paguajë taksat respektive. Sipas raportimeve të deritanishme, shuma e falur e borxheve arrin 58 milionë euro, për afërsisht aq sa shpenzojmë ne sot në shëndetësi nga paraja publike. Kjo shumë e barabartë, pra me shpenzimet tona vjetore në shëndetësi, është falur me një vendim prej 3-4 rreshtave, pa ndonjë analizë, pa ndonjë konsultim e vlerësim paraprak të mirëfilltë.

Për më tepër dhe ky bëhet rasti i çuditshëm, një numër i madh i rasteve që përfitojnë sot nga kjo amnisti ishte në proces gjyqësor pikërisht për këtë mospagesë, të tjerat veçse kishin marrë vendimin përfundimtar të drejtësisë, vendim që detyronte ambalazhuesit të ujit të paguanin taksën në fjalë. Pra, vendimi i kryeministrit është në kundërshtim të plotë me vendimet e gjyqësisë, si një rast i paprecedent në Kosovë.

Pra, një vendim i tillë përveçse është trajtim jo i barabartë dhe tërësisht i padrejtë ndaj taksapaguesve të rregullt, është edhe stimulues për shmangësit eventualë në të ardhmen, është tregues i qartë që ata që nuk paguajnë taksën në Kosovë mund t'ia dalin një ditë. Pyetja ime është: sa është shuma e saktë e falur ndaj këtyre bizneseve? Cilat biznese private me emër të bizneseve pra, kanë përfituar këto 58 milionë euro? Dhe, çfarë është motivi ekonomik i Kosovës për një amnisti të tillë? Unë pres përgjigje nga kryeministri në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Abdixhiku! Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Shqipe, dëshiron ta bësh pyetjen?

SHQIPE PANTINA: Në fakt, është e njëjta pyetje që shtroi Abdixhiku pak më parë, por shqetësimi im shkon edhe më tej, sepse një vendim i tillë është marrë në kohë fushate zgjedhore dhe nëse vazhdojmë me vendime të tilla, kjo e para, i diskriminon plotësisht bizneset e përgjithshme, të cilat i kryejnë detyrimet e tyre ndaj shtetit dhe, e dyta, është një inkurajim për bizneset e papërgjegjshme, të cilat nesër në një kohë tjetër zgjedhore, mund të bëjnë marrëveshje të tilla me kryeministrin, marrëveshje, të cilat ne nuk i dimë detajet dhe pastaj t'i dekurajojë plotësisht bizneset e ndërgjegjshme, të cilat vazhdojnë ta mbajnë gjallë ekonominë e vendit.

Shpresojmë që në seancën e radhës kryeministri do të japë detaje të hollësishme pse dhe si ka ndodhur kjo falje, kur e dimë që Ligji për faljen e borxheve ka pasur afat deri më 31 shtator të këtij viti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit! Unë pyetjen e kam bërë më datën 16 dhe po e shoh papërgjegjësinë e ministrit për të ardhur në seancë dhe për t'u përgjigjur. Pyetja ka të bëjë me sistemin paralel që zhvillohet në Republikën e Kosovës, respektivisht për planprogramet mësimore, pra të drejtpërdrejta prej Serbisë.

Desha të pyes ministrin, shpresoj që në seancën e ardhshme do të marr përgjigje nga ai, në lidhje me veprimet e tij konkrete dhe meqenëse nuk është këtu, dua të jap një sqarim të shkurtër. Sistemi paralel i arsimit në Kosovë sipas plan programeve mësimore zhvillohet në fshatrat e komunitetit goran kryesisht. Gjimnazi i këtij sistemi gjendet në fshatin Mlik, ndërsa selinë kryesore kjo strukturë paralele po e zhvillon në fshatin Branjo dhe pikërisht nga ky komunitet goran kemi pasur zëvendësministër, i cili ka qenë Ysmen Ballxhi, i cili është dashur që ta marrë këtë çështje seriozisht dhe se është dashur ta pranojë edhe Republikën e Kosovës si shtet të vetin dhe jo të zhvillojë sistem paralel, përndryshe edhe është dashur ta ushtrojë edhe ndikimin e vet. Prandaj, pres përgjigje prej tij.

KRYESUESI: Faleminderit! E keni edhe një pyetje tjetër, për të njëjtin ministër, zotin Bytyqi. Dëshironi edhe këtë ta lexoni apo dëshironi ta lini. Atëherë edhe pyetjen tjetër zoti Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Atëherë, meqenëse nuk është ministri këtu, por shpresoj që ai do ta marrë mundimin që të japë njëherësh dy përgjigje. Pyetja ka të bëjë me atë se studentët, të cilët kanë fituar në konkursin për vendosjen në konvikte janë maltretuar disa ditë me vendosjen e tyre në objektet e banimit studentor. Nga keqmenaxhimi i vendosjes së studentëve nëpër konvikte ata kanë qenë të detyruar të flenë jashtë për të pritur rendin e tyre herët në mëngjes.

Në fakt, unë doja ta pyesja ministrin a është në dijeni për këtë dhe se sot konvikti, pra, është marrë si çështje jobarazie e studentëve, ku studentët të cilët nuk kanë mundësi ekonomike banojnë nëpër konvikte, ndërsa do të duhej të ishte krejtësisht ndryshe, ku studentët, pra nëpër konvikte do të duhej ta kishin një jetë më të rregullt dhe se konvikti do të duhej të përfaqësonte këtë identitetin dhe dinjitetin studentor, dhe meqenëse po ndodhin këto për shkak të institucioneve, edhe dinjiteti i studentëve është nëpërkëmbur, sepse këto institucione po veprojnë kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

DRITA MILLAKU: Faleminderit! Meqenëse kolegja ime më herët e ngriti edhe si deklaram jashtë rendit të ditës, mirëpo ne ende nuk kemi arritur të marrim një sqarim konkret prej ministrit, atëherë unë dëshiroj t'i bëj pyetjen, e njëjta pyetje është: para disa ditëve në QKUK kanë humbur jetën tre persona, tre pacientë si pasojë e mosfunksionimit të oksigjenit.

Si ministër, a keni formuar komision, i cili do të duhej të merret me këtë rast, sepse situata është shumë e rëndë, domethënë gjendja është mjaft e rëndë, rreziku është ende permanent dhe kush do të duhej të marrë përgjegjësinë për vdekjen e këtyre personave?

KRYESUESI: Zoti Ismajli, e keni fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit, zonjë!

Së pari, një korrigjim të vogël, nuk është çështja me oksigjen, ka pas me oksidul, është një gaz tjetër medicinal. Një korrigjim të dytë, gjendja realisht është sanuar dhe unë kam dhënë disa përgjigje konkrete, por do ta jap edhe një para juve si deputetë.

Ne kemi pasur disa procese paralele që kanë ndodhur, procesi i parë ka pasur të bëjë me QKUK-në, i cili ka bërë komisione të veçanta për ta hulumtuar çështjen. Prosesi i dytë, i cili ka ndodhur nën autorizim timin, ka pasur të bëjë me Inspektoratin e shëndetësisë dhe Inspektoratin farmaceutik, ku ne kemi dalë në vend dhe puna e parë është bërë në nivel të kryeinspektorëve. Domethënë, e kemi ngritur në nivelin më të lartë që ministria ka pasur në dispozicion, është gjetur ose ka pasur dyshime se një gaz i caktuar ka mundur të shkaktojë. Ajo çfarë inspektorët kanë bërë është që përpos hulumtimit të raporteve, kanë dalë në terren, kanë arritur të zbulojnë një operator ekonomik, i cili nuk ka pasur licencë të prodhojë, ka pasur licencë për import, por nuk ka pasur licencë të prodhojë dhe kanë thirrur policinë duke e lajmëruar rastin si një mundësi të veprës penale.

Natyrisht, rasti ka qenë shumë i rëndë, kemi pasur humbje të jetëve të njerëzve, rasti po ashtu përpos dhimbjes njerëzore, ka shkakuar një dhimbje tjetër: humbjen e besimit të sistemi jonë shëndetësor. duke krijuar edhe gjendje më të rëndë në shëndetësi. Tani për tani kjo gjendje është

sanuar, janë lidhur kontrata me operatorë, të cilët kanë licencë, realisht është shkëputur kontrata me të gjithë ata, të cilët nuk kanë pasur licencë, është lidhur kontrata me ata që kanë pasur licencë.

I gjithë materiali është dorëzuar në Prokurori, i gjithë materiali i protokolluar me raporte është dërguar prapë në Prokurori, gazi i cili ka qenë i dyshuar, me urdhër të policisë dhe Prokurorisë po ashtu është dërguar në polici, në dhoma të veçanta për t'u mbajtur si i tillë. Domethënë, çfarëdo që kemi pasur në dispozicion ua kemi dorëzuar institucioneve të rendit dhe ligjit. Unë falënderoj shumë inspektoratin, për arsye se ka dalë jashtë leximit të raporteve, ka dalë në terren, ka kërkuar informata shtesë, ka kërkuar fakte shtesë dhe nga ai kërkim kemi arritur të zbulojmë se nuk ka pasur licencë dhe se një operator ekonomik i ka thyer ligjet duke tentuar të prodhojë gaz në Kosovë.

Prandaj, mund të themi që kemi pasur një varg të reagimeve të institucioneve dhe si të tilla ne presim një përgjigje nga prokuroria. Atë që ministria e ka bërë, domethënë që unë si ministër e kam bërë, e kam ngritur si në nivel institucional, ashtu publikisht kam dalë të flas për këtë, duke mos lënë të zvarritet rasti apo të krijohet ndonjë keqkuptim ose mundësi reagimi dhe besoj se...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Vazhdo, është në interes publik, mendoj që duhet ta sqarosh krejt.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Besoj se janë arritur të gjitha masat për një kohë të shkurtër. Unë nuk dua të flas për atë se kur ka ndodhur, unë flas vetëm për kohën kur kam qenë ministër dhe masat në dispozicion, të cilat unë kam mundur me autoritet institucional t'i marr.

Tani jemi në gjendje ku pos dorëzimit të dëshmive, jemi duke pritur nga Prokuroria e Shtetit se çfarë masa do të marrë. Në momentin e parë që unë kam ndonjë vendim të Prokurorisë, natyrisht që do ta bëj publike, mirëpo për momentin kjo është ajo që mund të them se është bërë dhe mendoj se ka qenë një reagim i shpejtë. Fatkeqësisht, nuk kemi mundur të shpëtojmë jetë, mirëpo atë çka mund të bëjmë është të sigurojmë një kualitet që raste të tilla të mos ndodhin prapë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Millaku?

DRITA MILLAKU: Po, pyetja ime shtesë është pse nuk keni kërkuar të bëhet obduksioni për këta persona dhe është fakt që është gjendja shumë alarmante. Ju thatë që është stagnuar, domethënë është ndërprerë, mirëpo unë po them, zoti ministër, gjendja nuk është stopuar. Pas disa javësh e kemi pasur edhe një rast vdekjeje në Prizren. Domethënë nuk është stopuar, mirëpo çka mund të ndërmerret pos që vetëm e keni ngritur çështjen në Prokurori dhe në hetuesi. Çka mund të bëni tjetër konkretisht që të mos përsëriten situata të tjera?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI URAN ISMAJLI: Zonjë, po më vjen keq, por informatat nuk i ke të sakta dhe më lejo... po tani unë po të dëgjoj dhe t'u kisha lutur të më dëgjosh.

E para, gjendja është stabilizuar për faktin se gazi i cili është përdorur është zëvendësuar me gaz të licencuar. E dyta, vdekja ka ndodhur për shkak të intervenimit në atë kohë, domethënë ka pasur komplikime dhe ka vdekur. Nuk ka ndodhur vdekja me një operacion të ri, domethënë vdekja ka ndodhur me operacion, i cili ka ngjarë në kohën e intervenimit. Ta përfundoj, më fal, të lutem, unë jam këtu për t'u përgjigjur dhe të përgjigjem. Unë e kam marrë shumë seriozisht, zonjë, kam folur publikisht shumë herë për këtë çështje, edhe 15 herë po të më bëni pyetje, do të dal prapë të flas, më lejo veç ta përfundoj.

E treta, obduksioni nuk është bërë në fillim, ngase kur kemi shkuar, domethënë po flas për procedura para se të jem unë ministër, por të cilat po i shpjegoj. Kur kam shkuar atje, kam kërkuar të njëjtën pyetje: pse nuk është bërë obduksioni? Familjarët nuk kanë lejuar që të bëhet obduksioni, për njërin ka pasur nënshkrim, për tjetrën ka pasur vendim verbal. Në momentin kur ne e kemi ngritur si çështje, Prokuroria ka filluar ta bëjë atë procedurë, s'kemi pasur ne nevojë të kërkojmë, sepse Prokuroria ka kërkuar ta bëjë. Domethënë, e para ka qenë një proces, i cili është mbyllur para se të jem unë ministër, e dyta, obduksioni ka filluar në momentin kur Prokuroria e ka marrë në dorë. Domethënë, ka qenë çështje e 1-2 ditëve, prandaj unë s'kam pasur autoritet t'i kërkoj Prokurorisë ta bëjë obduksionin kur ata veç e kanë marrë vendimin për obduksionin. Faleminderit!

Dëgjo, unë po ju përgjigjem drejt. Prokuroria ka kërkuar dhe është marrë prej tyre të bëhet obduksioni, ne si ministri kemi kërkuar të bëhen analizat e obduksionit, kemi kërkuar të bëhen analizat jashtë vendit. Obduksionin dhe gazin, të dyja i ka marrë përsipër Prokuroria dhe Policia e Kosovës, e kanë marrë gazin dhe kanë filluar procedurat e obduksionit. Domethënë, të dy gjërat janë bërë prej tyre si institucione. Ne si ministri nuk kemi të drejtë të futemi në një procedurë, e cila ka të bëjë me Prokurorinë, sepse unë konsiderohem që mund të bëj ndërhyrje në sistem të drejtësisë. Ata na kanë kërkuar që të jemi sa më konfidencial në këtë proces, kanë kërkuar prej neve që raportet që i kemi dorëzuar, t'i dorëzojmë të gjitha te ta, i kemi protokolluar, i kemi dorëzuar të gjitha, duke u mundësuar atyre qasjen në të gjitha dokumentet dhe në të gjitha çka dimë ne.

Tani, çështja se ku mbetet procesi dhe besoj që ajo është me rëndësi, është që ne të presim një përgjigje nga Prokuroria, të dimë saktë ku kanë mbërritur. Në qoftë se ka diskrepancë në mes të fakteve të propozuara ose të dhënave nga ministria, fakteve të dhëna nga QKUK-ja dhe rezultateve të dala nga Prokuroria, atëherë ne jemi këtu për t'i ngritur bashkarish, ose unë si

ministër, ose ju si deputetë, t'i ngremë bashkërisht pse ky fakt nuk është hulumtuar, pse kjo analizë nuk është bërë, pse obduksioni nuk është bërë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: A do ta vazhdosh? E keni edhe një pyetje tjetër për ministrin Pal Lekaj, zonja Millaku.

DRITA MILLAKU: Pyetja është për ministrin e Transportit, Pal Lekaj. Duke filluar ndërtimi i autostradës Vërmicë - Merdar ministri i atëhershëm ka dhënë garanci se nuk do të mbetet pronë private pa rrugë, aty ku ka mundësi për rrugë do të ndodh dhe aty ku nuk ka mundësi, do të ndodhë shpronësimi. Për fat të keq, në fshatin Vërmicë të Prizrenit, janë në pyetje afër 20 hektarë të ankesuara apo të bllokuara që nuk kanë qasje në rrugë dhe as nuk janë përfshirë as në procedurën e shpronësimit.

Çka do të ndërmerrni për këtë rast, zoti ministër?

KRYESUESI: Zoti Lekaj, e keni fjalën!

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar deputete, Faleminderit për pyetjen, është një shqetësim edhe i Ministrisë së Infrastrukturës dhe i bashkëpunëtorëve të mi që këtë kërkesë të qytetarëve të atij komuniteti ta shqyrtojmë me seriozitet dhe të marrim veprime konkrete.

Është e vërtetë që autostrada për Shqipëri është sistem i mbyllur që duhet të ketë kritere të caktuara, mirëpo fatkeqësisht nuk kam gjetur ndonjë kriter, kanë ndryshuar kriteret disa herë, çdo ministër që ka ardhur, ka sjellë Udhëzim administrativ që e ka ndryshuar këtë kriter sa u përket qasjeve në autostradë. Prandaj, të jeni të bindur, unë do t'i qasem dhe do të ketë zgjidhje, por jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse është rrezik për qytetarët dhe ne nuk guxojmë të bëjmë një të mirë për një komunitet dhe të rrezikojmë tërë projektin, por të jeni të bindur që shumë shpejt do të bëjmë zgjidhje për ata qytetarë të Vërmicës. Sepse, e meritojnë dhe ne në këtë drejtim do të bëjmë më të mirën të mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Millaku?

DRITA MILLAKU: Derisa është aty ministri, kështu pyetja tjetër shtesë është: kur e keni planifikuar dhe a keni ndarë buxhet të veçantë për këtë? Sepse ai komunitet, ato familje nuk po kërkojnë dalje drejtpërdrejt në autostradë, mirëpo po kërkojnë një dalje nëpërmjet nënkallimit apo mbikalimit.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI PAL LEKAJ: Sa i përket shpronësimit dhe Buxhetit, ju e dini që me standarde 3 deri 5 metra janë bërë të gjitha shpronësimet përgjatë autostradës dhe duhet një buxhet shtesë për rregullimin të nënkalimit apo të një qasje tjetër rrugore që kushton dhe ne do të bëjmë vijë buxhetore të veçantë për atë pjesë, për t'i kyçur ata qytetarë. Do të thotë, për infrastrukturë rrugore, qoftë ai nënkalim, çfarë do të bëhet fizibiliteti dhe do të jetë projekti zbatues në pyetje që ne do ta mbështesim me vija buxhetore, jo vetëm të flasim, në vitin 2018 do të përfundojë kjo histori e atyre kërkesave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lekaj! Me kaq edhe kjo pikë e rendit të ditës është kryer. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje deri në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

Faleminderit! Lus deputetët që janë jashtë sallës që të hyjnë në sallë.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Pyes deputetët nëse kanë vërejtje në procesverbalet nga seancat e mbajtura më 10 shtator e 2 tetor 2017, më 3 tetor dhe më 3 e 4 tetor 2017.

Nuk ka të paraqitur për vërejtje. Nëse nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 10 shtator e 2 tetor 2017, më 3 tetor dhe më 3 e 4 tetor 2017. Faleminderit!

Sasha, nuk është këtu, a? Kryetari i Grupit Parlamentar të Listës serbe, gde je Saša? Nije, nema ga!

Atëherë, e kemi pikën e katërt:

### **4. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve**

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2017, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtar të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve.

I ftoj kryetarët a përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtar të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve.

Unë i kam realisht grupet parlamentare, përjashtuar Grupin Parlamentar të Listës serbe, që i kanë dorëzuar. Po, zonja Jelena Bontiq e ka propozimin për Grupin Parlamentar. Zonja Bontiq, e keni fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Mi za člana Nezavisne komisije za medije imenujemo Jasminu Živković.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, për të mos i propozuar edhe një herë nga vendi, po i lexoj propozimet e grupeve parlamentare dhe pastaj po i votojmë menjëherë. Votimi është i thjeshtë.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i ka propozuar 3 anëtarë: Shqipe Pantina, kryetare; Adem Mikullovc, anëtar; Fisnik Ismaili, anëtar.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës propozon dy deputetë për anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie: Lirie Kajtazi, anëtare, dhe Imet Rrahmani, anëtar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës propozon dy deputetë për zëvendëskryetar të parë dhe një deputet për anëtar të komisionit: Nait Hasani, zëvendëskryetar, dhe Xhevahire Izmaku, anëtare.

Grupi Parlamentar i Listës serbe e propozon për zëvendëskryetar të dytë të komisionit zonjën Jasmina Zhivković.

Grupi Parlamentar i AAK-së e propozon një deputet anëtar të komisionit, zotin Rasim Selmanaj.

Grupi Parlamentar i “Nisma për Kosovën” e propozon deputetin Milaim Zeka për anëtar të komisionit.

Grupi Parlamentar “6+” e propozon deputetin për anëtar të komisionit, zotin Albert Kinolli.

Besoj që, meqenëse janë vendime të grupeve parlamentare, nuk ka nevojë që të diskutohet për këtë punë. Atëherë, procedojmë me votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë janë 90 deputetë. Votojmë tani!

Faleminderit, kanë votuar 74 deputetë. Për janë 72 deputetë, kundër është një dhe një abstenim.



Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie. Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve që të veprojë në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Atëherë, tani po hyjmë në pikën e pestë të rendit të ditës, që është pika më e rëndësishme e seancës së sotme, është

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017**

Komisioni Funkcional, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Procedimi i mëtejshëm vazhdon si në vijim:

E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Hamza, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, kryesues i seancës, zoti Haliti, Të nderuar ministra, Shumë të respektuar deputetë, Ndihem i nderuar që sot para juve kam mundësi të paraqes plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës me marrjen e mandatit është ballafaquar me mungesë në alokime në shumë programe dhe linja buxhetore, të cilat e kanë bërë të domosdoshëm procesin e rishikimit të Buxhetit të vitit 2017. Lartësia e këtyre kërkesave dhe kufizimeve në legjislacionin bazë e kanë bërë të pamundshëm adresimin e nevojave nëpërmjet nenit 16 të Ligjit të Buxhetit nr. 05/L-125, i cili lejon ndryshimin e rialokimeve deri në 5% të totalit të Buxhetit.

Ministria e Financave është përcaktuar që konform programit të Qeverisë ta nisë këtë proces duke marrë për bazë trendin real të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore. Ne jemi nisur nga parimi se proceset buxhetore duhet të bazohen vetëm në vlerësime reale për të siguruar mbarëvajtjen e stabilitetit makro-fiskal. Ne besojmë se do të kemi realizim të mirë të planit në arkëtimin e të hyrave buxhetore me përjashtim të disa kategorive, të cilat nuk do të kenë efekt sinjifikant edhe në deficitin primar, edhe në deficitin e përgjithshëm, edhe në bilancin bankar.

Përndryshe, sa u përket agjencive që merren kryesisht me grumbullimin e të hyrave, në këtë rast Dogana e Kosovës, presim që ta plotësojë planin e të hyrave; Administrata Tatimore e Kosovës

ndoshta me ndonjë ngecje, por do të jetë shumë afër planit; ndërsa disa të hyra që nuk kanë ndonjë ndikim shumë të madh në pozicionet që i përmenda, siç është dividenda prej PTK-së, nuk presim që të vijë këtë vit. Prandaj, rishikimi është përqendruar vetëm në anën e shpenzimeve buxhetore.

Duke u bazuar në një proces realist të rishikimit, e kemi reviduar vlerën totale të shpenzimeve në 1 miliard e 810 milionë, nga vlera origjinale prej 2 miliardë. Ndërsa, të hyrat buxhetore planifikohen në 1 miliard e 725 milionë euro. Shkurtimin e shpenzimeve e kemi ndërmarrë duke u bazuar në probabilitetin shumë të ulët të votimit në Kuvend dhe shpalljes së Ligjit për AKP në Gazetën Zyrtare brenda këtij viti fiskal, mjete të cilat nuk do të arrijnë në kohë për të përmbushur nevojat për të respektuar obligimet kontraktuale.

Po ashtu, duke u bazuar në nivelin e përgatitjes në të cilën gjenden projektet e klauzolës investive, duke pasur parasysh që kontigjenca prej 78,8 milionë euro nuk ka pasur asnjë indikacion për shpenzim real këtë vit, me të njëjtin princip ne u jemi qasur edhe projekteve tjera madhore, për të cilat parapërgatitja teknike ka munguar, apo ka qenë e vonuar në vitin 2017 edhe për shkak të rrethanave objektive, pasi vendi ka shkuar në zgjedhje të parakohshme.

Rishikimi realist na ka mundësuar që deficitin e përgjithshëm buxhetor ta ulim nga 300 milionë euro në 109 milionë euro, pra për 64%. Në të njëjtën kohë, sipas rregullës fiskale, deficitin e kemi ulur nga 97 milionë në 96 milionë euro.

Rishikimin e Buxhetit kemi arritur që ta diskutojmë dhe jemi dakorduar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, duke e ruajtur një deficit të shëndoshë buxhetor. Bilanci bankar në fund të vitit me këtë rishikim të Buxhetit planifikohet të jetë në nivel adekuat, apo thënë në terma konkretë rreth 4,5% të bruto-produktit vendor, respektivisht rreth 280 milionë neto. Në rishikim jemi kujdesur që kredibiliteti buxhetor dhe ai shtetëror të ruhen konform obligimeve ligjore dhe kontraktuale.

Andaj, rishikimi i Buxhetit adreson, ndër të tjera: sigurimin e fondeve të mjaftueshme për kategoritë e luftës sipas legjislacionit në fuqi në shumën prej 26 milionë euro; pagesat e detyrimeve në kohë për autostradën “Arbër Xhaferi” në shumën prej 50 milionë euro; sigurimin e fondeve për organizimin e zgjedhjeve lokale në shumën prej rreth 2 milionë euro; pagesën e detyrimeve financiare nga vendimet e prera të gjykatave në shumën prej rreth 5,6 milionë; mbulesën financiare për obligimet ligjore ndaj Radiotelevizionit të Kosovës në shumën prej 1,4 milion; mbështetjen financiare për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe për mungesat në financim brenda misionëve tona diplomatike, si dhe një numër të madh të rialokimit të nevojshëm për funksionimin adekuat të institucioneve tona, të cilat kapin shumën prej 5,4 milionë euro. Në total, vlera e kërkesave për financim shtesë e kalon shumën prej 90 milionë euro.

Riorientimi i këtyre mjeteve siguron financim adekuat të projekteve dhe implementim të politikave shtetërore, që synojnë zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Neni 25 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë na detyron që rishikimi i buxheteve të jetë neutral, që nënkupton se të gjitha shpenzimet shtesë duhet të bazohen në kursime ekuivalente. Në kohë të shpejtë kemi zhvilluar një proces produktiv të konsultimeve me organizatat buxhetore, niveli qendror dhe lokal, për çka dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata shërbyes civilë që kanë qenë të përfshirë në procesin e rishikimit. Dhe, kemi arritur që nevojat për financim shtesë t'i mbulojmë me kursime nga ato programe buxhetore, ku nuk ka pasur gjasa të realizimit.

Të gjitha kursimet janë rezultat i mirëkuptimit të seriozitetit të situatës nga e gjithë Qeveria, e jo shkurtime të imponuara. Kemi arritur që në krahasim me buxhetin origjinal të zbresim edhe me tutje disbalancin ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve, duke e ulur deficitin dhe duke dërguar mesazh të qartë të përkushtimit tonë për menaxhim të disiplinuar të financave publike.

Në anën tjetër, këtij rishikimi, përveç adresimit të mungesave në financim, ne po mundësojmë edhe një numër të madh harmonizimesh brenda organizatave buxhetore nëpërmjet rialokimeve që sigurojnë një ekzekutim më efikas të Buxhetit dhe funksionim më adekuat të institucioneve.

Të nderuar deputetë,

Po ashtu, më duhet të theksoj se në Buxhetin origjinal e kemi një vlerë mjaft domethënëse, por plotësisht të paspecifikuar të pranimeve nga financimi prej fondeve të AKP-së dhe huamarrjes së jashtme. Me këtë rishikim ne do ta pasqyrojmë vetëm situatën reale për këtë fundvit. Ne po bëjmë përgatitje që vitin e ardhshëm të kemi integritet të saktë të këtyre projekteve brenda buxhetit të rregullt.

Sot, para jush është Projektligji i rishikimit së bashku me propozim-ndryshimet që duhet të aprovohen dhe në të njëjtën kohë ju siguroj se të gjitha nevojat për harmonizime të brendshme të mëtutjeshme do të jemi në gjendje t'i akomodojmë pas plotësimit të kushteve ligjore, sipas nenit 16 të Ligjit të Buxhetit që mundëson rialokimin brenda vlerës prej 5% të ndarjeve të përgjithshme buxhetore.

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj t'i jap edhe disa sqarime që janë ngrehur, edhe në publik, edhe nëpër medie. Buxheti i Republikës së Kosovës funksionon në atë mënyrë ku destinacioni i shpenzimit, shpenzimi nuk lidhet me burimin e të hyrave. Është ngritur çështja që po hiqen sigurimet shëndetësore për t'i bërë pagesat ndaj veteranëve të luftës. Pagesat ndaj veteranëve të luftës, një kategori që ka dhënë shumë për këtë vend, janë obligim ligjor. Ligji bazik na obligon që deri në momentin e

rikategorizimit ne ta bëjmë buxhetimin sipas ligjit bazik dhe ne jemi të obliguar ligjërisht që të sigurojmë mjete të mjaftueshme për pagesën e kësaj kategorie.

Përveç lartësisë së mjeteve, e cila ka qenë problem, e që është siguruar, problem edhe më i madh për pagesën e kësaj kategorie ka qenë neni 24 i Buxhetit, i cili kufirin e pensioneve të veteranëve dhe invalidëve të luftës e kufizon në 38 milionë, përkatësisht në 12 milionë. Edhe nëse abstraktojmë lartësinë e mjeteve të cilat kanë munguar në Buxhetin e Kosovës, ky ligj i ka pamundësuar pagesat deri në momentin e plotësim-ndryshimit të Ligjit të Buxhetit. E, plotësim-ndryshimi i Ligjit të Buxhetit është kompetencë dhe ka mundësi që ta bëjë vetëm Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Sa u përket sigurimeve shëndetësore, këtu e kam një vendim të datës 30. 6. 2017, i marrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, vendim që në pikën 2 të tij thotë: “Ndryshimi nga pika 1 e këtij vendimi ka të bëjë me fillimin e mbledhjes së premieeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm për të gjithë qytetarët banorë të Republikës së Kosovës, të përcaktuar me vendimin e Qeverisë nr. 14/122, datë 23 dhjetor 2016”. Kështu që nga data 1 korrik 2017 ndryshohet si në vijim: “Shtyhet deri në aprovimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor, si dhe akteve tjera që derivojnë nga ky ligj.

Do të thotë, kërkohet që të bëhet plotësim-ndryshimi i këtij ligji dhe plotësim-ndryshimi i këtij ligji nuk ka ndodhur. Është i paraparë tek në Strategjinë Legjislative, 2018. Përveç kësaj, janë të parapara edhe një numër i madh i akteve nënligjore dhe kushteve që të fillojnë sigurimet shëndetësore. Asnjë prej tyre nuk është plotësuar, as nuk janë pajisur njerëzit me kartela, as nuk janë bërë aktet nënligjore, as nuk është caktuar çmimi për shërbime, as nuk ka mundësi të fillojnë pa u krijuar parakushtet.

Edhe një çështje tjetër: Thonë se të gjitha kushtet janë plotësuar. Edhe po qe se janë plotësuar të gjitha kushtet, duhet të shpjegohet qartë dhe në mënyrë profesionale që premiumet shëndetësore nënkuptojnë 3,5% ngarkesë për punëdhënësin dhe 3,5% ngarkesë për të punësuarin. Edhe në supozimin që sot të fillojë implementimi i sigurimeve shëndetësore, prapëseprapë Buxhetit të Republikës së Kosovës për këtë vit nuk mund t’i kushtojnë më shumë se 3 milionë. Nuk mund të kushtojnë më shumë se 3 milionë! Prandaj, është e padrejtë, është për konsum politik dhe mediatic, është joprofesionale të bëhet përpjekje të sqarohet se u morën mjetet nga sigurimet shëndetësore për pagesën e kategorive të dala nga lufta.

Pagesën për kategoritë e dala nga lufta e kemi obligim ligjor dhe duhet përmbushur këtë obligim ligjor. Sa u përket sigurimeve shëndetësore, në momentin kur të krijohen parakushtet ligjore, sigurisht se ne do t’i reflektojmë ato në Buxhet. Mirëpo, nuk do të derdhim mjete pa u krijuar parakushtet ligjore, pa u bërë plotësim-ndryshimi i ligjit, pa u kryer aktet nënligjore, pa u caktuar çmimet e shërbimeve dhe pa u pajisur personat me kartela.

Një çështje tjetër, që gjithashtu është debatuar, është debatuar rruga apo autostrada për Gjilan. Ky projekt ka kaluar në një fazë tjetër. Ka kaluar te organet që janë jashtë ndikimit të Qeverisë. Ne nuk paragjykojmë se si do të jetë fundi i këtij procesi, është çështje e organeve tjera. Mirëpo, ne ju sigurojmë dhe garantojmë, sepse me Buxhet të rregullt kanë qenë të parapara 1 milion e 850 mijë. Në çdo moment, pasi ligji na mundëson dhe na lejon, jo 1 milion e 850 mijë por 2 milionë e 850 mijë jemi në gjendje t'i sigurojmë për këtë projekt, por ai projekt ende nuk ka filluar. I dimë problemet me atë projekt, e dimë se është nisur pa projekt detaj, e dimë që është nisur pa studim të fizibilitetit, e dimë që është nisur pa elaborat të shpronësimit dhe e dimë se është segmentuar në 8 segmente.

Te klauzola e investimeve, ju lutem, shikojeni Buxhetin origjinal! Janë 78 milionë kontigjencë në Ministrinë e Financave. As nuk ka emër të projektit, as nuk ka kod të projektit, as nuk ka vlerë paralogaritare të asnjë projekti, as nuk e di kurrkush kur fillon dhe kur mbaron. Ne mund t'i lëmë në Buxhet. Asnjë ndikim nuk ma bëjnë krejt çka ndikon, ndikon se në fund të vitit del që në raport me Buxhetin e planifikuar, Buxheti është ekzekutuar në masën kaq. Përndryshe, asnjë procedurë, as s'ka mundur, as s'mund të nisë, sepse nuk ceket se cili është burimi i financimit. A është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, a është Banka Botërore, a është ndonjë marrëveshje bilaterale?

Prandaj, kanë qenë shuma të cilat kanë qenë të vendosura, nuk kanë mundur për një arsye apo një tjetër, nuk kam qëllim këtu kurrkënd ta fajësoj, as kurrgjë, por kam nevojë ta sqaroj për ju, deputetë të nderuar, kam nevojë ta sqaroj për publikun, se ndërhyrjet kanë ndodhur kryesisht në dy pozicione. Mjetet nga AKP-ja, Ligji nuk është aprovuar, pa ligj nuk mund t'i marrim dhe nuk mund t'i lëmë obligimet kontraktuale, posaçërisht ndaj projektit më të madh në Buxhetin e Kosovës, siç është autostrada në drejtim të Shkupit, për punë të ekzekutuara. Nëse ne s'i paguajmë obligimet, atëherë përballemi me ligjin. Ne është dashur ta bëjmë një veprim të tillë.

Pse ka pasur dilema se do të realizohet Buxheti qysh është planifikuar, tregon edhe vendimi tjetër i Qeverisë, është i datës 2. 8.2017, që thotë: "Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për autorizimin e reduktimit të fondeve të alokuara sipas tabelave të bashkëngjitura". Nëse ka pasur siguri dhe garanci që do të vijnë mjetet e AKP-së, pse u ndërmor ky veprim? Me të drejtë është ndërmarrë, për të mos mbetur obligimet kontraktuale të pakryera, kryesisht ndaj projektit të autostradës.

Prandaj, duke pasur për bazë këto rrethana të krijuara, duke pasur për bazë që ne t'i kryejmë obligimet tona ligjore, nuk po hyj në atë nëse janë a nuk janë të mira, por janë obligime ligjore, të cilat ne jemi të detyruar t'i kryejmë. Po qe se nuk i kryejmë, do të përballemi me pasoja më të mëdha, edhe ndaj kategorisë së veteranëve, edhe ndaj RTK-së, edhe ndaj autostradës "Arbër Xhaferi". Ne si Ministri e Financave pas një jave, pas dhjetë ditësh kalendarike, kemi arritur ta

bëjmë rishikimin, sigurisht se ka pasur nevojë edhe më tepër, por për shkak të kohës së shkurtër, e kemi përgatitur për një kohë shumë të shkurtër, i kemi adresuar nevojat emergjente.

Sot jemi para jush këtu, deputetë të nderuar, unë pas diskutimeve, me kujdesin më të madh do t'i përcjell, do t'i marr evidencat dhe ndërmjet dy leximeve në komisionet funksionale të Kuvendit do t'i reflektojmë të gjitha nevojat e domosdoshme. Ndërsa për informatën Tuaj, ne kemi obligim ligjore që deri më 31 tetor, do të thotë deri ditën e martë, në Kabinetin qeveritar ta aprovojmë Buxhetin e vitit 2018 dhe të njëjtin ta procedojmë në Kuvend.

Edhe sqarimin e fundit, autostradën e Gjilanit po e kalojmë në një financim të qëndrueshëm. Prej vitit të ardhshëm, për pesë herë, për pesëfish, do të rritet shuma nga Buxheti i Kosovës. Në vitin 2018, nëse i referohemi Buxhetit origjinal të vitit 2017, për këtë projekt kanë qenë të parapara 2 miliardë e 100 mijë nga Buxheti, dhe pjesa tjetër prej AKP-së, ndërsa unë sot para jush po deklaroj se shuma prej 2 milionëve do të rritet, të paktën, për pesëfish.

Prandaj, nuk kemi hequr projekte, nuk do të heqim projekte, por do të bëjmë përpjekje që brenda mundësive reale buxhetore, duke i ruajtur gjithmonë top-prioritetet, ua kam thënë edhe kolegëve të mi ministra, po e përsëris edhe këtu në Kuvend, është ruajtja e stabilitetit makro-fiskal. Ne si vend kemi nevoja, ne si vend kemi nevoja për më shumë para, mirëpo ne do t'i akomodojmë nevojat tona brenda mundësive tona. Prandaj, unë ju lus që pas diskutimeve, pas kontributit tuaj, të njëjtin ta votoni dhe të procedojmë pastaj në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zoti Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17 tetor 2017, Komisioni e ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Pas diskutimeve në komision, vërejtjeve dhe komenteve, komisioni vlerësoi se projektligji përmbush kushtet e parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe me shumicë votash, saktësisht 5 vota për, 3 kundër, një abstenim, pra me votat e opozitës kundër, u miratua. Kështu që komisioni i rekomandon Kuvendit për miratim në parim ligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje", kush do të flasë? Zoti Molliqaj, urdhëro!

DARDAN MOLLIQAJ: Të nderuar deputetë,  
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Ligji për rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës ka ardhur me vonesë, besoj edhe për shkak të zhvillimeve politike, si ato të zgjedhjeve dhe krijimit të institucioneve.

Mbi të gjitha, ky ligj është shumë i mangët për një arsye shumë të rëndësishme, sipas nesh. Nëse e vëreni ligjin që na ka ardhur, ai është më shumë një draft-ligj, i cili i ngjan një kontabilisti, i cili i ka renditur disa shifra dhe i ka hequr disa tjera. Pra, për mendim tim, mungon pjesa më e rëndësishme të Buxheti, e ajo është pjesa makroekonomike, ose pjesa e cila shpjegon se çfarë efekte ekonomike drejtpërdrejt do të ketë ky Buxhet.

Nëse ministri dhe Qeveria e Republikës së Kosovës e trajtojnë Buxhetin vetëm si çështje e ndarjes së shumave të projekteve të caktuara dhe nuk flasin aspak për efektin ekonomik që do të ketë, atëherë kjo paraqet një problem shumë të madh për shkak se krejt çka bën ministri është një kontabilist që nganjëherë edhe mund të jetë i dobët.

Ajo që shihet në këtë projektligj është që e tëra çka ka bërë Qeveria e ka përshtatur Buxhetin duke i lëvizur vetëm shpenzimet.

Prej krejt çka kam parë unë deri më tani është që është i vetmi projekt i rishikimit të Buxhetit, i cili është bazuar vetëm në lëvizjen e shpenzimeve, por jo edhe në të hyra.

Pra, kjo qasje është komplet joserioze dhe si rezultat i kësaj përshtatjeje të shpenzimeve, siç e dini, Buxheti i Republikës së Kosovës nuk është më 2 miliardë euro dhe këtu është shumë interesant çfarë ka ndodhur, se e kemi PDK-në, e cila ka qenë pjesë e dy qeverive, pra edhe e Qeverisë me LDK-në, edhe Qeverisë sot, që është prapë me AAK-në dhe të tjerët.

Dhe, i njëjti subjekt politik njëherë ka thënë që Buxheti i Kosovës është 2 miliardë euro dhe i njëjti subjekt politik sot thotë Buxheti i Kosovës nuk është 2 miliardë euro. Pra, kjo është e vërteta. Nuk e di tash a e kanë pasur gabim atëherë, apo e kanë gabim tash. Është mirë të vendoset se cila është e vërteta.

Kjo i tregon dy gjëra: Kur është bërë Buxheti dhe është paraparë vetëm në këtë aspekt atëherë tregon që, e para, Qeveria e kaluar ka qenë shumë e fiksuar te ky 2 miliardësh, dhe nuk ka qenë e argumentuar qysh do të mbërrijë te ky 2 miliardësh dhe në të njëjtën kohë te Qeveria e tashme, e cila është bërë joserioze duke e llogaritur dhe rishikuar Buxhetin vetëm në bazë të shpenzimeve.

Problemi tjetër është që nuk kam parë ndonjëherë që në çdo rishikim që ka ndodhur i Buxhetit të Republikës së Kosovës, të parashihen qind për qind të hyrat sikur në ligjin bazë.

Pra, kjo Qeveri që është sot këtu, e që po e sjell rishikimin e Buxhetit, po thotë që të hyrat do të jenë qenë qind për qind ashtu siç edhe kanë qenë.

Dëmi më i madh që është bërë është që në këtë rishikim dëmi është bërë te investimet kapitale. Pra, krejt lëvizjet që kanë ndodhur në rishikimin e Buxhetit janë në kurriz të investimeve kapitale. Pra, prapë e kemi një dëmtim të potencialit ekonomik në Kosovë.

Ministër, nuk është e vërtetë që nuk është hequr autostrada për Gjilanin. Ti e di këtë, sepse autostrada për Gjilanin është dashur të fillojë në vitin 2017. Ti mund të thuash që unë e kam futur në projekt-Buxhetin e vitit të ardhshëm 2018, kur ta sjellësh se ende s'e kemi parë, por për këtë vit autostrada është hequr. Edhe këtu problemi është i dyfishtë. Është i PDK-së, por është edhe i LDK-së. Pse është i PDK-së? Për shkak se PDK-ja po e heq tash, ndërsa është i LDK-së për shkak se LDK-ja, sipas informatave të ministrit në Komisionin për Buxhet dhe Financa, nuk i ka filluar procedurat e prokurimit. Arsyeimi sepse janë hequr këto para nga rruga e Gjilanit dhe rrugë të tjera, sipas ministrit në Komision, ka qenë se nuk kanë filluar procedurat e prokurimit. Edhe sikur t'i lëmë paratë aty, ato nuk mund të ekzekutohen.

Pra, LDK-ja e ka bërë një premtim elektoral për autostradën për Gjilan, ministri që e ka drejtuar Ministrinë e Infrastrukturës që vjen nga radhët e LDK-së, nuk i ka nisur këto procedura dhe këtu mund të vijmë në përfundimin që edhe vitin e ardhshëm mund të ndodhë e njëjta dhe kjo rrugë të mos ndodhë.

Mbi të gjitha janë rritur shpenzimet rrjedhëse dhe subvencionet. Diku për 20 milionë në këtë rishikim të Buxhetit i kanë dërguar te shpenzimet rrjedhëse dhe te subvencionet.

Një pjesë e tyre, diku 6,8 milionë euro, janë një dëm që e ka bërë një qeveri e mëhershme e PDK-së, e ai është dëmi i pasaportave. Ju e dini aferën e pasaportave dhe i dini vendimet te gjykata ndërkombëtare dhe sot qytetarët e Republikës së Kosovës detyrohen ta paguajnë një dënim për shkak të aferave korruptive të Qeverisë së Republikës së Kosovës në kohën e kryeministrit Thaçi, përkatësisht Bajram Rexhepi.

Pra, ne po vazhdojmë t'i paguajmë dëmet e aferave korruptive të kësaj Qeverie dhe të qeverive të kaluara.

Ajo që duhet patjetër të theksohet është që kjo mënyrë e buxhetimit të Kosovës dhe kjo mënyrë e ndarjeve të investimeve kapitale po rezulton me moszhvillim ekonomik në Kosovë.

Unë mendoj që, përveç që është gabim kjo çka u bë tash, ku kanë shkuar mjetet, edhe Buxheti i ardhshëm, nëse bëhet në të njëjtën logjikë, nuk ka mundësi të mirë për zhvillim ekonomik dhe e kam pyetur edhe ministrin në Komision, pastaj i kam nxjerrë edhe disa të dhëna vetë. Nuk ka



shpjegim cilat janë përfitimet për diku 7 vjet investime në autostradat e Kosovës. Pra, cili është impakti ekonomik? Dhe, kanë qenë disa supozime të asaj kohe. Sipas statistikave të Kosovës 2014, por edhe në bazë të intervistave që janë bërë me aktorët kyçë për këtë çështje, Rruga e Kombit siç quhet, ose Rruga 7, përdoret vetëm 1/3 e kapacitetit të saj. Pra, ne e kemi bërë një investim shumë të madh, miliard euro, ndërsa kapaciteti i saj është duke u shfrytëzuar vetëm 1/3 e saj. Pra, 2/3 e atij investimi nuk janë duke u shfrytëzuar.

Një gjë tjetër që ka qenë në zotim po ashtu i kësaj Qeverie, por më shumë i qeverive të kaluara sa u përket investimeve kapitale në autostrada, kanë qenë vendet e punës.

Prej hulumtimeve që i kemi parë në Administratën Tatimore, ka dalë që në vitin 2010 prej “Bechtel&Enka” kanë qenë të punësuar 1 000 persona.

Ndërsa sipas deklarimeve të vetë kësaj kompanie kanë qenë 3 000 persona, të cilët në maksimumin e vet kanë punuar 24 muaj, shumica prej tyre 12 muaj, me pagën për orë një euro, që është më lirë sesa tregu në Kosovë, që fillon minimalisht me 1,5. Nëse kërroj këto i llogarit në variantin kur kanë punuar 12 muaj është vetëm 1,7 e këtij projekti-Buxhetit vlera e saj. Ndërsa në variantin e dytë është më së shumti 3,5% e kërroj investimit, dhe çka është e vërteta e dhimbshme është që këto vende të punës nuk kanë qenë të qëndrueshme, pra kanë qenë afatshkurtra dhe si rezultat i këtyre investimeve në autostradë dhe në autostrada tjera nuk ka gjenerim të vendeve të punës. Rrjedhimisht, nuk ka zhvillim ekonomik. Ka përfitime të njerëzve të cilët janë marrë me këta tenderë.

Tutje, sa i përket deficitit tregtar, që është folur se do të ndihmojë, në fakt kjo është përshkallëzuar në raport me Kosovën. Gjendja është më keq sot sesa më herët dhe as në këtë drejtim nuk kemi asnjë avancim të kësaj çështjeje.

Si rezultat i kërroj këtyre që i thashë, edhe i kërroj atyre që i kemi diskutuar edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk e mbështet këtë rishikim të këtij Buxheti për shkak se ky Buxhet, siç e thashë edhe më herët, është jo në kuadër të zhvillimit ekonomik. Ky Buxhet është bërë për interesa elektorale dhe fushata elektorale dhe ky Buxhet po paguan dëme të cilat qeveritë e kaluara i kanë bërë për shkak të aferave korruptive, e një gjë të tillë ne asnjëherë nuk jemi gati për ta mbështetur. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!  
Ministër i Financave,  
Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar draft-ligjin për rishikimin e Buxhetit për vitin 2017 dhe kemi ardhur në përfundime që na bëjnë të dyshojmë në domosdoshmërinë reale të ndryshimit të projektligjit në fjalë.

Jo vetëm për shkak të vonesës së madhe, sepse tash jemi në kohën kur Qeveria duhet ta sjellë Buxhetin e rregullt sipas obligimit që e obligon Ligji për menaxhimin e financave publike për vitin 2018, por për shkak të kësaj logjike që kërkohet me ndryshimin. Kemi menduar që do të ishte në rregull sikur ta sillte draft-ligjin vetëm për ndryshime, të cilat kemi obligime kontraktuale për ato projekte, për të cilat duhet bërë pagesa, mirëpo kjo nuk ka ndodhur kështu. Ne e kemi një ndryshim të ligjit në kohën e papërshtatshme dhe për këtë i kemi edhe këto përfundime.

Ky draft-ligj para nesh rikonfirmon planifikimin ashtu siç është parashikuar me ligjin bazik për vitin 2017, se të hyrat nga burimet vetjake, tatimore dhe jotatimore janë reale dhe të sakta. Këtë e konfirmojnë po ashtu edhe raportet e Doganës dhe raportet e Administratës Tatimore, që janë si rezultat i reformës fiskale të Qeverisë së kaluar.

Zvogëlimi i Buxhetit dhe të hyrave nga projekcioni i parë që ishte 2 miliardë e një milion euro, në një miliard e 725 milionë është se janë hequr 103 milionë euro, pasi nuk kemi arritur të bëjmë ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare financiare, ndërsa 78 milionë të parapara si e hyrë nga AKP-ja me pretekstin e asaj që e tha edhe ministri se nuk kemi arritur ta bëjmë ndryshimin e Ligjit për AKP-në, konsideroj që nuk janë të qëndrueshme, sepse ndryshimi i ligjit në fjalë kërkon vetëm një kohë të shkurtër, një procedurë të shkurtër, e cila mund të bëhet, dhe jo 78 milionë sa kanë qenë të paraparë me Buxhetin bazik, por në këtë institucion janë diku gjithsej 450 milionë të lirë, të disponueshme, të cilët Qeveria me një angazhim të vogël do të mund të bënte të paktën inkasimin, siç ka qenë e planifikuar në bazë të ligjit bazik.

Sa u përket shpenzimeve, kjo na shqetëson shumë, jo vetëm shkurtimet në projektet ekzistuese për përmbushjen e obligimit të pagesës për “Bechtel&Enka”, është fjala për rrugën, e cila u përfol kaq shumë në shumën prej 50 milionë eurove, por për t’i siguruar këto mjete normalisht që është dashur të dëmtohen projektet tjera kapitale. Vetëm te shpenzimet kapitale janë hequr diku 45 milionë euro, që janë dëmtuar pa pikë nevojë për shkak të mungesës së angazhimit për t’i siguruar mjetet qysh kanë qenë të parapara në ligjin bazik.

Grupi Parlamentar i LDK-së shpreh publikisht pakënaqësinë pse janë hequr mjetet për autostradën Prishtinë-Gjilan.

E dëgjova me vëmendje ministrin, edhe Dardanin, por të mos harrojmë që projekti më i madh nacional i rrugës Prishtinë-Morinë nuk është bërë me projektin ekzekutiv, i cili është porositur, i cili ka kushtuar me miliona, por është bërë në mënyrën “projekto dhe puno”. Sidomos për

devijimet, të cilat janë bërë atëherë për interesa politike, por edhe atëherë, ç'është më e keqja, nuk ka pasur një transparencë të shumës se sa ka kushtuar. Tash e kemi një projekt. T'ia rikujtoj ministrit që procedurat e tenderimit kanë përfunduar, përzgjedhësit e punëve janë kryer. Janë tetë kompani në tetë loto vendore. Është pritur ta fillojnë punën për autostradën e Gjilanit këtë vit, të paktën punët fillestare të shënimit të trasesë dhe vënien e mekanizmit fillestar. Janë hequr një milion e 700 mijë, domethënë kjo kategori buxhetore ka mbetur pa mjete dhe është çështje krejt tjetër për vitin e ardhshëm se sa do të parashihen, jo dy milionë e gjysmë, jo pesë milionë, por ne do të kërkojmë që sipas planit dinamik të paraparë për projektin të sigurohen mjetet nga Buxheti i Kosovës.

Grupi Parlamentar i LDK-së nuk pajtohet asnjëherë që mjetet e ndara sipas ligjit bazik në shumën prej 17 milionë eurove për fondin e sigurimeve shëndetësore të hiqen.

Të rikujtojmë se për këto mjete financiare të ndara ka qenë një zotim pas diskutimeve të shumta për ligjin në fjalë, që ka pritur tre vjet për të filluar zbatueshmërinë, pas negociatave dhe kompromiseve të shumta me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore, e tani vetëm është dashur që ministri i ri, respektivisht Qeveria, t'i nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e sigurimeve shëndetësore, të cilat do të ndikonin në masë të madhe në përmirësimin e sistemit shëndetësor në Kosovë.

Tash ky vendim i Qeverisë, sipas dokumentit të rishikimit, na çon në pikën zero, domethënë me krejt atë mund, me krejt atë angazhim, jemi në pikën zero.

Brengosja është edhe më e madhe që këto mjete nuk do t'i ndihmojnë ashtu siç kemi menduar të sëmuret, ata që kanë nevojë për pagesa në shëndetësi, por do t'i ndihmojnë “veteranët e luftës”.

Ministri po thotë “mos e bëni këtë krahasim, se nuk janë ato para që kanë shkuar te veteranët e luftës”. Unë po them, nuk e di cilat, a janë të sakta ato, apo janë mjete tjera, por për veteranët e luftës shkojnë plus nga sa janë ndarë në ligjin bazik, d.m.th. plus 26 milionë e 189 mijë e 518 euro.

Të rikujtoj se për një negociim të tillë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me të cilën edhe kemi fituar programe, është precizuar me ligj se ato mund të jenë 38 milionë për veteranët e luftës dhe 12 milionë për invalidët e luftës. Pra, gjithsej 50 milionë për këto dy kategori.

Tani me këtë rishikim janë paraparë 64 milionë e 189 mijë e 518 euro vetëm për kategorinë e veteranëve të luftës dhe 12 milionë, njëjtë sa ka qenë, domethënë asnjë cent më shumë për invalidët e luftës, domethënë për këto dy kategori janë gjithsej 74 milionë e 189 mijë e 518 euro. Thjesht, kjo na frikëson, sepse e kam frikën që kjo shumë për interesa të ndryshme mund të shkojë dhe të rritet dhe atëherë të kemi atë që nuk e dëshirojmë, që edhe mbështetësit më të

mëdhenj të institucioneve tona të ikin nga vendi për shkak të qëllimeve tona të ngushta për këtë çështje.

Do të dëshiroja që ministri i Financave ta ruajë deficitin buxhetor ashtu siç e obligon edhe Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kjo do të duhej të ndodhte edhe pa rishikim fare. Për këtë duhet një përkushtim më i madh ta ketë në Ligjin e rregullt për vitin 2018, të ketë më tepër një përkushtim të ministrit që Ligji për vitin 2018 të ketë më shumë mjete për investime kapitale, sidomos për ato investime që ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe në zhvillimin ekonomik.

Të ketë një shpërndarje më të mirë buxhetore e më proporcionale për të gjitha regjionet e Kosovës, të ketë një përkushtim që resorët e caktuar ministrorë të mos na sjellin në situatë që të paguajmë ndëshkimet nga gabimet e tyre, siç ishte edhe rasti me pasaportat e Kosovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe një minutë, përfundoje!

NASER OSMANI: Një gjë e tillë nuk u bënë nder institucioneve të Kosovës.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk do ta votojë rishikimin e Buxhetit për këto arsye, i ritheksoj edhe një herë: për shkak të heqjes së mjeteve për autostradën e Gjilanit, për shkak të heqjes së mjeteve nga fondi i sigurimeve shëndetësore dhe për shkak se i ka degraduar moralisht veteranët e vërtetë të luftës, duke e shtuar numrin e tyre për një votë, më shumë politike dhe partiake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani!

Fjalën e ka zonja Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar plotësim-ndryshimin e Ligjit numër 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ku vërehet që janë bërë ndryshime të domosdoshme për ta kthyer Buxhetin në vlerësime reale, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti makro-fiskal, si dhe të plotësohen kërkesat e domosdoshme për këtë periudhë kohore gjatë këtij viti.

Ne e dimë se Buxheti duhet të jetë një plan real i të ardhurave buxhetore dhe shpenzimeve buxhetore, në mënyrë që të sigurohet një financim i qëndrueshëm dhe që të ndikojë në mirëqenien e qytetarëve, si dhe të mos rrezikohet stabiliteti makro-fiskal. Prandaj, ne i vlerësojmë përmirësimet të cilat janë bërë që ky Buxhet të kthehet në shifra reale.

Nëse e shikojmë me kujdes projektligjin për ndryshim-plotësim të Buxhetit, vërejmë se nuk ka ndryshim të të hyrat. Me rishikim vërehet se janë planifikuar një miliard e 725 milionë, për çka gëzon fakti që ka një performansë pozitive të realizimi i të hyrave, qoftë në ATK, qoftë në Doganë.

Kurse vërehet se shpenzimet në këtë rishikim janë zvogëluar në një miliard e 810 milionë. Pse janë zvogëluar këto të hyra? Nga Buxheti janë hequr shifrat fiktive të planifikuara në Buxhet për ta arritur shifrën 2 miliardë euro të shpenzimet, për çka kemi ngrehur shqetësimet edhe kur është miratuar Buxheti në fund vitin e kaluar.

Për një rritje të tillë joreale, të bazuar në rritjen e huazimeve, rritjen e borxheve dhe kalkulimeve të pabazuara për të hyrat nga AKP-ja nëpërmjet likuidimit, që në fakt kanë qenë të perealizueshme dhe mjetet që janë planifikuar të realizohen me kredi nëpërmjet klauzolës së investimeve kanë qenë të pamiratuara në Kuvend, marrëveshjet për t'u realizuar kreditë e tilla.

Nëse e shikojmë raportin gjashtëmuor të shpenzimeve, ne vërejmë se asnjë hyrë nuk është realizuar as të AKP-ja, as të klauzola e investimeve.

Prandaj, ka qenë e domosdoshme që të bëhen rregullimet e nevojshme, në mënyrë që Buxheti të kthehet në shifra reale.

Me këtë rishikim është evituar disbalanci ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve duke e ulur deficitin dhe duke u përkushtuar për efikasitet në financat publike dhe ajo që duhet vlerësuar është që deficitin buxhetor është i përballueshëm dhe është sipas rregullave fiskale të parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shprehur shqetësimet e tij edhe gjatë miratimit të Buxhetit për planifikim jo të qëndrueshëm të investimeve në nivel qendror, por edhe në nivel lokal, e sidomos të planifikimi i Buxhetit të investimeve kapitale në Ministrinë e Infrastrukturës, ku ka pasur me dhjetëra projekte të planifikuara me vlera shumë të ulëta, të cilat atëherë kanë qenë të ditura se nuk do të realizohen.

Në Buxhet, projektet e planifikuara në shifra të ulëta dhe në fakt vlerat e këtyre projekteve kanë qenë shumë të larta, kanë qenë të pamundura për t'u realizuar dhe kuptohet që tash është dashur të bëhen ndryshimet e duhura.

Planifikimi jo i mirë sjell realizim jo të mirë të Buxhetit.

Në disa ministri vërehet se nuk ka pasur vullnet politik për t'i realizuar disa projekte, por edhe planifikimi jo i mirë e ka sjellë mosrealizimin e projekteve kapitale për çka vërehet se ka shkurtime të mjeteve edhe në investimet kapitale, por nuk rrezikohen projektet për të cilat janë realizuar procedura dhe të cilat janë në realizim e sipër.

Buxheti i rishikuar tregon një gjendje stabile të financave publike. Nga projeksionet vërehet se bilanci bankar në fund të vitit do të jetë 2,8% të bruto-produktit vendor, për çka duhet vlerësuar një gjë e tillë.

Pse është sjellë në pikën zero çështja e sigurimeve shëndetësore? Është sjellë për arsye se ministri i Shëndetësisë nuk ka punuar mirë, nuk e ka ndryshuar Ligjin për sigurimet shëndetësore dhe nuk ka pasur hartim të rregulloreve, sipas të cilave do të zbatoheshin mjetet të cilat janë planifikuar në Buxhet dhe është bërë mirë që është hequr ai ministër se po të lihej edhe tre vjet në ministri, ai s' do të bënte asgjë për sigurime shëndetësore.

Dhe unë jam shumë optimiste se shumë shpejt do të bëhet një punë efiçence në këtë drejtim dhe do të ketë mundësi që të realizohen edhe sigurimet shëndetësore.

Po bëhet zhurmë për autostradën Gjilan-Konçul. Nëse e marrim dhe e shikojmë planifikimin e Buxhetit, me Buxhetin e Kosovës për këtë autostradë janë paraparë një milion e 850 mijë euro. Po janë paraparë edhe nga AKP-ja 8 milionë e 236 mijë e 415 euro. A janë realizua mjetet nga AKP-ja? Nuk është realizuar asnjë euro, nuk është realizuar, sepse nuk është miratuar ligji.

Atëherë, a është fajtor rishikimi i Buxhetit, apo mospuna e cila është bërë në këtë drejtim.

Ne si grup parlamentar vlerësojmë që nëpërmjet këtij rishikimi është bërë siguri i fondeve të mjaftueshme për kategorinë e veteranëve të luftës sipas ligjit në fuqi, me çka është siguruar fondi për 26 milionë euro dhe e mira është që të gjithë veteranët do t'i marrin pagesat e tyre sipas obligimeve që i ka Qeveria për ta realizuar sipas ligjit çdo gjë që e ka për obligim.

Pagesa me kohë e detyrimeve për autostradën prej 50 milionë eurove, pagesa edhe te autostrada janë të parapara mjetet nëpërmjet AKP-së që të bëhet pagesa 60 milionë euro dhe nuk ka pasur mjete të tilla. Atëherë si të mos vlerësohet një rishikim i tillë për t'i hequr shifrat fiktive dhe për t'i kthyer në shifra reale.

Te financimi i RTK-së po ashtu janë të parapara me ATK-në nëpërmjet AKP-së, domethënë të realizohen 1.4 milion euro. Nuk janë realizuar. Prandaj, duhet të gjejmë zgjidhje dhe të plotësohen mjetet edhe për Radiotelevizionin e Kosovës dhe ky problem po na përcillet nga viti

në vitin tjetër, faktikisht prej vitit 2015 nuk ka ligj që bënë ndarjen sipas të cilit bëhet ndarja e Buxhetit për RTK-në dhe mungon vullneti politik dhe angazhimi që të rregullohet mënyra e financimit të RTK-së dhe të mos financohet më nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Me rishikim është adresuar edhe nevoja e misioneve diplomatike, si dhe nevojat e domosdoshme për funksionimin e institucioneve tona për shkak të planifikimit joreal në fillim të këtij viti, si dhe mbulimi i shpenzimeve që dalin nga kontrata për “Trepçën”, të cilat na obligojnë të ndahen mjetet prej 600 mijë eurove.

Ne si grup parlamentar e përkrahim rishikimin e Buxhetit, sepse ndryshimet të cilat janë bërë në këtë rishikim janë të domosdoshme për ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal dhe për adresimin e nevojave të domosdoshme, të cilat kanë ardhur si pasojë e planifikimit jo të mirë në fillim të vitit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta japë kontributin maksimal edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që t'i mundësohet Qeverisë që t'i realizojë objektivat e veta programore dhe Buxheti të jetë në interes të mirëqenies të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Lista serbe? Zonja Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa Srpska lista analizirala je Nacrt-zakona o rebalansu budžeta i uočili smo da u tekstualnom delu Zakona postoji zakonska ograničenja u raspodeli sopstvenog budžeta pojedinih ministarstava.

Mi ćemo kao Poslanička grupa Srpske liste tražiti izmene, jer u jednoj Vladi uslovi moraju biti jednaki za sva ministarstva, dok ćemo danas ovaj Zakon podržati u načelu, a u međuvremenu podnećemo naše amandmane Komisije za budžet i finansije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Ministri Hamza, si në Komisionin e kësaj fushe, edhe sot në këtë seancë ka dhënë sqarime të bollshme lidhur me këtë ligj, edhe sqarime profesionale.

Duke u bazuar në këtë dhe në njohuritë tona që i kemi lidhur me këtë ligj, Grupi ynë Parlamentar do ta votojmë këtë projektligj, pra Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e buxhetit të vitit 2017.

Do ta votojmë duke qenë të vetëdijshëm se ky ligj e reflekton punën e Qeverisë paraprake dhe jo punën e kësaj Qeverie, pra orientimet programore të Qeverisë paraprake. Po ashtu, them se jemi vonuar me miratimin e këtij ligji dhe kanë mbetur më pak se dy muaj për implementimin e ndryshimeve të parapara me këtë projektligj. Ne po ashtu presim që së shpejti t'i hyjmë punës si Kuvend, procesit të miratimit të Ligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018, ku vetëm me këtë ligj i shohim prioritetet e kësaj qeverie nëpërmjet Buxhetit, pra. Edhe një herë, ne do ta përkrahim dhe do ta votojmë Projektligjin për ndryshim-plotësimin e Buxhetit të vitit 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: “Nisma”, s’e keni shtypur kartelën... tash Bilall Sherifi... merre kartelën me vete...

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka trajtuar me kujdes propozimin e Qeverisë për Projektligjin dhe plotësimin e ndryshimin në Ligjin për Buxhet dhe na vjen mirë që po kthehet, siç thotë populli, Buxheti “me këmbë në tokë”, sepse qysh në miratim të Buxhetit vitin e kaluar kemi pasur dilemat tona, se ai 2-miliardëshi ka qenë i pabazuar dhe i pamundshëm për t’u realizuar. Prandaj, do ta mbështesim gjithsesi.

Sa u përket temave që u ngritën këtu lidhur me sigurimet shëndetësore, mendoj që asnjëherë Qeveria e kaluar dhe ministri i kaluar nuk ka pasur qasje serioze në realizimin e këtij premtimi, prandaj të gjitha ato të tjerat mund të jenë në kuadër të retorikës, por një qëndrim serioz dhe praktik dhe të argumentuar nuk e ka pasur asnjëherë, për pagesat e kategorive të luftës, veteranëve të luftës, ku na obligon ligji bazik dhe mendoj që as nuk duhet të nxirret si dilemë kjo çështje për të mos miratuar këtë plotësim-ndryshim të ligjit.

Sa u përket temave lidhur me ato që u dëgjuan këtu për autostradën, unë duhet ta them edhe këtë, autostrada, rruga e kombit dhe aeroporti “Adem Jashari” janë dy projekte, të cilat neve na bëjnë të gjithëve krenarë, i bëjnë qytetarët e Kosovës. Cilat janë përfitimet e qytetarëve të Kosovës nga këto dy projekte, besoj që më së miri e dinë qytetarët e Kosovës, ata të cilët janë të vonuar dhe kanë dilema në interesin e këtyre projekteve ju bëjmë thirrje që t’i pyesin qytetarët dhe besoj që edhe ata ndjehen mirë kur i shfrytëzojnë dhe kur kalojnë nëpër këto projekte.

Problemet e tjera politike që ata mund t’i shfaqin për interesa politike neve nuk na bëjnë fare përshtypje. Ne jemi të bindur se për realizimin e këtyre dy projekteve është dashur të ketë vullnet dhe guxim politik, i cili që nga atëherë deri tash po mungon. Ne si Grup Parlamentar do ta votojmë dhe do ta mbështesim propozim- ndryshimin që është paraqitur nga Qeveria dhe ju bëjmë thirrje të gjithë deputetëve që t’i miratojnë këto plotësim-ndryshime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, kush do të flasë? Zoti Kinolli e ka fjalën.



ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+”, pas shqyrtimit të rishikimit të Buxhetit, do ta përkrahë të njëjtën, i cili është paraqitur nga ana e Ministrisë së Financave dhe kemi vlerësuar se ky Buxhet i rishikuar është kthyer në gjendjen reale dhe po ashtu është në përputhje dhe harmoni me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në shumë fusha.

Për shkak të zgjedhjeve parlamentare dhe atyre lokale kemi vërejtur mungesa në investime kapitale, sidomos për projektet të cilat kanë qenë të parapara për komunitetet. Shqetësimi ynë më i madh është se në dy vjetët e fundit nuk është implementuar Ligji i Buxhetit, neni 12, ku precizohet Buxheti i Ministrisë për Komunitete dhe Zyrës për çështje të komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, ku qartë është e precizuar ndarja e Buxhetit për komunitete. Shpresojmë që në këtë Buxhet do të merret parasysh ky nen i ligjit dhe do të implementohet.

Po ashtu, shpresojmë se Ministria e Financave gjatë hartimit të projekt-Buxhetit për vitin 2018 do të marrë parasysh këto kërkesa që kanë të bëjnë me projekte dhe investime kapitale të komuniteteve. Grupi Parlamentar “6+” do ta përkrahë këtë projektligj për plotësim-ndryshimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hamza dhe meqenëse kryeministri nuk është këtu, zoti Hamza, e ke të lejuar të ballafaqohesh me çështjet që i ngritin deputetët.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht, dëshiroj të falënderoj të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare për diskutimet dhe kontributin e tyre dhe besoj që kam nevojë që t’i jap disa sqarime shtesë.

U ngrit këtu çështja e projeksioneve makro-ekonomike, ne si Ministri e Financave, Departamenti i makro-ekonomisë, e ka bërë vlerësimin e gjendjes dhe nuk ka dallime të mëdha. Kemi reflektuar dy herë, gjithçka çka është e mirë dhe çka është e qëndrueshme, ne e njohim kontinuitetin dhe ka pasur vlerësime edhe sa i përket Buxhetit fillestar vitit 2018. Është reflektuar edhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve, edhe vlerësimet e fundit janë që rritja ekonomike për vitin 2018 do të jetë rreth 4%. Këtë e argumentojnë edhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, e cila ka dalë me vlerësimin për rritjen ekonomike për 2-3 mujorët e parë dhe çojnë deri në atë që rritja ekonomike për këtë vit do të jetë shumë afër projeksioneve fillestare dhe unë i përgëzoj të gjithë ata që kanë punuar në projeksione fillestare për këtë punë.

Tash mungesën e investimeve të caktuara apo ndryshimin në strukturë e kanë kompensuar: rritja e kreditimit, rritja e remitencave, investimet e huaja direkte, rritja e investimeve në sektorin privat dhe kjo ka sjellë që parashikimet për rritjen ekonomike të jenë ato fillestare, me disa

korrigjime të vogla. Sa i përket pjesës pse i kemi ndryshuar, pse i kemi reflektuar vetëm te pjesa e shpenzimeve, e jo e të hyrave, ne kemi reflektuar edhe te pjesa e të hyrave, por jo te të hyrat e rregullta, se të hyrat e rregullta kanë pasur një parashikim bukur të qëndrueshëm, bukur realist, me disa ndryshime të vogla që mund të paraqiten te të hyrat, të cilat i mbledh dhe i administron Administrata Tatimore e Kosovës, disa të hyra që janë si të hyra të njehershme prej burimeve të tjera, si është dividenda prej AKP-së dhe mund të ketë një nënperformansë të të hyrave të nivelit lokal, po ato për qëllime të deficitit primar, deficitit të përgjithshëm dhe bilancit bankar e kanë efektin neutral, se nëse nuk mblidhen, nuk mund të shpenzohen.

Ndërsa, janë eliminuar burimet e financimit të njehershme që u përmendën këtu nga AKP-ja dhe nga klauzola e investimeve. Një pjesë e tyre, pa dashur të kritikojë askënd apo pa dashur ta amnistojë askënd, kanë qenë edhe si rezultat i zgjedhjeve të parakohshme. Mirëpo, shtrohet pyetja logjike: nëse ka dashur e është dashur të vijë mjetet prej AKP-së, pse nuk erdh ligji në gjashtëmujorin e parë në Kuvend? Nuk ka pasur asnjë draft të ligjit, unë tek javën e fundit i kam pranuar komentet e fundit prej FMN-së për këtë ligj dhe nëse e shikojmë procedurën se sa nevojitet një ligj prej momentit të draftit deri në momentin e finalizimit të tij, gjasa teorike nuk ka që Ligji për AKP-në këtë pjesë të mbetur të vitit të aprovohet, kur e dimë që sa kërkon diskutimi publik, sa kërkon të procedohet në Kabinet qeveritar, sa kërkon të futet në rend të ditës në Kuvend, mes leximeve, prandaj pyetja është më shumë se logjike. Duke e ditur që Buxheti, një pjesë e madhe e Buxhetit, ka qenë e bazuar në financim prej të hyrave të AKP-së, pse ligji nuk është sjellë në Kuvend në gjashtëmujorin e parë? E tash po bëhen përpjekje që ne të fajësohemi pse s'e kemi sjellë për 10 ditë!

Pjesa tjetër, u ngrit gjithashtu ndryshimi në strukturë, nuk ka ndonjë ndryshim sinjifikant. Po, është e vërtetë se shpenzimet operative në Buxhetin e rishikuar në raport me shpenzimet kapitale janë më të mëdha, por jo ndonjë ndryshim sinjifikant, për shkak se pjesa e madhe e ndryshimeve prapë shkon në projektin kapital që është autostrada në drejtim të Shkupit. Do të thotë, 50 milionë nga ky rishikim shkojnë në drejtim të Shkupit. Janë rritur subvencionet, unë e di, u ngrit këtu, e di që nuk ka qenë mirë, nuk është mirë, po ka njerëz që janë aversivë ndaj kategorive të caktuara. Unë e di fatkeqësisht që po përmendet puna e veteranëve. Po, ka aversion, po çka mund të bëjmë, kjo është përgjegjësi ligjore. Por nëse duam pra që të jemi realë, janë kategoria që kanë dhënë më së shumti për këtë shoqëri, por nëse flasim për proces, procesi është nisur gabim. Është caktuar lartësia e pagesës, ka filluar lartësia e pagesës pa e ditur numrin. Pse nuk është mbyllur numri, të caktohej lartësia e pagesës e pastaj të dihej kostoja buxhetore.

Jo, procesi është udhëhequr, për informatën tuaj, procesi është udhëhequr brenda Kryeministritë, pa dallim kush është, brenda Kryeministritë dhe brenda Ministritë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nuk munden grupe të interesit, kushdo qofshin ata, të na e bëjnë Buxhetin, prandaj për një proces të udhëhequr jo në përputhje me rregullativën, të mos gjuhemi te kategoritë e caktuara.

U ngre gjithashtu çështja e përfitimeve prej autostradave. Mund të kemi dallime programore, mund të ketë dikush mendim që më mirë është të bëhen rrugë me dy korsi se autostrada. Unë nuk e kam këtë problem, veç e di një gjë të sigurt që Kosova, për shkak të rrethanave të njohura se jemi shteti më i ri, është vendi i fundit ku po e kompletton infrastrukturën rrugore dhe nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa infrastrukturë të mirë rrugore. I dimë cilat kanë qenë kostot për biznesin, i dimë cilat kanë qenë kostot për qytetarët, i dinë të gjithë ata që qarkullojnë në këto rrugë dhe në këto drejtime.

Unë jam shumë i sigurt që Kosova brenda tre vjetëve të ardhshme po e përfundon edhe po e kompletton infrastrukturën rrugore.

U ngrit çështja e të hyrave. Prapë po e potencoj, me gjithë disa dallime të vogla, unë pres që të hyrat e rregullta të plotësohen në masë të pranueshme. Ligji për AKP-në ende nuk është drafti i kompletuar, ende nuk janë të inkorporuara komentet e FMN-së, të cilat i kam pranuar para një javë dite. Nuk ka më shumë se një javë ditë, unë nuk do të ec në këtë projekt pa u konsultuar edhe me partnerët tanë në këtë punë. Këtu janë edhe përfaqësuesit e FMN-së dhe nëse kam thënë diçka që nuk qëndron, atëherë unë sigurisht që mbaj përgjegjësi, por komentet e fundit prej Fondit Monetar Ndërkombëtar i kam pranuar para një jave dhe sigurisht se do t'i trajtoj me kujdes, të njëjtat do t'i inkorporoj dhe do të procedoj tutje.

Gjilani: Po ju garantoj dhe po ju siguroj, nëse doni në mes të dy leximeve, nëse doni nëpërmjet nenit 16 të Ligjit të Buxhetit, i cili na mundëson rialokimin e 5% të totalit ndarje buxhetore, jo 1 milion e 850 mijë sa kanë qenë, 2 milionë e 850, 3 milionë e 850, 4 milionë e 850, aq sa ka nevojë. Mirëpo duhet të krijohen parakushtet. Cili është parakushti? Duhet të lidhet kontrata dhe duhet të bëhet kontrata e ligjshme. Pa kontratë të ligjshme, pa u lidhur kontrata pa përfunduar procedurat nuk mund të ecim në këtë projekt. Ndoshta ka të atillë që, po e relaksoj pak, ka të atillë që mendojnë që punët në rrugë mund të fillojnë në dimër. Unë e di që s'fillojnë, është e pamundur.

Por, le të fillojnë punët, le të lidhet kontrata, unë ju siguroj dhe ju garantoj që mjetet e nevojshme do të jenë në çdo kohë në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Prandaj, vitin e ardhshëm, nëse e shikojmë strukturën e Buxhetit origjinal të vitit 2017, edhe e shohim Buxhetin e vitit 2018, ka ndërruar fondi i financimit. Pjesa ku ka qenë e paraparë me AKP, që prapëseprapë pa u aprovuar ligji, do të jetë me disa dilema, do të jetë financim prej Buxhetit të rregullt të Kosovës dhe shtesat e tjera do të jenë mbi këtë. Prandaj, të mos dalë që një parti politike ka më interes ta përkrahë Gjilantin, e tjetra s'ka. Është rrugë me prioritet si shumë rrugë të tjera dhe ne do t'ia sigurojmë financimin.

Te sigurimet shëndetësore. Po ju garantoj dhe po ju siguroj, edhe po e thjeshtësoj, masa e pagave, paga, çeku i pagave mujore është 45.5 milionë, po e thjeshtësojmë po e biem në 50

milione, punëdhënësi do t'i paguajë 3,5%, 3,5% e 50 milionëve apo 45,5 milionëve bëjnë afërsisht 1 milion e gjysmë dhe themi për nëntor dhe dhjetor, nën supozimin që nuk ndodh të fillojnë prej 1 nëntorit, ne kemi obligim për t'i paguar 3 milionë. Por, nuk ndodh, se s'është bërë ai plotësim-ndryshimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore. Nuk është kompletuar infrastruktura nënligjore, nuk janë pajisur njerëzit me kartela, nuk janë caktuar çmimet, nuk janë caktuar kostot, prandaj unë uroj që të fillojë në fundin e vitit të ardhshëm. Mirëpo një diçka që ju siguroj, ju siguroj se Buxheti për shëndetësinë 2018, duke e ditur gjendjen në këtë sektor do jetë i rritur. Do të jetë i rritur edhe për barnat esenciale, edhe te pjesa kapitale.

Ka qenë rishikim i nevojave të domosdoshme, është bërë rishikim brenda një jave pasi e kemi marrë mandatin, për të reflektuar dhe t'i kryejmë obligimet tona ligjore, në të kundërtën ne si shtet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, mikrofonin!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ne do të përballemi me pasojat e ligjit, pa hyrë në atë se qysh u bë, tek u bë. Puna e autostradës në drejtim të Shkupit, në raport me punët e ekzekutuara ne kemi obligim, kemi obligime kontraktuale dhe ligjore dhe puna ndaj kategorisë së veteranëve që për pjesën dërrmuese, flasim me respekt, nëse ka problem, çështjet të tjera, si puna e numrit, tjetërkush merret me atë punë, ka të atillë që kanë aversion, mirëpo ne kemi obligim t'ua paguajmë ato që ua ka garantuar ligji, e ligji bazik thotë derisa të kryhet rikategorizimi, duhet t'ua paguajmë mbi bazën e ligjit bazik, ky është obligim që ne duhet t'ua paguajmë edhe 26 milionë shtesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Po vazhdojmë me të paraqiturit për të diskutuar. Atëherë po e bëjmë në 1 e gjysmë pauzën, fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,  
Qytetarë të Republikës,  
Kabinet qeveritar,

Ky rishikim është versioni më i fundit i improvizimit në llogari të zhvillimit të munguar. Edhe një administrim i së tashmes pa zhvillim për të ardhmen. Buxhetimi i këtij lloji që po bëhet nga këto qeveri të njëpasnjëshme tregon për profilin e njëjtë. Të ndryshëm janë veçse emrat e ministrave, por krejt të njëjta janë politikat buxhetore. Nuk ka asnjë shenjë se do të ketë diçka të re sa i takon projekteve në industri, prodhimit, ndërmarrjeve të vogla e të mesme apo kërkimit shkencor, në kundërshtim me fjalët e mëdha në programin qeverisës. Ky është Buxhet i mjerimit

të mendimit financiar dhe politik. Ky Buxhet i mban të pasurit dhe koniunkturën përreth pushtetit në të njëjtin nivel e i zhyt thellë e më thellë në vështirësi klasën e mesme dhe të varfrit.

Para këtij rishikimi të Buxhetit na pati ardhur Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, për të cilin nuk u debatua këtu në Kuvend. Është diskutuar vetëm për Parimet Programore të Qeverisë, një tekst ky që nuk i kishte as 10 faqe, por jo edhe për Programin Qeverisës që i ka mbi 130 faqe. Te programi qeverisës ne duhet ta gjejmë frymën dhe germën e orientimit dhe politikave të qeverisë, para se t'i gjejmë shifrat te ky rishikim i Buxhetit. Pra, para se të flasim për këtë rishikim Buxheti, unë do të theksoj disa gjëra tek objektivat e shpallura paraprakisht.

E kanë thënë shumë veta pa numër herë, mirëpo i pari e ka thënë një poet i shquar anglez i shek. XIX, Robert Browning, në një varg se “less is more”, pra “Sa më pak, aq më shumë”. Kjo formulë më pas është përdorur shumë nga arkitektë e urbanistë, nga artistë e estetë, bile edhe nga juristë e filozofë. Por, programi qeverisës i kësaj qeverie është ndër ato raste kur mund të themi saktësisht të kundërtën. Pra “more is less”, apo “Sa më shumë, aq më pak”.

Programi qeverisës i Qeverisë aktuale ka shumë më shumë faqe e fjalë se sa dokumenti fillestar i Parimeve Programore, me të cilën kjo qeveri u paraqit atëherë kur u votua nga 61 deputetë. Bashkë me faqet, është shtuar dhe numri i kontradiktave, i gabimeve logjike, i shkarjeve e i gafave. Ky program ka shumë fjalë, por pak kuptim.

Ai fillon me një listë dëshirash për sundimin e ligjit, pa treguar se si do të bëhen realitet këto dëshira. P.sh. premton një veting të ri, shumë më përmbytësor se i pari, pa treguar se ç' nënkuptohet me përmbytësor në këtë rast. Ku nuk ishte përmbytësor i pari, e si e qysh do të garantohet përmbytësimi i të dytit? Po e vë theksin këtu, sepse mungesa e metodës e degradon zhvillimin në administrim. Nuk flisni dot për të hyrat, sepse s'mund të flisni për zhvillim, por vetëm për shpenzime dhe administrim. Qeveri e shpenzimit dhe e administrimit, jo e të hyrave dhe e zhvillimit.

Atje, me klishe, thuhet se institucionet e zbatimit të ligjit do të avancohen e reformohen, e menaxhimi i kufirit do të arrijë standard evropian. Sërish, nuk thotë se si apo me çfarë instrumenti? Ky rishikim i Buxhetit ka ardhur i tillë, sepse këta s'kanë metodë.

Fjalët boshe nuk mbarojnë këtu te Programi qeverisës. Te vizioni për zhvillimin ekonomik dhe punësimin kjo qeveri na thotë se do të targetojë rritje ekonomike me normë mesatare prej 5-7%. Kjo është tallje. Të gjithë e dinë se kjo është e pamundur. Që të arrihen shifra të tilla, duhen së paku dy-tre vjet punë sistematike për mëkëmbjen e prodhimit vendor. Një shoqëri e shkatërruar prej luftës dhe e vjedhur prej pasluftës, nuk mund të arrijë rritje të tillë mesatare që në vitin e parë duke u nisur nga zero. Sidomos në kohën e ngadalësimit ekonomik rajonal e global.

Në lëndën e Administrimit Publik ky program nuk do të merrte notë kaluese, pra nuk do të merrte as gjashtë. Sepse, autorët e tij nuk dinë të ndërtojnë prioritete e as strategji. Ata kanë shkruar se: “Prioritetet strategjike në qeverisjen tonë me investime substanciale në fusha si arsimi, shëndetësia, rendi dhe ligji, infrastruktura, shëndetësia dhe fusha e sigurisë”. Çfarë mbeti këtu pa u priorizuar? A e dinë këta qeveritarë se kur shpall kaq shumë prioritete (ku secila përbën shumë të gjëra në vetvete), në fakt, kallëzon se nuk e ke asnjë prioritet? Prandaj këta nuk mund të zhvillojnë, veçse të administrojnë. Prandaj nuk mund të flasin për të hyra, por veçse për shpenzime.

Ky program qeverisës nuk do ta merrte notën kaluese as në lëndën e ekonomisë. Një fjali aty shkruan se Buxheti i Kosovës do të mbahet stabil nëpërmjet bashkëpunimit me institucione, si Banka Botërore e Fondi Monetar Ndërkombëtar, të cilën porsa e theksoi ministri i Financave. E, në fjalinë menjëherë pasardhëse kemi kontradiktë që e kupton çdo student i vitit të dytë të Ekonomisë. Aty thuhet se do të ndahen fonde buxhetore për subvencionimin e blegtorisë, pemëtarisë, vreshtarisë, bletarisë, bujqësisë në tërësi, kërkime bujqësore, zhvillimin e infrastrukturës rurale etj. Pra, do të subvencionohet gjithçka, sepse as te bujqësia kjo qeveri nuk di të vendosë prioritete.

Por, të gjithë e dinë se Buxheti i disiplinuar nga Banka Botërore e Fondi Monetar Ndërkombëtar nuk lë vend për subvencione, siç premtojnë këta. Siç duket, e përdorën mashtrimin në këtë program qeverisës për fushatë lokale, për të marrë votat e bujqve, duke u premtuar pa garanci subvencione që bujqit i dëgjojnë për të mos i marrë kurrë.

Edhe po të studiohej në universitet astrologjia, apo parashikimi i fatit, Programi i kësaj Qeverie do të merrte notë ngelëse edhe aty. As në astrologji nuk do ta merrte gjashtën. Sepse, është aq optimist sa as një fëmijë nuk mund të jetë. Parashikon që punët do të ecin vaj në çdo sektor, pa probleme as të brendshme e as të jashtme. Siç duket, shkruesi i programit, që diku është në vetën e parë njëjës e diku në vetën e parë shumës, është porositur t’ia bëjë rrafsh publikut e ndoshta edhe vetë kryeministrit, duke thënë: “Hajt se bëhet mirë”, në miniera e shkolla, spitale e fabrika, fshatra e qytete, me ushtri e me integrim, praktikisht me gjithçka. Askund nuk thuhet konkretisht si dhe me çfarë mjetesh, cila është mënyra, por mbizotëron gëzimi naiv se “do të bëhet mirë”. As një fëmijë nuk di të jetë kaq naiv. Edhe në astrologji parashihen pengesa e vështirësi.

Të nderuar deputetë,

Përshtatja buxhetore është arritur nëpërmjet përshtatjes së shpenzimeve që nënkupton uljen e shpenzimeve buxhetore përafërsisht 190 milionë €. Kjo përshtatje ka dy implikime:

E para, tregon joseriozitetin e qeverisjes aktuale, e cila nuk e ka prekur aspak pjesën e të hyrave, meqë e parashih që ato të realizohen në tërësi sipas parashikimit. Kjo reflekton nguti në përpilim

të draft-Buxhetit të rishikuar, meqë të hyrat me një probabilitet prej 100% nuk do të realizohen sipas planifikimit.

Së dyti, përshtatja komplet në anën e shpenzimeve në masë 10% të Buxhetit të planifikuar e shpërfaq joseriozitetin e qeverisë së kaluar, e cila më shumë se sa në përmbajtje ka qenë e obsesionuar me shifrën magjike prej 2 miliardëve të Buxhetit. Ne e dimë se me sa zhurmë është proklamuar ky Buxhet 2-miliardësh si sukses i madh i ish-Qeverisë. Tash na del se kjo ka qenë farsë, bashkë me idenë e klauzolës së investimeve dhe bashkë me idenë e shfrytëzimit të mjeteve nga të hyrat e privatizimit. Madje, ideja e futjes së të hyrave të privatizimit në Buxhet dhe përdorimi i tyre për mburrje nëpër fushatë del problematike nga secili këndvështrim i buxheteve ndër gjenerata. Meqë rritja e të hyrave është planifikuar në kurriz të asetëve të shtetit, e në mungesë të shtetit.

Problem tjetër serioz me këtë rishikim buxhetor është se më shumë se 100% e përshtatjes së shpenzimeve është bërë në kurriz të projekteve kapitale. Duke rritur shpenzimet rrjedhëse dhe kategorinë e subvencioneve, është fshirë komplet autostrada e planifikuar në drejtim të Gjilanit, me idenë e zbehtë se mund të fillohet në vitet në vijim, 2018, ndoshta 2019, ndoshta as 2019. Megjithatë kjo nuk po e pengon Hazirin, atje, që edhe më tej të vazhdojë me mashtrimin e qytetarëve të Anamoravës, duke grumbulluar vota me autostradën inekzistente drejt Gjilanit.

Është gënjyer në qershor me buxhetin 2 miliardësh dhe po vazhdohet gënjeshtër kur është fjala jo vetëm për autostradën drejt Gjilanit, por edhe për vëllimin e shpenzimeve kapitale si proporcion i shpenzimeve të përgjithshme buxhetore.

Me rishikimin buxhetor janë rritur krejtësisht, pa ndonjë logjikë shpenzimet rrjedhëse, edhe pse të njëjtat në pesë vjetët e fundit kanë qenë madje edhe më të ulëta se sa shifra që ka qenë e paraparë me Ligjin e Buxhetit për vitin 2017. Kështu, edhe pse në vitin 2016 shpenzimet rrjedhëse kanë qenë vetëm 203 milionë euro dhe është ditur që në start se nuk do të jenë më të larta as në këtë vit, ato janë vendosur në kufirin e 225 milionë eurove. Në vend që kjo shifër të reduktohet me rishikim, Qeveria ka vendosur ta rrisë edhe një herë për 20 milionë të tjera, që në shikim të parë duket vendim i pamenduar, ama, fshehja pas kësaj kategorie e dënimeve për aferën korruptive të pasaportave në masën e 6 milionë eurove nuk mjafton për këtë rritje kaq të madhe, përveç nëse kemi edhe ndonjë dënim tjetër nga gjykatat ndërkombëtare, e për të cilat nuk janë informuar as deputetët e Parlamentit e as qytetarët e vendit.

Ajo që me siguri do të ndodhë është që në fund të vitit mjetet e pashfrytëzuara në këtë kategori do të keqpërdoren për ndonjë shpenzim të panevojshëm apo politik, ose të shërbejnë për mbulimin e mosrealizimit eventual të të hyrave të planifikuara buxhetore. Rishikimi buxhetor është tërësisht jotransparent, meqenëse as ligjvënësi, as qytetari në asnjë moment nuk e di se cilat projekte kapitale me saktësi janë fshirë nga Buxheti i fillimvitit, janë modifikuar ose janë futur

rishtazi në tabelat buxhetore. Në vend të përpilimit të një tabele aneks të veçantë, ku do të listoheshin vetëm projektet e prekura dhe shumat respektive, Qeveria, thjesht, e ka sjellë edhe një herë materialin fillestar prej mbi 440 faqesh duke kërkuar nga ligjvënësit që të kërkojnë pozicion për pozicion deri sa të gjejnë projektet e ndikuara nga rishikimi.

Edhe nëse dikush vendosë që të krahasojë secilin prej dhjetëra-mijërave të dhënave numerike të dokumentit prej mbi 440 faqesh prapë do të hasë në vështirësi, në pjesën më të madhe paraqitja...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit, edhe një minutë shtojani, regjia!

ALBIN KURTI: ...Kështu, duke filluar nga faqja 299 e deri në faqen 418 që paraqet pjesën më të rëndësishme të këtij Ligji për Buxhetin, lexuesi e ka të pamundur të interpretojë të dhënat mbi projektet kapitale në nivel komunal, meqenëse të njëjtave ju mungon krejtësisht vargu sqarues.

Kolona me sqarime për llojin e të dhënave është ofruar vetëm në faqen e parë 299, por jo edhe në faqet vijuese. Qeveria ka ende shumë nevojë për përmirësime përmbajtjesore në mënyrën e raportimit rreth Buxhetit dhe në paraqitjen vizuale të ndarjeve buxhetore.

Apo, ndoshta, e thënë shkurt: “Sa më pak, aq më shumë” dhe sa më pak këso qeverie, aq më shumë shtet do të kemi.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E kam një lutje, doktor, merre fjalën, e ka kërkuar fjalën se ka një urgjencë për të shkuar diku.

HAXHI AVDYLI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Fjalimin tim po dua ta nis me një lloj replike me ministrin në fjalë, i cili tha se ju një grup keni averzion ndaj një grupi tjetër, siç janë veteranët e luftës.

Si veteran i luftës, si mjek i luftës, dua t’i them ministrit që nuk ka shqiptar që i thotë bukës bukë dhe ujit ujë që ka aversion për veteranët e luftës, por dua t’i them që ka aversion nga ajo shumë minimale që është ndaj këtyre veteranëve të vërtetë dhe aversion ka për veteranët e rrejshëm. Aversion ka secili në këtë sallë, e secili qytetar i Kosovës për veteranët e rrejshëm, të cilët janë bërë me mijëra dhe ne e dimë që kemi qenë në luftë se sa ka qenë numri i tyre. Unë dua të koncentrohem në sektorin e shëndetësisë, i cili që nga paslufta është duke vuajtur nga nënfinancimi shëndetësor dhe akoma sot e kësaj dite nuk po shihet si prioritet.



Në vendet e rajonit shëndetësia financohet nga 600 deri në 1 mijë euro për kokë banori, kurse te ne ajo mezi arrin 134 euro për kokë banori, ndërsa vazhdon që ky Buxhet i shëndetësisë të zvogëlohet. Ky Buxhet po zvogëlohet edhe me 17 milionë euro, derisa sektori i shëndetësisë i ka nevojat shumë të mëdha dhe ka nevojë për rritje të Buxhetit.

Pacientët tanë po blejnë barna, pacientët tanë po shërohen nëpër klinika jashtë shtetit, po shërohen dhe po bëjnë shpenzime në incizime nëpër klinika private, derisa ne kemi mungesa të mëdha për një rezonancë magnetike, e cila nuk e ka një çmim aq të madh për Buxhetin tonë. Derisa Prishtina s'ka spital të Prishtinës, SHKSUK është e mbingarkuar dhe me një cilësi shumë të dobët të shërbimeve si pasojë e investimeve të ulëta. Derisa mjekët tanë të rinj specialistë, specializantë, po na ikin jashtë shtetit, ne po vendosim që atë Buxhet për shëndetësi ta zvogëlojmë edhe më tutje, duke e dërguar në pagesën për veteranë. E dimë se ka mundur të gjenden pagesat për veteranë dhe ky Buxhet për shëndetësi të rialokohet në nevojat shumë të mëdha të shëndetësisë, të cilat janë më se të nevojshme edhe për vetë veteranët, sepse edhe ata i kanë familjarët e vet, kanë nevojë për një sistem shëndetësor me një cilësi të lartë.

Unë mendoj se duhet përkrahur reformat në shëndetësi dhe hapat për reformimin e shëndetësisë duhet përshpejtuar dhe deri atëherë, derisa ne ta krijojmë fondin për sigurime shëndetësore, duhet ta rritim Buxhetin për shëndetësinë. Mendoj se investimi në shëndetësi nuk është investim i humbur, por është një investim i madh dhe një rikthim i parësë të taksapaguesit kosovarë, sepse sëmundjet, siç e dini, po e dëmtojnë buxhetin e pacientëve, buxhetin e popullatës në përgjithësi.

Prandaj, unë mendoj se për veteranët e vërtetë, për rolin e secilit prej tyre në përkulemi, duhet të gjendet zgjidhje, por asnjëherë duke e dëmtuar sistemin më të dëmtuar që e kemi ne dhe në programin e Qeverisë thuhet se spitalet tona do të bëjnë krahasim me vendet evropiane, ndërsa me Buxhet jemi duke u bërë karshillëk vendeve afrikane. Mendoj se me këtë Buxhet ne nuk do të kemi përkujdesje të vërtetë për pacientët tanë dhe do të kemi cilësi dhe rënie të cilësisë në sistemin shëndetësor, vuajtje dhe humbje të mëdha të Buxhetit të familjeve të kosovarëve dhe Buxhetit të taksapaguesve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Deputet, faleminderit!

Qenkemi në ekip të njëjtë, se të dytë po i dashkemi ata veteranët e vërtetë dhe të dytë po flasim për kategorinë e veteranëve të njëjtë.

E unë nuk jam këtu avokat i mbrojtjes së asnjë të keqeje, çfarëdo që ka ndodhur, por jam këtu për ta kryer obligimin ligjor, për t'i kryer pagesat ndaj një kategorie që i ka dhënë të drejtë ligji. Prandaj, mos provo, as mos tento që dikush të dalë më mbrojtës, e dikush më akuzues ndaj diçkaje. Këtu qenkemi në ekip të njëjtë, mirë qenka puna.

Diskutimin tënd e kuptova në aspektin politik, por jo në aspektin profesional. Deputet, po të lus, asnjë cent prej Buxhetit të shëndetësisë nuk është zvogëluar. Ky Buxhet i shëndetësisë është aq sa ka qenë, vitin e ardhshëm do të vijë me rritje. Edhe me rritjen që do të vijë, prapë s' do të jetë i mjaftueshëm, duke e ditur gjendjen. Mirëpo, të lutem, pozicioni për sigurimet shëndetësore nuk ka qenë Buxhet i shëndetësisë. Merre shikoje Buxhetin dhe Ligjin e Buxhetit origjinal, ka qenë te masa e pagave. Dhe unë po të siguroj dhe po të garantoj, edhe ti të njëjtën gjë e kërkon, pa ligj, pa u bërë baza ligjore, asgjë s' mund të veprohet.

Prandaj, unë po i lus të gjithë ata që kanë për obligim, e kanë fushën e përgjegjësisë së tyre, le të ecin me reforma, le të ecin me plotësim-ndryshimin e ligjit, le të ecin me kompletimin e akteve nënligjore, pajisjen me kartela të sistemeve dhe të gjitha, që të mund të fillojë implementimi i sigurimeve shëndetësore.

Edhe një çështje tjetër: Të mos dalim që me sigurimet shëndetësore do të përfitojnë pacientët. Duhet shpjeguar drejt. Do të jetë një shtesë, e cila të gjithë të punësuarve në sektorin publik dhe privat do t'ua zvogëlojë pakat për 3,5% dhe në të njëjtën kohë 3,5% do t'i kushtojnë punëdhënësit. Prandaj, ngritja e çështjeve, "po merren paratë prej shëndetësisë... u ngritën paratë, u hoqën paratë prej shëndetësisë e shkuan diku tjetër", nuk qëndron. Këto para kanë qenë të vendosura si fond. Këto para kanë qenë të vendosura si fond te masa e pagave.

Ndërsa, sa i përket Buxhetit të shëndetësisë, Buxheti i shëndetësisë po, veç duhet të vendoset drejt. Edhe unë sot po kërkoj si ministër i Financave, që reformat të vendosen në binarë të rregullt, përndryshe po të garantoj dhe po të siguroj, që pas katër vjetësh, pas pesë vjetësh, nuk ka lidhje kush do të jetë ministër i Financave, kush do të jetë deputet dhe kush do të jetë në Qeveri, nëse nuk udhëhiqet drejt reforma do të prodhojë probleme që do ta rrezikojnë qëndrueshmërinë makro-fiskale, sepse mjetet e mbledhura prej kontributeve, prej premive, sigurimeve shëndetësore, ndoshta s'kanë për të qenë të mjaftueshme për t'i mbuluar faturat që do të vijnë, nëse s'vendoset mbikëqyrja dhe kontrolli drejt.

Prandaj, reforma duhet të zhvillohet, duhet të zhvillohet drejt, me mbikëqyrje të mirë, me ligje të mira, me akte nënligjore të mira. E Buxheti i shëndetësisë do të vijë me rritje, por unë jam i sigurt që edhe me rritjen që do vijë shëndetësia do të ketë nevojë për një Buxhet edhe më të lartë, kanë nevojë edhe shumë sektorë të tjerë, por ne duhet parë edhe cilat janë mundësitë reale të vendit tonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Beqaj e ka kërkuar fjalën për ta dhënë një sqarim shtesë për kohën kur ka qenë ministër.

**BESIM BEQAJ:** Faleminderit, i nderuar kryesues!  
Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Meqenëse u ngre çështja jashtëzakonisht e rëndësishme për të gjithë qytetarët tanë anekënd vendit, për dy kategori, për kategorinë e veteranëve, por edhe për një veprim apo një orientim të Buxhetit për shëndetësinë, për hir të opinionit dhe tuajin si deputet, po ashtu edhe për deputetët e rinj që janë këtu dhe nuk e kanë njëfarë memorie institucionale, në vitin 2014, kur është bërë planifikimi i Buxhetit për vitin 2014 kam qenë unë ministër i Financave. Dhe, në vitin 2014 kanë qenë të planifikuara 17 milionë euro për implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore.

Qeveria e kaluar ka pasur tre vjet të plota për të marrë masa konkrete e për të mos ardhur këtu për të qarë me lot krokodili sesi po transferohen mjetet prej shëndetësisë e po dërgohen te veteranët. Mungesa e aktivitetit në Ministrinë e Shëndetësisë, mungesa e akteve nënligjore, të cilat për tre vjet nuk janë bërë, e ka pamundësuar Qeverinë dhe ministrin e Financave atëherë, i cili në rishikim të Buxhetit të vitit 2014 ka ardhur dhe na ka thënë “po e kursejmë Buxhetin”, po e kursejmë nga shëndetësia, kur është bërë rishikimi. Pra, duhet të jemi të përgjegjshëm para qytetarëve të vendit.

Tre vjet nuk është bërë asnjë hap dhe tash jemi dy muaj para përfundimit të vitit dhe të konsideroni që këto mjete financiare duhet të shkojnë në suficit buxhetor është goxha çështje profesionale për të folur për këtë farë pune, doktor. Prandaj, po ju lus, rishikimi i Buxhetit është çështje e interesave shtetërore për kategorizim të parave të taksave të qytetarëve, që janë me interes për t’u shpenzuar. Dhe, ne kemi kalimin e këtyre mjeteve, jo nga fondi i Ministrisë së Shëndetësisë, por nga Ministria e Financave, kanë qenë në kontigjencë. Pse nuk është bërë ligji dhe pse nuk janë bërë të gjitha këto veprime? Pra, nëse dëshironi ta trajtoni politikisht, politikisht që nga 2014-ta Qeveria e kaluar ka pasur mundësi tre vjet ta zbatojë këtë ligj, por nuk e ka zbatuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, meqenëse ta ka përmendur emrin, ke të drejtë në replikë.

HAXHI AVDYLI: Faleminderit për përgjigjen!

Të nderuar ministra,

Faleminderit për përgjigjen, por gjithkush që merr vesh nga pak nga politika shëndetësore e di që është kohë shumë e shkurtër për këtë fond që ta bëjmë, t’i funksionalizojë sigurimet shëndetësore. Për atë po pajtohem gjithsesi dhe nuk po ju themi juve pse nuk po e funksionalizoni për këtë kohë shumë të shkurtër, sepse e dimë që sigurimet shëndetësore kanë nevojë për akte nënligjore, kanë nevojë për një përgatitje më të madhe, si nga SISHI, si nga përgatitja e infrastrukturës. Por, unë thashë që një pjesë nga ky Buxhet keni mundur ta rialokoni për shëndetësi. Aty ishte poenta ime.

Poenta ishte që shëndetësia sot, unë po e them këtë, sepse po vij direkt nga ky sektor, po vij nga sallat e operacionit nëse doni ta dini, dhe e di se çfarë mungesash ka, e di çfarë mungesash ka në

barna, çfarë mungesash ka në aparaturat radiologjike, ku një rezonancë magnetike kushton jo aq shumë, njerëzit presin me vite për ta bërë një rezonancë dhe drejtohen nëpër institucione private. Pastaj, ju jeni të informuar që e kemi një kontingjent të mjekëve të papunë, që janë duke pritur dhe janë duke punuar pa paga dhe janë në pritje. Edhe në këto momente ata janë duke më shkruar mua, që ta ngre çështjen që janë pa paga dhe janë duke punuar në këtë sektor.

Ky ishte shqetësimi im, që ndoshta do të kishim mundur nga ky fond që t'i reallokojmë për shëndetësi dhe disa nga problemet më akute që i kemi për këtë vit ndoshta do t'i kishim zbutur, se t'i zgjidhim krejt problemet e shëndetësisë nuk do të mundnim, besoj se pajtohemi të gjithë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, zoti ministër ka kundër-replikë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Po, jemi të njoftuar që ka mjekë të papunë edhe specialistë dhe duhet adresuar këtë çështje, dhe kjo çështje duhet të adresohet me Buxhetin e vitit të ardhshëm. Mirëpo, nuk është problem yni, nuk e kemi krijuar në këtë problem. Këtu t'i kemi të qartë dallimin. Dhe nuk mund të lejojmë. Unë e di që ka nevoja, thashë jo veç në shëndetësi, po pajtohem, por edhe në shumë sektorë të tjerë, por nuk mund të lejojmë që një fond, qysh po kërkojnë disa, të shkojë në suficit dhe të mos kryhen obligimet ligjore.

Obligimet ligjore, pavarësisht rëndësisë së tyre, çfarëdo qoftë që janë, duhet të kryhen në kohë, përndryshe do të ballafaqohemi me pasojat ligjore dhe përndryshe do ta bartim një obligim të këtij viti në vitin e ardhshëm që do ta zërë hapësirën e Buxhetit dhe do të bëjë shumë probleme për ta përmbushur atë obligim. Prandaj, ka qenë një rishikim i domosdoshëm për t'i adresuar këto nevoja.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Unë po e kuptoj që ky është rishikim i Buxhetit dhe nuk është Buxhet i ri, prandaj nuk e di pse disa po diskutojnë, thujse po diskutojnë për një program të ri qeveritar.

Konkretisht po dua të diskutoj gjithashtu për shëndetësinë, për vendimin e Qeverisë nr. 08/151, datë 2. 8. 2017. Po flas konkretisht për reduktimin që është bërë për investimet kapitale në Spitalin e Gjakovës prej 200 mijë eurove. Flas për arsyen, sepse dihet se Spitali i Gjakovës është një ndër spitalet ku nuk ka pasur ndihma në përmirësimin e infrastrukturës ose kushteve të punës atje, sikur ka pasur në spitalet tjera regjionale dhe në këtë spital, i cili punëson një numër të konsiderueshëm të punëtorëve shëndetësorë dhe të mjekëve e motrave medicinale dhe kryen shërbime për shumë komuna të tjera, siç është për shembull Komuna e Rahovecit, e Malishevës, pastaj kryen 99% të shërbimeve për komunën e Deçanit dhe Junikut. Gjithashtu, me

marrëveshjen ndërshtetërore ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kosovës merr obligim dhe kryen shërbime si për qytetarët e Tropojës, Krumës, Qarkut të Kukësit, Bajram Curr e tjera, si qytetarë të barabartë, domethënë me një trajtim të barabartë.

Këtu kryhen afërsisht 400 operacione dhe 200 lindje në vit, ku rezultatet dhe sukseset janë evidente. Unë kërkoj që me anë të një amendamenti këto mjete t'i kthehen Spitalit, sepse ai punon në kushte shumë të vështira, edhe pse thashë që sukseset janë të mira, por duhet përmirësuar këto kushte. Natyrisht, në Buxhetin e ri të vitit 2018 unë do të kërkoj më shumë ndihmë për këtë spital, por tani si amendament kërkoj që t'i kthehen paratë që janë marrë me vendimin e Qeverisë, datë 2. 8. 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Nga të gjitha fjalimet, komentet, sinqerisht gati e tha Flora atë që pata me e thënë. Unë në radhë të parë e përgëzoj ministrin Bedri Hamza si ministër i Financave, sinqerisht në momentin që është emëruar ministër, ndoshta ka qenë njeriu më profesionist dhe më adekuat. E përgëzoj për korrektësinë, saktësinë, sepse mbi të gjitha është diçka që është korrekte dhe e matshme dhe jo sikur ka ndodhur në Qeverinë e kaluar, kur është folur shumë dhe në fakt është realizuar shumë pak.

Në fakt, projekti, ose Buxheti i vitit të kaluar, i Qeverisë së kaluar më shumë ka qenë sikur fushata që ende s'po përfundon edhe këtu në Kuvend, me poezi, me proza, e çka jo tjetër. Në fakt, sot shumë kategori presin që ta miratojmë rishikimin e projekt-Buxhetit. Një shqetësim që mua më tepër më ka bërë përshtypje është shuma për shumë vende, në fakt janë shuma shumë të mëdha, që janë të qiradhënies, qiramarrjes, në fakt janë para që shpenzohen nga qytetarët e Kosovës për objekte të shfrytëzuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Është një shqetësim jo sot në këtë vit, por vite të tëra, kur qeveritë që nga paslufta nuk merren me këto shuma shumë të mëdha, që i kushtojnë Buxhetit të Kosovës, në fakt janë taksa të qytetarëve dhe që nuk mendohet drejt në objekte, për të cilat nuk do të shpenzoheshin para pra për qira, janë shuma marramendëse, si 300 mijë euro, pastaj për mbulimin e shpenzimeve kontraktuese nga qiraja për ndërtesa, domethënë në shumën prej 300 mijë euro të Administratës Tatimore të Kosovës, pastaj në mirëmbajtjen e ndërtesave qeveritare dhe pagesën e qirave gjithashtu në shumën prej 200 mijë eurove, e shuma të tjera. Thjesht, është një shqetësim shumë i madh që është shqetësues dhe nuk do të duhej të ndodhte, që me një planifikim në të ardhmen do të duhej të punohej më mirë, të ndërtoheshin objekte të tilla dhe të mos paguhej qira. Këso qirash ka në shumë vende që paguhen dhe thjesht po i kushtojnë Buxhetit dhe mbi të gjitha qytetarëve të vendit.

Unë ju përgëzoj ministër për kompensimin e dëmeve të fermerëve nga ngordhja e kafshëve prej sëmundjes gungore, që ka qenë e janë përballur qytetarët vitin e kaluar dhe, në fakt, është një kompensim i cili u është mohuar qytetarëve dhe unë ju përgëzoj që keni menduar edhe për këtë kategori, se në fakt sinqerisht më së paku do të duhej të bëhej fushatë me qytetarët.

Dhe, pres që ky rishikim, jo vetëm të kalojë, sepse mbi të gjitha është shumë i matshëm dhe është shumë i qartë, por të punojmë sinqerisht në Buxhetin e vitit të ardhshëm, me projekte që janë shumë më të sakta dhe shumë më afër qytetarëve, që unë pres dhe jam shumë e sigurt që këto do të ndodhin në qeverisjen tuaj, sinqerisht në Qeverinë e Republikës së Kosovës, por mbi të gjitha në sektorin ku ju udhëhiqni, ngase keni treguar edhe në mandatet e kaluara.

Prandaj, edhe njëherë, pres që të flasim konkretisht, të mos flasim tamam sikur jemi, e di që është edhe koha e balotazhit, po flasim dhe po shihet pra që ende nuk na është hequr nga koka çështja e fushatës, ne të gjithë kemi qenë në fushatë, dikush ka fituar e dikush ka humbur, por megjithatë ne jemi për qytetarët dhe të shohim se çfarë po përfitojnë qytetarët prej nesh sot. Nga ne i kanë drejtuar sytë shumë qytetarë dhe presin miratimin e këtij rishikimi të Buxhetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, deputetë të nderuar!

Përshëndetje, zoti kryesues e qytetarë të nderuar!

Nuk e kisha ndërmend të lajmërohem fare për fjalë, sepse në emër të grupit e tha fjalën deputeti Enver Hoti, por meqë këtu u fillua të bëhet politikë, thash hajt të përfshihem edhe unë pak në këtë politikëbërje, sepse në aspektin personal të Buxhetit mendoj se u tha nga grupi, por tash do t'i them edhe unë disa fjalë sa u përket disa çështjeve që u ngrehën këtu.

Mendoj se të jesh për bashkim kombëtar dhe t'ia fusësh lapsin se sa ka kushtuar një autostradë, del pak hipokrizi, sepse projektet e mëdha kombëtare natyrisht kushtojnë. Gjeneratat tjera e kanë paguar me gjak, ndërsa edhe gjenerata jonë, kemi shumë shokë, bashkëluftëtarë të cilët e kanë dhënë jetën për ta bashkuar kombin dhe tash t'ia fusësh lapsin nëse ka përfitim nga ajo autostradë apo jo, nuk është bash korrekte. Mund të ketë qenë çmimi më i lartë, ka mundur ndoshta të ketë edhe ndonjë çmim më të ulët, por autostrada është aty, nuk ikën më, nuk zhduket më dhe kombi gjithnjë e më shumë do të shkojë duke u afruar dhe duke u bashkuar.

Pra, ky është një projekt konkret për të cilin "Nisma", edhe pse është krijuar pas autostradës, ndihet krenare, sepse kryetari i saj ka qenë ministër në Qeverinë, e cila e ka ideuar dhe e ka zbatuar projektin e autostradës. Fatmir Limaj, nëse ju kujtohet, po...

Tash, dalim te kjo autostrada e Gjilanit. Luta në mënyrë perfekte e ka krijuar një armik që nuk ekziston, pastaj luftoi si kuçedër kundër atij armiku dhe në fund e mundi armikun. Kjo është mjeshtri e tij. Bravo, hallall i qoftë, e krijoi kundërshtarin, pra tha “po na e marrin autostradën”. Çka duhet bërë kur dikush të merr diçka, a duhet luftuar kundër tij? Hyri në luftë dhe e fitoi luftën. Dolën të gjithë pastaj edhe i thanë Lutës, “O, jo bre, nuk e kemi ndërmend të ta marrim autostradën”. E ai të nesërmen, tha: “A e patë, unë reagovala dhe e shpëtova autostradën”.

OK, bëhen edhe këto lojëra politike, por le të dihet që janë strategji të fushatave, të cilat nganjëherë edhe japin rezultat siç i dha Lutës rezultat kjo, por e vërteta është se nuk ka pasur, së paku për aq sa unë i kam parë letrat, ndonjë lëvizje buxhetore të atyre vijave. Ndoshta, nëse ka diku që janë lëvizur e unë s’i kam parë, mirë do të ishte të na i tregojë.

Dhe, e treta, desha të ngre çështjen e veteranëve, të flas edhe unë, t’i them disa fjalë për çështjen e tyre. Pa dyshim që ajo shifër është e madhe, edhe veteranët vetë e thonë, edhe drejtuesit e tyre vetë e thonë. Natyrisht se këtu dikush mban përgjegjësi, edhe personale, por edhe organizative, edhe qeveritare, por është një parim universal, nuk mund t’ia mohosh të drejtën dikujt që ka të drejtë ta ushtrojë atë të drejtë vetëm pse në kategorinë e tillë kanë hyrë edhe njerëz që nuk e meritojnë. Bëjmë padrejtësi të dyfishtë.

Ne duhet të fillojmë t’i kryejmë obligimet ndaj asaj kategorie ashtu siç e parasheh ligji. Keni mundur me ligj e me kohë të mos ua jepni dhe pastaj do të shndërrohej në një çështje tjetër, që a dëshiron kjo shoqëri apo nuk dëshiron ta shpërblejë apo ta trajtojë më me dinjitet atë kategori. Kjo është çështje tjetër, por tani kur e kemi ligjin këtu, ne jemi të detyruar ta zbatojmë atë ligj dhe njëkohësisht, të gjithë ata që e duan Buxhetin e vendit, që e duan vendin, të gjithë ata veteranë që nuk janë veteranë, por që për nga ligji kanë fituar të drejtë, duhet të denoncohen, nëpërmjet ligjit duhet t’u merret ajo e drejtë, sepse me një ligj u është dhënë dhe vetëm me ligj mund t’u merret. Me arbitraritet, autoritaritet, nuk mund të ushtrohet në atë mënyrë sa t’u thuhet “këtu janë 60 mijë, apo 20 mijë”, sa do të marrin 20 e ca mijë sa do të paguhen, dhe tash “shihe, këtu nja 10 mijë nuk e meritojnë...”. Por, çështja pastaj kalon te individit, te emri i përveçëm, kush është ai që nuk e meriton? Nuk e kemi zgjidhur, as nuk e kemi hequr nga rendi i ditës vetëm duke thënë “ka malverzantë, ka falsifikatorë...”, por këtu tash nuk janë shpallur të gjithë përnjëherë veteranë nëpërmjet ligjit, të gjithë i janë nënshtruar njëfarë procedure dhe nëpërmjet së njëjtës procedure duhet të trajtohen ashtu siç e parasheh ligji.

Nuk besoj që duke e shtyrë, duke e zvarritur këtë çështje për shkak se ka të tillë që nuk e meritojnë, bëjmë ndonjë punë të drejtë. Mendoj se gabojmë, u hyjmë në hak dy herë, nëse për shkak se ka malverzantë nuk u dilet hakut, nuk zbatohet ligji edhe për kategoritë, për ata të cilët janë në këtë kategori me meritë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan Molliqaj ka kërkuar replikë.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Me një pjesë shumë të vogël të asaj që e tha zoti Sherifi pajtohem. Është e vërtetë që çështjet që kanë interes kombëtar kurrë nuk janë me laps, se po të hysh me laps plot sende s'bëhen. Por, është interesant me pjesët tjera ku unë s'pajtohem.

Kjo autostradë nuk ka përfunduar në Prishtinë, po në Merdar. Edhe ajo s'është ndonjë problem i madh në vetvete, por s'di a e di që në këtë autostradë kamionët e Serbisë për Shqipëri janë rritur prej se është ndërtuar. Pra, asaj pjesës së kombit nëse nuk ia shton edhe ekonominë pastaj, ka rrezik t'i bëjë dëm kombit. Pra, mendoj se deri tash, çka kemi bërë me këtë autostradë, ia kemi bërë një dëm të madh kombit, sepse produktet e Serbisë e kanë vërshuar edhe tregun e Shqipërisë dhe Serbia po bëhet faktor rajoni në aspektin ekonomik. Kështu që ia keni bërë një nder Serbisë me këtë punë.

E dyta, atëherë ke qenë në PDK, e tash je në "Nismë", por je bashkë me PDK-në. Ju të PDK-së keni vjedhur edhe në shtatore të dëshmorëve, pra diçka që ka qenë shumë kombëtare. Ju s'keni përtuar të vidhni. Autostrada për të cilën po flasim, shumë mirë që është ndërtuar, por është dashur t'ia bashkëngjitni edhe ekonominë, por mbi të gjitha është e pafalshme dhe e papranueshme që trefishin e çmimit të tregut e kemi paguar për këtë autostradë, më shtrenjtë se vendet evropiane dhe trefishin e çmimit të tregut në Kosovë. Ai trefishi, njëfish është dashur të paguhet, ky dyfishi tjetër është ndarë në përqindje. Ka aty njerëz që kanë marrë përqindje. Nuk e di a ke marrë ti, veç që kanë marrë njerëzit, kanë marrë. Unë e di që ju ia futur shti lapsin kësaj, në fakt lapsin ia keni futur, por për vete, as për kombin, as për shoqërinë. Se as nuk po zhvillohet ekonomia në Kosovë e në Shqipëri, por po zhvillohet ekonomia në Serbi, pra po i ndihmon asaj, dhe nuk janë pasuruar qytetarët e Republikës, nuk janë punësuar qytetarët e Republikës, por janë pasuruar disa politikanë që kanë qenë në Qeveri.

Pra, hajde...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Po, kolegu Molliqaj i tha përshtypjet e veta, pikëpamjet e veta. Këtu s'kam çka merrem me të. Krejt këtë do ta kisha përkufizuar me një fjali.

Dardanit nuk i intereson e vërteta. Rëndësi ka ajo që ai e thotë. Pastaj, thotë "kushdo le ta besojë, kushdo mos ta besojë", dhe kjo ma kujton një ngjarje, është mjeshtër në këtë drejtim, një ngjarje shumë interesante në histori. Në vitet diku 1700 e diçka, në kohën e Revolucionit Francez, u tha, u shpërnda se mbretëresha, kur i kanë thënë se populli s'po ka bukë të hajë, atëherë ajo paska pas



thënë, në mos paçin bukë le të hanë biskota. Edhe nuk ka rëndësi pastaj a e ka thënë ajo apo s'e ka thënë, njerëzit besuan që ka thënë.

Edhe ky Dardani nuk mërzhitet për atë nëse është e vërtetë apo s'është, për të ka rëndësi ta thotë atë që ai e dëshiron ta thotë, ta plasojë atë që ai dëshiron ta plasojë, fare nuk shqetësohet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, e kemi pauzën deri në orën 15:00.

\* \* \*

*Vazhdim i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj,  
Po e vazhdojmë seancën. Fjalën e ka zoti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Realisht unë i dëgjova me vëmendje edhe arsyeshmërinë e rishikimit të Buxhetit për këtë vit nga ana e ministrit të Financave, por edhe kolegët deputetë nga kampi opozitar dhe nga kampi i Qeverisë.

Unë konsideroj që kur janë çështje të rëndësisë për institucionet, qytetarët e vendit dhe ato shtyllat që e mbajnë gjallë një shtet, duhet të jemi të kujdesshëm, të saktë dhe profesional.

Tek e fundit, ardhja e rishikimit të Buxhetit në këtë tremujor të fundit, kur dihet që Qeveria e ka një mundësi ligjore të bëjë alokime në një përqindje të caktuar të Buxhetit.

Kërkesa për shtesë në alokime të reja të Buxhetit janë diku në 90 milionë euro. I shikova me vëmendje, diku rreth 45 milionë euro janë marrë nga investimet kapitale.

Jemi në fushatë zgjedhore dhe unë jam ithtar i asaj që ne të flasim këtu si të zgjedhur të popullit, sepse ato janë zgjedhje lokale e duhet të kemi përgjegjësi të fjalës publike.

Duhet të jemi kujdesshëm, zoti ministër, që kur bëhet rishikimi i Buxhetit projektet e caktuara për lokalitete të caktuara, qoftë ajo edhe një fshat me 30 shtëpi, të jemi të kujdesshëm se, mbase 5

000 apo 10 000 euro për atë lokalitet për një shtesë kanalizimi apo ujësjellësi kanë rëndësi jetike apo, mbase edhe një pjesë e ndriçimit për lokalitete të caktuara dhe këtu duhet të jemi të kujdesshëm.

U përmend nga disa kolegë deputetë, por edhe nga ministri çështja e pagesës së veteranëve.

Ju lutem, obligimet ligjore duhet të respektohen, edhe këtu nuk ka kompromis, ama pse nuk është terrorizuar opinioni me shifra, me dhjetëra-mijëra, sepse ne këto 20 vjetët e fundit kemi qenë këtu dhe i dimë të gjitha ato. Është komplet nganjëherë papërgjegjësi edhe e gjyqësorit, sepse realisht me këto çështjet duhet të merret drejtësia. Nuk mund të merret as ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, as ministri i Financave dhe as kryeministri, por është jologjike, zoti ministër, që diku rreth 50 milionë në vit, që ka qenë një akordancë edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar të ndahen për veteranët dhe për invalidë dhe 50 milionë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e presim të bëhet ushtri.

Sa i takon çështjes së 17-milionëshit që ka qenë i ndarë për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Fondi është themeluar, ministër, kemi një ushtrues detyre, kemi një administratë të caktuar aty, por është e vërtetë që është marrë vendim qeveritar për plotësim-ndryshimin, ndodhën zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe ai ligj nuk është proceduar.

Por, duhet ta krijojmë një disiplinë financiare për obligimet ligjore, në këtë rast për veteranë dhe invalidë dhe duhet ato mjete të shikojmë se ku po i dërgojmë.

Sa më shkroi drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi nga Komuna e Istogut, thotë që sot janë furnizuar me material shëndetësor dhe i kanë shkuar shiringat pa gjilpëra. Të gjithë nganjëherë ngritën kundër mjekëve dhe personelit mjekësor, se gjendja është e keqe në shëndetësi, e tjera e tjera, e në 80% të rasteve fajësohen mjekët. Jo, sistemi nuk është në rregull, thjesht këto 18 vjetët e fundit e kam të paqartë pse asnjë Qeveri nuk u ul, me një konsensus me fokus grupe, me profesionistë dhe ta stabilizonte një herë e përgjithmonë këtë sistem.

Unë kam kërkuar këtu publikisht që 100 milionë euro ndahen më shumë për sistemin shëndetësor në vend. Nuk është asgjë që të lihen nga 10 kilometra investime kapitale në infrastrukturë, ministër i Infrastrukturës, sepse vini nga shkencat shëndetësore, dhe të destinohen për sistemin shëndetësor në vend.

Prandaj, u tha shumëçka dhe nganjëherë po merremi me akuza dhe kundëraakuza dhe nuk po ndalemi në aspekte substanciale.

Po vazhdon trendi i buxheteve shabllon dhe nuk ka performansë të një projektligji, por dua të besoj që Projektligji për Buxhetin e vitit 2018 të ketë objektiva të qarta, të ketë disiplinë

financiare, të ketë balancë mes të hyrave dhe shpenzimeve, që thjesht e mbajnë gjallë shtetin dhe shoqërinë, por duhet të ketë edhe objektiva zhvillimore në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kurse, sa u takon aspekteve të tjera, kur një Buxhet i një shteti duhet t'i prekë të gjitha shtresat e shoqërisë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm që në Buxhetin e ardhshëm për vitin 2018 të ketë shpërndarje të barabartë, sepse pati fillua të krijohet një kulturë e shpërndarjes së Buxhetit për të gjitha komunat dhe regjionet në nivel Kosove, qoftë investime në spitale regjionale, qoftë në infrastrukturën rrugore apo edhe në infrastrukturën tjetër.

Unë dua t'i bëj një kërkesë ministres së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila nuk është këtu, që të shikojë që në projekt-Buxhetin e ardhshëm ta ndajë një shumë të konsiderueshme për rregullimin hapësinor dhe planet rregullative për zonat e rëndësishme turistike, siç janë Bjeshkët e Rugovës dhe Bjeshkët e Sharrit, sepse ka hyrë ligji në fuqi, kanë filluar procedura, janë krijuar shpenzime dhe nuk është bërë zonimi adekuat.

Gjithashtu inkurajoj ministrin e Infrastrukturës që t'i lidhë qytetet, e në veçanti t'u ikë qendrave të qyteteve të caktuara, konkretisht rruga Klinë-Gurrakoc, t'i ikët qendrës së Klinës. E pashë aty një projeksion buxhetor prej 900 mijë eurove, por të ndërmerren edhe hapa të tjerë për lidhjen edhe të qyteteve dhe qytezave të tjera, në mënyrë që t'u krijojmë lehtësi qarkullimi edhe njerëzve, edhe studentëve, edhe bizneseve të tjera.

Te e fundit, rishikimi i Buxhetit është çështje e mazhorancës dhe e Qeverisë. Ju e keni paraparë kështu dhe unë uroj që thjesht ky destinim, ky rialokim i mjeteve të shkojë në interes të zhvillimit ekonomik dhe të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

*Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Më herët ministri Bedri Hamza e dha një zotim këtu për këtë vit, tha që do të jetë rritja ekonomike prej 4%, sipas parashikimeve të njësitit makro-ekonomik në Ministrinë e Financave që ky e drejton. Nuk e di se sa është për t'i besuar këtij parashikimi që jep zoti Hamza, sepse nuk është si në të kaluarën nuk kemi pasur raste po me këtë njeri, kur ia ka huq rritjes ekonomike edhe kur ka përfunduar viti, e lere më 2 muaj pa përfunduar viti, po ia ka huq edhe kur është krye viti, e lere më në parashikim, siç bëri sot.

Për ta kujtuar një rast në vitin 2014, BQK-ja nën drejtimin e Bedri Hamzës, kur ky ishte guvernator, pati thënë që, në fund të vitit natyrisht, që rritja ekonomike ka qenë prej 2,7%, për të njëjtin viti Banka Botërore sipas Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës thoshte që ka qenë vetëm 1%.

Pra, tash ky po thotë që do të jetë qenë 4%, e nëse aplikojmë të njëjtën, të them kështu, llogaritje që paska bërë sikur në vitin 2014, i bie të jetë 1.5% rritja ekonomike për vitin 2017, po kjo mbetet natyrisht të shihet pasi të përfundojë viti.

Është e çuditshme se si kjo seancë prej orës 10:00, e në të duke u diskutuar Buxheti ose rishikimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe kryeministri nuk është fare. Pra, erdhi gjysmë ore, tha që ka një takim shumë të rëndësishëm dhe nuk u kthye më, që i bie praktikisht që kjo e tregon se si i paskan ndarë punët në Qeveri. Pra, menaxhimin e financave publike dhe Buxhetin ia paska lanë PDK-së, e Ramushi për vete merret me shkarkim bordesh e falje borxhesh, dhe kur flitet nga pozicioni i kryeministrit për punësim, nënkuptohet të krijojë kushtet, në mënyrë që zhvillimi ekonomik t'i punësojë qytetarët, e jo të trajtohet shteti dhe institucionet shtetërore si firmë në të cilën i punëson të vetët.

Pra, ky po më duket që është një keqkuptim që e paska Ramush Haradinaj si kryeministër, që do të ishte mirë ta përmirësonte.

Po projektligjin që e kemi përpara, edhe pse konsiderohet të jetë rishikim i Buxhetit, nuk është i tillë. Ndryshimet në të nuk janë rishikim, e kjo që kemi përpara vështirë të quhet Buxhet.

Ndryshime në Buxhet janë dy, me këtë që e kanë sjellë nëpërmjet këtij projektligji që po e diskutojmë sot.

Shkurtimi i shpenzimeve nga 2 miliardë, në 1, 8 miliard, si dhe bartja e dy zërave buxhetorë nga ajo që është menduar të jetë për sigurime shëndetësore te zbatimi i Ligjit për veteranët dhe nga shpenzimet e tjera kapitale, në autostradën Prishtinë-Hani i Elezit, këto janë dy ndryshime madhore që i kanë ndodhur këtij Buxheti sot.

Dhe kështu më së miri vërtetohet nëse shikohet te pjesa e të hyrave në tabelën një të Buxhetit nuk ka ndryshuar as edhe një numër i vetëm. Megjithëse raporti gjashtëmujor i të hyrave për vitin 2017 paraqet trend më të vogël të rritjes së të hyrave tatimore, nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, më saktësisht rritja e buxhetuar është 6,4%, kurse rritja e realizuar për gjashtëmujorin e parë është vetëm 3%.

Nëse rishikimi do të bëhej si duhej, reflektimi në të hyra do të ishte një ulje prej 50 milionë eurosh, pra të hyrat reale do të jenë 1,463 miliard, e jo 1,512 miliard, siç janë në këtë Buxhet.

Gjithashtu pjesa tjetër e ndryshuar është tek pjesa e financimit, gjë për të cilën patëm paralajmëruar vitin e kaluar që nuk është reale, por megjithatë PDK-ja dhe LDK-ja, që atë botë ishin në koalicion, e votuan këtë Buxhet ashtu siç ishte.

Dhe kështu vijmë deri te konstatimi i dytë, pra që ky nuk është Buxhet fare, sepse Buxheti është një instrument politik ekzekutiv, nëpërmjet të cilit zbatohen parimet programore e të politikave të një qeverie të caktuar.

Përveç që nëpërmjet tij do të duhej të zbatohet një plan i caktuar zhvillimor, Buxheti po ashtu do të duhej ta orientonte paratë publike drejt sektorëve të caktuar, ku do ta ndikonte zhvillimin, mirëqenien dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Kjo nuk mund të bëhet kur nuk ka as vizion zhvillimor, e as planifikim të financave publike.

Shkurtimi i shpenzimeve si parim mbi parimet që është përdorur nga Qeveria e kaluar, e që po vazhdon edhe nga kjo, nuk është as mençuri, e as dobi ekonomike.

Natyrisht që me këtë nuk po them se shpenzimet duhet të rriten vetëm për hir të rritjes, ato duhet të rriten atëherë kur nevojat zhvillimore të identifikuar e të planifikuara mirë tregojnë qartë se investime në sektorë të caktuar do ta nxisin e do ta rrisin ciklin ekonomik, në mënyrë që viteve të mëpastajme të kemi rritje të të hyrave e më shumë mundësi për më shumë investime, për më shumë rritje ekonomike në funksion të rritjes së mirëqenies, por jo në Kosovë.

Në Kosovë ka vetëm shkurtime, e shkurtimet e shkurtojnë dhe e cungojnë mirëqenien dhe e rrudhin potencialin.

Një prej justifikimeve kryesore të neoliberalizimit është ajo që në anglisht quhet “threcall down economy” që nënkupton se sa më shumë që grumbullohet pasuri lart në hierarkinë shoqërore, aq më shumë do të pikë ajo poshtë.

Po ja që këtu në Kosovë, sikur në vendet e tjera, është dëshmuar që aplikimi i parimeve neoliberale në shtet dhe ekonomi e bën atë që në vend se të pikë poshtë, pasuria të vërshojë lart, pra të vërshojë te ata që tashmë i kanë punët mirë dhe jo vetëm kaq.

Edhe ky projektligj tregon se Buxheti në Republikën e Kosovës nuk planifikohet fare ose qëllimisht planifikohet keq.

Pra, tash kah fundi i vitit, po e marrim vesh që Buxheti i vitit 2017 ka qenë i fryrë në rrafshin e të hyrave, ka qenë pra mashtrim dhe i fryrë e i paplanifikuar në rrafshin e shpenzimeve, prapë pra, mashtrim.

Edhe kur ishte miratuar, ishte bërë për qëllime propagande, edhe tash kur po rishikohet, po bëhet për të njëjta qëllime. Pra, nuk është Buxhet, alokim i parave publike për zbatimin e politikave zhvillimore, por po trajtohet si para xhepi të kryeministrit e ministrave për të blerë popullaritet e për të kënaqur miq.

Kjo është logjika e 'tyxharit' problematik. 'Tyxhari' problematik udhëton e jeton nga tregu në treg, e blen lopën në tregun e para ditës 200 euro, e shet atë 180 euro pasdite, prej të cilave pastaj në mbrëmje i shpenzon 80 euro dhe i mbesin vetëm 100 euro për ta filluar ditën e nesërme dhe thotë i lumtur: "Dita e re, nafaka e re".

Po ja që jemi në vitin 2017, deputetë të nderuar, po bëhen 10 vjet që jemi shtet i pavarur dhe sovran, asnjë ditë nuk ishte as e re, e as nuk solli kurrfarë "nafake të re". Pra, po lëvizim nga Bedri Hamza te Besim Beqa, nga Besim Beqa te Avdullah Hoti, nga Avdullah Hoti te Bedri Hamza dhe kështu po sillemi në këtë qerthull vicioz të keqbuxhetimit, keqplanifikimit dhe pamundësisimit të zhvillimit ekonomik e rëndesës për jetën e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ministri i Financave e ka fjalën. Ndërkohë le të bëhet gati zonja Xhefahire Izmaqi.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Ma përmendi emrin zoti Ymeri, po bëj replikë,

Jo, sa u përket parashikimeve për rritjen ekonomike, e shpjegova në fillim, aty punon një numër i madh i njerëzve, për të cilët unë kam respekt. Besoj që ka respekt apo të paktën është dashur të ketë respekt edhe zoti Ymeri, se i njeh ata.

Sa i përket asaj se sa ua kemi qëlluar parashikimeve, se ato për rritje ekonomike janë vlerësime, janë parashikime, të lutem, merri e shikoi raportet e fundit të Bankës Qendrore dhe publikimet që i ka bërë Agjencia e Statistikave të Kosovës që kanë dalë të jenë të përafërta.

Ndërsa sa i përket vitit të parë them si guvernator, ato parashikime unë i kam trashëguar, i kam publikuar dhe nuk ka qenë ndonjë dallim i madh, se dallime të tilla ndodhin kudo nëpër botë, sepse janë dallime mes vlerësimit dhe asaj reale. E thashë, dhe po e ripërsëris që edhe vlerësimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për 2-3 muajt e parë të këtij viti dalin që në këtë vit Kosova do të ketë rritje ekonomike rreth 4%.

Tash nëse duam të lidhemi për fjale, a është 3.8 a 4.1, atëherë mbetet të shihet në fund, po këto janë vlerësime.

Ndërsa sa i përket pjesës tjetër, unë e dëgjova që jo shpenzime... edhe prej deputetëve të tjerë. Po nuk mund të ketë shpenzime pa pasur të hyra. E para, duhet pasur të hyra, pastaj shpenzime.

Prioritetet e qeverive mund të dallojnë, dikush ka prioritete të tjera, e dikush të tjera, mirëpo ky është një rishikim, i cili i adreson nevojat që kanë lindur si rezultat, disa për shkak ndoshta të planifikimeve jo të duhura, ndërsa disa edhe si rezultat sepse vendi ka shkuar në zgjedhje të parakohshme.

Prandaj, në këtë rishikim, në këtë kohë shumë të shkurtër, jemi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Do ta respektojmë Rregulloren në mënyrë të përpiktë. Zonja Xhevahire Izma. Kundër-replikë!

VISAR YMERI: Unë e përmenda atë për vitin 2014, sepse m'u duk goxha treguese për aftësinë tënde për t'i interpretuar shifrat dhe për të dhënë premtime, të cilat janë të papërbushura. Po nuk po them që nuk di të llogaritësh, unë po them që t'i qëllimisht i shtrembëron shifrat për të treguar një pasqyrë tjetër prej asaj që ndodh, sepse kjo na ka ndodhur edhe kur ke qenë ministër i Financave, edhe me kolegun tënd, Besim Beqën, si ministër i Financave, këtë logjikë të keqplanifikimit të Buxhetit ose projektimit të gabuar qëllimshëm të Buxhetit, me më shumë të hyra, ku pastaj në rishikim i keni reduktuar nganjëherë, e nganjëherë jo, e keni nisur ju si logjikë, pastaj e kanë përcjellë edhe këta të tjerët që kanë qenë bashkë me juve në qeverisje.

Pra, kjo nuk është mosdije, kjo është maliciozitet në projektim, i cili i kushton shumë ekonomisë së vendit.

Dhe, e dyta, po. Pritjet për rritjen e ekonomike edhe mund t'i kesh, siç i keni pasur zakonisht, mirëpo pritjet ishte dashur të përcillen me disa veprime, me të cilat e synon një rritje ekonomike të caktuar, të qëndrueshme ....

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zonja Xhevahire Izma, vazhdojmë se i kemi edhe 260 minuta në dispozicion.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që po e përcillni këtë seancë,

Para se të filloj fjalimin, i nderuar ministër, më lejo që pasi filluam me epitete, ta përcjell një kompliment për të cilin kam mundur ta tregoj edhe në parti kur jemi takuar, meqenëse po i dëgjoj kolegët këtu afër që të japin epitete që nuk të takojnë.

Kemi qenë një grup deputetësh në një konferencë botërore në Uashington DC këtë vit dhe, në një pauzë na u afrua një zyrtar i lartë amerikan i Bankës Botërore, ku na dha komplimente për emrin dhe punën tënde, kështu që mua më bëri të ndihem krenare, por edhe deputetët që nuk ishin të PDK-së u ndien krenarë. Pra, mjafton ajo që të tregojmë se çfarë pune ke bërë si guvernator edhe si ish-ministër.

Tani i dëgjova kolegët deputetë dhe nuk pretendoj të jem kompetente, edhe nuk jam në fushën e financave, mirëpo të gjithë e kemi përcjellë punën dhe sot megjithatë e përgëzojmë sjelljen e Buxhetit në rishikim dhe përmirësimin e atyre problematikave, të cilat na bëjnë që shpeshherë edhe ne të sfidohemi si deputetë dhe në përgjigje të telefonatave, kryesisht nga veteranët, të cilët më në fund sot do ta marrin në lajm, po shpresoj të mirë dhe besoj që pas të gjitha kritikave që i bëjnë kolegët deputetë, do ta votojnë në parim projektligjin.

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kisha planifikuar, duke menduar se me rishikim do të jetë shifra, të cilën e kemi parë si deputetë gjatë mandatit, mirëpo tash e shoh që ka qenë ndoshta më shumë imagjinatave dhe pres që të ketë përmirësime dhe sigurisht që do të ketë në menaxhimin tënd.

Një buxhet shtesë e kisha planifikuar të kërkoj për të gjitha kategoritë sociale në vend, e cila do t'u ishte dedikuar komunave në buxhetin e emergjencave. Pra, kryesisht qendrave sociale nëpër komuna për t'u mundësuar ndarjen e ndihmave së paku për furnizim me dru në këtë periudhë para dimrit, por vetëm familjeve që janë në skema sociale. Pra, i kam dëgjuar shpeshherë kryetarët e komunave që ankohen që në buxhetin e tyre për emergjenca nuk e kanë të mundur t'i përkrahin familjet, të cilat janë në nevojë, kryesisht në periudha të vështira qysh është para dimrit.

Duket ndoshta periferike dhe i ka takuar Komunës së Prishtinës, do të paraqes një shqetësim human lidhur me kushtet, në të cilat jetojnë të moshuarit në Shtëpinë e Pleqve në kryeqytet. Unë kam qenë në atë objekt dhe më erdhi keq, më vjen keq si shoqëri që ende nuk e shohim pleqërinë si moshë, e cila duhet të gëzohet e jo të shtyhet për mbijetesë. Qeramika të vjetruara, ftohësi dhe enterier të vjetër, pra mendoj se ata njerëz meritojnë një trajtim më human dhe nuk e di as që është diskutuar ndonjëherë në ndonjë forum gjendja e tyre në atë shtëpi. Pra, të mendojë Ministria e Punës pak buxhet shtesë do të ishte mirë, që në këtë moshë asnjëri nuk dëshirojmë t'i shohim prindërit e vet duke qëndruar në një objekt jodinjitoz.

Vlen të theksohet se stafi ka qenë i mrekulluar në punën e tyre, mirëpo kushtet i kanë shumë të vështira. Nuk e mbaj mend për këto katër vjet që e kam parë një vizitë të kryetarit aktual të Prishtinës duke i bërë asaj shtëpie, bile ta bënte për fushatë, pse jo edhe kandidatët e tjerë, së paku që të mobilizojnë ndërgjegjen ndaj moshës së tretë.



Tani më lejoni të theksoj dy shqetësime, të cilat lidhen me lokalitetin nga unë vij, pra nuk është që mund të bëjmë diçka në këtë pjesë, mirëpo po paralajmëroj për pjesën tjetër ku shpejt do të diskutojmë për Buxhetin e vitit 2018. Është në pyetje rruga magjistrale Prishtinë - Mitrovicë, e cila ka filluar që tre vjet dhe po shihet që do të zgjatë edhe më tutje nëse nuk do të ketë një kujdestari shumë më të fuqishme të ministrit dhe unë do të risjell vështirësitë e qytetarëve, pra për tre vjet radhazi në një rrugë, e cila duhet të bëjë 20 minuta dhe bën dy orë. Po besoj që me ministrin Hamza do ta kemi shumë të lehtë t'i shkojmë në fund edhe këtij problemi.

Meqenëse kam përpara ministrin Lekaj, bashkë ishim, domethënë e pamë qysh është gjendja në rrugën R220, për të cilën mendoj që e ka marrë shumë seriozisht ministri dhe besoj që në vitin 2018, ashtu siç u ka premtuar banorëve, edhe do të realizohet. Unë do të jem avokate për të gjitha projektet, të cilat komuna ime i ka paraparë që të jenë në projektet me të cilat duhet të bashkëfinancojë edhe Ministria e Infrastrukturës, mirëpo duke parë gjendjen dhe kuletën qeveritare, sa është mundësia, sigurisht që nuk po dua të bëj fushatë, edhe pse jemi në prag të balotazhit, mirëpo krejt në fund shpresoj që bashkë me kolegët, të cilët dhanë vërejtje shumë të mira, do ta miratojmë në parim dhe do të vazhdojmë përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën, regjia, më duket ka zë pak shumë, nuk e di a po ju pengon juve. Uleni pak, i lutem regjisë, se ka tepër zë.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Edhe ashtu jemi shumë vonë me rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, u tha që janë arsyet objektive, ka dhe subjektive, se kemi mundur të jemi më aktivë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, t'i kryejmë detyrat tona, por më shumë jemi marrë me fushatë, e për atë jemi vonë dhe presim pas këtij rishikimi menjëherë trajtimin e Buxhetit për vitin 2018, duhet ta përmbushim edhe këtë obligim.

Mendoj që çdo tendencë për t'i mjegulluar ose të mos sqarohen ashtu siç duhet të gjitha ato që janë obligime shtetërore sa i përket ndarjes së Buxhetit, e pengon Kosovën, i pengon qytetarët e saj në funksionimin e jetës normale. Prandaj, kur flitet për pagesën e pensioneve të veteranëve, ju i keni dëgjuar, i keni parë reagimet e tyre që disa muaj nuk i marrin pensionet, e ata, në fakt, nuk janë as për lëmshë, as për ndihmë sociale, madje as për pension, por janë për realizimin e një statusi që ne po thirrremi se janë vlera më e lartë e shoqërisë sonë, sepse kanë kontribuar për lirinë, demokracinë, kanë kontribuar që edhe ne të jemi në këto ulëse ku jemi këtu.

Prandaj, as që duhet vënë në pikëpyetje tensionet e veteranëve, por duhet të solidarizohemi me ta, sepse po të dalim në pozitën e tyre do të shohim vetën shumë më keq se sa që ndjehemi këtu

si deputetë. Po ashtu, u përmend edhe një vijë buxhetore, e cila vërtet është e çuditshme, se këtu thuhet që ka qenë i planifikuar Buxheti për autostradën Prishtinë - Gjilan - Konçul, e që në njërin anë thuhet se procedurat e prokurimit nuk janë kryer, në tjetrën anë thuhet se Buxheti veç ka qenë i paraparë. Dikush duhet të na tregojë këtu: a është e vërtetë që janë kryer të gjitha procedurat, e dikush po do të na e ndalë këtë buxhet, se do ta bartë tjetërkah, apo nuk janë përfunduar këto procedura, e dikush po do, në njëfarë forme, të tregojë që ka manipuluar për shkak të zgjedhjeve që i kemi pasur.

Këtë duhet sqaruar edhe Qeveria e tanishme, por edhe ata që kanë qenë më herët që i dinë, por në fund të fundit, nëse s'janë në gjendje ta sqarojnë asnjëra palë, atëherë thonë në popull: "Nëse pitja është hëngër, tepsia është". Janë dokumentet, janë faktet të cilat tregojnë se a ka manipuluar dikush me rastin e parashikimit të këtij Buxheti për këtë autostradë, apo dikush po do ta ndalë, kjo duhet të sqarohet. Dhe, njëkohësisht po ju them, edhe ashtu Anamorava ka qenë regjion, i cili është anashkaluar vazhdimisht. Shpresoj që kjo qeveri duhet të mbledhë mend nga qeveritë e tjera që ta trajtojë Kosovën një, të pandarë, në interesin e të gjithë qytetarëve, se në fund të fundit, të gjithë kemi kontribuar që të ketë në Kosovë të lirë, të pavarur, demokratike dhe një shtet funksional ashtu qysh e meritojnë qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën, ministri i Transportit, zoti Pal Lekaj.

**MINISTRI PAL LEKAJ:** E kuptoj shqetësimin e deputetëve të Parlamentit të Kosovës, por diç nuk përputhet me deklaratimet, edhe të kryetarit të Gjilanit, por ajo që më duhet ta them, procedurat nuk janë ndjekur konform Ligjit të prokurimit publik.

Lënda është në OSHP, Organin e Shqyrtimit Publik, që do të marrë vendim, mirëpo unë kam kërkuar edhe opinione të tjera nga auditimi i brendshëm, edhe opinionin e Zyrës Ligjore dhe në bazë të rekomandimeve do të marrim vendime. Por, diç mund t'i sigurojë qytetarët e Gjilanit dhe të Anamoravës, kjo autostradë do të bëhet jo për hir të individëve, jo për fushatë elektorale, por Qeveria e Kosovës është e vendosur që t'i trajtojë të gjithë qytetarët anekënd Kosovës, të gjitha regjionet dhe nuk do të injorohet asnjë regjion, asnjë komunë dhe, të jeni të bindur, që Qeveria e Kosovës do të funksionojë në të gjitha kërkesat e shtruara nga të gjitha komunat, sepse mund të them lirisht para juve, ka pasur diskriminim, ku kanë qenë kryetarët që e kanë pasur kryeministrin kanë shkuar dhjetëra e dhjetëra miliona, ndërsa janë diskriminuar shumë komuna që nuk kanë pasur qasje në qeveri. Kjo nuk do të ndodhë në këtë qeveri, por nuk do të bëhet për individë të caktuar, por për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe autostrada e Gjilanit do të bëhet, mirëpo konform procedurave ligjore. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

E para, kisha dashur të më përgjigjesh blic se e kam një pyetje për ty, por kurrë s'po të zë. Tash, po vazhdojmë, jo sot, s'kemi mundësi, se jemi për Buxhet, por nesër, ndoshta.

Zoti kryetar, çështja e Buxhetit për të cilën ne po diskutojmë sot besoj që ministri Hamza u kthye se e kam pasur shok klase, ashtu ikte edhe prej mësimit kur flisja unë, po u kthye në sallë. E çështja për të cilën ne po flasim është çështje ekskluzive e PDK-së dhe e LDK-së. Unë sinqerisht po habitem jo me deputetët e rinj të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por me deputetët e kaluar, pasi që kjo pjesë e Buxhetit i përngjan në mënyrë absolute, sikur djemtë kur duan ta lënë nënën në rrugë: “jo po e marr unë, jo po e marr unë”. Kjo është pjesë e Buxhetit të kaluar dhe këtu s'kemi çfarë të diskutojmë, mirë apo keq, ka qenë pjesë e qeverisë së kaluar në të cilën ka qenë Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës.

E dyta, kisha dashur prej ministrit Hamza të më tregojë se Buxheti prej 2 miliardëve i qeverisë së kaluar a ka qenë Buxhet real apo ka qenë Buxhet i rrejtshëm, që u rrejt qytetari i Kosovës. Në këtë duhet të përgjigjesh, zoti ministër, besoj pasi që unë do ta përfundoj. Sa i përket çështjes të asfaltit, sikur unë të isha kryeministër i Kosovës dhe ministër i Financave, asnjëherë nuk do të çoja Buxhetin e Qeverisë time mbi 30% në asfalt, për arsye se kjo është një eksperiencë edhe e Sllovenisë, e Kroacisë, edhe e vendeve perëndimore. Sikur qeveritë e kaluar të kishin investuar më shumë në çerdhe, ne edhe këtu në Parlament do të kishim një nivel tjetër të debatit, sepse s'ishim rritur me tëhollues e me bisht të shatit duke na rrahur në familje, por ishim rritur me moshatarët tanë edhe kishim treguar krejt një kulturë tjetër të debatit.

Qeveria e Kosovës në të ardhmen Buxhetin duhet ta orientojë në çerdhe, në spitale, në azilet e pleqve, në shkolla moderne, në qendra të rekreacionit që rinia jonë t'i ikë drogës dhe t'i kthehet jetës reale. Prandaj, unë pavarësisht se do ta votoj këtë pjesë të Buxhetit që ka mbetur, po flas për Buxhetin e vitit 2018, sepse në fund të fundit, popujt nuk hanë asfalt, janë disa prioritete më të mëdha që të ndërtojmë spitale moderne, sepse qytetarët e Kosovës gjatë një viti në bazë të disa llogarive shpenzojnë 120 milionë euro për shërimin e tyre jashtë territorit të Kosovës.

Sa i përket çështjes së një deputeti, të cilit nuk po ia përmend emrin që e ngriti çështjen e tenderëve, të asfaltit, e të rrugës së kombit, unë e garantoj deputetin se edhe në Lëvizjen “Vetëvendosje”, edhe në Partinë Demokratike të Kosovës, jo deputeti që foli, por dikush mbrapa kurrizit të tij kanë marrë shumë tenderë të asfaltit, edhe në rrugën e kombit, edhe tenderë të tjerë, por për këto do të flasim në ndonjë seancë tjetër parlamentare.

Tash po kaloj tek çështja e veteranëve të luftës.

Zoti ministër, unë personalisht mendoj që kategoria më e ndershme, më e respektuar janë pikërisht kjo kategori dhe ne po t'i pyesim institucionet ndërkombëtare rreth qëndrimit tonë për veteranët e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po bëj be që gjysmën prej tyre kishim

dërguar në Dyz, në burg. Kështu që ju duhet të merrni vendim në bazë të listave, të cilat çdokush e di që fill pasluftës numri i veteranëve të luftës ka qenë 17 mijë. Se kush e ka fryrë at listë në 60 mijë, për atë duhet të përgjigjen përpara prokurorit të shtetit edhe ish-ministrat e Partisë Demokratike të Kosovës, edhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ata që i kanë fryrë listat, edhe ata që i kanë bërë listat.

Por, ju garantoj, zoti ministër, që edhe ajo nëna që ka bërë fli maje malit gjatë luftës, e ka më meritore rrogën se sa pjesa dërmuesve e ne deputetëve në Parlamentin e Kosovës. Kështu që atë pjesë unë për vete nuk e kisha prekur.

Dhe, në fund, kisha dashur të them që jemi vend i çudirave, pasi që në 2017-ën qytetarët e Kosovës nuk kanë sigurime shëndetësore. Qeveria e ardhshme duhet ta zgjidhë këtë problem, dhe në fund, te misionet diplomatike, zoti ministër, ju së bashku me kryeministrin duhet të merrni një hap vendimtar që në misionet tona diplomatike të ketë një përfaqësim shumë më të madh të djemve dhe të vajzave tona e mërgimtarë, të cilët njohin gjuhë të huaja, të cilët i ulin me 70% shpenzimet e Qeverisë së Kosovës, për arsye se nuk kemi ne nevojë të çojmë në Stokholm ose në Londër, ose në Uashington djalin e hallës, e tezet e kushërinjtë që shpenzojnë miliona, pasi që kemi atje mërgimtarë, të cilët kanë përfunduar universitetet dhe mund të punojnë në misionet diplomatike.

Dhe, krejt në fund, zoti ministër, desha të them që unë personalisht, pavarësisht që jam kritik, ose jo kritik, më fal, që jam sugjerues për këto të cilat i thashë, unë do ta votoj Buxhetin e 2 muajve që kanë mbetur. Faleminderit, zoti kryetar, që më dhatë fjalën!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj, a është në sallë? Po!

ARMEND ZEMAJ: Qysh po thonë për atë Gazmend Muhaxherin “plus katër”, Kamish, faleminderit.

KRYETARI: Përsërite edhe një herë, se s’kanë dëgjuar gjysma.

ARMEND ZEMAJ: Kamishi tha “e ka të fundit”, thashë qysh po thonë për këta kryetarët e komunave “plus katër”, thashë për Gazmend Muhaxherin, sikur edhe katër mandate të tjera.

Kërkojmë falje, faleminderit!

Kolegë deputetë,

Unë këtë plotësim-ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e pashë një çështje, e cila siç duket akoma po e përcjell Kosovën dhe keqpërdorimin e taksave të qytetarëve të ndershëm, tenderi i pasaportave, i cili mbetet skandali më i madh institucional dhe që shihet që nuk do të përfundojë asnjëherë.

Ministria e Financave, me anë të plotësim-ndryshimit të Ligjit për Buxhetin, e paska marrë përsipër detyrimin për leximin e pagesës për rastin e pasaportave bazuar në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Mirëpo, zoti ministër, bazuar në nenin 39 të Ligjit për arbitrazhin, ligjin nr. 02/L-75 i miratuar në Kuvendin e Kosovës, çdo vendim i arbitrazhit të huaj i nënshtrohet procedurës të njohjes dhe ekzekutimit nga gjykata kompetente e Republikës së Kosovës, e që në këtë rast kompetente është Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Gjykatës Themelore.

Pa dashur që ta kontestoj vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit ndërkombëtar lidhur me rastin e pasaportave, sot para se të votohej ky Buxhet, duhet të kemi dy përgjigje: një nga ministri i Drejtësisë dhe një nga ministri i Punëve të Brendshme, që sigurisht ju duhet t'i keni si ministër i Financave. A ka bërë pala austriake, konkretisht kompania e cila ka fituar arbitrazhin për rastin e pasaportave kërkesë për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit, sipas paragrafëve të nenit 39 të Ligjit për arbitrazhin. Sepse sipas nenit në fjalë është detyrim ligjor që çdo vendim i arbitrazhit të huaj para se të ekzekutohet t'i nënshtrohet procedurës së njohjes dhe ekzekutimit në gjykatën kompetente të Republikës së Kosovës.

Pra, unë mendoj që para se të inkorporohet ky detyrim financiar në Ligjin për rishikimin e Buxhetit, paraprakisht duhet të përfundojë detyrimi tjetër procedural e juridik, i përcaktuar në nenin 39 të Ligjit për arbitrazhin, nëse kjo procedurë nuk ka përfunduar. Sepse, me këtë rast kemi konflikt ligjor, për arsye se po e prejdukujmë vendimin e Gjykatës Ekonomike të Republikës së Kosovës, pra po e anashkalojmë të drejtën e brendshme në këtë çështje, pavarësisht se kjo kërkesë për njohje dhe ekzekutim mund të jetë edhe vetëm formalisht.

Po ashtu, sa jam në dijeni, Avokatura e shtetit në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e kanë hapur një proces gjyqësor, në të cilin e ka kontestuar kompetencën e Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe ne nuk jemi në dijeni a ka përfunduar ky proces gjyqësor. Ku ka mbetur procedura, apo është tërhequr padia pranë gjykatës vendore, krejt këto me qëllim që të plotësohen kushtet ligjore të parapara me legjislacionin vendor për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar.

Si përfundim, propozoj që nëse nuk janë kryer këto obligime ligjore sipas legjislacionit vendor, të hiqet nga rishikimi i Buxhetit shuma e paraparë për kryerjen e këtij obligimi financiar, e cila është 5 milionë euro, derisa të përfundojë procesi i njohjes së ekzekutimit të vendimit sipas Ligjit për arbitrazhin. Në të kundërtën, ne po e anashkalojmë legjislacionin tonë në këtë rast dhe mund të na bëhet precedent edhe për rastet e tjera që presin të na vijnë në këtë Kuvend.

Ministri e tha, më duket për sigurimet shëndetësore. A do të qesim mjete pa u përmbushur obligimet ligjore. Tash, cili kriter po përdoret në këtë rast? Përmbushja e obligimeve ligjore duhet të vlejë për të gjitha kategoritë, për të gjitha bartjet e këtyre pagesave apo edhe pjesët e

tjera që kanë të bëjnë për rishikimin. Kjo nënkupton, nuk do të dëshiroja që të ishte këtu, sepse qartazi shihet që zhatja e taksave të qytetarëve, ku përfitojnë grupet kriminale, nuk mund të pritet përmbushja e obligimeve ligjore, ndërsa për të përfituar qytetarët nga pjesa më e ndjeshme, siç është shëndetësia, ka kohë të pritet për përmbushjen e obligimeve ligjore.

Zoti ministër, e keni obligim t'ua shpjegoni Kuvendit të Republikës së Kosovës, deputetëve, këto norma ligjore dhe se si ka proceduar ky rast dhe është fat i keq që Kosova duhet të paguajë edhe 5 milionë shtesë nga ai skandali i madh i pasaportave. Të mos harrojmë edhe diçka, sot temë e ditës ishte që pasaporta e Kosovës ishte radhitur në vendin e 85-të, nga cilësia e barabartë me shtetin diktatorial, Birmaninë, e cila po akuzohet nga OKB-ja për krime kundër njerëzimit. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri e ka fjalën, e ka kërkuar!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit deputetë,

E para, do të bëj përpjekje që të jap disa sqarime të nevojshme në çështjet që i ngriti deputeti Milaim Zeka. Sa i përket Buxhetit të vitit aktual, zakonisht ndodh në praktikë, jo shpesh, por ndodh që gjërat nuk zhvillohen sipas planifikimeve të nevojshme për një arsye dhe një arsye tjetër dhe del që Buxheti i planifikuar për vitin 2017 nuk mund të realizohet në shumën prej 2 miliardë e 1 milionëve, por do të realizohet në shumën i cili është i propozuar me rishikim.

U ngrit gjithashtu pjesëmarrja, s'e kisha quajtur të asfaltit, por që po themi edhe asfalt 30%. Zoti Zeka, as në Kosovë nëse e marrim veç asfaltin dhe e ndajmë prej investimeve të tjera kapitale, sigurisht që vitin e ardhshëm nuk do ta kalojë 30%-shin. Por nuk është kjo përqindje e vogël. Sa u përket orientimeve të Buxhetit, Ministria e Financave, organizata buxhetore i jep kufijtë buxhetorë për kategoritë ekonomike, mirëpo brenda kategorive ekonomike pastaj si vendosin organizatat buxhetore është në autonominë e organizatave buxhetore ku i vendosin ata prioritetet e tyre.

Sa i përket çështjes së misionëve diplomatike, u dha një propozim, ndërsa ne kemi propozuar një shumë për t'i mbuluar shpenzimet e domosdoshme, për shkak se shumë njerëz që punojnë nëpër ambasadë kanë mbetur pa pagesën e qirave dhe disa prej tyre janë detyruar t'i lëshojnë shtëpitë ku banojnë. Sa i përket çështjes së pasaportave, përgjegjësia është individuale, juridike, për të cilët unë nuk di. Po bëhet përpjekje dhe po tentohet që kjo të shitet dhe t'i faturohet një partie, por në nivelin menaxherial dhe politik unë nuk e di që ndonjë zyrtar i ndonjë partie politike ka pasur përgjegjësi juridike në këtë rast.

Ndërsa sa i përket ekzekutimit të vendimit, organizatat buxhetore, në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme si bartëse e këtij fondi sigurisht se nuk mund të bëjë pagesën pa u vërtetuar që

është vendim përmbarrimor. Është vendim i formës së prerë pa përfunduar të gjitha procedurat legale që i kanë kaluar disa faza. Ministria e Drejtësisë është duke i ndjekur. Mirëpo, edhe një çështje duhet të sqarohet. Nëse vendimi përmbarrimor nuk paguhet, se dikush mban përgjegjësi pse ka ndodhur rasti dhe kanë shkuar në përgjegjësi, por edhe dikush mund të mbajë përgjegjësi pse s'ka adresuar këtë çështje në kohë dhe shuma fillestare si rezultat i vonësive të pagesave të interesave dhe obligimeve tjera që rrjedhin prej kësaj ndoshta dyfishohet. Nëse s'reagohet në kohë dhe s'kryhet në kohë, kjo shumë rrezikon që të rritet edhe më tutje.

Prandaj, po që se e merr një vendim, po flas gjithmonë për formën përfundimtare, është vendim që duhet të përmbarrohet. Ne si Ministri e Financave i kemi siguruar fondet që si rezultat i mungesës së fondeve të mos rritet vlera, ndërsa organizatat buxhetore, besoj fort në atë, që Ministria e Punëve të Brendshme në këtë rast do të jetë shumë e kujdesshme, që pasi të kryhen të gjitha procedurat të cilat ka obligim që t'i ndjekë Ministria e Drejtësisë, ta bëjë ekzekutimin, apo nëse e kemi një vendim tjetër është edhe më mirë për institucionet e Kosovës dhe për shtetin e Kosovës.

Mirëpo, ne, përveç dëmit ekonomik, duhet ta kemi të qartë dhe të ruhem prej dëmit reputacional, që mund ta pësojë vendi ynë. Prandaj, nëse ka vendim të formës së prerë, mjetet janë, nëse s'ka vendim të formës së prerë, unë nuk besoj që dikush e bën ekzekutim të vendimit i cili s'është i formës së prerë. Faleminderit!

KRYETARI: Armend, dëshiron prapë edhe një herë?

ARMEND ZEMAJ: Unë nuk e di, ministër, a ishe këtu kur e adresova këtë çështje. As nuk theksova parti politike, as individ, as strukturë. Unë vetëm e përmenda obligimin ligjor, domethënë obligimin ligjor sipas ligjeve që janë në fuqi. E përmenda Ligjin për arbitrazhin, i përmenda obligimet dhe vetëm kërkova përgjigje nga Ministria e Drejtësisë, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga ju: A janë përmbushur obligimet ligjore? Nuk hyra në paragjykimet e çka. Ky është skandali më i madh, edhe një herë po e përsëris, në aspektin edhe të humbjes së parasë publike, edhe të asaj çfarë ka ndodhur, dhe këtë nuk mund ta fshehë askush, se si e adreson, nëse e ka adresuar gjykata, sigurisht do ta adresojë pastaj nëse ka elemente penale.

Kështu që unë vetëm proceduralisht dhe ligjërisht kërkova ky 5-milionësh kujt po i ngutet të paguhet pa u përmbushur obligimet ligjore? Kaq! Asgjë më shumë, as më pak!

KRYETARI: Faleminderit! Armend, a e ke përmendur Bekimin? Me emër, a të ka përmendur? Eiii, sa herë e përmend Skënderbeun unë! Mytaher Haskuka, fjala për ju. Ma ka sjellë "Vetëvendosja" një listë prioritare, në fakt, kryesuesit më herët, Mytaheri, Fatoni dhe Alia. A dëshironi në bazë të kësaj liste, apo dëshironi në bazë të radhitjes elektronike? Në bazë të listës

është Albin Kurti, Visar Ymeri, Mytaher Haskuka. Kush po e merr pra fjalën? Faton, veç... Mytaher Haskuka. Atëherë mirë ka qenë grupet parlamentare t'i sjellin listat. Urdhëro, fjala për ju.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Këtu po e shohim një Buxhet të rishikuar, i cili faktikisht i ka 191 milionë më pak se buxheti i parashikuar në fillim të vitit dhe në këtë aspekt nëse e shikojmë në total, zvogëlimi i buxhetit në përgjithësi është 10% me atë të parashikuar.

Në anën tjetër, po thuhet që rritja ekonomike është 4%. Pra, nëse nga një ekonomi ku faktikisht këtu është paraparë, nga shpenzimet kapitale tërhiqen 200 milionë euro, atëherë kemi 200 milionë euro më pak në treg, më pak në ekonomi, prandaj edhe e kemi njëfarë zvogëlimi të ekonomisë. Ashtu flitet, bile në lëndën e ekonomisë. Në atë aspekt, unë vetëm desha të pyes nëse mund të jetë reale kjo rritja ekonomike për 4%, kur zvogëlimi i Buxhetit ndodh në 10%.

Domethënë, kemi zvogëlim të Buxhetit, zvogëlim në shpenzime kapitale për 191 milionë euro, ndërsa në anën tjetër ne presim prapë të kemi rritje ekonomike. Kjo është një pikëpyetje e madhe se cila është e saktë.

Në anën tjetër, lidhur me Buxhetin, problemi më i madh i këtyre 500 faqeve që i kemi këtu është krahasimi se çfarë është ndërruar dhe nga ku janë marrë paratë dhe ku janë dërguar. Është problematike të bëjmë krahasime. Duhet të shikojmë Buxhetin paraprak me këtë Buxhet, në mënyrë që të shohim se cilat janë dallimet ndërmjet dy buxheteve. Por, pasi nga kjo fleta e parë po shohim që në investimet kapitale janë zvogëluar investimet, ose së paku i kemi 199 milionë më pak, atëherë unë kisha pritur që këto shpenzime të shkojnë bile në arsim, ngase në aspektin e Kuvendit të Republikës të Kosovës, ne më 19 janar 2017 e patëm marrë një rezolutë që e patëm aprovuar të gjitha partitë politike që jemi këtu me unanimitet, Rezolutën për arsim në Kosovë, ku pika e parë ka qenë që arsimi të merret si prioritet në Kosovë dhe sipas asaj të ndahet më shumë buxhet për arsimin dhe të ndahet më shumë buxhet për hulumtime dhe zhvillim, por edhe në investime kapitale në arsim.

Në këtë aspekt, nuk kemi kurrfarë ndërrimi këtu. Unë kisha pritur, sidomos nga AAK-ja dhe "Nisma", ngase atëherë kemi qenë bashkërisht që e patëm filluar këtë rezolutë, që të punojmë që të rritet buxheti për arsim, pasi është zvogëluar në përgjithësi Buxheti, që ato para nga investimet kapitale të shkojnë në arsim dhe në përmirësimin e gjendjes në arsim, po kjo nuk ka ndodhur.

Në aspektin e ligjit, po ashtu dua të them që sipas Ligjit për arsim të lartë, diku rreth 0,07% të shpenzimeve të Buxhetit duhet të shkojnë në hulumtime dhe zhvillim. Kjo është edhe kërkesë e Bashkimit Evropian, por këtu prapë nuk kemi asnjë linjë që shkon në hulumtim dhe zhvillim.



Domethënë, prapë injorohet Ligji për arsim të lartë, injorohet Rezoluta për arsimin, të cilën e patëm marrë pas rezultateve të testit të PISA-s dhe arsimi prapë injorohet në njëfarë aspekti në rishikim të Buxhetit, dhjetë muaj pas rezolutës unanime që e pati kaluar ky Kuvend.

Në aspektin e Buxhetit të komunave, te buxhetet e komunave është problematike pak, dhe këtu të shikohet se çka është ndërruar, ose a ka pasur dallime dhe ndryshime në aspektin e shpenzimeve të komunave, por diku pas faqes 300, pastaj fillon “Buxheti i Kosovës në nivel komunal”, në faqet tjera nuk kemi çka paraqesin shtyllat. Domethënë, edhe është problematike të kuptojmë se për shembull çka paraqet shtylla e parë, çka paraqet shtylla e dytë, e tretë... Duhet të shikojmë në faqen e parë të këtij Buxheti, ashtu që të kuptojmë se çfarë po ndodh me Buxhetin nëpër komuna. Por, këtu i kam disa pyetje lidhur me shpenzimet, si për shembull në Prizren është paraparë që inspektorati të ketë të hyra 50 mijë euro në rrënimin e objekteve. Po shohim që zero janë shpenzuar këtu, ndërsa totali për këtë vit qenka 50 mijë euro. Në total, si për shembull, në këtë drejtori nuk janë shpenzuar 155 mijë euro, apo janë shpenzuar, s’po di. Domethënë është problematike të kuptohet nëse janë realizuar buxhetet apo nuk janë realizuar buxhetet në dhjetëmujorin e parë. Por, edhe nëse janë realizuar, ka shumë pika ku në disa komuna shpenzimet komunale paraqiten me projekte dhe kemi diku rreth 3-4 faqe projekte, ndërsa në komunat e veriut, si për shembull, paraqiten vetëm nja dy-tri vija buxhetore, pa projekte. Është problematike të krahasohen shpenzimet e një komune me komunën tjetër. Unë shpresoj që në Buxhetin e vitit të ardhshëm të bëhet një riformatizim i mënyrës së paraqitjes së shpenzimeve buxhetore, ashtu që ta kemi një uniformitet ne si deputetë, uniformitet në raportim, po uniformitet edhe në aspektin e krahasimit të buxheteve të komunave të ndryshme të Kosovës, por edhe të ministrive lidhur me komunat.

Këtu po ashtu dua ta tërheq vërejtjen se pasi kemi më pak shpenzime në investime kapitale dhe gjersa është paraparë 2 miliardë për këtë vit, ndërsa tani e kemi Buxhetin e shpenzimeve 1 810 milionë, kemi pesë universitete, të cilat rishtas janë krijuar, domethënë Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Ferizajt, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Gjilanit, dhe në këto universitete në shumicën e vendeve ka shumë probleme me infrastrukturë, por prapëseprapë këtu nuk e shohim ndonjë investim në infrastrukturën e këtyre universiteteve, apo së pari unë nuk munda ta gjej.

Kur shikoj këtu te Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shoh që investime kapitale janë vetëm 1,4 milion euro, gjersa shpenzimet në përgjithësi në këtë sektor janë shumë më të mëdha, domethënë diku rreth 40 milionë. Por, për arsimin e lartë, ose për objektet e universiteteve të sapokrijuara janë më pak se 1,5 milion euro. Ndoshta, në këtë aspekt për t’i treguar edhe prioritetet që i kemi, gjeneratat e reja, arsimin, shkencën dhe zhvillimin, atëherë besoj që së paku në Buxhetin e vitit të ardhshëm duhet të reflektohen edhe kërkesat e Kuvendit të Kosovës, që arsimi të jetë prioritet, që të ndahen para të mjaftueshme për arsimin në Kosovë, por

edhe për hulumtime dhe zhvillim dhe në njëfarë aspekti të reflektojmë atë që po flasim nëpër foltoret tona, ose në diskutimet e publikut të përgjithshëm.

Edhe një vërejtje këtu, deputetja Xhevahire Izmaqi foli për Shtëpinë e Pleqve si çështje e Komunës së Prishtinës. Shtëpia e Pleqve në Prishtinë është në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, prandaj çdo investim aty shkon nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Shpendi ka shkuar, e ka vizituar atë objekt, është në gjendje e keqe, po nuk është në kompetencën e Komunës që të bëjë diçka aty, por për shkak se ajo nuk është në kompetencën e Komunës, Komuna e Prishtinës ka paraparë që ta ndërtojë një qendër për qëndrim ditor për pensionistët, ashtu që të jetë një ndërtesë, e cila është së paku nën mbikëqyrjen e Komunës dhe ku faktikisht të tregojë që Komuna po ashtu u jep rëndësi pensionistëve.

Në të njëjtën kohë, ne e dimë që transporti publik në Prishtinë nuk paguhet nga pensionistët, e kështu me radhë... Janë edhe politikat tjera që i ka bërë Komuna e Prishtinës. Përndryshe, këto politika mungojnë nga Qeveria. Pra, të mos i përziejmë kompetencat. Shtëpia e Pleqve është në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ju falënderoj edhe një herë dhe shpresoj që në Buxhetin e vitit të ardhshëm të reflektohen këto sugjerime që i kemi bërë edhe në Kuvend, por edhe me rezolutat e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka reagim, replikë për emrin nga Xhevahire Izmaqi.

XHEVAHIRE IZMAKI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kuptoj kolegun që ka nevojë pak fushatë për vete, pak fushatë për kolegun, por unë e njoh shumë mirë kompetencën dhe fola për kompetencën. Kur ka bërë punë të mira e kam përmend edhe Shpendin, mirëpo në këtë rast realisht nuk e mbaj mend që ka qenë, domethënë nuk e kam parë edhe pse e përcjell fushatën shumë.

E sa i përket çështjes së kompetencave, e kam edhe në fjalim, kështu që nuk do ta citoj, se e dëgjuan mendoj edhe qytetarët, edhe kolegët, që e përmenda. Në momentin kur një kryetar komune lobon dhe shkon e paraqet një problem, atëherë ministria ngjallet në atë drejtim. Pra, ishte në pyetje edhe pak mobilizim. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: S'ka reagim, a? A dëshiron kundër-replikë? Nëse do, ke drejtë. Kundër-replikë, deputeti Haskuka.

MYTAHER HASKUKA: Unë nuk bëra fushatë, vetëm ju e përmendët Shtëpinë e Pleqve si kompetencë e Komunës së Prishtinës. Ajo nuk është kompetencë e Komunës së Prishtinës dhe thashë që është kompetencë brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Çdo kritikë për këtë institucion duhet të shkojë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

KRYETARI: Faleminderit! Brenda fushatës jemi, lejohet. Abdyl Salihu e ka fjalën.

ABDYL SALIHU: I nderuar kryetar i Kuvendit,  
I nderuar Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Kam nderin dhe kënaqësinë që për herë të parë e kam mundësinë t'ju drejtohem nga pozita e deputetit në Kuvend të Kosovës, për më tepër në diskutim për çështjen e rëndësisë së veçantë, të rishikimit të Buxhetit për vitin 2017 si akti më sublim për financimin e institucioneve tona publike.

Unë edhe ashtu jam profesionalisht më afër me fushën e shëndetësisë dhe të arsimit, prandaj edhe kontributi im do të orientohet, sot dhe në të ardhmen, nga këto këndvështrime. Nevoja për reforma në këtë sektor është slogan që dëgjohet për çdo ditë. Po ashtu, dihet se sfidat e sektorit të shëndetësisë janë të shumta, të cilat i kanë vështirësitë dhe të papriturat e veta, andaj para nesh del si imperativ një reformë gjithëpërfshirëse, e cila fillon dhe mbaron me shëndetësinë si një synim parësor i Ministrisë së Shëndetësisë, por në fakt është edhe një problem thelbësor për financat publike, që ndërlihet dhe me proceset buxhetore.

Sipas gjykimit tim personal, e konsideroj reformë të domosdoshme, e cila duhet të fillojë menjëherë. Qëllimisht fola për shëndetësinë për t'u ndërlidhur edhe me rialokimin të rishikimi i vitit 2017 i mjeteve nga kontigjenca e sigurimeve shëndetësore, që e konsideroj në këtë vit si të perealizueshme. Prandaj, riorientimin për mbulimin e nevojave aktuale e konsideroj të arsyeshëm.

Për më tepër, këtë e them edhe për faktin se për ta funksionalizuar fondin për sigurime shëndetësore janë të njohura sigurisht parakushtet që duhet plotësuar dhe deri tani, sa jam i informuar, vetëm dy prej tyre janë të plotësuara, ndërsa parakushte tjera që janë ende në proces përgatitor janë të një rëndësie kyçe dhe me ndikim të madh buxhetor, si për shembull lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor, lista shërbimeve shëndetësore emergjente, apo e shërbimeve shëndetësore esenciale, për të cilat duhet ta kemi një parallogaritje të kostos buxhetore.

Edhe deri më tani nga Buxheti paguhen shuma të konsiderueshme për këto skema dhe duhet ta japim një zgjidhje sa më të shpejtë, por edhe përfundimtare. Prandaj, konsideroj që kjo duhet të trajtohet në një rast tjetër si pikë e veçantë, në të ardhmen.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Nuk do ta zgjas shumë, andaj pa u ndalur në detaje, duke marrë parasysh domosdoshmërinë e lartë për këtë rishikim të Buxhetit, në veçanti për adresimin e nevojave brenda një kohe shumë të shkurtër, e sidomos nevojave siç është financimi për zgjedhjet lokale si një proces shumë i

rëndësishëm për vendin, sigurimi i fondeve për pagesën e detyrimeve në kohë ndaj partnerëve strategjikë, sigurimi i fondeve për pagesën e pensioneve të veteranëve, mjetet për kompensimin e dëmeve, në realitet të fermerëve, në sektorin e bujqësisë dhe shumë nevojave tjera për sektorin e drejtësisë.

Të gjitha këto më çojnë në përfundim se ky dokument e pasqyron përkushtimin për t'i adresuar sfidat brenda kornizës ligjore dhe më këtë rast e përgëzoj Qeverinë, në përgjithësi, si dhe ministrin e Financave në veçanti, për përgatitjen e dokumentacioneve në këtë proces mjaft të rëndësishëm brenda një kohe shumë të shkurtër.

Mbi këto parime vlerësoj se ndryshimet e propozuara janë në harmoni me pritjet dhe mundësitë aktuale, prandaj si të tilla i mbështes në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Avdullah Hoti s'qenka. Lumir Abdixhiku është në radhë. Po shkojmë në bazë të radhës.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Unë, në fakt, do të flas për shëndetësinë dhe për veteranët si dy shembuj të trajtimit të qytetarëve në këtë vend dhe dua që ky koment dhe kjo kritikë të shërbejë edhe për rishikimin e Buxhetit, por edhe për Buxhetin që na vjen pas një jave në këtë Kuvend.

Nuk besoj që ka një vend tjetër në Evropë që e ka shëndetësinë më të sëmurë, e që jep kaq pak para për shëndet. Nuk ka vende të tjera në Evropë ku vdesin qytetarë në spital, siç vdesin te ne, ku nënat lindin nëpër korridore, fëmijët lihen në mëshirë të donacioneve të rrjeteve sociale, kush nga sa po jep, hallelxinj që s'kanë as penj, as oksigjen, as shtretër.

Ata që kanë para kanë zgjedhur, natyrisht, spitalet private nëpër rajon. Ne këtu në këtë sallë shërimin kryesisht e bëjmë jashtë vendit. Këtë luks na e sigurojnë pagat tona. Bashkë me ne në Shkup, në Beograd e në Stamboll, shërohen e trajtohen me nga 70 milionë euro në vit, secilin vit, nga Kosova.

Sikur ky Parlament ta kishte trajtuar shëndetin tonë për 17 vjet siç i ka trajtuar asfaltin, veturat, drekat e darkat, pra me luks të majmë e me mjaft bollëk, qytetarët tanë do të kishin më shumë dinjitet dhe do ta donin njëmend edhe Parlamentin, edhe këtë shtet. Por, qysh do ta duan këtë Parlament, kur mundësinë e parë, rishikimin e parë buxhetor, gjënë e parë që ky Parlament e kjo Qeveri e bëjnë, është shkurtimi i fondeve të parapara për sigurime shëndetësore. Pra, kaq ka rëndësi shëndeti i tyre.

Në 1,8 miliard euro Buxhet shkurtohen 17 milionë euro për shëndetësinë, nuk gjejnë vend. Gjejnë vend edhe mëditja, edhe dreka, edhe darka edhe nafta, po s'gjen vend halli kryesor i kosovarëve, shëndeti. Dhe, arsyetimi i dhënë në këtë Parlament është sinqerisht trishtim. Po thonë se nuk është funksionalizuar Ligji për sigurime shëndetësore, rrjedhimisht janë hequr fondet e siguruara për premiume. Por, një qeveri që e ka prioritet shëndetin e qytetarëve do t'i mbante këto fonde për shëndet. Në fond ose jo, ka vend sa të duash për t'i harxhuar 17 milionë euro në shëndetësi, edhe në shtretër, edhe në barna, edhe në penj, edhe në shërim jashtë vendit. Pra, do të duhej t'i mbanin në shëndetësi.

Dhe trishtimi tjetër është se, paramendojeni, ministri i Shëndetësisë, që s'është këtu, njeriu kryesor që është dashur ta promovojë këtë logjikë, që paratë e shëndetësisë t'i mbajë në shëndetësi, e arsyeton këtë shkurtim të fondeve. Pra, unë tash, si deputet i opozitës, bëj më shumë kërkesë për fondet e tij sesa ai vetë. Ai do të duhej t'i rrinte zotit Hamza para zyrës së Ministrisë së Financave ditë e natë, të mos ia preknin 17 milionë eurot për shëndetësi.

Po ku shkuan këto para? Mos harroni, nuk janë shkurtuar vetëm 17 milionë euro nga fondet, janë shkurtuar edhe 4 milionë euro në investime kapitale në shëndetësi, gjithsej 21 milionë euro. Të gjitha dhe më shumë, plot 26 milionë euro i janë shtuar fondit të veteranëve, pra para shtesë mbi paratë e parashikuara. U janë shtuar 60 mijë veteranëve. Ky fond ka arritur 70 milionë euro në vit dhe derisa flasim këtu, lëshohen ende certifikata false, blerje e pazare statusesh ndodhin gjithandej. Prokuroria e Shtetit ka filluar rast për këtë punë. Fondi, sipas llogaritjeve, do të arrijë 100 milionë euro në vit. Kosova nuk i ka 100 milionë euro në vit, nuk i ka për t'i paguar falsifikatorët e listave.

Dhe, paramendojeni, përgjigjja kryesore që ne jepet kur ngrihet kjo çështje, kur flasim për pastrim të listave, është e zakonshme ajo që përdoret kur mbeten pa argumente hiç, se "ju që kritikoni fondin e veteranëve", kështu na thonë, "jeni kundër luftës së UÇK-së, jeni kundër vlerave të luftës". Çfarë vlere e luftës është të prodhohen 60 mijë veteranë? Çfarë vlere e luftës qenka heqja e parave në shëndetësi për t'i paguar njerëzit që janë fals dhe pa meritë në listë?

Dilni këtu, le t'u thotë dikush qytetarëve se në Kosovë janë 60 mijë veteranë. Ju që keni përpiluar lista, dilni thoni që 60 mijë veteranë ishin 17 vjet më parë. A njëmend po e merrni qytetarin si të marrë? A po besoni njëmend se qytetari kosovar e beson këtë, se një hallexhi që sot e shtrin fëmijën e vet në spital e nuk ka bocë oksigjeni, sepse ky Parlament po ua shkurton paratë edhe më tutje, nuk na shikon me përçmim? Kosova nuk i ka 60 mijë veteranë! S'mund ta ndryshoni këtë fakt. Prandaj, arsyetimi ligjor është i paarsyeshëm, ligji nuk shërben si mekanizëm për ta mbuluar mashtrimin...

Në qoftë se është ligji, ligji ndryshohet për ta bërë të drejtën. Prandaj është propozuar rikategorizimi, ndarja e kontribuesve në kategori.

Dhe, unë këtu nga kjo foltore i ftoj veteranët e njëmendtë, ata që kanë luftua përnjëmend të bëhen bashkë dhe t'i shtrojnë kërkesat e qarta, të nisim kategorizimin e veteranëve, në mënyrë që ata që marrin para në emër të luftës të largohen prej listave, ata që marrin fals, dhe të tjerëve t'u trefishohet, t'u trefishohet shuma e parave që marrin. Kjo punë bëhet me kategorizim.

Dhe, a ka diçka më patriotike sesa pastrimi i listave, trefishimi i kontributit për veteranët e njëmendtë, ruajtja e Buxhetit dhe shtimi i parave për shëndetësi?

Unë u drejtohem sot këtu edhe deputetëve që të kalojnë mbi interesa partiake, ta trajtoni këtë çështje që po e përsëris, do të na vijë pas një jave në Buxhetin e vitit 2018, në të kundërtën barra financiare që po i shtrohet vendit me kapërcime si këto shkel e shko është e paqëndrueshme dhe e parikuperueshme.

Për fund fare, rishikimi buxhetor e dëshmon edhe një herë koston financiare që i kanë shkaktuar vendit vonesa e formimit të institucioneve.

Bllokimi i bërë nga PAN dhe Lista serbe muaj me radhë ka dëshmuar se Kosova ka humbur qindra miliona euro nga ky Buxhet.

Rrjedhimisht, rishikimi buxhetor është improvizim prej kontabiliteti, barazim i numrave aq sa mundet.

E arsyetimet e pozitës se planifikimi i LDK-së është i parealizueshëm, sa për sy e faqe, siç e tha dikush është imagjinatë, në fakt unë pajtohem me ju. Çfarë mund të bëjë LDK-ja, për ne është e thjeshtë, për ju është fanta-shkencë. Dy miliardë euro Buxhet për këtë Qeveri, është një mendje e paarritshme. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ministri i Financave e ka fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** E para, dëshiroj ta falënderoj zotin Abdixhiku. Ia thashë, por tash do t'ia them pak më troç edhe pak më qartë.

Edhe shumë përgjigje do t'i jap nëpërmjet pyetjeve të mia.

Zoti Abdixhiku, kush e ka udhëhequr shëndetësinë? A e ka udhëhequr LDK-ja? Zoti Abdixhiku, kush e ka udhëhequr procesin e veteranëve? A ka qenë në kryeministri dhe a ka qenë në Ministrinë e Punës së Mirëqenies Sociale? Ku ka logjikë, ku ke parë rast që mund të kostohet një proces, të caktohet paga për dikë, të fillojë pagesa për qëllime politike, se “ne filluam të jua paguajmë ju veteranëve”. Edhe në fushatë të përdoret kjo, edhe sot të përdoret prapë si fushatë, “ne filluam të jua pagua juve” pa e ditur numrin, dhe pastaj doni t'i ikni përgjegjësisë.

Përgjegjësia ka adresë. Ka adresë në institucionet që kanë qenë përgjegjëse ta mbajnë këtë proces të kontrolluar. Bile për veteranë që janë veteranë të vërtetë, nuk është problem veç shuma, është problem që ata nuk pajtohen të barazohen ata që kanë qenë me ata që s'kanë qenë.

Prandaj, nuk është këtu faji te veteranët, por te ata që kanë pasur përgjegjësi për ta udhëhequr procesin.

Këtu ka shumë ngatërime. Jorastësisht puna e veteranëve lidhet me shëndetësinë. Nuk janë paratë të shëndetësia, janë te pagat. Asnjë kusht, asnjë kriter nuk është plotësuar që të fillojë zbatimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Unë po të siguroj dhe po të garantoj që prej vitit të ardhshëm në shëndetësi nuk do të ketë mjek të diplomuar dhe specialistë që do të presin për punë. Do të rritet Buxheti i shëndetësisë, do të rritet te pjesa e barnave esenciale më së paku për 50%, do të rritet te investimet kapitale për dhjetëra miliona euro, dhe do të ketë mundësi që të adresohen nevojat më emergjente në këtë sektor. Sigurisht se as Buxheti i vitit të ardhshëm nuk do të mund t'i zgjidhë të gjitha problemet as në këtë sektor, as në shumë sektor të tjerë. Mirëpo, do t'i adresojë nevojat e domosdoshme.

Nuk mund të mbeten obligimet ligjore të pakryera, se humb kontesti, rritet kostoja.

Rikategorizimi, edhe unë pajtohem që ligji duhet zbatohet, reforma do të ecën. Mirëpo, derisa të bëhet rikategorizimi ne jemi të obliguar që t'i kryejmë obligimet sipas ligjit bazik që është në fuqi, pa hyrë në atë se sa është kostoja, a është mirë, a është keq.

U përmend edhe çështja te shpenzimet kapitale. Më tepër e kisha quajtur, jo kursim, ky nuk është kursim, kjo është mos punë, është nënshpenzim.

Po të përdoret terminologji adekuate për të gjitha projektet që nuk janë zhvilluar dhe po të përkthehet drejt është mospunë, është nënshpenzim, dhe si rezultat i nënshpenzimit në shumë kategori, është dashur të adresohen disa nevoja që kanë qenë të domosdoshme, që kanë qenë obligime ligjor dhe kontraktuale, për të mos e përballur shtetin edhe me kosto financiare, edhe me dëm reputacional, dhe të mos lihen mjetet të shkojnë me suficit, po të adresohen nevojat që kanë qenë.

Prandaj, ky është realiteti dhe nuk di pse po e diskutojmë kaq shumë.

Nuk është hera e parë që Buxheti ulet në rishikim. Kësaj radhe Buxheti është ulur si rezultat që ai është ndërtuar mbi supozime dhe situata hipotetike, të cilat kanë qenë vështirë për t'u realizuar.

Ndërsa, merreni ju lutem, shikojeni drejt, rishikimin e Buxhetit më 2014/15, janë reduktuar të hyrat e rregullta të planifikuara, Buxheti është zvogëluar për qindra miliona dhe sigurisht se edhe atëherë ministri i Financave ka vërejtur që diçka nuk mund të shkojë në përputhje me planifikimet.

Prandaj, Buxheti ka ardhur në rishikim për adresimin e çështjeve emergjente dhe adresimin e obligimeve ligjore, të cilat ne si Qeveri jemi të detyruar t'i kryejmë. Faleminderit!

KRYETARI: Kush replikë? A ta ka përmendur emrin? Urdhëro menjëherë!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit!

Në fakt, ministër unë me ty nuk kam shumë punë, sepse kritika ime për veteranë nuk ka të bëjë me ty, sepse ty të konsideroj si një kontabilist të mirë. I ke barazuar numrat siç të kanë dhënë urdhra shefat. Unë problemin e kam me shefat tu. Këta i kanë bërë listat. Procesin e listave nuk e ka udhëhequr LDK-ja. Kot e ke! A ke qenë kur ka qenë kryetari i Komisionit dhe të gjithë komandantët tjerë të kohës i shtuar listat për qëllimin elektorale. Këtë e di krejt Kosova! Qysh mund ta fajësosh LDK-në për një gjë të tillë?

Dhe, tash na ka ardhur barra neve, normalisht, ty si ministër që vitin e ardhshëm duhet t'ua gjesh vendin në Buxhet 100 milionë eurove për këto lista që janë bërë për qëllime elektorale. Ti mund ta fajësosh LDK-në, por LDK-ja këtu nuk ka faj.

Për pjesën tjetër të shëndetësisë, dallimi ndërmjet meje dhe teje është që unë kritikoj kur duhet kritikuar. Unë nuk e mbroj askënd që ka bërë gabime. Shëndetësia është lëmsh. Nuk ndreqet as me 17 milionë, ti e di mirë atë punë, ndreqet me 170 milionë euro.

Prandaj, propozimi im është, bëje një kategorizim të veteranëve, kurse paratë te veteranët, vëre një kufi të lartë, dhe më pas shpërndaje sipas numrit të veteranëve pas pastrimit të listave dhe kështu ke para edhe për shëndetësi, edhe jepu qytetarëve Buxhet më tepër.

Por, e para punë nuk duhet të japin përgjegjësi ata njerëz që kanë bërë mashtrime me lista, se këto janë vepra kriminale, janë vepra penale, dhe t'i duhet të dalësh këtu sot e të thuash "po, është e vërtetë, ne duhet t'i pastrojmë listat sa më parë".

KRYETARI: Vetëm pak! Ky nuk është ministër për t'i pastruar listat, po ti është mirë t'ia bësh me gisht dikujt, se ne të gjithë i kemi disa, krejt ata që kanë ikur është e vërtetë që i kanë bërë veteranë, po ti nuk ke të drejtë të flasësh, dhe kur ke të drejtë thuaje konkretisht, se është e vërtetë që disa manipulues, sikur ti që flet sot, kanë manipuluar, i kanë fryrë listat. Kjo është e vërtetë. Por, është mirë drejtpërdrejt, konkretisht cili preson? Cili? Bëja me gisht tash dhe le të merret Prokuroria, për arsye se manipuluesit që flasin po thuaj sikur ti, edhe listat i kanë fryrë



atje e ikin tash, përpiqen t'i bartin në Kuvend. Fol konkretisht, cili? Po, se do ta konkretizojmë, për arsye se ka nevojë të konkretizohet.

Jo të lutem, ministër! Lumir, fjala është për ju! Për arsye se të gjithë kemi pakënaqësi. Urdhëro konkretisht, se po kam dëshirë të të dëgjoj.

LUMIR ABDIXHIKU: Ministër, a po pret prej meje që ta bëj hetimin e njerëzve tu që i keni shtuar listat, që i keni bërë 60 mijë vota, a?

KRYETARI: Kush i ka shtuar, Lumir?

LUMIR ABDIXHIKU: Ju i keni bërë ato lista...

KRYETARI: Kush i ka shtuar?

LUMIR ABDIXHIKU: Tash po kërkon prej meje proces hetimor këtu në Parlament që ta vërtetoj që i keni shtuar 60 mijë vota në lista. E emrin e ka Kadri Vesel, emrin e ka Hashim Thaç, e kanë komandantët e tyre që kanë bërë lista zgjedhore. Mos bëni hajgare...! E shqiptarëve po u thoni që unë i kam fryrë listat, a?! Tash po ju po doni që unë të di të ju kallëzohet kush i ka fryrë listat. Ja njeri që i ka fryrë listat! A ka qenë shef i SHIK-ut ky njeri këtu? A ka qenë Hashim Thaçi bashkë me të? Kush i ka bërë këto lista? Jo, ne i kemi bërë këtu, në LDK i kemi bërë! Mos bëni hajgare!

*Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Faleminderit!

Realisht, ka qenë mirë të fokusohemi te pjesa e Buxhetit, por mirë është edhe kjo pjesë, se është fushatë elektorale. Por, më e rënda është kur disa njerëz mundohen t'ia shkatërrojnë dikujt jetën me të pavërteta, e tani nuk e dinë si mund ta hanë krejt për shkak të vërtetave të veta.

Është kollaj veç të flitet. Thjesht, është shumë lehtë edhe përpjekja për të fyer, por është shumë mirë të qenët konkret, e ti Lumir me këto manipulime, që po mundohesh si me poezi, mund ta arrish ndonjë votë te elektorati që është anti-UÇK.

Po ti as nuk ke guxim intelektual, as nuk ke guxim moral. Edhe në kuptimin tjetër, dëgjo thjesht, për besë pak a shumë, kur unë të kujtoj para disa ditësh hiç larg, me çfarë dinjiteti, me çfarë dinjiteti manipulativ, thjesht më duket si poezi. Duhet pasur kujdes kur flet, të nxjerrësh gjëra konkrete, se ta kemi parasysh te listat, ti të jesh më konkret, unë mendova se po e jep ndonjë

kontribut, po jo të aktrosh me gjendjen e sistemit shëndetësor, i cili do të përmirësohet, për arsye se duhet pasur parasysh që për tre vjet ai sistem shëndetësor është udhëhequr nga partia në të cilën je ti.

Pastaj, të njëjtën kohë është një situatë që nuk është e mirë, po ti nuk mund ta ndërlidhësh sistemin shëndetësor me çështjen e veteranëve. Ti kështu mund të lëmohesh edhe të fyesh sa të mundesh, dhe gjithë fatkeqësinë e Kosovës ta gjesh te gjaku e luftëtarëve. Por, ne që tash po mundohemi ta kryejmë Buxhetin është kjo.

Ne do ta përfundojmë, po të kishim shtet ligjor Lumir, atë lëmimin tënd do të kishte ardhur dikush e do të kishte pyetur: Cilin veteran e ka futur Kadri Veseli, a ka ndonjë anëtar të familjes, anëtar të Shtabit të Përgjithshëm, ndonjë shok që është i futur në listat e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Ti e ke urreyer UÇK-në, o Lumir! Ti e urren edhe sot! T'i më shumë e do..., o Lumir! Po vetë fakti, që kinse vjen prej shoqërisë civile, si po të ecën puna në pazar e në atë anë? Kah Presheva, mirë a? Hala e ke mendjen, se po ta kishe me Preshevën, do të kishe menduar këndeje, me vëllezërit tanë, por hala mendjen e ke andej. Mendo për BIA-n, jo për SHIK-un. Fatkeqësi e Kosovës është BIA, por çka të kesh edhe për SHIK-un vendose këtu në foltore zyrtarisht, pa inat, fol konkretisht çka do që ke, por mos u mundo të fyesh dhe mos u mundo të bësh paralelizma me situatën e pacientëve, një imoralitet, të cilin e keni lënë ju vetë, dhe me situatën e familjeve të luftëtarëve. Ti po mendon se janë fryrë listat, a? Janë fryrë shumë!

Unë kam qenë pjesë e koalicionit të kaluar. A e di sa lista janë fryrë nga partia juaj? Me qindra veta, të cilët kur s'kanë qenë në luftë. Dëgjo, mos më keqkupto, e kemi bërë për hir të pajtueshmërinë, dhe dëgjo, i kemi mbyllur të gjithë sytë. Dëgjo! Unë e thërras Prokurorinë, e kam thirrur publikisht, është një muaj fushatë elektorale, ndodhin raste të rralla si në fushatë elektorale, që një ish-luftëtar i UÇK-së ta thërrasë Prokurorinë që t'i hetojë të gjitha listat. Edhe po e thërras prapë edhe sot kur po flas.

Në qoftë se flasim se a ka lista të fryra, ka lista të fyera edhe janë manipulues shumë të këqij, të cilët mbi situatën sociale të luftëtarëve tanë, të cilët janë realë, kanë manipulua, por ti nuk mund që 90% të luftëtarëve t'i fyesh në këtë mënyrë. Kjo është ajo çfarë do ta bëjmë tash.

Buxheti do të kalojë, të njëjtën kohë Prokuroria dhe organet gjyqësore duhet t'i shkojnë deri në fund çdo manipulimi që mund të ekzistojë. Ama ti s'mund ta kalosh aq lehtë duke përmendur emra, se arusha nuk është këtu. Ke kryer pak shkollë, ti je goxha i mençur. Pastaj ti ke qenë edhe në shoqërinë civile. Kjo bota jonë politike na ka mësuar t'i gjuhemi shoqërisë civile, fjala ka përgjegjësi. Ti e ke thënë për shembull sot, e ke thanë që Kadri Veseli i ka fryrë listat.

Ti tash po të jesh burrë, mos u bëj shumë i lëmuar, shko te Prokuroria dhe sille argumentin te cili luftëtar. Një emër, sille vetëm një emër!

Dëgjo, unë i kam edhe katër minuta e pesëdhjetë sekonda. Mësohu të durosh, këta kolegët e Kuvendit e dinë, por në të njëjtën kohë të thashë edhe njëherë - mos u mundo të tregohesh manipulues. Të gjitha gjërat që janë do t'i hapim këtu me emër të Zotit bashkërisht, në mënyrë të qetë, në mënyrë dinjitoze. Askujt nuk do t'ia lëmë për më vonë që të vonohet. Çdo gjë që ka këtu drejtpërdrejt, pa ikur askush, s'do të ikim. Thjesht, kjo është.

Faleminderit se e kam një simpozium, por kisha pasur dëshirë pas reagimit, ndoshta do ta kem edhe unë një kundër-reagim.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Abdixhiku!

LUMIR ABDIXHIKU: Shumë pak minuta paskam, jo nuk po më lënë, ty po të lënë më shumë minuta.

Unë po besoj që Kadri Veseli është në panik dhe e keni një problem shumë serioz, po ta them kështu.

E para, ti do të mbahesh mend për dy çështje. Gjëja e parë për çka do të mbahesh mend është që ke qenë shef i SHIK-ut, dhe si shef i SHIK-ut, si një organizatë kriminale, të pëlqeu nuk të pëlqeu, njerëzit tu t'u kanë dënuar me nga 25 vjet burg për vrasje. Kjo!

E dyta, ti do të mbahesh mend që e ke sjellë PDK-në prej një partie të madhe në Kosovë në një parti që ka një grusht deputetësh.

Krejt këta janë duke qeshur me ty. Janë duke qeshur, por nuk po guxojnë të të thënë. Jeni duke qeshur. Për ne, kjo është shumë e mirë, është lajm i mirë, këtu të asistojmë.

Problemin me ty e kam Kadri, kur t'i do ta falimentosh Kosovën. Aty s'mund të pajtohem me ty, se në qoftë se i bën ti 100 milionë euro në Buxhet për veteranë, ti je duke thënë që "unë mund ta falimentoj Kosovën, çka dua bëj". Ti sapo e pranove në këtë foltore që ke bërë dallavere, the "po kemi heshtur".

Te cili prokuror të shkoj, Kadri? Te cili? Te Bahri prokurori, a?! Që e keni caktuar me telefon vetë në aferën "Pronto", a? Atje po do t'i çoj unë dokumentet tuaja, a? A di çka të bëjmë këtu? E nisim një proces hetimor, një komision hetimor, e nisim një komision hetimor edhe për SHIK-un, edhe për veteranët, edhe për krejt të zezat që keni bërë këtu. Edhe ajo do të ndodhë, Kadri! A e di pse? Se partia jote është duke u zvogëluar, Lidhja Demokratike e Kosovës është duke u rritur, e ajo ditë do të vijë shumë shpejt, të pëlqeu a së të pëlqeu ty. Shijoje panikun, shijoji këto ditë sa të kanë mbetur në një parti të vogël, me pak komuna, me pak deputetë. Është niveli yt, sinqerisht për keqardhje!

KRYESUESI: Zoti Veseli, kundër-replikë!

KADRI VESELI: Mirë e ke, se kur ta jep njeriu.... A e shijove hiç, fito ndonjë votë!

Dëgjo, së pari nuk e di që në këto vite pas lufte u dënua një person i SHIK-ut. Në qoftë se e gjen, unë jap dorëheqje prej kryetarit të Kuvendit. Një, je rrenacak!

E dyta, dëgjo, dëgjo çfarë të them! Pastaj, pjesa tjetër. Ti ke filluar me aktrim, e ke filluar mirë karrierën. Të tregojmë gradualisht më 19 nëntor, pastaj dalëngadalë ecim, lëvizim dalëngadalë, por puna e forma si e ke filluar ti mund të sjellë përfitim në moment të caktuar, por në afat të gjatë kjo nuk është politika, që të manipulosh.

Do të më mbash mend për shumë gjëra, por ti s'do të mbahesh mend për asgjë. Mbaje në mend! Kjo është e turpshme, thjesht. Por, ke manipuluar edhe për ato 25 vjet. Mos e shiko kohën, dëgjo. Unë jap dorëheqje nga kryetari i Kuvendit në qoftë se dikush është dënuar. Njerëzit e UDB-së që i keni sjellë këtu, jeni munduar të improvizoni, ju nuk po i lexoni fare, i ka sjellë prej UDB-ës. Thashë edhe më herët, unë e di çka po flas ti që po lëmoresh. Unë po di çka po flas dhe e di ku e ke kokën ti, po kjo është e turpshme.

Edhe një herë po ta them, njerëzit të cilët i keni sjellë prej UDB-ës jeni përpjekur t'i bë pjesë e asaj që s'ka qenë kurrë. SHIK-u ka ekzistuar, unë jam krenar që kam qenë deri në vitin 2008, dhe do të jem çdo herë krenar për atë dhe do të shkojmë deri në fund. Unë pres prej juve, tani jeni rreth 60 deputetë, vetëm që kur ta krijojmë atë pjesën që dëshironi ju, të jetë publike nga zyrtarët, mediet të jenë aty, dhe do të flasim, do të hapim shumë. Vetëm ruaju, mos bëj "ciu, ciu", prapë po ta them - mos ik, mos e humb frizurën!

Unë do të isha larguar, pastaj e vazhdojmë prapë, kemi ende.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Lumir, e the që ky është një kontabilitet. Mos Lumir, se në këtë dokument kanë punuar një numër i madh njerëzve të pushtetit lokal edhe qendror.

Lumir, e di që e ke atë turrin e të riut, edhe të kuptoj, por po të them sinqerisht - ti e ëndërron ta kesh karrierën time.

Është e vërtetë që unë jam edhe kontabilist i mirë, që kam qenë edhe drejtor, edhe zëvendësministër, edhe ministër, edhe guvernator, edhe krejt.

Prandaj, Lumir, po të kthehesh e t'i lexosh shkrimet tua, unë isha turpëruar prej shkrimeve të mia po të ishin ato. Moti ka bankrotuar shteti sipas teje, edhe më 2008, edhe më 2009, edhe më vonë. Prandaj, të lutem, kur të flasësh, fol në mënyrë profesionale, referoju çështjes së caktuar, lëri ofendimet, lëri përpjekjet për t'i ulur të tjerët e për ta ngritur veten, se nuk ngrihesh ashtu. I ri je.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

**ZAFIR BERISHA:** Faleminderit, kryesues!

Nuk desha të flas për Buxhetin, por diskutimet këtu, e veçanërisht këto të fundit sa për t'u bërë lajm më nxitën që ta marr fjalën dhe seriozisht ta tërheq vëmendjen për kolegët deputetë, veçanërisht për këta të rinjtë, për t'i paralajmëruar nëse janë të vetëdijshëm për çka po flasin. Nuk është mirë të gënjëhet ky Kuvend.

Zoti Lumir, nuk janë 60 mijë veteranë. Kanë aplikuar 60 mijë veta. Jam unë ai që në legjislaturën e kaluar, kur ti merreshe me analizat që i kam kërkuar në këtë Kuvend prej shefit tonë si kryetar i Qeverisë, që të ketë kujdes për fyerjen e listave, nuk është mirë që në këtë moment të ndjeshëm, tani kur tre muaj veteranët e vërtetë nuk i kanë marrë ato paga minimale, që janë edhe ofenduese po të këqyret hollë e hollë, por nuk është shumë korrekte të bëhet krahasimi i gjendjes në shëndetësi me fondin e ndarë për veteranët.

Gjendja në shëndetësi është e mjerueshme. Është i vërtetë konstatimi i të gjithëve, por kjo gjendje është edhe si rezultat i ish-ministrave, e kryesisht ministrave të LDK-së, sepse u fol për shëndetësi të sëmurë, për fëmijët që kanë lindur nëpër korridore, për 70 milionë euro shërbime që kanë ndodhur jashtë shtetit në vitet e fundit, kur LDK-ja e ka qeverisur këtë ministri.

Unë pajtohem që këto janë raste shqetësuese, por dua t'i dimë edhe pasojat se pse vijmë deri te kjo gjendje, që ne pastaj kërkojmë mjete financiare, ose taksa të qytetarëve për të shkuar në shëndetësi. Sepse krimi i organizuar që ka lidhje me institucione, që ka pasur dhe dyshoj që ka ende, dhe për të cilin të ardhmen e afërt dua të diskutoj veçanërisht brenda 100-ditëshit të Qeverisë është se institucionet e caktuara të lidhura me parapolitikën e partive që e kanë qeverisur vendin kanë lënë viteve të fundit mbi 10 milionë litra vaj pallma që të hyjë në Kosovë, të cilin edhe institutet e ndryshme ndërkombëtare, e veçanërisht evropiane, e kanë konstatuar se është kancerogjen, dhe mbi 50 produkte ushqimore në Kosovë aktualisht kanë përmbajtje e këtij vaji, nga i cili pastaj natyrisht qytetarët përfundojnë nëpër spitale, e Buxheti i Kosovës duhet të jetë afër qytetarëve, ai 70-milionëshi që u përsërit disa herë.

Këtu, me një fjalë, unë kam pritur, meqenëse të gjitha partitë janë nga pak fajtores për situatën edhe për rishikimin me vonesë e Buxhetit, unë kam pritur që debati të jetë ndërtuar në mënyrë thelbësore me gjuhën e fakteve dhe argumenteve dhe ndryshimin e vijave buxhetore varësisht prej prioriteteve që ka vendi, kur bëhet Buxheti për vitin e ardhshëm. Mirëpo, foltorja e Kuvendit

të përdoret për ofendime dhe duke tentuar për t'u bërë lajm për të lënë pasoja në opinion, unë mendoj që është më shumë se e papranueshme. Prandaj kisha kërkuar përmbajtje nga të gjithë, ta kalojmë këtë rishikim të Buxhetit, me gjithë defektet që ka dhe, po e ripërsëris, të gjithë janë nga pak fajtorë për këtë situatë, sepse në fund të fundit, dy parë zgjedhje janë duke u organizuar dhe pak kush e ka pasur, edhe në opozitë, edhe në pozitë, domethënë vëmendjen të Buxheti dhe të rialokimi i mjeteve nëpër vija buxhetore të duhura. Gjithsesi, kisha kërkuar që foltorja në këtë rast të mos përdoret edhe për poenë mbi një të kaluar, që është sa e hidhur, aq edhe e lavdishme. Është një e vërtetë që të gjithë kanë faj për fryrjen e listave, po i rikthehem, unë jam nga të paktët deputetë që me shumë ngulm kam thënë që nuk jam veteran i UÇK-së, në rast se është veteran edhe një bashkëpunëtor i UDB-së, nuk jam veteran i UÇK-së nëse invalid lufte është edhe një njeri që është kthyer dy vjet pas luftës në Kosovë.

Nuk është veteran i luftës në rast se një invalid, i cili është bërë operacion prej majasëllit, është invalid i luftës. Këtë e kam thënë me përgjegjësi të lartë, prandaj nuk është mirë të manipulohet me këtë kategori tepër të ndjeshme. E bëjmë miratimin e këtij rishikimi dhe u rikthehem pastaj edhe listave, edhe shumë çështjeve të tjera, të cilët i potencova dhe që janë si rezultat i gërshetimit zinxhiror të krimit të organizuar me parapolitikat e partive politike që kanë qeverisur dhe që, për fat të keq, një pjesë janë edhe në qeveri. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Merruni me Buxhetin, mos u merrni fort me veteranët e luftës, se është dashur ligji të bëhet në kohë dhe jo tash, pas marrëveshjeve politike, lojërave që janë bërë, gjoja po zbulojmë diçka të re. Fjalën e ka zoti Faton Topalli.

Mua m'u tha që Zafirrit t'ia jap fjalën, nënkupton që krejt ka përfunduar, a kanë folur këta të AAK-së? A keni folur para "Nismës" ju? Nuk e bëra me qëllim. S'kanë folur, ani që, flisni dikush, kush po e do fjalën?

**FATON TOPALLI:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Të nderuara kolege,

U diskutua shumë për Buxhetin prej 400 faqesh, ku nuk mund të shihen fare ndryshimet, të cilat janë bërë. Si duket, ka pasur qëllim për t'i fshehur premtimet elektorale dhe posa të përfundojë kjo çështje, të krijohet një komplikim i tillë që të mos shihet se cilat janë ndryshimet e bëra. Si duket, kjo është e qëllimshme, prandaj dhe kërkoj nga Qeveria e Kosovës që kur ta bëjë Buxhetin e vitit 2018 të kujdeset që ndryshimet të jenë të dukshme për të gjithë deputetët, pa pasur nevojë për të krahasuar gjithë Buxhetin prej 400 faqesh.

Unë jam marrë më shumë me anën sociale të rishikimit të Buxhetit, e kam parasysh faktin që qeveria lindi para kohe, me vonesa dhe komplikime të mëdha në procesin e lindjes, por i kam parasysh edhe premtimet e bëra për ndryshim në programin qeverisës në fushën sociale. Buxheti i një vendi tregon më së miri se cilat janë politikat konkrete të një qeverie, edhe këtu nuk e kam

lënë për harresë faktin që ne kemi para vetes Buxhetin e PDK-së dhe të LDK-së, por kam parasysh edhe faktin se me ardhjen e qeverisë, këto politika do të rishikoheshin, pra Buxheti i rishikuar dhe do të duhej të shfaqte politikat e reja sociale të qeverisë së re.

Sot në Kosovë jetojnë 107 mijë qytetarë nga ndihmat sociale, një numër që është i njëjtë me numrin e banorëve të komunës së Ferizajt apo të Gjilanit. Këta qytetarë e qytetare, pra gra, burra e fëmijë, janë të detyruar të jetojnë me mesatarisht nga 252 euro në vit, respektivisht me nga 0.69 centë në ditë. Buxheti i rishikuar është 27 milionë e 427 mijë euro, edhe Buxheti i rishikuar nuk ka asnjë cent më shumë se sa kjo shumë.

Zonja deputete e zotërinj deputetë,  
Zoti kryeministër, ministra,

Harrojeni për një çast që po flet një deputet i opozitës, më ndiqni vetëm një çast, ju lutem, vetëm për pak çaste. Mbyllni sytë, mendoni për një moment që jeni qytetarë që jetoni nga ndihmat sociale. Është dimër, jeni në një dhomë të errët me gruan dhe dy fëmijë, sepse kurseni energji, nuk keni dru për ngrohje, pra është ftohtë, frigoriferi është i zbrazët, sepse me mjetet që posedoni nuk mund ta mbushni kurrë frigoriferin. Me këto mjete nuk mund të blini as bukë dhe asgjë më shumë. Keni parasysh fëmijët që duan të shkojnë në shkollë dhe turpërohen para shoqeve të tyre me rrobat e këqija, me këpucët e papërshtatshme për dimër.

Derisa fëmijët e tjerë hanë hamburgerë, fëmijës tuaj i rrjedh lëngu në gojë, por ai mund të kënaqet vetëm me aromën e tyre, ndoshta as kaq jo, sepse fëmija tjetër nuk e lë t'i afrohet. Jeni pa barna, pa artikuj higjienikë, pa rroba të përshtatshme për motin, pa asnjë shpresë që dita që vjen do të jetë më e mirë se dita që shkon. Tani hapini sytë dhe mendojeni sikur ju papritur nga qytetari me asistencë sociale do të ishit ministër, çfarë do të bënit? A do të investonit në autostradë, apo do ta rritni Buxhetin për ndihma sociale? Besoj që përgjigjen e dini. Ju do ta siguronit së pari bukën e gojës. Shumica e 107 mijë qytetarëve që jetojnë me ndihma sociale rrallë do të kenë mundësinë për ta shfrytëzuar autostradën, për të mos thënë asnjëherë.

Ministri Pal Lekaj e tha që autostrada është bërë për të lidhur kryeqytetet, Beogradin, Prishtinën e Shkupin. Kam pritur që me rishikimin e Buxhetit do ta rrisni këtë shumë, mjerisht nuk keni bërë asnjë lëvizje, janë shumë qytetarë, ministër. Duhet të bëni diçka për ta, janë më shumë se numri i të gjithë banorëve të Gjilanit, e kam parasysh Buxhetin e mashtrimit 2 miliardë euro dhe rishikimin 200 milionë më pak. Megjithatë sigurimi i ekzistencës është prioritet i parë, vendet e punës prioriteti i dytë, kur kemi prodhim, pra kur kemi vende pune, na duhet autostrada për të qarkulluar njerëzit dhe mallrat, por tani qarkullojnë vetëm mallrat e Serbisë dhe të vendeve të tjera fqinje.

Ju jeni duke e përgatitur Buxhetin e vitit 2018, keni edhe pak kohë për të shprehur me Buxhetin tuaj politika të reja sociale, në qoftë se keni, por nuk keni politika sociale. Keni parasysh

premtimin që keni bërë për pensionet, për jetë me dinjitet, zbatoheni sistemin tre shtyllës, siç e propozoi Lëvizja “Vetëvendosje”, krijoni mundësi për implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore, e dëgjova debatin e deritanishëm duke ia lënë fajin njëri-tjetrit, por ishte PDK-ja ajo që e bëri ligjin në kohën kur ishte në pushtet, ishte PDK-ja dhe LDK-ja që nuk e implementuan këtë ligj gjatë këtyre viteve të qeverisjes së përbashkët. Pra, mos ia leni fajin njëri-tjetrit. Jeni të dy palët fajtorë, nuk e implementuat Ligjin për sigurimet shëndetësore, edhe pse thatë që ky ligj po bëhet edhe për të ulur varfërinë, sepse për çështje shëndetësore familjet japin shumë para.

Ju kishit mundësi ta rregulloni shëndetësinë në Gjiilan, në Prizren, në qytetet e tjera të Kosovës, pse nuk e rregulluat ashtu siç e rregulloi edhe Prishtina. Rishikoni edhe rishqyrtoni politikat për punësim të rinjve, masat efektive në tregun e punës që i keni propozuar në programin qeverisës nuk i përgjigjen realitetit në Kosovë. Ato janë thjesht masa të kopjuara për tregjet perëndimore, si të tilla mund të gjesh në çdo libër shkollor në vendet e zhvilluara perëndimore. Tek ne nuk është problemi se kemi njerëz të pashkolluar dhe nuk po arrijmë t’i mbulojmë vendet e punës, ne nuk kemi fare punë, ministër. Shkolloni dhe rikualifikoni sa të doni, sepse nuk ka punë, prandaj masa të tilla në tregje janë shpenzim i mjeteve, por nuk sjellin ndonjë ndryshim për punësim.

Më lejoni që krejt në fund të shtroj edhe 2-3 çështje për Ferizaj. U përmend shumë çështja e implementimit të Ligjit për veteranët e luftës. Unë dua t’ju përkujtoj që kemi edhe një vendim të gjykatës për Fabrikën e gypave, i cili gjithashtu është obligim ligjor dhe të cilin nuk po e përmbushni. Kryeministri aktual u ka premtuar punëtorëve të Fabrikës së gypave se do t’ua paguajë mjetet, për të cilat duhet t’i paguani, por megjithatë në Buxhet nuk shihet se ka ndonjë lëvizje. Është premtuar ndërtimi i spitalit në Ferizaj me Buxhetin fillestar për vitin 2017, shihet që në vitin 2016 janë paraparë 1,1 milion euro, në vitin 2017 - 1,1 milion euro, ndërsa në vitin 2018 - 791 mijë euro, gjithsej 3,6 milionë euro.

Buxheti i rishikuar i vitit 2017 thotë që për vitin 2017 janë paraparë 20 mijë euro për spital, për vitin 2018, 791 mijë euro dhe për vitin 2019 1 milion e 791 euro. Pra, edhe tre vjet nuk do të kemi spital. Pse po i mashtroni qytetarët e Ferizajt me nga 20 mijë euro për vitin 2017, pra edhe tre vjet me atë që shihet nga Buxheti, shihet që nuk do të ketë spital. E para, me këto 20 mijë euro shihet që keni bërë mashtrime edhe në fushat e tjera, për shembull ndërtimi i rrugës Bibaj, kycja R6 “Driton Islami”, N2 në Ferizaj, për këtë rrugë janë paraparë 20 mijë euro për këtë vit, edhe pse projekti kushton 320 mijë euro. E njëjta gjë është për asfaltimin e rrugës Sojevë - Mirosal - Softaj 20 mijë euro, edhe pse projekti është 320 mijë euro.

E njëjta gjë edhe me asfaltimin e rrugës Pleshinë - Kashtanjevë të Ferizajt, tjetër njësoj është edhe asfaltimi i rrugës Talinocv i Muhaxhirëve në Ferizaj, ku keni ndarë vetëm 10 mijë euro, e projekti kushton 160 mijë euro. Pra, të gjitha këto janë mashtrime elektorale me shuma



qesharake, ndërsa implementimi i tyre nuk mund të bëhet këtë vit, e madje nuk mund të bëhet as vitin e ardhshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Më vjen keq që kryetari i Kuvendit nuk është këtu për të dëgjuar, sepse si kryetar i Kuvendit nuk i takon që në çdo seancë të merret me nga një deputet të LDK-së veç e veç, s'ka për t'ia dalë në krye kësaj pune, po sidoqoftë.

Kthehemi tani tek tema për të cilën jemi duke diskutuar. Rishikimi i Buxhetit dy muaj përpara se të mbyllet viti fiskal, nuk besoj që do t'i hyjë në punë tash qeverisë. Kjo punë është dashur të bëhet menjëherë me marrjen e mandatit, ka qenë pothuajse i gatshëm në atë kohë. Kjo besoj do t'i kishte mundësuar qeverisë, i kisha lut deputetët të shohin punën e tyre tash ndërkohë që unë e kam fjalën, i kam minutat e mi, do të kishte mundësuar ministri që ta përmbyllë vitin ashtu si duhet, pra i bie që vonesa në kryerjen e obligimeve, përfshirë edhe obligimin ndaj veteranëve të luftës, janë thjesht çështje të neglizhencës së procedimit me kohë të këtij projektligji.

Sidoqoftë, problemi i parë me këtë rishikim është rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për 22 milionë euro, të cilat nuk është e qartë në Buxhet se cila është arsyeja për këtë rritje të shpenzimeve koherente për mallra dhe shërbime. Janë rritur 7,2 milionë euro në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nëse nuk gaboj, ministër, besoj e sqaron më vonë dhe duhet të japësh arsyet pse janë rritur. Nëse është për pagesën e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit, atëherë është çështje tjetër, dhe Ministria e Punëve të Jashtme me 1,5 milion euro. Pra, këtu një arsyetim i qartë pse duhet për fund vitit 1,5 milion euro për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Problemi kryesor është tek investimet kapitale, këto janë zvogëluar për 214 milionë euro. Nga kjo shumë, 87 milionë euro janë paraparë mjete, kanë qenë të parapara mjete nga Agjencia e Privatizimit, ajo që është dashur të ndodhë, ministër, është që në gjysmë të shtatorit të vijë rishikimi i Buxhetit bashkë me Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit të AKP-së. E thatë me fjalën hyrëse, më lejo të korrektoj, nuk po them fjalë tjetër, por veç të korrektoj që ky projektligj i ka kaluar të gjitha procedurat e diskutimit publik dhe është dorëzuar në Qeveri, vetëm ka pritur miratimin e Qeverisë dhe procedimin në Kuvend. Kostoja oportune e mosshfrytëzimit të mjeteve të AKP-së është bukur e madhe, ju si ekonomist e dini po aq sa unë që këto mjete, qindra miliona euro, mbesin të pashfrytëzuara për shkak të mosndryshimit të ligjit.

E dyta, investimet kapitale nga klauzola e investimeve, është hera e parë që ne në qeverinë e kaluar e kemi bërë këtë. Ju keni qenë guvernator dhe bashkë i kemi zhvilluar bisedat me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe e dimë të gjithë arsyeshmërinë e futjes së klauzolës së investimeve

në projeksionet buxhetore, të cilën atëherë e keni përkrahur ju dhe tash e përkrah partia juaj, e ka përkrahur edhe atëherë partia juaj këtë lloj klauzole, e cila mundëson që negociatat që zhvillohen për projektin me financim nga huamarrja gjatë vitit kalendarik, në momentin që aprovohen, ratifikohen marrëveshjet në Kuvend, të futen në Buxhet.

Sidoqoftë, problemet janë të disa projekte që janë më specifike, ta zëmë, tek Universiteti i Prishtinës hiqet komplet ndërtesa e Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në shumë prej 400 mijë eurosh dhe shtyhet tek në vitin 2019. Pastaj mjetet për autostradën e Gjilanit, besoj që u sqarua mjaft kjo temë. Te Ministria e Ambientit, ministër, është Fabrika e ujërave të zeza në Pejë, me kod 14691 që ka qenë në buxhetin origjinal, tash nuk figuron fare, në shumë prej 3.8 milionë eurosh. Këto janë obligime të Qeverisë së Kosovës karshi KWF, Bankës Gjermane për Zhvillim për tri projekte të tilla në Pejë, Gjakovë dhe në Prizren.

Nuk është hequr projekti për Prizrenin, ka mbetur në shumën origjinale, për Pejë është hequr komplet nga buxheti. Ky është obligim ndërkombëtar në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara në këtë Kuvend. Në Prizren është një projekt interesant që insistonte vitin e kaluar Komuna e Prizrenit ta fusë teleferikun prej 1 milion euro. Nuk ka filluar fare asnjë procedurë, ndërkohë që mjetet mbesin aty. Mjetet për autostradën e Gjilanit merren me arsyetimin që s'kanë filluar procedurat, një projekt në Prizren 1 milion euro s'ka asnjë procedurë që ka filluar, mbetet projekti aty ku ka qenë, ndërkohë që Pejë i hiqet komplet 3,8 milionë euro nga huamarrja.

Grupi ynë parlamentar gjatë dy leximeve do të ofrojë amendamentimet e nevojshme për t'u siguruar që nuk kthehemi në praktikën e të kaluarës, ndarjes së buxhetit nëpër komuna mbi baza politike. Unë kërkoj dhe lus ministrin që në veçanti të japë sqarime ku janë buxhetuar në mënyrë specifike mjetet për pagesën e firmës austriake lidhur me vendimin e arbitrazhit për aferën e pasaportës, janë 5.3 milionë euro, plus ndëshkimet e ndryshme që mund të kalojë 6 milionë euro. Të na sqarojë në projeksionet afatmesme të Buxhetit, e dyta, se si do të merret eventualisht me vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit për kompaninë "Aksus" ndaj PTK-së, të na tregojë gjithashtu se si do t'i kryejë obligimet që ka tash Qeveria e Kosovës ndaj një padie që Posta e Kosovës i ka bërë aksionarit të vet, Qeverisë së Kosovës, në shumë prej 3.2 milionë euro? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar ministër,

I nderuar deputet Hoti,

Faleminderit për mundësinë t'i sqaroj disa çështje. Ne kemi diskutuar se ku janë marrë mjetet dhe ku duhet të shkojnë mjetet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe unë si ministër i Financave kam marrë obligim që anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa t'ua dërgoj listën me shkurtimet dhe me ridestinimet e këtyre projekteve dhe të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa e kanë marrë këtë listë.

Megjithatë, po e sqaroj se 716 mijë euro kanë shkuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës për kompensimin e personave, të cilët kanë pasur dëme për gjedhet të cilat u kanë ngordhur. Pastaj, është Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, janë 300 mijë euro për qira, Ministria e Financave, Doganat janë 149 mijë euro, Ministria e Administratës Publike, mirëmbajtja e ndërtesave janë 200 mijë euro, Ministria e Financave - Ministria e Inteligjencës Financiare, janë 30 mijë euro, Ministria e Financave - administrata qendrore, janë 69 mijë euro. Ministria e Administratës Publike - licencat për softuerë të ndryshëm janë 450 mijë euro, Ministria e Administrimit Publik, janë 10 mijë euro te Instituti, Ministria e Infrastrukturës, 50 mijë euro janë te autostrada, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 95 mijë euro, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale janë 26 milionë euro, Ministria e Punëve të Brendshme janë 5,6 milionë euro, që është për vendime gjyqësore, nëse këto veç e marrin formën e prerë, Ministria e Punëve të Jashtme janë 1 milion e 550 mijë euro, sepse e dimë që janë shkurt të marrin shërbime dhe shumë ambasada, të gjithë ne i posedojmë informatat, janë me vështirësi sa u përket pagesave të obligimeve.

Janë shpenzimet e paparashikuara të rezervave 1 milion e 100 mijë euro. Këshilli Prokurorial i Kosovës 300 mijë euro. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë 1 milion e 900 e diçka mijë euro, rreth 2 milionë euro dhe po përmend vetëm edhe dy shuma pak më të larta, që është Radiotelevizioni i Kosovës 1 milion e 400 mijë euro dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për rastin e studimit të fizibilitetit Trepça janë 598 mijë euro, që gjithsej këto bëjnë 90 milionë e 965 mijë euro.

Sa u përket çështjeve të tjera, nuk kam mundur të përgatis dhe të kryej rishikimin më shpejt se sa 1 javë që jam bërë ministër. Më datën 11, 12 shtator e kam marrë postin e ministrit, më 22 shtator është aprovuar Buxheti në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kaq ka qenë domethënë në mbledhjen e parë që ka mbajtur Qeveria është aprovuar rishikimi i Buxhetit. Sa i përket rritjes për mallra dhe shërbime, besoj që e dhamë përgjigjen, sa u përket çështjeve të shpenzimeve kapitale, edhe më herët e sqaruam, ne e dimë që klauzola e investimeve është mirë, është mirë që u bë, por e dimë që edhe marrëveshjet e caktuara ndërkombëtare, ratifikimi i tyre po merr kohë.

Deri në momentin kur po kryhen procedurat po merr kohë, e unë besoj që ka qenë viti i parë ku ne kemi vendosur diçka me klauzolën e investimeve. Sigurisht që do të vijnë edhe projekte për vitin e ardhshëm 2018 me klauzolën e investimeve, po sot po deklaroj këtu në Kuvend, po qe se tani nuk fillojnë që të bëhen përgatitjet për ekzekutimin e këtyre projekteve, organizatat buxhetore do t'i kenë mjetet në Buxhet, por realizimi i tyre do të jetë pak më ndryshe se sa realizimi që shkon i mjeteve direkt nga Buxheti i Kosovës. Do të thotë, puna e universitetit është njëjtë, kanë qenë mjete të planifikuara prej AKP-së, sigurisht se fakultetet kanë qenë financim prej AKP-së.

Sa i përket Fabrikës së ujërave të zeza në Pejë, sinqerisht këto kanë qenë projekte të përgatitura, nuk ka këtu asnjë, se unë sot i kam pritur edhe diskutimet e deputetëve të pozitës, opozitës, ka pasur ngritje për projekte të caktuara që janë hequr edhe në drejtim të Mitrovicës, se çdo ditë e bëj atë rrugë, edhe projekte të tjera, por aty ku ka nevojë, e kam thënë edhe në prezantimin tim të parë, mjetet do të kthehen duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit të Buxhetit, që neve na mundëson një... komplet e kthejmë edhe në mes të dy dëgjimeve. Nuk ka qenë qëllimi dhe nuk është qëllimi i rishikimit të dëmtojë projektet, të cilat janë në vijim dhe cilat mund të realizohen. Do të thotë, realisht çdo gjë që ka mundur të ketë shmangie për projekte të caktuara dhe ka nevojë që të kthehen projekte të caktuara, kode të caktuara, ndërmjet të dy leximeve, nëpërmjet amendamenteve, ne si Ministri e Financave jemi të gatshëm t'i rregullojmë.

Sa u përket proceseve të tjera, unë kisha dashur të besoj dhe uroj që Qeveria e Republikës së Kosovës, shteti i Kosovës të mos përballet me ndonjë situatë që do të ketë nevojë që të paguajë edhe obligime të tjera. Sa i përket rastit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Postës ka disa vendime, informata të cilat mua m'i kanë dhënë juristët ditëve të fundit është që ky proces duhet të kthehet edhe një herë në proces gjyqësor dhe pastaj ta marrë formën finale. Do të thotë, nuk është vendim i formës së prerë dhe besoj që zotit Hoti kam arritur t'i jap sqarimet e nevojshme në çështjet që ju i keni ngritur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën, a replikë. Zoti Hoti ka replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, ministër, për sqarimet, veç nuk e qartësuat deri në fund çështjen e projektit të ujërave të zeza në Pejë. Nuk e kam veç për komunën e Pejës, por është obligim ndërkombëtar që ka shteti i Kosovës ndaj Bankës Gjermane për Zhvillim, në bazë të marrëveshjes së ratifikuar në këtë Kuvend, është hequr për Pejën, nuk është prekur për Prizrenin.

Edhe e dyta, projekti i teleferikut në Prizren, 1 milion euro. Asnjë procedurë nuk është kryer. Pse nuk merren ato mjete, të rialokohen ku ka nevojë të shpenzohen, ta zëmë në autostradën për Shkup, ose në autostradën për Gjilan, që të mund ta fillojnë punimet së shpejti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Hoti!

Të gjitha projektet që s'kanë mundur të përfshihen në rishikim ka mundësi të trajtohen ligjërisht, e ju jeni më shumë se mirë i informuar për këtë, që brenda Ligjit të Buxhetit, mbi bazën e nenit 16 ne do të shikojmë se aty ku do të lajmërohen tepricat për projektet që nuk kanë filluar të realizohen, ato do t'i ridestinojmë. Ndërsa obligimet kontraktuale që i kemi, jo veç ku jemi në bashkëfinancim me institucionet financiare ndërkombëtare, por edhe që janë në financim prej Buxhetit, ne nuk do t'i ndalim.

Prandaj, në momentin kur e rishikojmë, e shohim në sistem që projekti i teleferikut, apo cilido qoftë tjetër, të mos flasim me projekte konkrete, ne do t'i marrim dhe t'i vendosim t'i kryejmë ato ku i kemi obligimet. Ndërsa, unë ju siguroj që sa i përket projektit të Pejës, ne do të jemi shumë të kujdesshëm dhe do të qesim fonde të mjaftueshme për realizimin pa pengesë të atij projekti.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

I nderuar ministër Hamza,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua të bëj atë që kisha në plan më herët, një replikë me Armendin, pasi m'u apostrofua emri. Unë dua të uroj të gjithë kryetarët e komunave, të cilët kanë fituar në zgjedhjet lokale pa balotazh dhe ata të cilët janë në garë dhe të cilët unë shpresoj që të jenë në shërbimin e qytetarëve. Në veçanti dua ta uroj Bekim Hamzë Jasharin për fitoren në Skenderaj me mbështetjen më të madhe në nivel të Republikës së Kosovës. Dhe, gjithsesi, kur jemi te kjo, edhe në Pejë te zoti Muhaxheri, meqë e pati Armendi një diskutim, i urojmë edhe Gazit fitoren, sepse ishte edhe një përkrahës i demarkacionit, derisa gjysma e Grupit Parlamentar të LDK-së e kundërshtonte.

Prandaj, është mirë Armendi të na tregojë, nëse tani LDK është me Gazmend Muhaxherin, apo me Shpejtim Bulliqin?

I kthehem diskutimit për Buxhetin. Fillimisht dua të falënderoj ministrin Hamza për punën e bërë, për gjetjen e zgjidhjeve ligjore për problematikat që janë krijuar si pasojë e mungesës së vendimmarrjes dhe projeksioneve të gabuara në Buxhetin e vitit të kaluar, për të cilin edhe PDK-ja, edhe unë si deputet i kam dhënë vërejtjet e mia. Bedri Hamza po mundohet ta mbajë nivelin e debatit në këtë diskutim, edhe pse shumica e diskutimeve po shkojnë nga një diskutim më tepër politik për fushatë elektorale, në veçanti deputetët të cilët i kanë në balotazh kandidatët për kryetarë të komunave. Por, Bedri Hamza prapëseprapë po tenton ta mbajë nivelin e diskutimeve pa e atakuar askënd. Ai vërtet është një realist dhe një profesionist i mirë, i cili me sinqeritet po përgjigjet në të gjitha ato shqetësime të deputetëve, po jep arsyetimet për autostradën për Gjilan pa e atakuar askënd dhe nuk e atakon paraardhësin e tij, i cili e paguan këstin e kredisë për rrugën Prishtinë - Mitrovicë, ndërsa Bedri Hamzës i duhet që atë rrugë ta bëjë përditë, kurse kredia për këtë rrugë tani e tetë muaj ka filluar të paguhet nga Buxheti i shtetit, e procedurat për rrugën nuk janë askund.

Zoti Hamza, të gjithë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u janë mirënjohës për zgjidhjen që ua keni bërë atyre dhe shumë kategorive tjera.

Të nderuar kolegë deputetë,

E dini që në çdo lexim të Buxhetit kam kërkuar përgjigje nga ministrat për çështjen e implementimit të Ligjit për sigurime shëndetësore. Ky Ligj për sigurimet shëndetësore, i miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, ishte planifikuar që të fillojë implementimin në vitin 2014, janë ndarë mjetet për këtë qëllim, janë zvarritur procedurat, nuk është funksionalizuar sistemi i informimit shëndetësor, nuk është funksionalizuar AFSH-ja, nga ministri paraprak i Shëndetësisë ka pasur një tentativë, një pilot-projekt për implementimin apo testimin e sistemit të informimit shëndetësor, ka dështuar dhe realisht jemi në një situatë e cila kërkon zgjidhjen, por kjo zgjidhje nuk mund të bëhet. Nuk ka sigurime shëndetësore pa implementim të sistemit të informimit shëndetësor pa funksionalizim të AFSH-së. Këtë e dinë të gjithë ata që janë profesionistë të fushës, për çka po diskutojmë.

Nuk është e vërtetë se mund të fillohen sigurimet shëndetësore pa u parapërgatitur dhe pa u bërë kushtet për këtë. Prandaj, kërkoj që vërtet të mos manipulohet me këtë çështje në veçanti, sepse interesi i të gjithë neve është që të fillohet implementimi i sigurimeve shëndetësore. Nuk mund të implementohen sigurimet shëndetësore kur ka nevojë që edhe të plotësohet ky legjislacion, sepse ligji paraprak paramendojeni nuk e ka të specifikuar edhe një kategori, kategorinë e të vetëpunësuarve.

Ka mangësi në Ligjin për sigurimet shëndetësore, ka mangësi edhe të aspekteve tjera që ndërlidhen edhe me ligjet tjera të Ministrisë së Financave dhe mendoj që gradualisht ne duhet të punojmë si deputetë, si Kuvend i Kosovës për krijimin e parakushteve, që Ligji i sigurimeve shëndetësore të implementohet dhe qytetarët tanë ta kenë një përkujdesje më të mirë shëndetësore.

Gjithashtu kërkoj që Buxheti për shëndetësi të rritet dhe ai të jetë substancial dhe i monitoruar nga përgjegjësit kryesorë dhe të mos kemi situata të tilla sikur në vitet paraprake kur është rritur Buxheti për barnat e listës esenciale, ndërsa shërbimi ka qenë më i vogël. Ju e dini që në këtë Kuvend kam kundërshtuar kur janë transferuar mjetet nga Qendra Klinike Universitare në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në AFSH, e AFSH-ja në atë kohë i kishte vetëm 6 punonjës, ndërsa ishin alokuar mjete milionëshe. Dhe, për këtë fakt sot ne kemi mungesë të barnave të listës esenciale, kemi rritje të dyfishimit të çmimit për barna dhe mungesë të barnave, njëkohësisht. Pra, është rritur kostoja dhe kemi mungesë të barnave. Kam qenë kritik në këtë aspekt dhe do të vazhdoj të jem kritik, derisa kjo gjendje të përmirësohet.

Shpresoj që kjo vërtet të arrihet me bashkëpunim dhe kërkoj një unitet të deputetëve të Parlamentit të Kosovës sa i përket kësaj çështjeje, sepse është jetike për qytetarët e vendit. Të mos bëjmë politikë me shëndetin e qytetarëve, po t'u ndihmojmë qytetarëve me punë konkrete që ajo të realizohet, që shëndeti i tyre të mbrohet fillimisht dhe pastaj, kur ai të atakohet, ta ketë përkujdesjen e duhur shëndetësore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju e dini që gjithsesi kam kërkuar edhe një funksionalizim të odave të profesionistëve shëndetësorë dhe një ndarje të mjeteve sa u përket funksionimit të atyre odave, sepse nuk është bërë një zbatim i duhur i Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë, ngase ato mjeteve të cilat kanë qenë të planifikuara me ligj nuk janë ndarë dhe se pastaj janë përballur me mungesa financiare. Ka qenë një tentativë nga Ministria e Shëndetësisë që odat të falimentohen, me qëllim që pastaj t'u merren kompetencat, sepse Ligji për odat e profesionistëve shëndetësorë u jep atyre mjaft kompetenca, në veçanti në menaxhimin human dhe në edukimin e vazhdueshëm, gjë që është tentuar të bllokohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Është kërkuar një investim më i saktë sa i përket parandalimit të sëmundjeve, në veçanti në diagnostifikim dhe trajtim. Kërkoj gjithsesi një llogari dhe një përgjigje nga ministri i Financave, nëse ka mundësi edhe ai i Shëndetësisë, për projektin për modernizimin e Kardiologjisë, një kredi e cila është marrë në Bankën Austriake dhe kjo kredi është rritur pastaj për 500 mijë euro, gjë të cilën unë e kam kundërshtuar. Kërkoj një përgjigje të saktë se çfarë është bërë me këto mjete, ku janë aparaturat? Edhe pse është ky projekt i modernizimit, ne e dimë se kemi pasur blerje apo dublikim të aparaturve dhe jo modernizim. Ku janë ato aparatura, pasi ai ligj dhe ai projekt është miratuar një vit më parë? Dua një përgjigje nga ministri i Financave, ose nga ministri i Shëndetësisë, sa i përket këtij projekti.

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të tërheq vëmendjen edhe te disa investime, të cilat prekin fushën e sportit, në veçanti projektin për stadiumin nacional, që planifikohet. Unë mendoj që ai duhet të jetë një pjesë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, në veçanti për vitin 2018, por gjithsesi përfundimi i investimeve në stadiumin "Adem Jashari" dhe stadiumin e Prishtinës brenda vitit 2018 duhet të jenë objektiv kryesor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të përgatiten kushtet që këto dy stadione ta plotësojnë kriterin 4 për garat ndërkombëtare.

Gjithashtu, kur të jemi te fushat e sportit, kërkoj një mbështetje të veçantë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për një projekt, të cilin e kanë filluar banorët e fshatit Runik, ndërtimin e fushës së futbollit në këtë fshat, i cili është një bashkëfinancim i KFOR-it dhe i FSK-së, të cilin po e ndihmojnë qytetarët e Runikut. Dua ta falënderoj këtu donatorin, KF Basel nga Zvicra dhe bashkatdhetarin tonë, i cili e ka mundësuar sjelljen e barit sintetik nga ky stadium i Zvicrës, Tahir Çitaku, i cili vërtet e ka bërë një punë të mrekullueshme, prandaj po kërkojmë edhe një mbështetje që të përfundojë ky projekt dhe se kjo i takon Ministrisë së Sportit që ta mbështesë këtë projekt për stadiumin e KF Përparimi në Runik.

Gjithashtu, pasi ministrit nuk i takon që të kërkojë buxhet ose mjete për vendlindjen e tij, më takon mua që të kërkoj një mbështetje të Ministrisë së Financave për projektin e pastrimit dhe rregullimin e shtratit të lumit "Klina" nga fshati Kuqishtë deri në Skenderaj, sepse është projekti

i kanalizimit, i cili do të përfundojë në impiantin në Skenderaj, dhe pas realizimit të projektit të kanalizimit është më se i domosdoshëm edhe projekti për rregullimin e shtratit të lumit “Klina” dhe gjithsesi në këtë fazë do të duhej një mënyrë urgjente në ndaheshin mjetet për një mbikalim në Klinë të Epërme, te lagjja Mecina, sepse pas ndërtimit të rrugës me katër korsi është rrezikuar jeta e banorëve në atë lokalitet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Vërtet po më vjen keq që sot kjo seancë e Kuvendit më shumë është shndërruar në një gjykatore apo në një orë letrare, sesa në një Kuvend i cili duhet t’i trajtojë çështjet e Kosovës, ose çështjet që janë me prioritet për Qeverinë dhe vendin.

Ministrin e falënderojmë për elaboratin e Buxhetit dhe sqarimet shtesë për çdo paqartësi që u diskutua këtu. Është mirë që Buxheti të ndahet në mënyrë racionale dhe jo në mënyrë rajonale, sepse e kemi pasur një rast shumë të keq. Ka qenë rasti i rrugës për Pejë, i cili qe dhjetë vjet ka filluar dhe ende ka mbetur pa përfunduar, ose rasti tjetër më konkret është ndarja e Buxhetit nga Qeveria paraprake për rrugën Deçan-Plavë, rrugë e cila është e rëndësisë nacionale e janë ndarë veç 50 mijë euro.

Ministri s’qenka këtu, desha t’i them se ka qenë i përfshirë në projekt-Buxhet rregullimi i shtratit të lumit “Bistrica” në Deçan dhe po e shoh se tash nuk është në Buxhet.

Qeveritë paraprake kanë thënë që shumë sektorë janë me prioritet dhe unë mendoj se kjo Qeveri duhet ta marrë shembullin më të mirë, që vërtet sektorët që duhet të jenë me prioritet të jenë sektorë me prioritet, siç është bujqësia, sepse bujqësia është një ndër sektorët kryesorë për zhvillimin ekonomik të vendit, kjo për arsye se rreth 90% e popullsisë posedon tokë kultivuese. Ndërsa, nga mungesa e mbështetjes së Qeverisë, vetëm 35% e popullsisë është e angazhuar në fushën e bujqësisë dhe mendoj se bujqit, meqenëse po merren me bujqësi, duhet të subvencionohen dhe mjetet vërtet të ndahen për ata bujq që vërtet punojnë.

Sektor tjetër që është thënë se është me rëndësi ka qenë shëndetësia, por në fakt nga qeveritë paraprake ne e dimë se prioritet ka qenë veç në letër, ndërsa në fakt nuk mund të jetë një sektor prioritet kur ka qenë i nënfinancuar dhe duke ia shkruar kësaj se edhe ato mjete të pakta janë keqmenaxhuar dhe është kurorëzuar me afera të shumta korruptive, që e ka bërë sistemin shëndetësor sistemin më të përfolur.



Unë mendoj se të gjitha këto duhet të eliminohen dhe Qeveria të ndajë vërtet Buxhet, në mënyrë që më shëndetësia të mos jetë e nënfinancuar, por të financohet në mënyrë që të dalim prej kësaj krahature, në të cilën gjendemi.

U fol shumë për fondin e sigurimeve shëndetësore. Ne si deputetë paraprakë edhe në legjislaturat e kaluara e kemi ngrehur shumë çështjen e implementimit të Ligjit të sigurimeve shëndetësore dhe gjithmonë janë prolonguar afatet për fillimin e implementimit të Ligjit të sigurimeve shëndetësore, duke filluar në janar 2014, 2015, 2016, 2017 dhe ende nuk kemi fillimin e implementimit të ligjeve shëndetësore. Mendoj që kjo Qeveri duhet ta ketë prioritet që Ligji i sigurimeve shëndetësore të fillojë të implementohet, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të marrin shërbime shëndetësore ashtu siç e meritojnë.

Unë dua ta përgëzoj Qeverinë që më në fund kategoria më e vlefshme e shoqërisë, që janë veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë përfshirë në një vijë buxhetore të rregullt dhe ata nuk do të trajtohen më si qytetarë të kategorisë së dytë. Janë elita e Kosovës dhe mua më vjen keq që familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët sot kanë mundur t'i dëgjojnë fjalët më fyese për këto kategori. Të mos kishte qenë kjo kategori shumë njerëz që sot po ligjërojnë këtu do të ishin azil, ku e kanë dhënë kontributin gjatë luftës, kur në Kosovë është luftuar dhe ku shumëkush ka rënë dëshmorë, domethënë do të ishin në ato vende ku e kanë dhënë kontributin, në Gjermani a në Zvicër, në Austri a në ato vende që e kanë dhënë kontributin gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ministër, meqenëse u ktheve, në vijën buxhetore, e thashë më herët, nëse nuk përton të mbash shënim, ka qenë rregullimi shtratit të lumit "Bistrica" dhe nëse është e mundshme, pse është larguar nga vija buxhetore ky projekt dhe a ka mundësi, meqenëse është lexim i parë, në leximin e dytë të kthehet kjo vijë buxhetore, në mënyrë që të rregullohet.

Unë dua t'i përgëzoj veteranët, t'u them se pas kalimit të Buxhetit, vërtet do t'i merrni ato pensione që i meritoni dhe më askush nuk mund të luajë me pagat e tyre, sepse ajo është në vijë të rregullt buxhetore. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Albulena Balaj, urdhëro!

**ALBULENA BALAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Këtu po përmenden vepra të mëdha, me të cilat krenohet çdo qytetar. Punë më e madhe deri më tash nuk është bërë në Kosovë sesa autostrada dhe Aeroporti. Po, ju nuk mund që me shpifje të merrni ndonjë votë aty-këtu, se tashmë kjo formë po tejkalohet, e duke shprehur dyshim mbi këto projekte, të cilat do të jetojnë përtej jush.

Filloni e tregoni se çka ju do të bëni për vendin. Filloni e tregoni se çka ju mendoni për projektet, të cilat duhet t'i arrini nëpërmjet këtij Buxheti, por ju nuk keni çka të flisni, sepse juve ju mungon vullneti, gatishmëria dhe idetë për të punuar për vend. Prandaj, merreni me veprat të cilat janë krenaria e vendit, sepse juve, siç po shihet, e edhe vetë e pranuat, veprat e mëdha për Kosovën po ju pengojnë. Ju mund të vazhdoni t'i përbuzni veteranët, siç i keni përbuzur dikur dhe po vazhdoni t'i përbuzni edhe tash dëshmorët, mirëpo vepra të cilën e kanë krijuar dëshmorët dhe veteranët, së bashku me aleatët perëndimorë, e që është çlirimi i Kosovës, nga e cila më së shumti keni përfituar ju, sesa ata që kanë derdhur gjak e kanë dhënë gjymtyrë nga trupi i tyre, por këtë nuk mund ta arrini.

Nuk mund të jeni më veteranë se veteranët. Ju nuk mund të jeni më ushtarë se ata që kanë luftuar. Nuk mund të ndjeni dhembje për këtë kategori më shumë se ata që kanë qenë me këtë kategori. Prandaj, lërnini shpifjet, mundohuni dhe jepni ide për të ardhmen e këtij vendi nëpërmjet këtij Buxheti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA RADŽEPI: Zahvaljujem se potpredsedniče!

Poštovani građani,

Vidim da većina poslanika iz albanskih partija se danas jako puno zabrinula oko bošnjačke zajednice i naših projekata, zato što je još aktuelna izborna trka oko gradonačelnika opštine Prizren, a u nedelju 22 oktobra su nam svi pokazali kako se dobro kupuju bošnjački glasovi u Župi i Podgori. Ali gospodo poslanici, zakasnili ste dosta zato što su bošnjački delegati u opštini Prizren zajedno sa mnom odavno u rebalansu budžeta uvrstili naše prioritetne projekte, koji se odnose na poboljšanja osnovnih uslova života naših građana. Tako da vi nemate toliko potrebe da se brinete, jer izbori će proći, a vas će Bošnjaci znati samo kao TV-lice.

U budžetu opštine Prizren ubačeni su sledeći projekti: izgradnja nove škole u Planjanu i nastavak izgradnje školske zgrade u Grnčaru, izgradnja sportskih terena u Jablanici, Nebregoštu, ali i novi teren u Pousko i Grnčare, nova kulturno-sportska sala u Donjem Ljubinju, rekonstrukcija lokalnih puteva u našim selima i izgradnja potpornih zidova, izgradnja kanalizacione mreže u Ljubiždi, ali i vodovodni sistem u Grnčaru ali imamo samo 30 hiljade evra, pa zahtevamo od ministra Financije da nam pomogne po tom pitanju.

Takođe imamo finansijsku podršku i za rekonstrukciju vodovodne mreže u naselju Baždarana i Tusus, kao i dugogodišnji nerešivi problem svih ovih građana koji žive u Prizrenskoj opštini. Zatim naš direktor za Kulturu je takođe isplanirao finansijska sredstva za Bošnjački kulturni centar u gradu Prizrenu, koji se već gradi i koji bi trebalo da se ubrzo završi, ali nam je jako potrebna podrška ministra Finansija za infrastrukturu oko rekonstrukcije puta Prizren - Rečane, i tu podršku zahtevamo i od ministra za Infrastrukturu.

Gospodine ministre za Finansije, koji bi trebao preispitati funkcionalnost Kancelarije za zajednice pri uredu premijera, moje obraćanje danas odnosi se na tu kancelariju. Tražimo da se obnovi konkurs u vezi medija za manjinske zajednice, koji je bio nekih 200 hiljada evra, kao i konkurs za raspodelu novca nevladinih organizacija, vrednost toga je bila oko 100 hiljada evra, koji je nestao faktički pre parlamentarnih izbora. Zašto je to stopirano, i ko snosi odgovornost, i gde je taj novac prebačen, ukoliko jeste? Vrednost je više od 300 hiljada evra, i ta kancelarija nije namenjena samo zajednici Srba, nego svih ostalih zajednica koji žive na Kosovu.

Takođe zahtevam od ministra Finansija da hitno obezbedi finansijsku podršku za najveće bošnjačko selo u opštini Prizren, Gornje Ljubinje, koje decenijama unazad ima velikih problema oko vode za piće, a hidro-region nema razumevanja da se ovaj problem reši, iako smo se u nekoliko navrata obraćali Ministarstvu za ambijent i prostorno planiranje. Gospodine ministre, potrebna nam je vaša pomoć. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Sot jemi më 25 tetor, e rishikimi i Buxhetit dihet se është dashur të bëhet shumë më herët, por dihen vonesat e pajustificueshme që janë bërë, qoftë me konstituimin e Kuvendit, qoftë në krijimin e Qeverisë, e së fundmi këto vonesa që janë bërë për arsye të paarsyeshme, që Kabineti qeveritar është marrë me fushatë, e jo me punët që i takojnë.

Një praktikë e tillë e shqyrtimit me procedurë të përshpejtuar të projektligjeve të rëndësishme po vazhdon ashtu siç ka ndodhur edhe në mandatin e kaluar, mirëpo tash kemi edhe avancim në këtë drejtim, por për së mbrapshti, sepse po bëhet rishikimi i Buxhetit pa u diskutuar as Programi qeverisës. Prandaj, pa një analizë të mirëfilltë po bëhen gabime të tilla, që prej një dikasteri, siç është shëndetësia, ku Buxheti për këtë ministri është i nënfinancuar me një shumë prej 165 euro për kokë banori, që është më i ulëti në rajon, po merren mjete në vend se të shtohen.

Se e dimë se në çfarë gjendje është ky sektor, e në këto momente që jam duke folur, jo që nuk ka barna në spitale dhe në qendrat e mjekësisë familjare, po nuk ka as alkool dhe gjilpërë për dhënie e injeksioneve.

Prandaj, me rishikim të Buxhetit është dashur të shtohet Buxheti për shëndetësi, së paku këtë gjendje kaq të rëndë për ta zbutur.

Mirëpo, po ia kujtoj Qeverisë se në mandatin e kaluar në Kuvend është miratuar një rezolutë që ka qenë iniciuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, po që është votuar nga të

gjitha grupet parlamentare. Pika 4 e kësaj rezolute e obligon Qeverinë që të risë Buxhetin në mënyrë të vazhdueshme për shërbime shëndetësore, barna dhe material harxhues deri në funksionalizimin e Fondit për sigurime shëndetësore.

Prandaj, të nderuar, përgjithmonë duhet të ndërpritet praktika e tillë që në sektorin më të ndjeshëm, siç është shëndetësia, të merren mjete pa marrë parasysh se ku dedikohen.

Ndonëse e dimë se këto mjete po shkojnë për veteranë dhe invalidë të luftës së UÇK-së, që do të thotë se veteranët dhe invalidët e luftës të UÇK-së padrejtësisht janë anashkaluar tash e 17 vjet pas luftës nga të gjitha qeveritë. Ne jemi që veteranët dhe invalidët e luftës së UÇK-së të trajtohen denjësisht ashtu siç e meritojnë.

Është dashur që krahas ligjit të miratuar në Kuvend për veteranë, të sigurohet edhe përcjellja buxhetore dhe jo të presin aq gjatë për realizimin e të drejtës me ligj që u takon.

Ne shpresojmë që në Buxhetin për vitin 2018 Qeveria do të ketë parasysh që Buxheti për shëndetësi së paku të dyfishohet, sepse siç thashë, jemi vendi i vetëm në rajon që e ndajmë shumë më të vogël për kokë banori për shëndetësi. Po ashtu jemi vendi i vetëm në rajon që nuk kemi sigurime shëndetësore.

Krejt në fund, me që ministri Pal Lekaj qenka tani i pranishëm, e kam një pyetje për ministrin, i cili na tha këtu pak më parë se autostrada për Gjilanin do të bëhet, mirëpo nuk e tha kohën se kur do të fillojë apo kur do të mbarojë.

Prandaj, unë po e shoh se autostrada për Gjilanin ka qenë një temë, e cila është përdorur goxha shumë në fushatë, e siç po shihet paskan qenë mashtrime edhe të Qeverisë së kaluar, edhe të kësaj Qeverie, por po besoj që qytetarët e Gjilanit dhe të Anamoravës këtë sot e kanë kuptuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mërgim Lushtaku e ka fjalën.  
Ministrin, ia lejoni fjalën regjia.

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar deputete,

Mund të them lirshëm që ata që nuk kanë pasur Buxhet e kanë proceduar dhe mashtrimi dihet ku shkon.

Ndërsa ne, po ju garantoj para qytetarëve të Gjilanit dhe në përgjithësi të Anamoravës se ajo do të fillojë në vitin 2018 dhe tre vjet do të zgjasë i tërë projekti.

Prandaj, nuk e di pse kur ne numërojmë 50 ditë të qeverisjes na akuzoni neve që ju kemi mashtruar. Sa herë që jam prononcuar, kam thënë se së pari kontrata nuk është e nënshkruar, në

orën 23 janë përzgjedhur operatorët e favorshëm dhe dihet se si janë përzgjedhur dhe janë në procedurë. Çdo herë e kam potencuar që kjo autostradë do të ndërtohet, por le t'u mbetet atyre që kanë dashur të bëjnë projekte pa financim, pa mbështetje financiare, sikur janë mësuar edhe me 300 projekte të tjera, atëherë le t'u mbetet në ndërgjegje atyre. Por, ne nuk e kemi ndërmend ta mashtrojmë askënd. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lushtaku e ka fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi duke diskutuar për një proces shumë të rëndësishëm për ta konfirmuar rregullimin dhe përmirësimin në Projektligjin e Buxhetit, në mënyrë që të mundësojmë ekzekutimin efikas të Buxhetit për këtë vit.

Konsideroj që të gjithë jemi të vetëdijshëm që për arsye tashmë të njohura ky proces është i vonuar. Mirëpo, si i tillë, është i një rëndësie të veçantë për përmbylljen e këtij viti buxhetor dhe për obligime të tjera kontraktuale që duhet të plotësohen.

Më lejoni të përgëzoj ministrin Hamza dhe ekipin e tij për angazhim e tyre këto ditë për procedimin e rishikimit të Projektligjit për Buxhetin, përkundër kohës shumë të shkurtër.

Duke votuar këtë rishikim të Buxhetit në bazë të mandatit tonë, ne po afrojmë mundësinë për alokimin e duhur të fondeve, duke lehtësuar realizimin e projekteve nga organizata buxhetore dhe kryerjen e obligimeve që kanë lidhur edhe nga një planifikim jo i duhur i Buxhetit për këtë vit.

Është e domosdoshme të theksohen këtu obligimet për kategorinë e veteranëve të luftës, të cilët tash e tre muaj, në pritje të pagave të tyre, kanë mbetur viktimë e vakumit institucional të krijuar dhe neglizhimit të bërë nga Qeveria e kaluar gjatë ndarjes së mjeteve për këtë kategori.

Prandaj, është obligim yni që të vendosim një bazë të rregullt të pagesës së plotë dhe me kohë të mjeteve për këtë kategori, dhe dua të nënvizoj që është gabim shumë i madh nëse një veteran i vërtetë nuk e merr pensionin e tij për shkak të ndonjë mashtruesi, të cilët si të tillë, nëse ekzistojnë, duhet të ndiqen penalisht konform dispozitave ligjore në fuqi.

Ky proces i rishikimit të Buxhetit e tregon situatën faktike dhe rregullimin e Buxhetit duke larguar mjete të cilat janë të vendosura vetëm në formën e numrave, pa arsytim përkatës, që mundësojnë shfrytëzimin e tyre, sikurse është rasti e mjeteve nga AKP-ja.

Ky proces i rishikimit të Buxhetit mundëson, ndër të tjera, edhe kryerjen e obligimeve të kontraktuara për ndërtimin e rrugëve, në veçanti për zgjerimin e rrugës Skenderaj - Drenas - Komoran. Mjete të cilat kanë qenë të planifikuara, mirëpo fatkeqësisht Qeveria e kaluar e ka neglizhuar procedimin e mëtutjeshëm.

Është bërë debat njëkohësisht edhe për çështjen e sigurimeve shëndetësore.

Andaj, më lejoni t'ju rikujtoj që zakonisht në vitet e fundit po ndahen mjete për këtë çështje, por kjo punë mbeti vetëm për konsum politik nga qeveria e kaluar, sepse në vazhdimësi është neglizhuar ky proces, pasi që asnjë veprim konkret nuk është ndërmarrë dhe kjo tregon që nuk ka pasur interesim për fillimin e zbatimit të tij.

Jam shumë i vetëdijshëm që ky proces i rishikimit të Buxhetit nuk është më i miri i mundshëm dhe ne kemi prezantuar vërejtjet tona edhe në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Mirëpo, po përsëris, është me interes të miratohet për t'i dhënë dritë të gjelbër përmbylljes së projekteve që kanë filluar së zbatuari dhe janë në përfundim të sipër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Zonja e zotërinj deputetë,

Edhe sot, si një kohë të gjatë u shpërfaq logjika e PDK-së se këtë Kuvend të Kosovës, njëjtë siç e konsideron edhe gjyqësinë e Prokurorinë, e sheh si pronë të veten.

E shesh si pronë të veten, sepse njerëzit e PDK-së ankohen kur dikush u thotë të vërtetat, por nuk hezitojnë që njerëzit e këtij Kuvendi t'i akuzojnë për lidhje me BIA-n e me UDB-në dhe të thonë shkoni në Prokurori, përderisa edhe unë këtu nga kjo foltore po u bëj thirrje edhe atyre të shkojnë në Prokurori për këta njerëz të UDB-së apo të BIA-s.

Madje, nuk kanë turp që dikë të akuzojnë se është i BIA-s vetëm pse ka prejardhje nga Presheva. Shpresoj që sonte kanë dëgjuar të gjithë vëllezërit e motrat tona nga Kosova lindore për një akuzë të tillë, e sidomos ata nga Presheva, Medvegja e Bujanovci që i janë bashkuar luftës çlirimtare të Kosovës në momentet më të rënda për këtë popull.

Po flas këtu si një njeri që ka respektin më të thellë për secilën ushtar e secilin ushtar që ka luftuar për këtë vend, që ka luftuar për ta mbrojtur neve.

Po flas si një anëtare e një familjeje që ka marrë pjesë në ndërtimin e celulave të para të sistemit të mbrojtjes së Republikës së Kosovës.

Prandaj, edhe besoj që njëjtë sikur ju kam të drejtë të them që vërtet veteranët e meritojnë t'i marrin pagat, po e meritojnë veteranët e vërtetë, e meritojnë ata që vërtet luftuan, e jo ata që flisnin qoftë nga Shqipëria, qoftë nga Zvicra, qoftë nga shtetet e tjera dhe sot na shesin mend se kinse qenkan mbrojtësit e vërtetë të luftës çlirimtare të Kosovës.

A ka hipokrizi më të madhe që të kërkohet nga ne që të mos flasim për fryrje të listave, kur edhe vetë e pranojnë, secili, që një gjë e tillë ka ndodhur, kur Prokuroria tashmë është duke hetuar këtë proces, pra kërkohet që të mos thuhet e vërteta në këtë Kuvend, përderisa kjo e vërtetë po ashtu do t'i kushtojë qindra- miliona euro në vitet e ardhshme Republikës së Kosovës. Pse kjo ka ndërlidhje me shëndetësinë, ka sepse përkundër faktit që u tha disa herë që këto nuk kanë qenë Buxhet të drejtpërdrejtë i spitaleve, janë Buxhet nga Fondi për Sigurime Shëndetësore që është plani strategjik i Republikës së Kosovës për ta përmirësuar atë sistem dhe ju po ankoheni që nuk paskan ekzistuar aktet ligjore, nuk paska ekzistua infrastruktura, kush ju ndali? Kush ju ndali nga shtatori deri sot të ndërtoni aktet e nevojshme nënligjore, në mënyrë që ai Buxhet milionësh të shfrytëzohej.

Secili prej nesh, se unë nuk jam e re në institucione, zoti ministër, e dini, po i bëj 17 vjet që punoj në institucionet e Republikës së Kosovës, kur doni të ndërtoni një akt nënligjor e ndërtoni për 24 orë. Pra, mungon vullneti, jo që ka munguar mundësia për t'i shfrytëzuar ato të holla, në mënyrë që sistemi shëndetësor të përmirësohet. Edhe këtu po flas si një deputete që në 99% të rasteve shkoj në QKUK dhe jo veç për vete, po edhe për fëmijët e mi. Pra, e shoh çdo ditë se cilat janë mungesat elementare për qytetarët e Republikës së Kosovës, në një sistem të shëndetësisë të shkatërruar, të keqpërdorur, të manipuluar e çka jo tjetër.

Prandaj, po, do të flasim, sepse do të ishte vërtet tmerr e turp për ne.

Në qoftë se në këtë Kuvend të Kosovës ne nuk flasim për mungesën e barnave esenciale, për mungesën e penjve, të oksigjenit e të anestezionit, të të gjithave dhe këtu përsëri po flas si një deputete që vazhdimisht, pavarësisht kush e ka udhëhequr qeverinë, kanë bërë amendamente në Buxhetin e Republikës së Kosovës për barna esenciale dhe ju deputetë të PDK-së gjithmonë keni votuar kundër. Po, po, ekzistojnë transkriptet, shikojeni kush ka votuar, mund të jetë ndonjë, kujtoj zonja Flora Brovina ka votuar pro, mund të jetë edhe ndonjë tjetër, për barna esenciale, e të mos flasim për gjëra të tjera.

Po thonë të mos flasim për falsifikim, mirëpo nuk po e kuptoni që ky falsifikim i listave më së shumti i ka dëmtuar veteranët e vërtetë të luftës sonë çlirimtare, më së shumti i ka dëmtuar ata të cilët vërtet qëndruan pranë nesh, kur ne kishim më së shumti nevojë për ta. Në vend se të gjithë

të bëhemi bashkë që kjo çështje të sqarohet deri në fund, ne provojmë që t'ia mbyllim gojën dikujt që e thotë një të vërtetë të tillë për ata burra dhe gra që e meritojnë pagën.

Dhe, meqenëse fola për gra, do të ishte mirë të sqarohet pse në tërë këtë Buxhet nuk po gjendet edhe ajo shumë për ato 20 mijë gra të dhunuara. Deri kur duhet të presin ato, të cilat janë heroinat e vërteta të Republikës së Kosovës.

Përndryshe, ka edhe tema të tjera përveç autostradës Prishtinë-Gjilan, për të cilën ju dhe për çështje të tjera po premtoni që do të ketë Buxhet në Buxhetin e ri që do të procedohet pas një muaji.

Po, e vërteta është që PDK-ja kurrë s'e mbani fjalën, asnjëherë deri sot nuk e keni mbajtur. Pse t'u besojmë ne kësaj radhe kur thoni se do të ketë Buxhet edhe për barna esenciale, do të ketë Buxhet edhe për autostradën Prishtinë - Gjilan, e ku mbetën edhe ato 8 milionë për magjistralen Prishtinë - Mitrovicë, shpresoj që do të sqarojë ministri Hamza në veçanti, meqenëse vjen nga ai rajon dhe e di shumë mirë që për më shumë se një dekadë jo vetëm qyteti i Mitrovicës, por edhe Vushtrria, sepse kalojmë andej, kanë vuajtur nga mungesa e zhvillimit ekonomik pikërisht se po zvarritet hyrja në fuqi apo shfrytëzimi i atyre mjeteve nga huamarrja.

Pse po i merren shuma të caktuara, sado të vogla që janë, Agjencisë Kundër Korrupsionit, apo Ministrisë së Integritimit Evropian? Kjo e shpërfaq atë se as nuk e kanë prioritet luftën e korrupsionit, e as nuk e kanë prioritet agjendën e integritimit evropian të Republikës së Kosovës.

Ku mbetën 5.5 milionët e Ministrisë së FSK-së? A nuk ka thënë presidenti juaj dhe kryeministri juaj po ashtu që deri në fund të këtij viti do të transformohet FSK-ja? Me cilin Buxhet do ta transformoni, me cilin Buxhet, kur është larguar gjatë këtij rishikimi. Unë shpresoj shumë të jetë bërë ndonjë gabim në atë dokumentin përmbledhës, të cilin e kanë dërguar Ministria e Financave te Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe në qoftë se na sqaron që një gjë e tillë nuk është e vërtetë, do ta mirëpresim të gjithë.

Përndryshe, shpresoj shumë që të krijohet një logjikë e respektimit edhe të kritikave, sidomos kur ato kanë të bëjnë me çështjen më të ndjeshme sot për qytetarët e Republikës së Kosovës, që është shëndetësia, e jo në defensivë këtu, qoftë kryetari i Kuvendit, qoftë ministra të caktuar të fillojnë të akuzojnë njerëz që në kohën e luftës i kanë pasur 15 vjet, se paskan qenë agjent të BIA-s apo UDB-së apo diçka tjetër, sepse është e turpshme të biesh në një nivel të tillë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër Hamza, e keni fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Zonja Osmani, më lejoni që fillimisht t'ju falënderoj për diskutimin tuaj, do të bëj përpjekje të jap disa sqarime për temat që u ngritën.



Në pika të caktuara ne veç pajtohemi, asnjë njeri në sallë këtu nuk e dëgjova që e arsyetoi numrin e atyre veteranëve që nuk kanë qenë. Qeveria, pra, pasi po do të thuash Qeveria, Kryeministria e ka udhëhequr këtë proces dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Edhe ata kanë përgjegjësi, po askush nuk është duke e arsyetuar numrin e veteranëve dhe s'po kërkojmë të përfitojnë prej këtij ligji ata që nuk kanë qenë.

Për më tepër, me qëllim që organet e drejtësisë, në këtë rast Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor, në Buxhetin e vitit të ardhshëm do të kenë numër të rritur, do të kenë Buxhet të rritur dhe ne inkurajojmë dhe i lusim që ata ta bëjnë punën e vet e ta hetojnë këtë proces.

Zonja deputete,

Në njërën anë po thoni numri i madh i veteranëve, në tjetrën anë po paragjykoni shifra, po flisni shifra, pa fakte, pa numra, për një kategori që është kategoria më e dhimbshme e shoqërisë, që është kategoria e viktimave të dhunës seksuale. Ku e more shifrën 20 mijë veta? Kush ta dha atë shifër, pse po flet për atë shifër. Mos paragjyko, se tani del e njëjta gjë që na ka ndodhur me veteranët, mos.

Çështje tjetër, sa mirë e the. Prishtinë - Mitrovicë, po, po, Prishtinë - Mitrovicë qe tre vjet asnjë kilometër rrugë nuk është bërë, asnjë kontratë nuk u lidh se Lidhja Demokratike e Kosovës i ka lënë paratë të shkojnë në suficit dhe nuk ka kontratë. Thuama me kë është kontrata, sa është vlera e kontratës, kur është lidhur ajo, nuk keni dashur ta bëni, paratë i keni pasur, për të cilat ne jemi duke paguar taksa administrative, e nuk jemi duke i shfrytëzuar.

Ministria e FSK-së, po. Ministria e FSK-së ka ardhur me kërkesë dhe i ka deklaruar si teprica mjetet për shkak se është centralizuar prokurimi, janë bërë procedurat dhe rregullat dhe nuk mund të bëhen procedurat edhe rregullat kur në tjetrën anë nuk i ke ngritur kapacitetet e njësisë për t'i zhvilluar proceset. A e di cila është lutja e organizatave buxhetore: "O jepna autonomi në shfrytëzimin e Buxhetit, o mos na jep Buxhetin".

Prandaj, pa kapacitete Ministria e FSK-së nuk ka mundur ta realizojë Buxhetin, por nuk është përgjegjëse Ministria e FSK-së, është përgjegjës Agjencia e Prokurimit Publik, ata nuk kanë mundur të prokurojnë, se nuk kanë kapacitete dhe duhet ndërtuar kapacitetet.

Sigurisht që vitin e ardhshëm do të ketë Buxhet të rritur për barnat esenciale, Buxhet të rritur në shëndetësi për kapitale, numër i rritur i të punësuarve në shëndetësi.

Edhe një të dhënë po e prezantoj këtu para deputetëve, është një dhënë zyrtare që në Buxhetin e Kosovës mbi 2 500 pozita janë aprovuar të pabuxhetuara, pa buxhet, pastaj është krijuar ajo procedura burokratike administrative: pyeteni Ministrinë e Financave a po lejon të punësohet një

punëtor a jo? Edhe Komuna e Prishtinës, edhe një ministri e linjës, edhe një tjetër, edhe një tjetër.

Nëse Kuvendi e aprovon ligjin, e aprovon numrin e të punësuarve, s'ka çka të pyetet Ministria e Financave.

Organizatat buxhetore duhet ta zhvillojnë punësimin sipas planeve të tyre.

Këto ishin sqarime e nevojshme.

Faleminderit, që ma dhe mundësinë të sqarohem për rrugën e Mitrovicës, se më ka lodhur, çdo ditë e bëj atë rrugë, që tre vjet asnjë kilometër, asnjë punë, asnjë veprim nuk është bërë. Çdo herë paratë kanë shkuar në suficit. Uroj që ministri i ri t'i shfrytëzojë paratë që në buxhetin e vitit të ardhshëm do të jenë për këtë rrugë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Vjosa Osmani, për kundër-replikë.

VJOSA OSMANI: S'ka përse, zoti ministër,

Po atë të drejtë nuk ta dhashë unë, ta jep Kushtetuta për të folur këtu në Kuvend, kështu që kurdo që mendon se ke lajme të mira për rrugën Prishtinë-Mitrovicë, urdhëro, që ku e ke foltoren, besoj që anëtarët e partisë tënde nuk ta ndalojnë asnjëherë, siç na kanë ndaluar neve shpesh.

E dyta, nuk e sqarove çka po ndodh tash, sepse je mësuar edhe ju dëgjova të gjithëve deri tash, asnjë arsytim nuk e jepni pse nuk po punoni tanë, por veç thirreni në LDK-në ose qeveritë e kaluara. Tregoni çka po ndodh tash dhe a ka diçka, a ka Buxhet të caktuar dhe ku kanë mbetur ato 8 milionë?

Jo s'ka më vonë, tash le të tregojë!

Mirëpo, të thuash se kur flet për gra të dhunuara po paragjykon, se ajo listë qenka fryrë, sikur te rasti i veteranëve, vërtet është diçka që duhet ta rimendoni edhe një herë. A e kuptoni çka thatë? Ju po thoni që një grua vjen dhe lajmërohet se është dhunuar, pa qenë vare e dhunuar, këtë ju po e thoni. Asnjë grua, zoti ministër, mbaje në mend këtë, asnjë grua e këtij vendi nuk vjen për hir të një beneficioni të thotë: "Unë jam dhunuar dhe ma jepni atë beneficion". Kjo është vërtet turp. 20 mijë, dëgjoi organizatat joqeveritare, përfshirë Fondin për të Drejtën Humanitare, organizatë shumë e respektuar që flet edhe për rreth 13 mijë të vrarë, edhe për 128 mijë shtëpi të shkatërruara, edhe për shumë prona të trashëgimisë kulturore, edhe për rreth 20 mijë gra të dhunuara. Përndryshe, edhe ambasadorja e Republikës së Kosovës, ish-bashkëpartiakja juaj që na përfaqëson në Kombet e Bashkuara, në çdo raportim çdo tre muaj para Kombeve të

Bashkuara e përmend këtë numër. Deri tash s'ju kam dëgjuar që e keni kundërshtuar, kurse tash po thoni që qenka fryrë ky numër, që është pikërisht argument që e përmend Serbia.

KRYESUESI: Kundër-replikë, ministri.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja Osmani!

Asnjë kilometër, asnjë metër për tre vjet të udhëheqjes të Ministrisë së Infrastrukturës nuk është kryer për Mitrovicë, paratë kanë shkuar suficit.

*(Reagime nga salla)*

Sot unë tregoj që jam ministër, bëj durim, më 31 tetor aprovohet Buxheti për vitin e ardhshëm, i sheh fondet prej dy burimeve: një që është jo kredi që pritet të ratifikohet, po marrëveshje e ratifikuar dhe burimi i dytë është prej Buxhetit të Kosovës dhe mjetet janë që kjo rrugë të nisë prej dy drejtimeve: edhe prej drejtimit Prishtinë-Mitrovicë, aty ku ka mbetur, po edhe prej Mitrovicës për Prishtinë. Dhe unë besoj që ministri i Infrastrukturës tashmë i ka nisur planet për ta realizuar këtë projekt dhe e lus që të fillojë.

Çështja tjetër te gratë e dhunuara është kategoria që më së paku dëshiroj të bëj politikë me këtë popull, është kategoria më e ndjeshme në shoqëri, më e ndjeshme se të gjithë të tjerët. Dhe ne kemi reflektuar qysh kur e kemi marrë Qeverinë dhe kemi ndarë mjete për këtë kategori. Unë uroj që ky numër të jetë sa më i vogël, jo për shkak të Buxhetit, jo për shkak të ngarkesave të Buxhetit, por për shkak të dhimbjeve të mëdha që ka përjetuar kjo kategori, e cilat i ndiejmë të gjithë, i ndjen edhe ti, edhe besoj në atë. Asnjë shqetësim s'e kam për atë.

Mirëpo, prapë po e them, unë uroj që ky numër të jetë sa më i vogël, ai që të jetë, kur të konfirmohet, do të bëhet kompensimi adekuat brenda mundësive reale. Mirëpo të dhënat aktuale që sot i posedojnë OJQ-të dhe i kanë të evidentuara, unë e di për shkak të ndjeshmërisë së kësaj çështjeje që shumë prej tyre, që janë shumë të dhimbshme, shumë të prekshme, as që do ta kërkojnë këtë. Jo që do të kërkojë dikush më tepër, por s'do t'i kërkojnë as ato që u takon kjo e drejtë. Prandaj, nuk kemi dallime këtu, por po flasim për diferencë numrash, për një proces ende që është në vijim, që nuk e dimë ku do të mbyllet. Unë nuk e di ku do të mbyllet, është proces mbyllet aty ku mbyllet, por unë nuk e kam asnjë dyshim më të vogël që këtu do të vijë do të aplikojë një që s'i plotëson kushtet dhe kriteret ose që s'është e kësaj kategorie. Por, kam frikën tjetër që për shkak të ndjeshmërisë së çështjes nuk kanë për t'i kërkuar edhe ato që u takojnë.

*(Ndërrhyrje...)*

Prandaj, këtu nuk kemi... ne jemi për të zbatuar ligjin, ne kemi filluar të jemi të kujdesshëm, të ndajmë mjete për to dhe ne do të vazhdojmë që të ndajmë mjete për këtë kategori, kaq.

KRYESUESI: Jo, s'ka replikë, ky është duke sqaruar, nuk është duke replikuar me ty. Zoti Lekaj e ka fjalën!

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar deputete,

Disi është duke më ardhur keq për qytetarët e Mitrovicës që i keni maltretuar tre vjet dhe paramendoni njësia implementuese është paguar dhe asnjë veprim nuk e ka bërë. Janë fondet e ratifikuara këtu dhe për një muaj është kryer fizibiliteti, është shpallur tenderi për projektin zbatues, prandaj është për të ardhur keq që ju që e keni pasur përgjegjësinë nuk e keni marrë asnjë veprim për t'i operacionalizuar vijat buxhetore dhe marrëveshjen që është bërë në këtë Kuvend.

Dhe, tani kërkoni që brenda muajit ne duhet të bëjmë mrekulli. Po, më fal, bre, po duhet t'ju vijë keq për ata qytetarë që s'e keni bërë asnjë veprim, jo në këtë projekt, por në asnjë projekt që është dashur të jetë i saktë, kur fillon dhe kur mbaron. Të jeni të bindur që ky projekt do të fillojë në vitin 2018 dhe do të përfundojë brenda 2 vjetëve. Të jeni të bindur, ne nuk presim që të shkrihet bora vetë, pastaj të themi se e kursyem Buxhetin, por ne reagojmë në momentin e caktuar për të krijuar atë që duhet për qytetarët. Jo në praktikë, politikë filozofike të tuajat "durim", "durim", dhe hajt se ecin projektet vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zonja Osmani.

VJOSA OSMANI: Mirë, ministër Lekaj, ne do të jemi në këtë Kuvend edhe gjatë vitit 2018 dhe unë besoj që edhe një herë, sikur edhe herëve të kaluara do ta dëshmoni që nuk e mbani fjalën. Mirëpo unë nuk e arsyetoj asnjë njeri, pavarësisht i cilës parti është, për mosndërtimin e asaj rruge, asnjë të vetëm, por asnjëri nga ju dy ministrat nuk sqaruat ajo huamarrje prej 8 milionësh ku është sot? Kjo ishte pyetja ime dhe nuk sqaruat. Po flisni që ajo është ratifikuar në këtë Kuvend, unë e di se kam qenë edhe atëherë kur është ratifikuar, mirëpo edhe tash pse nuk është në këtë rishikim buxhetor?

Kurse sa u përket grave të dhunuara, zoti ministër, ju tash keni ndarë një buxhet të vogël për trajnime, po për trajnime, e kam lexuar shumë mirë vendimin, kurse për ato 200 e sa gra, të cilat janë lajmëruar dhe janë në proces për beneficionet e tyre, nuk ka, nuk ka Buxhet. Në qoftë se nuk doni të flisni për shifra të tjera, atëherë ndajeni së paku Buxhetin në këtë rishikim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zoti Bekim Haxhiu ka replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Është replikë, Vjosa, sepse përmende Partinë Demokratike dhe sigurisht që kemi të drejtë në një replikë të tillë. Ju Vjosa, e nderuar deputete, e dini që kam qenë një nga kritikët më të mëdhenj për gjendjen në shëndetësi. Shumë çështje që i ngrite këtu sot, besoj që do të duhej t'i ngritje në grupin parlamentar në mandatin e kaluar. Kam qenë një nga kundërshtuesit më të mëdhenj kur është bartur Buxheti nga Qendra Klinike Universitare në Ministrinë e Shëndetësisë, është rritur Buxheti, ndërsa është dyfishuar çmimi i barnave esenciale, prandaj kemi mungesë atje. Edhe prapë përgjigjen e ke brenda grupit parlamentar për këtë.

Çështja tjetër, pse nuk e ngrini edhe ju problemin e kredisë me bankën austriake për 500 mijë euro është rritur kredia, sot po paguajmë 50 mijë euro dënim, aparatura mungon. S'është aparatura, kemi mungesë aparature prej se LDK-ja ka udhëhequr Ministrinë e Shëndetësisë lista e pritjes në klinika është rritur, sepse ka pasur mungesë fondesh. As nuk pajisen me mjetet e duhura klinikat dhe gjendja e sallave është për mjerim aty ku luftohet për jetën, ndërsa ne paguajmë kosto 50 mijë euro në muaj, sepse mjetet rrinë në Austri, nuk vijnë këtu. Mjetet, të cilat i kemi paguar dyfish më shtrenjtë dhe as ato s'i kemi.

Prandaj, për gjendjen në shëndetësi kërkoj vërtet një unifikim të të gjithëve që të përmirësohet. Nuk ka sigurime shëndetësore pa SISH, vetëm nëse do të manipulohet dikush me mjete financiare, pa funksionalizim të AFSH-së, nuk ka. Ka provuar të bëhet, ka dështuar ministri juaj, prandaj përgjigjen nuk mund ta merrni: atë që ka dështuar tre vjet të bëhet për 30 ditë. Besoj që do të bëhet edhe kjo, unë do të jem kritik edhe për ministrin e PDK-së nëse nuk implementon politikat e aprovuara në Qeveri...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Osmani.

VJOSA OSMANI: Mua vetëm po më çudit ku po e di Bekim Haxhiu çka kemi folur ne në grupin tonë parlamentar. Është shumë interesant, domethënë, a ka pasur aty ndonjë përgjim që është goxha njëfarë... por ka gjasa që është asi që po thua ti, Salë, mirëpo të manipulohet me qytetarët se kinse e dinë se kush çfarë qëndrimi ka mbajtur në grup parlamentar është e ulët, kur siç e thashë më herët, ekzistojnë transkriptet e amendamenteve që edhe gjatë kohës kur është udhëhequr qeveria nga LDK unë me kolegët e mi i kemi bërë pikërisht për çështjen e barnave esenciale.

Juve, si duket, do t'ju kalojnë këto katër vjet vetëm duke u ankuar për dy vjet e gjysmë të Qeverisë Mustafa. Po shihet, nga dita e sotme që s'e keni ndërmend të kryeni asnjë punë të vetme, pos të merreni me qeverinë e kaluar. Në qoftë se keni ndërmend ta bëni sado ndonjë

përmirësim të vogël, atëherë filloni tash të merreni edhe me shëndetësi, edhe me Buxhet, edhe të shohim nga ato...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Fjalën e ka Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit!

Sot u debatua për Buxhetin e vitit 2017, edhe për Buxhetin e vitit 2018, më së paku është debatuar për rishikim. Ajo që më ka habitur është një fakt, që më ka shtyrë të marr fjalën është kryetari i Komisionit, zoti Lumir Abdixhiku, është edhe kryetar i Komisionit për Buxhet edhe Financa, ai e di shumë mirë që Buxheti i paraparë për shëndetësi nuk është harxhuar për shkak të mospunës, pamundësisë, paaftësisë për të menaxhuar me këtë Buxhet.

Edhe e di shumë mirë, sepse është kryetar i komisionit që kjo pjesë e Buxhetit po të ishte lënë në gjendjen që ka qenë, do të kishte kaluar në suficit. Kam pritur prej zotit Abdixhiku, si kryetar i komisionit, së paku në këtë fushë të jetë më objektiv, e jo kaq demagog. Edhe kjo është demagogji, s'kam pritur prej kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa të jetë kaq demagog për fushën e vet. Ai i di shumë mirë procedurat, unë i kuptoj kolegët e mi të grupit tim parlamentar që kanë pasur kërkesa që të futen në Buxhet projekte të investimit kapitale, që në aspektin kohor nuk ka mundësi, sepse ka kohë vetëm 15 ditë, duhen deri në 30 ditë që të menaxhojnë me atë Buxhet, kurse procedurat për diçka të tillë janë 45 ditë.

Kurse, zoti Abdixhiku, si kryetar i komisionit, e di në çfarë kohe jemi, kjo është demagogji. Unë e di që është fushatë, por kjo është më shumë se sa fushatë, është demagogji. Edhe prej tash e tutje, në qoftë se nuk jep ndonjë sqarim zoti Abdixhiku si kryetar i komisionit, do ta thërras 'kryetar demagog'. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Jo, sinqerisht, a mund t'i shfrytëzoj minutat e mi, Armend, të lutem, po të dija çka tha, edhe i kisha kthyer përgjigje, e t'i them diçka, s'besoj që kupton, kështu që po e lë krejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë!

BLERIM KUÇI: Doppio demagogji, kjo është doppio demagogji, sepse ai i njeh shumë mirë procedurat, procedurat i ka të njohura. Të sillet dhe të na mendojë, edhe ministrin e Financave, sepse ministri i Financave e ka shpjeguar, ka dhënë sqarimet e duhura në komision dhe prapë të na mendojë të gjithë neve me këto procedura kine ai ka të drejtë që këto mjete janë keqpërdorur

ose po shkojnë në vend jo të duhur, është demagogji. Këto mjete të mos kishte propozuar ministri t'i kalojë në një kategori tjetër, do të kishin kaluar në suficit.

Edhe, as kohë nuk ka që mjete të dërgoheshin në një kategori tjetër, sepse prapë do të kishin kaluar në suficit, është koha e pamjaftueshme për t'i dërguar në kategori të tjera, dhe janë dërguar në kategorinë më të favorshme për të realizuar...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Ali Lajçi e ka fjalën, s'është, Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Tash pasi kjo seancë u bë replika e kundër-replika, po ia nis edhe unë pak me këto replika.

Kam jashtëzakonisht shumë respekt për personalitetin dhe angazhimin e deritashëm edhe të Vjosës, edhe të Lumirit, edhe teksa po i dëgjoja për një moment mendova që kanë kaluar në radhët e "Vetëvendosjes", sepse flisnin sikur të ishin deputetë të "Vetëvendosjes". Po ashtu, do të mendoja që LDK-ja paska ndryshuar, pasi këta po mundohen ta tregojnë fytyrën tjetër të LDK-së, por për një moment m'u kujtua se shef i Grupit Parlamentar është Avdullah Hoti, i cili ka qenë ministër i Ekonomisë dhe i Financave, e unë kam qenë anëtare e Buxhetit për Financa dhe i di mirë qysh ministri dilte jashtë bashkë me Naser Osmanin dhe me Safete Hadërgjonajn, merreshin vesh në korridor për buxhete, vinin mandej dhe e çonin dorën krejt deputetët e LDK-së për atë Buxhet.

Po ashtu, desha edhe unë të flas për çështjen e grave të dhunuara dhe po ashtu m'u kujtua se përgjegjësinë për të ndarë buxhet për t'i krijuar të gjithë mekanizmat për zbatimin e ligjit ka qenë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila po ashtu është udhëhequr nga Arban Abrashi, i cili po mundohet të paraqitet si fytyra e re e LDK-së. Kështu që kjo, s'po dua që ta emëroj, e përsëris, kam jashtëzakonisht respekt edhe për Vjosën, edhe për Lumirin, por bashkëfajtorët i keni në mesin tuaj.

E tash, sa i përket Buxhetit, dua të ndalem te një aspekt. U fol për shëndetësinë, s'po flas. Ajo çka kuptohet prej këtij Buxheti, e që nuk do shumë filozofi, është se është Buxhet i asfaltit edhe i rrugëve. I njëjtë ka qenë dhe ky Buxhet në këtë formë është hartuar nga Avdullah Hoti. Pyetja ime që e kam edhe për ministrin e Financave, edhe për ministrin e Infrastrukturës, se s'qenka kryeministri këtu, është: kush është përgjegjës të shtrojë asfalt dhe rrugë?

Tash, unë po e lexoj misionin e njëjës prej ministrive të linjës. Është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Në misionin e kësaj ministrie thuhet kështu: "Misioni i ministrisë është të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e komunave që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të

qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik të ofrohen shërbime me kosto efektive për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale”, por kur e shihni Buxhetin e kësaj ministrie, thuhet: “Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Godanc - Drenas, asfaltimi i rrugës Gorozhdec - Grabovc - Gorozhdec, prapë, në fshat”, dhe siç na thuhet “te rruga e minoriteteve egjiptian të komunës së Pejës”. Tash edhe rrugët qenkan të ndara, rrugët e minoriteteve dhe rrugë të shumicës, e kështu me radhë.

Pra, shumica e Buxhetit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal shkon në asfalt. Tash arsyeja më logjike që të mendosh pse janë ndarë këto para për të shtruar rrugë është që të mos shkojnë krejt tenderët te Pal Lekaj, por edhe dikush tjetër të merret me tenderë dhe të fitojë ndoshta ndonjë përqindje prej këtyre tenderëve që shtrohen rrugët.

Pyetja ime e dytë ka të bëjë me Buxhetin e Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit. Aty janë 3,10 milionë, të cilat thuhet se shkojnë për Projektin e konsoliduar për kthim dhe këtu përfundon gjithçka. Janë 3,10 milionë, për të cilat ne nuk e dimë se ku do të shkojnë, në çfarë projektësh, kush janë përfituesit, e kështu me radhë. A mund të na tregoni se çka do të bëhet me këto 3,10 milionë?

Dhe, e treta ministër, pasi së shpejti po shpresoj do të vijë Buxheti i vitit 2018. Ky Buxhet nuk është veç për Qeverinë, nuk është as veç për deputetët, është për të gjithë qytetarët e vendit. Edhe ata duan ta dinë se si shpenzohen këto para. Mënyra qysh ju e hartoni këtë Buxhet, as ata që e hartojnë vetë besoj se në fund nuk e kuptojnë, kështu që ju lutem ndërrojini këto tabela. Bëni të kuptueshme dhe të lexueshme për secilin, sepse në këtë mënyrë është më shumë t’i mbuloni manipulimet që bëhen, se sa të tregohet se vërtet ku dhe qysh shpenzohen paratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vjosa, replikë!

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Shqipe, po më vjen interesant sa shumë të paskan dhimbsur këto replikat tona me PDK-në. Vërtet je duke e dëshmuar katërcipërisht që jeni po ai brumi i njëjtë, vetëm shiko sa ish-deputetë të PDK-së ke përreth, shiko sa ish-LPK-istë ke përreth dhe do ta marrësh përgjigjen pse unë e Lumiri jo sot, por kurrë nuk do të vijmë në “Vetëvendosje”. Por edhe sot po tregoni që jo vetëm qeveria e Koalicionit PAN, por edhe ju në vend se të punoni e ta luani një rol efektiv në mbikëqyrje të qeverisë, e paskeni ndërmend katër vjet të merreni vetëm me ish-qeverinë e LDK-së.

KRYESUESI: Kundër-replikë ka Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Pse PDK-ja është e keqe, e kemi ditur, edhe këta deputetë që dikur kanë qenë në PDK e kanë ditur, prandaj e kanë lënë PDK-në dhe kanë ardhur në “Vetëvendosje”.



Nuk e di, Vjosa, a e ka ditur partia jote kur ka shkuar te PDK-ja ta bëjë qeverinë. Mos harroni se në mandatin e kaluar nuk keni qenë ju që e keni pasur shumicën edhe e keni marrë PDK-në në qeveri, por kanë qenë këta që ju kanë marrë juve dhe keni qenë ju që keni tradhtuar një kauzë, që qe ndërtuar për ta rrëzuar PDK-në dhe shkuat. Unë prapë po them, për ty personalisht dhe për Lumirin kam respekt, por fajin kërkojeni brenda jush, aty është faji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit!

Shqipe, respekti për Lumirin dhe për Vjosën, domethënë respekt edhe për LDK-në, se na këtu nuk jemi njerëz pa parti, e para. E dyta, po edhe këtë e dëgjova, “Vetëvendosjes” nuk po i pengon këtu shkurtimi i Buxhetit të shëndetësisë, as listat e veteranëve, sepse nuk i përmendët asnjëherë. Të vetmin rast që e përmende është kritika e LDK-së që po ia bëjmë PDK-së për këtë punë.

Unë edhe një herë po të ftoj, mos u merr me këtë çështje, mos u merr me LDK-në, se problemin e kemi këtu. Këtu po flitet për rishikimin e Buxhetit, a në qoftë se doni që t’i bëni shërbim PDK-së dhe të nisni betejën me LDK-në, edhe për atë punë këtu jemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Respekti për LDK-në do të rritej atëherë kur Isa Mustafa nuk e drejton, ai i cili ka qenë bashkë me PDK-në, ai i cili ka shkuar te PDK-ja, e para.

E dyta, më duket nuk i paskeni dëgjuar fjalimet e kolegëve të mi deri tash, folën shumë për shëndetësinë. Besa Baftiu gjithë fjalimin e saj e pati rreth shëndetësisë, por edhe për shëndetësinë, prapë po them, ministri ka qenë i LDK-së. Këqyrni pak brenda. Luftën tonë me PDK-në e kemi nisur moti, ju kemi thënë: “Ejani me neve ta bëjmë luftën bashkë”. Ju atëherë shkuat te PDK-ja, tash nuk mund të shfajësoheni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj, në emër të partisë dëshiron të bëjë replikë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Lidhja Demokratike e Kosovës është e qartë në atë çka po e thotë sot, është shumë koncize edhe në parametrat ligjorë, atë çka është e shkruar dhe çka kërkohet me përgjegjësi për t’u përmbushur.

Që sa herë po përmendet rruga për Mitrovicë. Unë jam shumë i përgjegjshëm që edhe ministri i Financave, por edhe ministri i Infrastrukturës e di që ky problem ka qenë nga ata që i kanë dhënë paratë, nga tri bankat, nga tre donatorët për tre vjet rresht, a katër, nuk e di, të cilët nuk kanë

mundur të merren vesh, të koordinohen për t'i alokuar këto të holla. Edhe kjo ka qenë pyetje parlamentare, ka qenë përgjigjja këtu pikërisht në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, ministri i Infrastrukturës i ka gjetur procedurat në nisje, tenderimin të këtyre pjesëve për të vazhduar, kjo është e vërteta. Nëse ka ndonjë të vërtetë ndryshe, atëherë urdhëroni, thoni. Unë po flas vetëm për obligimet, përmbushjen e obligimeve ligjore dhe nuk besoj që për këto tre vjet ka pasur një arsyeshmëri tjetër e kësaj rruge të rëndësisë të veçantë. Më vjen mirë, tash le të startojë, le të përmbushet, nuk do të dëshiroja që të stërzgjaten këto procedura qoftë në tenderim, qoftë në OSHP, qoftë ashtu siç jemi mësuar, por të kryhet sa më shpejt dhe të monitorohet ashtu siç na takon me ligj dhe pjesa e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu, edhe ky e ka në emër të partisë. Jo, unë Armendit ia dhashë fjalën se e përmendi Shqipja LDK-në. Unë s'po mund t'ua ndal fjalën, meqenëse e mori Armendi në emër të LDK-së, se e përmendi LDK-në, merreni fjalën dikush si kundër-replikë dhe në rregull është. Kush dëshiron të flasë, Liburni.

LIBURN ALIU: Këtu u tha, u fol për presidentin, u kundërshtua presidenti prej Vjosës, por unë po dua t'ia përkujtoj që ditën kur është zgjedhur presidenti ka qenë LDK-ja që e ka votuar. Ne kemi pasur jashtëzakonisht edhe në të kaluarën përpjekje të vazhdueshme që bashkë me juve t'i ndalim shumë procese të këqija, shumë herë këtu në sallë kemi dalë bashkë e është kthyer LDK-ja e i ka votuar proceset e dëmshme në këtë vend.

Kemi qenë vazhdimisht në pritje të nënshkrimeve për të hetuar SHIK-un, të cilin ju vazhdimisht e keni kundërshtuar. Ende jemi në pritje, do të kemi rast ta bëjmë, tjetra, po ka këtu të subjekteve të tjera që kanë qenë dikur, ka që kanë qenë dikur edhe në LPK, ka dikur që kanë qenë edhe LKÇK, edhe në PDK, edhe në UÇK e krejt. Sa herë ka pasur lëvizje në këtë vend, shumë prej nesh kanë qenë pjesë të atyre lëvizjeve dhe do të jemi, bile-bile jemi krenarë që kemi qenë edhe pjesë e lëvizjeve në kohën kur shumëkush na ka dënuar, njëjtë gati qysh edhe në kohë të Rankoviqit, e më zi në të gjitha periudhat. Ngjashëm me atë periudhë, ka qenë edhe periudha tash kur kemi luftuar edhe kundër "Zajednicës", të cilën "Zajdenicë" prapëseprapë, të mos harrojmë, edhe pse gjatë marrëveshjes fillimisht e keni kundërshtuar nga pak, kur ka qenë Marrëveshja e prillit, në fund e patët votuar. Erdhi puna te "Zajednica", ju keni qenë shtytësi kryesor, LDK-ja. Erdhi puna te demarkacioni, prapë ju keni qenë shtytësi kryesor. Kemi bërë në vazhdimësi përpjekje për të bashkëpunuar dhe ende jemi të gatshëm, ende ne jemi të gatshëm për t'u ulur e për të bashkëpunuar me juve. Nëse ju jeni ata që doni t'i ndalim këto procese, hajde urdhëroni, i ndalim. Por, sa herë që kemi dashur t'i ndalim, ju keni qenë ata të fundit, në momentin më kritik që na e keni dështuar krejt procesin. Ju e keni sjellë Hashim Thaçin, që unë tash po...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues, faleminderit!

Unë ju kisha lutur, i kemi edhe 14 delegatë të lajmëruar... Jo, jo, kam replikë në emër të PDK-së. Hiqmi ata minuta, i lëshon një herë një minutë a dy, a sa është replika, pastaj ma jepni fjalën. Faleminderit!

I dëgjova herë në të majtë, herë në të djathtë, PDK, PDK, PDK... Ne s'kemi faj që keni trauma politike prej PDK-së. Edhe këto trauma kanë për të ju mbajtur për sa ta keni karrierën politike. Bile, ju të rinjtë disa që keni hyrë këtu, ju do ta kryeni karrierën politike me trauma të Partisë Demokratike të Kosovës dhe fakti që kurrë s'do të mund as ta mundni PDK-në, e as ta kaloni PDK-në. Por, mos u ngutni shumë se më 19 është balotazhi, e më 20 do ta përmendni prapë PDK-në, por PDK-në do ta përmendni, e para që do të ju mundë në krejt komunat ku garon, e besa do të ju mundë edhe në ato komuna ku nuk garon, sepse po e shohim një tendencë të dikujt-dikujt, disa e kanë që ta mundin partinë e vet, disa e kanë që ta mundin partinë kundërshtare, por në fund vendimet që do t'i marrë PDK-ja, që po e përmendin me kaq shumë zell, do të jenë ato që do të jua vendosin fatin për goxha shumë vite të ardhshme. Faleminderit, kryesues! Tash flas kur të ma japësh fjalën.

KRYESUESI: Faleminderit! Me rregullore nuk është të bëhet replikë 15 herë e kundër-replikë. Mos ia përmendni emrin njëri-tjetrit. Është në rregull, e keni përmendur PDK-në, edhe PDK-ja e bëri reagimin e vet.

Vazhdojmë! Fjalën e ka Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Është kënaqësi të rikonfirmohet arsyeja pse duhet vendosmërisht për të fituar në Gjakovë, në mënyrë që pak a shumë t'i iket një pjese të debatit të panevojshëm mbi ofendimet, fyerjet, kategorizimet.

Sidoqoftë, tema e ditës së sotme, apo ajo që po trajtohet është rishikimi i Buxhetit. Kur erdha në sallë i numërova karriget e ministrave, sa prej tyre janë këtu. Urova që i kanë shtuar karriget, se e kemi një qeveri me 24 pozita, që i bie se sot ishte dashur ne ta trajtonim një Buxhet afërsisht 20 miliardë, e jo një Buxhet që prej 2 miliardëve që ka rënë në 1,8 miliard, he tash gjithçka diskutohet, veç më së paku për atë Buxhet.

Nëse e analizojmë strukturën e Buxhetit të rishikuar, ose arsyeshmërinë e Buxhetit, nuk ndryshon aspak prej asaj sesi është formuar kjo qeveri. Kjo qeveri është "qeveri e arnuar", është si një thes me plot arna që është ngjitur për të shërbyer për një afat shumë të shkurtë kohor dhe

në momentin kur fillon të mbushet me presion, ato arnat një nga një kanë do ta lëshojnë. E këto, po më duket, do ta lëshojnë shumë më shpejt sesa që e kanë paramenduar edhe vetë.

Së pari, po më vjen mirë ta shoh në rishikim të Buxhetit që e kemi shtuar numrin e të punësuarve me këtë Buxhet, hiç më pak se një ministri me shtatë persona, Ministrinë pa Portofol, dhe një ministri tjetër me dymbëdhjetë persona, Ministrinë e Inovacionit, përderisa në Buxhet nuk paraqitet ndarja e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ende është në rishikim si një, përderisa në Buxhet nuk paraqitet Buxheti për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ose sido që e kanë quajtur. Po flas për një Buxhet të mbijetesës dhe të administrimit të njerëzve që janë emëruar në poste. Po flas për një rishikim, i cili nuk e prezanton qysh ka ardhur Qeveria pa vizion, as edhe një vizion të vetëm. Sikur kjo Qeveri që ka ardhur ta kishte një vizion të vetëm, do të mund të bënte disa ndërhyrje që, edhe pse për tre muaj ose dy muaj e gjysmë, mund ta ketë efektin e vet në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në këtë Buxhet, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, edhe pse fushata e zgjedhjeve lokale është bërë duke u munduar të lidhet niveli lokal me nivelin qendror, nuk figuron Aeroporti i Gjakovës, aeroporti i cili është aset strategjik dhe i cili në një aspekt krejt çka ka mundur të bëhet është së paku të mbulohet studimi i fizibilitetit, që ta ketë një fizibilitet që më 2018 të jetë i promovuar ashtu si duhet për një funksionim të mirëfilltë.

Në këtë Buxhet nuk është sjellë vendimi që tash është në Zyrën e Kryeministrit prej Qeverisë së kaluar, vendimi për kalimin e aseteve nga Agjencia e Privatizimit të Komunave. Është lista e aseteve që ka kaluar te Ministria e Pushtetit Lokal në muajin maj, njëkohësisht ajo listë ka shkuar nëpër të gjitha fazat e miratimit për asetet ose kompanitë - ndërmarrjet shoqërore, dhe nuk është miratuar në Qeverinë e Kosovës, çka do të ishte një mundësi shumë e mirë që ato një milion euro, të cilat janë të paraqitura në Buxhet për funksionalizim të zonave industriale, të hynin në funksion.

Në një aspekt, ky Buxhet nuk e ka asnjë projekt strategjik, absolutisht. Asfalti i cili po përmendet në kuadër të Buxhetit është vazhdimësi e punëve që kanë nisur, e në shumicën e rasteve, tash po ju paralajmëroj se askush nuk e tha, u fol shumë nga kjo foltore për autostradën e Gjilanit, është me të vërtetë shumë e dhembshme që Qeveria e Republikës së Kosovës vitin e ardhshëm do të paditet prej tetë kompanive që janë fituese të loteve dhe nëse lënda është në OSHP tërhiqet autoriteti kontraktues, që në këtë rast është Ministria e Infrastrukturës, të gjitha kanë të drejtë ta paditin Qeverinë për shkak të procedurës që e ka zhvilluar.

Njoftimi paraprak duhet të bëhet në formën zyrtare dhe të shikohet a hapësirë ligjore për ndërprerje të njëanshme të kontratës, ose për ndërprerje të njëanshme të procesit të tenderimit. Tërheqja e tillë që është bërë, përveç gjobave që i merr Qeveria, dhe do t'i marrë dhe do t'i paguajë, tash u përmendën pasaportat. Po e harrojmë Postën dhe Telekomën e Kosovës, tash keni

për të paguar edhe kompani kosovare, nëse veç nuk është ndonjë marrëveshje, se zakonisht fshihet prapa këtyre gjërave, për atë që autoriteti kontraktues tërhiqet në gjysmë të procesit. Kur shkon në OSHP, kjo është e kryer, është gjykatë e tenderëve. Dhe, atëherë ata vendosin se kush janë përfundimisht fituesit, mandej ministria ua dërgon edhe një njoftim se thotë “po na vjen keq, se ju s’jeni fitues, se ne kemi vendosur ta tërheqim këtë projekt”.

Në anën tjetër, ajo çka po diskutohet, është e vërtetë që në vitin 2014 Buxheti i Kosovës ka humbur qindra milionë, në vitin 2017 ka humbur 200 milionë. Kjo po ndodh për shkak të krizës politike në nivel vendi, për arsye se forcave të caktuara politike u teket ta çojnë vendin në zgjedhje të parakohshme, se u teket për t’i marrë postet, edhe pse nuk i arrijnë, siç nuk i kanë arritur në vitin 2017.

Ky Buxhet, ose ky rishikim i Buxhetit, është në kurriz të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për interesa vetjake, në këtë rast të atyre që kanë votuar që vendi të shkojë në krizë dhe mandej ajo krizë të përcillet deri në këtë pikë. Paralelja e 2014-tës me 2017-tën është e njëjtë dhe vendi do të ballafaqohet me cikle të tilla të krizave të vazhdueshme politike dhe të humbjeve të vazhdueshme, për shkak të megalomanisë, ose për shkak të urisë së disa personave që të marrin poste.

Në anën tjetër, një element shumë specifik, një prej kushteve kryesore për liberalizim të vizave është luftimi i krimit dhe korrupsionit në Kosovë. Njësia për Krime Ekonomike në kuadër të Buxhetit vjetor i ka 38 393 euro. Më falni, a mendoni ju që këto janë resurse të mjaftueshme që në Kosovë të luftohet krimi? Nuk po flasim për Agjencinë Kundër Korrupsionit, po flas për Njësinë e Krimeve Ekonomike në kuadër të Policisë së Kosovës. Si mund ta fuqizojmë një entitet të tillë, që supozohet t’i hedhë gjërat në dritë, përderisa mundohemi ta kalojmë një element tjetër që paraqet edhe shumë bazë për hetime të tjera në Prokurori.

Ajo çfarë po i ndodh Kosovës është fatkeqësi shumë e madhe. Pse po fshihet fakti që Lista serbe nuk e voton kthimin e Fondit të Privatizimit? Janë deklaruar edhe publikisht, nuk e votojnë kthimin e 200 milionëve. Po thuhet tash se “jemi vonuar me procedura ligjore”. Kemi qenë të gjithë dëshmitarë që është ndërruar Kushtetua e Republikës së Kosovës për një pasdite, kur ka qenë koha e transformimit të Pakos së Ahtisarit. Pse po thuhet se nuk kthehet Ligji i privatizimit? Fondi i Privatizimit mbahet peng i Serbisë.

Qeveria e Republikës së Kosovës ia ka konfirmuar Serbisë legjitimitetin mbi ato mjete, që nuk e kanë asnjë bazë ligjore. 200 milionë euro janë të mangëta sot jo për shkak të procedurës ligjore, janë të mangëta për shkak se nuk ka miratim të Listës serbe. Urdhëroni, pyetini dhe le të deklarohen vetë, le të tregojnë nëse kanë apo nuk kanë vullnet për t’i kthyer ato mjete në Kosovë, për shkak se Beogradi ka pretendime ndaj mjeteve të privatizimit. Përderisa sot nga Buxheti i Kosovës vetëm paga dhe mëditje e shërbime tjera, mallra dhe shërbime në këtë agjenci,

Buxhetit të Kosovës i kushtojnë 7 600 000 euro, ne po flasim për një pamundësi totale të Qeverisë së Kosovës në funksionalizim të mjeteve të veta si rrjedhojë e paaftësisë brenda Qeverisë.

Po, është e vërtetë që përgjegjësinë për këtë Buxhet e ka LDK-ja baras me PDK-në, se bashkë e kanë miratuar në fillim të vitit 2017. Prej prillit të këtij viti kanë filluar negociatat dhe skenarët për rrëzimin e Qeverisë, e cila e ka sjellë situatën këtu, kur në fund të tetorit, në fushatë zgjedhore të zgjedhjeve lokale, ne e diskutojmë rishikimin e Buxhetit, kur fillojnë e diskutohen rrugë e mëhalla, e krejt ato të gjitha janë me rëndësi, por nuk do të përfshihen në Buxhet, sepse dihet se ato vijnë me Buxhetin e vitit 2018.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës sot diskutojnë për projekte madhore, që duhet të përfshihen në Buxhetin e vitit të ardhshëm, përderisa ka hapësirë të mjaftueshme të përfshihen projekte, të cilat sot do të kenë ndikim dhe do të na tregojnë që kjo Qeveri e ka një vizion. Ne sot e kemi kuptuar absolutisht që kjo Qeveri, përveç që e ka shtuar këtë karrige, edhe s'ka mundur t'ia gjejë ngjyrën të njëjtë sikur këto tjerat, se s'i ka dalë numri, se i ka 24 dikasterë që duhet t'i mbulojë, ka arritur t'i përfshijë dy ministri të reja në këtë rishikim të Buxhetit, të tjerat i ka arnuar qysh e di vetë dhe do ta bëjë një "tik" aty që e ka rishikuar Buxhetin.

Nuk e ka asnjë element bazë të zhvillimit. Të paktën, ka pasur projekte zhvillimore strategjike, të cilat kanë ofruar mundësi për të menduar se e kemi zhvillimin e projekteve strategjike. Sa projekte strategjike janë sot? Janë autostradat e bllokuara dhe është kryeministri që s'ka lënë komunë në Kosovë ku s'ka premtuar autostradë. Unë po ju them që s'ka nevojë për të premtuar autostradë, ka nevojë për të premtuar zgjerim të rrugëve dhe siguri në rrugë.

Jo, nuk është puna më pyet apo jo, më pyet si kryetare e Komunës, se ka thënë që krejt do t'i mbështesë njëkohësisht dhe njëtrajtësisht, por problemi që është premtimet që po bëhen nuk i mbulon as korniza afatmesme e Buxhetit. Premtimet që po bëhen janë në ajër. Po diskutohet për gratë e dhunuara. Ofendimi maksimal që mund ta mendojë dikush, që për ato 200, të cilat nuk do të dalin në fund as 50 me letra, vijmë në një situatë dhe diskutojmë këtu në Parlamentin e Kosovës. S'po diskutohet që sot familjarët e të pagjeturve, kur u vjen mosha e pensionimit, duhet të zgjedhin a ta marrin pensionin e familjarit të pagjetur, a ta marrin pensionin që e kanë fituar vetë, për shkak se i kanë humbur fëmijët. Tash duhet edhe të mendojnë cilin pension kanë të drejtë ta marrin, vlera është 175 euro.

Ju kisha lutur, vlerësoni në një element, për arsye se as gratë e dhunuara, e as familjarët e pagjetur nuk po mund të shumohen, por po shumohen listat tjera. Përndryshe, politika muskulore që e tregon veç forcën dhe e tregon atë çfarë ju keni manipuluar gjatë gjithë fushatës deri në një natë para zgjedhjeve me lista të veteranëve është e gërditshme. Të jepen certifikatat...

Të lutem, nëse do merre fjalën dhe mund të më replikash, po s'ke nevojë të ma ngresh dorën dhe zërin prej vendit ku je ulur! Atë që e bëtë ju gjatë gjithë kohës, e keni bërë në mënyrën më të paligjshme e të pandershme të mundshme. Dhe, për këtë arsye jemi në këtë situatë kur duhet ta artoni Buxhetin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Lekaj e ka kërkuar fjalën për sqarime shtesë.

PAL LEKAJ: E nderuara deputete,

Mund të them që më vjen keq që nuk ke qenë e përqendruar në diskutimin tim dhe thua se nuk ke ekzistuar në sallë. Unë po e përsëris për të satën herë, që unë nuk kam thënë se do t'i ndërpres procedurat njëanshëm, po e përsëris që çfarëdo vendimi që sjell Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik unë jam i obliguar ta zbatoj. Dhe, unë nuk di kush e përmendi këtu ndërprerjen e kontratës njëanshëm.

Prandaj, e di që është balotazhi, e di që jemi në përparësi, e di që në Gjakovë do të fitojë më i miri dhe ai është Ardian Gjini, por jo që këtu të vini dhe na shitni atë që çdoherë, për çdo ditë po e shitni atje.

Sa u përket autostradave që i ka premtuar kryeministri, të jesh e bindur, edhe në Gjakovë do të ketë. Ju them para të gjithë qytetarëve të Gjakovës, jemi të vendosur që kjo të ndodhë në vitin 2018, që çdo autostradë ku e kemi përmendur do të implementohet me përpikëri. Prandaj, juve ju kanë mbetur vetëm fjalët dhe prapë po them më vjen keq, Mimoza Kusari-Lila. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zonja Mimoza.

MIMOZA KUSARI-LILA: Para se të merrem me thashetheme e me inate të para katër vjetësh, që duket s'i kanë kaluar ende ministrit Lekaj, më duhet t'ju rikujtoj se ju e keni sjellë këtë Buxhet me autostradën e Gjilanit të hequr nga Buxheti. Domethënë, ju keni parashikuar diçka që nuk u takon të parashikoni dhe të ndërhyni në gjykatën e tenderëve, përkatësisht në OSHP.

Duhet të jetë organ i pavarur, i cili pavarësisht vendimeve politike që ju i merrni në nivel të Qeverisë, ose të ministrisë, ato vendime duhet të zbatohen. Në rast se në OSHP kompanitë, të cilat i zgjidhin kontestet mbi fituesit në tetë lote të kontratës për autostradën e Gjilanit dalin fituese, atëherë ju në formën e drejtpërdrejtë do të keni, ose nuk do të keni Buxhet që ta zbatoni atë kontratë dhe rrjedhimisht do të hyni në obligime. Po, për ju personalisht nuk është hera e parë. Keni hyrë në obligime shumë më herët, mbi 20 milionë euro kontrata pa mbulesë në Komunën e Gjakovës, mbi 6 milionë euro borxhe. Kështu që fatkeqësia e krejt kësaj është se ajo çfarë i ka ndodhur Gjakovës për shtatë vjet qeverisjeje tuaj mund t'i ndodhë Kosovës.

Fatmirësisht do të jetë se s'keni jetë të gjatë si Qeveri. Presim zgjedhjet. Ata që ju kanë marrë bashkë në koalicion, ata ju rrëzojnë, siç ua kanë bërë edhe të tjerëve. Prandaj, "Urime e suksese", do të thoshte Presidenti.

KRYESUESI: Kundër-replikë, Pal. Tash një minutë e ke!

PAL LEKAJ: Sa i përket asaj, prapë po e citoj, ne nuk do të marrim vendime politike, por e di mjaft mirë si funksionojnë gjykatat për tenderë. Dhe, prapë më vjen keq, që ende nuk e ke kuptuar, më duhet të ta shkruaj në letër, nëse doni zyrtarisht do të ju përgjigjem, sepse po më duket, ose s'po dëgjoni, ose nuk jeni e koncentruar.

Sa i përket punës sime në Gjakovë, këtë e kanë thënë me votë çdoherë qytetarët e Gjakovës dhe jam krenar për çdo punë që e kam bërë. Ju kërkoj falje qytetarëve, që nuk kam mundur të arrij atë që kam dashur, por e kanë treguar qytetarët e Gjakovës për kë votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ne sot kur e filluam këtë seancë, realisht krejt që kemi qenë këtu të pranishëm e kemi ditur që kjo do të jetë pjesë e fushatës politike, se jemi pak para balotazhit dhe është krejt e kuptueshme që Kuvendi është "arenë politike", po besoj se është duke shkuar goxha mirë.

Kjo pjesa e dytë, ishte pak më e habitshme, se më duket disa deputetë filluan e morën vesh që ka grevë të aktorëve në Teatrin Kombëtar dhe menduan se këtu është audicion për t'i marrë në vend të tyre dhe filluan të aktrojnë goxha si shumë. Kur të ndalesh të shohësh kush po aktron, janë disa deputetë, disa të rinj, e disa jo fort të rinj besa, po një koleg i LDK-së ua kishte lënë një emër, që mua m'u duk interesant, para disa ditësh tha "këta jurishnikët e rendit të parë".

Dhe mua mu duk kjo "jurishnikët" që goxha shumë është duke iu përshtatur këtij rendit të parë të "jurishnikëve" aty të LDK-së, sepse këta marrin turr shumë, por realisht e kanë goxha të vogël efektin. Po, janë këta "jurishnikët" që kanë qenë edhe kundër Isa Mustafës, edhe kundër Avdullah Hotit, edhe kundër Lutfi Zharkut, Imet Rrahmanit e krejt atyre ministrave të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që kanë qenë pjesë e Qeverisë, që e kemi pasur bashkë deri para disa muajve. Ama, këtyre unë dua t'u tregojë diçka, i vogli nuk mund të bëhet i madh duke u kapur me të madhin. Kot e ka! Këta mund të flasin për Hashim Thaçin, për Kadri Veselin, Ramush Haradinajn. Këta mund të flasin për shumë njerëz tjerë, të cilët sikur këta, karrierën e tyre politike dhe plot deputetë që janë në Kuvend të Kosovës e kanë bërë duke i luftuar armiqtë e Kosovës, e edhe Serbinë, jo veç me urrejtje.



Por, këta karrierën janë munduar ta bëjnë duke i urreyer këta njerëz, po ashtu edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, se ndryshe nuk mund ta arsyetojnë krejt atë zell për t'i kundërshtuar pagat për veteranët.

U fol sot shumë për pagat e veteranëve dhe është e vërtetë që është një proces që duhet të verifikohet dhe për atë arsye vetë kemi kërkuar që Prokuroria të merret me këtë çështje. Kemi kërkuar të bëhet kategorizimi, të bëhet plotësim-ndryshimi i legjislacionit. Është një proces që kurrkush s'na ka penguar ta bëjmë. Kush e ka pasur përgjegjësinë? Partia Demokratike e Kosovës, a? A e ka pasur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, a "Nisma" a...? Kush e ka pasur, LDK-ja, a "Vetëvendosja"...? E ka pasur Qeveria që e ka udhëhequr Isa Mustafa. E ka pasur Zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që e ka udhëhequr Arban Abrashi.

Për çka u fol tjetër këtu, përveç për pagat e veteranëve? U fol për sigurime shëndetësore më së shumti, u fol për autostradën Prishtinë - Gjilan, u fol për autostradën Prishtinë - Mitrovicë, u fol për klauzolë të investimeve, u fol për fondet e likuidimit të Agjencisë së Privatizimit të Kosovës. Këto ishin temat e sotme që u manipuluan poshtë e përpjetë për t'u munduar për të fituar ndonjë votë të balotazhit, se jo pse kanë ndonjë bindje përnjëmend që duhet bërë këtë, apo për ta marrë këtë ose atë drejtim.

Ndalemi veç racionalisht ta kujtojmë kush ka pasur përgjegjësi për krejt këto pika që u përmendën sot më së shumti: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. A dini të më tregoni në Qeverinë deri para tre muajsh që ka ekzistuar dhe e ka udhëhequr Isa Mustafa, që është kryetar i LDK-së, kush i ka udhëhequr këto dikastere? Nuk i ka udhëhequr Partia Demokratike e Kosovës, as partnerët tjerë të koalicionit. I ka udhëhequr Lidhja Demokratike e Kosovës. E qysh mund të ketë fytyrë sot një deputet, del në foltore, ose prej vendit, dhe u thotë ministrave që e kanë marrë detyrën që një muaj e gjysmë a dy, s'i kanë tamam, edhe thotë "qysh s'i keni bërë ju aktet nënligjore që tri javë..." Tre vjet s'i keni bërë aktet nënligjore në Ministrinë e Shëndetësisë për sigurime shëndetësore, e po pritni që për tri javë t'jua bëjë dikush tjetër?!

Tha një deputet a deputete, "kur ka vullnet për 24 orë bëhen udhëzimet administrative, aktet nënligjore...". Nëse është e vërtetë, pse tre vjet s'ka pasur vullnet Ministria e Shëndetësisë? Pse tre vjet s'ka pasur vullnet Ministria e Financave? Pse, more s'po flet Imeti, pse s'po flet Avdullahi? Sepse, e dinë shumë mirë dhe është mirë të dalin të tregojnë, se unë kam qenë me ta në Qeveri edhe kur e kemi miratuar këtë Buxhet, të cilin po duam ta rishikojmë. Duhet folur drejt, cili është "background"-i i këtij Buxheti. Unë kam qenë anëtar i Qeverisë dhe marr përgjegjësi pse e kam votuar këtë Buxhet. Edhe atëherë e kanë ditur, edhe ministri i Financave, edhe kryeministri, edhe secili prej nesh, që ky Buxhet e ka pothuajse të pamundur për t'u realizuar.

Ka qenë një sërë legjislacioni tepër i komplikuar, që është dashur të ketë mbështetje goxha të madhe në këtë Kuvend, e besa edhe me faktorët tjerë, që të mund të ndryshohet që mandej të merren fondet që janë paraparë. Çka “klauzola e investimeve”...? Ku janë ato mjete? Klauzolë të investimeve ne jemi kënaqur atje në Qeveri duke e futur këtë projekt dhe atë projekt, po ratifikimi duhet bërë me 2/3-at. Ne e dimë që me 2/3-at ka qenë e vështirë të bëhet. Edhe atëherë i kemi diskutuar këto, në takime të brendshme. Unë kam qenë ministër që e kam ngrehur shqetësimin tim në mbledhjet e Qeverisë, le t’i shikojnë transkriptet. Le t’i shikojnë procesverbalet. Atë fushë të përgjegjësisë që e kam pasur, për bujqësi, sot kurrkush s’po e përmend këtu bujqësinë. Nja 40 veta folën, por bujqësinë s’e përmendën. Atë ditë kur u votua Qeveria e bënë temë kryesore, për shkak të nacionalitetit të ministrit. Sot kurrkush nuk po thotë “Pse bujqësia nuk i ka fondet më të mëdha?”, sot kurrkush s’është duke thënë “Pse ish-ministri i Financave i ka zvogëluar fondet e bujqësisë?”, të cilat janë të reflektuara tash fatkeqësisht në këtë Buxhet.

Ministria e Shëndetësisë na e ka ndërruar në ish-Qeverinë çdo katër-pesë muaj datën e fillimit të implementimit. Unë kam qenë edhe në atë Qeverinë para kësaj, edhe atëherë e mbaj mend që, e përmendi tash ministri Besim Beqaj, 17 milionë euro ne i kemi lënë qysh atëherë për atë fond. Ia kemi lënë të gatshme ministrit të Shëndetësisë së LDK-së, se hera e parë është që Partia Demokratike e Kosovës e ka marrë përgjegjësinë për këtë dikaster. Kanë shkuar tre vjet, e kemi shtyrë herë më 1 janar, herë më 1 korrik, herë më 1 janar, herë më 1 korrik, dhe në fund e kemi mbajtur një mbledhje urgjente. Le ta dinë të gjithë që po flasin për sigurime shëndetësore, mbledhje urgjente ka thirrur Isa Mustafa më 30 qershor, nëse s’gaboje, një ditë pa i ardhur obligimi ligjor për ta filluar implementimin.

Dhe, çka kemi bërë më 30 qershor në atë Qeveri? Kemi thënë, “hajt se këqyrim në të ardhmen...”. Nuk e ka bërë kjo Qeveri, e ka bërë Qeveria ku unë kam qenë anëtar, e ka udhëhequr Isa Mustafa dhe LDK-ja, edhe Financat, edhe Shëndetësinë, edhe kreun e Qeverisë. Dhe më 30 qershor, mund të më përmirësoni nëse e kam gabim, është marrë vendimi “kur të përmirësohet dhe kur të plotësohet, të ndryshohet legjislacioni”, e ai legjislacion nuk plotësohet e ndryshohet për një ditë, as për një muaj, po edhe sikur të duhej të ndryshohej, ai ka mundur të ndryshohej për tre vjet. Po të më pyesnin mua në fillim të qeverisjes me Isa Mustafën “A do të kryhet ky mandat dhe s’do të fillojë implementimi i sigurimeve shëndetësore?”, kurrë s’kisha besuar. E kam thënë edhe më herët publikisht.

Po, ky është njëri prej shembujve pse e kemi shkarkuar atë Qeveri. Nuk është veç demarkacioni. Nuk janë vetëm çështjet tjera. Është kjo se s’kanë lëvizur, kanë ndenjtur si uji i ndenjtur, dhe ashtu janë, nuk kanë lëvizur prej vendit. S’kanë qenë në gjendje t’i bëjnë sigurimet shëndetësore, edhe pse i kanë pasur të gjitha mundësitë. S’kanë qenë në gjendje t’i implementojnë në bujqësi strukturat e IPARD-it për t’i thithur fondet e BE-së dhe do t’i humbim deri në periudhën e përfundimit të IPA-s. Nuk kanë qenë në gjendje ta shtrojnë rrugën Prishtinë-Mitrovicë duke i

pasur fondet, për tetë muaj është paguar njësia e implementimit të projektit. Kush nuk e ka penguar ta fillojë implementimin, po le se nuk është e vërtetë ajo që po thonë ka pasur problem me bankat.

Tre vjet nuk mundi të zgjidhet problemi me financues? Ajo është miratuar, është ratifikuar në këtë Kuvend, e nuk kanë qenë në gjendje ta bëjnë autostradën Prishtinë-Gjilan për tre vjet. Pasi e paskan pasur shumë me rëndësi rrugën Prishtinë-Gjilan, pse nuk e nisën? Pse more nuk e nisën, po edhe kur ka hyrë autostrada Prishtinë-Gjilan, ka hyrë me insistim të PDK-së. I keni të gjallë njerëzit, le të bëhen të sinqertë dhe le të tregojnë, edhe ish-ministri i Financave, edhe njerëzit e tjerë. Ne kemi insistuar të hyjë rruga Prishtinë-Gjilan, edhe kur ka hyrë, nuk e kanë dhënë në financim, e kanë nxjerrë me fonde të Agjencisë së Privatizimit, duke e ditur që 99.9% ato fonde sivjet nuk vijnë. Sot është krejt normale nëse bëjnë politikë dhe mundohen ta përmendin Gjilanin për vota. Po, ajo nuk ka qenë e planifikuar hiq, as nuk ka qenë bile në plane të LDK-së. A kanë këta arsye të brendshme pse dikush prej një rajoni tjetër brenda partisë së tyre ka qenë më i fortë, e ka dashur ta pengojë dikë tjetër të një rajoni, ato janë çështje për ta. Por, të manipulohet qytetari sot sikur ne kemi dashur, por na ka penguar dikush, kjo është e padrejtë.

Dhe, në fund, dua t'i them veç edhe 2-3 fjalë.

Ne e kemi me rëndësi ta miratojmë këtë rishikim, sepse janë dy muajt e fundit për t'u mundësuar agjencive buxhetore, ministrive të linjës dhe krejt atyre që kanë krijuar obligime ta përfundojnë vitin.

E kemi Buxhetin për 2018 shumë shpejt dhe besoj nuk do të kalojnë 2-3 javë, se më 31 tetor e kanë obligim ta miratojë Qeveria, e ndoshta edhe para balotazhit bëjmë pak politikë edhe me atë Buxhet dhe na e bie ministri ta trajtojmë.

Por, do të ishte mirë që njëherë e përgjithmonë në Kuvendin e Kosovës të paktën një minimum të moralit ta ruajmë kur diskutojmë dhe të paktën, qysh kemi diskutuar në një seancë të kaluar, të mos shpifim, të mos ofendojmë dhe të mos mundohemi të rritemi duke i zvogëluar të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Pacolli. Lutfi, a deshe replikë, a e ke shtypur, nëse do. Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

I përshëndes ministrat, deputetë, mediat, të gjithë që na përcjellin.

Kisha dashur që njëherë e përgjithmonë t'jua përkujtoj që pjesa e Gollakut është pjesë e territorit të Republikës së Kosovës, unë nuk e gjeta asnjë projekt në këtë drejtim.

Gollaku, si të gjitha pjesët e tjera të Kosovës, meriton përkrahje, është një jetë e njeriut që në pjesën e Gollakut nuk është bërë asnjë investim i rëndësishëm.

Po më duket që pjesa e Gollakut përkujtohet vetëm kur është çështja e fushatave.

Edhe në Qeverinë e kaluar është bërë një projekt, së paku anash një kalim i rrugës Prishtinë-Badovc-Mramor-Slivovë-Llabjan, lidhet me Gjilanin, dhe ai është anuluar dhe nuk ka projekte të tjera.

I bëj kërkesë ministrit që t'i parashohë këto projekte, të cilat janë bërë më herët, që të mos anulohen, po të përkrahen, të shkojnë përpara, se pjesa e Gollakut kufizohet edhe me Serbinë. Prandaj, duhet të ndiheni krenarë se kjo ka dhënë kontributin e vet dhe meriton projektet.

I bëj thirrje edhe Ministrisë së Industrisë, Ministrisë së Pushtetit Lokal që t'i adresojnë projektet në zonën e Gollakut, se është një vend fantastik për turizmin malor dhe ka hapësira të zhvillimit që sado pak të ruhet edhe zhvendosja apo shpërngulja e fundit nga Gollaku.

Prandaj, mos e anashkaloni, të kini kujdes, se ka nevojë për përkrahje, se e gjithë pjesa e Gollakut është shpërngulur vetëm se pushteti nuk e ka prekur fare.

Gjithmonë vetëm në pjesën apo në kohën e fushatës i kujtohet dikujt që ekziston diku pjesa e Gollakut, po asnjëherë për një projekt konkret, një investim adekuat nuk është bërë në atë pjesë, deri kur kështu?

Unë i përkrah të gjitha këto projekte të tjera, por kërkoj që tani të shohim cilat projekte do të ecin në atë drejtim, e në veçanti kjo që është anuluar në qeverisjen e kaluar, nuk e di me çfarë arsye, nga Ministria e Infrastrukturës.

Është folur edhe më herët për çështjen e shëndetësisë. Shëndetësia është një katrahurë, do të thosha, me probleme jashtëzakonisht të shuma, por ne duhet të bëjmë një mobilizim të përbashkët nëse duam ta ndryshojmë këtë gjendje. Mos harroni se janë vëllezërit tanë, motrat tona ata që shkojnë në ato spitale dhe nuk kanë kushte për trajtim.

Unë dëgjova edhe më herët që është bërë goxha një problem i madhe për veteranët e luftës, të mos harrojmë se dikush, unë nuk i di listat, sigurisht ata që i kanë drejtuar duhet dhënë llogari, por kanë qenë ata njerëz, të cilët i kanë thënë 'jo' okupimit të Kosovës.

Prandaj, mendoj që është mundësia për t'u gjetur edhe Buxheti, për arsye që në administratë ka mundësi të shqyrtohen, sidomos ata të cilët janë me kontrata mbi vepër. Për çka janë ata, nuk duhet shkuar në pa kufij, por ne t'i analizojmë dhe t'u japim përkrahje.

Edhe për gratë e dhunuara që u përmend, mua më vjen keq, po duhet të jepet përkrahje dhe të mos mendohet fare.

Ministër, të kisha lutur, këto le të shkojnë përpara, do ta keni përkrahjen së paku për ato që i kemi mundësitë të shkojnë.

Po, mos e harroni Gollakun, se përndryshe ne nuk do të jemi të pajtimit nëse kjo pjesë do të mbetet e anashkaluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë kolegë,

Edhe pse sot po diskutohet për shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, po shihet se edhe kjo Qeveri, sikurse edhe ato të mëparshmet, nuk do të interesohet as për zbatimin e projekteve të qëndrueshme, po as për zbatimin e programit të saj qeverisës.

Pasi objektivat e përcaktuara nuk i ka përcjellë me rishikim të Buxhetit dhe planifikim për zbatimin e tyre në praktikë.

Unë sot do të fokusohem te planifikimi i Buxhetit të këtij projektligji për arsimin para universitar dhe konkretisht, te kategoria e investimeve kapitale në arsimin para universitar si dhe te Buxheti i planifikuar për trajnimin e mësimeve dhe zhvillimin e plan-programeve.

Sa u përket investimeve kapitale në arsimin parauniversitar duhet theksuar se janë paraparë vetëm 7 milionë e 693 mijë e 778 euro, këtu dua të bëj një krahasim të vogël me investimet e tjera.

Konkretisht, te Buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës, vetëm për mirëmbajtjen e rrugëve parashihen 9 milionë e 366 mijë e 670 euro, kurse për rehabilitimin e rrugëve parashihen 9 milionë e 15 mijë e 995 euro.

Pra, dallimi në mes të Buxhetit të planifikuar për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe mjeteve të parapara për ndërtimin e çerdheve, të shkollave dhe hapësirave të tjera shkollore, si dhe kabinete, salla të edukatës fizike, laboratorë e të tjera është 10 milionë e 688 mijë e 851 euro.

Pra, kjo Qeveri, sikurse edhe ato të kaluarat, prioritet e ka asfaltin dhe mirëmbajtjen apo rehabilitimin e rrugëve, sepse parasheh të investojë hiç më pak se 10 milionë euro më tepër në këto të dyta.

Përkundër se tashmë është e njohur botërisht rëndësia e edukimit të hershëm dhe krijimit të hapësirave të duhura për zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për edukimin dhe arsimin cilësor si dhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendit, ky Buxhet nuk planifikon as për së afërmi krijimin e mundësive për zhvillim të mirëfilltë të arsimit dhe të vendit.

Aspekti i dytë ku do të fokusohem është planifikimi i Buxhetit për trajnimin e mësimdhënësve.

Për këtë linjë janë paraparë vetëm 705 mijë e 291 euro. Dua të sjell këtu në vëmendje vetëm një dokument strategjik, Planin strategjik të arsimit të Kosovës të vitit 2017-2021, ku sipas kësaj strategjie shumë të rëndësishme, e cila tashmë është dokument i aprovuar, vetëm për sigurimin e cilësisë janë paraparë 605 mijë e 646 euro, ndërsa për zhvillimin profesion të mësimdhënësve një milion e 57 mijë e 900 euro.

Pra, ia vlen të theksohet edhe fakti se vlerësimi i kostos së planit strategjik të arsimit në Kosovë është rezultat i një procesi të gjerë e të gjatë të konsultimeve brenda institucioneve të Kosovës, por edhe me partnerët zhvillimorë dhe me shoqërinë civile.

Që të jem konkrete, përderisa projektligji i propozuar parasheh 705 mijë e 291 euro për trajnim të mësimdhënësve, sipas caktut, vetëm për vitin 2017 janë paraparë se nevojiten edhe 958 mijë e 255 euro më shumë, e që ky Buxhet i rishikuar nuk i merr fare parasys.

Kategoria e tretë, ku dua të fokusohem sot, ka të bëjë me mjetet e planifikuara për zhvillimin e plan-programit.

Është një shumë që ky projektligj e parasheh 200 mijë euro. Në fakt, kjo vlerë vetëm sa përcillet nga viti në vit, sepse edhe në buxhetet e kaluara ka qenë e planifikuar e njëjta shumë.

Kur kemi parasys se sivjet ka filluar implementimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat, ky Buxhet i planifikuar as për së afërmi nuk i përmbush kërkesat dhe nevojat reale të mësimdhënësve në këtë drejtim.

Duke ditur se Korniza e kurikulës së Kosovës paraqet një zhvendosje nga mësimdhënia dhe të nxëniet të bazuar në objektiva dhe përmbajtje mësimore, drejt mësimdhënies dhe të nxëniet të bazuar në rezultatet e pritshme dhe në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, një qasje e tillë implikon përgjegjësi shumë më të mëdha për shkollën dhe për mësimdhënësit, të cilët ngarkohen me zhvillimin e përmbajtjeve mësimore, për zgjedhjen e metodave të mësimdhënies si dhe

materialeve dhe mjeteve mësimore. E kjo, në fakt, nënkupton edhe planifikim dhe ndarje të Buxhetit në këtë drejtim.

Në këtë fakt, sipas Planit strategjik të arsimit në Kosovë, për të mbështetur implementimin e kurrikulës së re MASH-ti do të duhej të zhvillonte kurikulën dhe plan-programin për çdo klasë dhe lëndë.

Andaj, Buxheti i planifikuar është jashtëzakonisht i ulët në këtë drejtim.

Nëse këto i sjellim në vëmendje dhe arsimin dhe aftësim profesional, ku mungojnë plotësisht kurrikulat bërthamë, mungesa e mjeteve të planifikuara për këtë qëllim, gjegjësisht për zhvillimin e plan-programeve as për së afërmi nuk do t'i përmbushë nevojat reale.

Në fakt, ky Buxhet i rishikuar nuk i adreson as vetë objektivat që kjo Qeveri ka paraparë me programin e saj qeverisës.

Sa për demonstrim, po theksoj se në pjesën e objektivave për arsimin parashkollor kjo Qeveri ka paraparë të shfrytëzojë modelet e punës që aplikohen në vendet e zhvilluara, për shembull, montesorin për edukimin parafillor.

Për ata që sadopak kanë njohuri për këtë metodologji të punës, e dinë koston që ka zbatimimi i saj, e që fare nuk është marrë parasysh.

Po ashtu derisa në programin qeveritar kjo Qeveri e parasheh si objektiv të saj masivizimin e përfshirjes së fëmijëve në çerdhe dhe sidomos në edukimin parashkollor si dhe ndërtimin e godinave respektive që janë të qasshme për popullsinë, Buxheti i planifikuar për investime kapitale në arsim është ashtu sikurse e përmenda, vetëm 7 milionë e 693 mijë euro, pra diku 10 milionë më pak se sa është paraparë për rehabilitimin e mirëmbajtjen e rrugëve.

Është më se e qartë që edhe për këtë Qeveri, ashtu sikurse edhe për qeveritë e kaluara, arsimit është prioritet vetëm në mënyrë deklarative, e jo duke e përcjellë edhe me ndarje të Buxhetit, gjegjësisht në planifikim real të Buxhetit për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të arsimit, për arsimimin cilësor dhe zhvillimin ekonomik përsheptuar, që po ashtu adresohet nëpërmjet zhvillimit të arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Imet Rrahmani.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Të nderuar qytetarë,

Edhe unë si kryeministri, tash po mësohem prej asaj anës të flas, sa u mësova prej kësaj, e që nuk është çudi pse nganjëherë s'po na ndezën ato, s'po dimë ta kërkojmë fjalën, po mësohemi, nuk është problem.

Unë kam menduar që jemi lodhur qe një muaj ditë duke folur në fushatë elektorale dhe këtu së paku do të fokusohemi në çështje që janë me rëndësi, e nuk do të bëjmë shumë fushatë, sepse i kemi maltretuar qe sa kohë qytetarët dhe po i maltretojmë edhe sot.

Sidomos me të pavërteta, insinuata dhe diskutime tendencioze që kanë edhe ngjyrimë jo vetëm politike, por edhe personale, deri një fyerje për individin.

Unë do të mundohem të jem i qetë, të jem përmbajtjesor në diskutime dhe do të mundohem të mos bie në provokime të askujt.

Është e vërtetë që kam udhëhequr njërin prej dikastereve më të vështira, atë të shëndetësisë dhe është e vërtetë që unë ndihem shumë komod dhe shumë mirë në raport me mundësitë dhe në raport me përkrahjen që kam pasur për të arriturat që kam bërë.

Unë e di shumë mirë që vlerësohem nga punëtorët shëndetësorë, vlerësohem nga qytetarët, vlerësohem nga kolegët e mi dhe vlerësohem edhe nga stafi i Ministrisë së Shëndetësisë për punën dhe angazhimin, përkushtimin dhe qëllimet e mira që i kem pasur për ta bërë më të mirën në Ministrinë e Shëndetësisë.

Sot u ngrit çështja e sigurimeve shëndetësore, e kam thënë në këtë foltore nga një pozitë tjetër, e kam shpjeguar pse edhe çka është dashur të bëhet prej marrjes së mandatit deri në ditën kur e kemi dorëzuar mandatin.

Unë veç po them nja 2-3 pika, besoj që edhe kryeministri do t'i marrë informatat. Agjencia e Financimit Shëndetësor, që tash është fond, më nuk ekziston si Agjenci e Financimit Shëndetësor, sepse ne e kemi kaluar në Qeveri statutin dhe ky miratim i statutit e ka shndërruar dhe e ka avancuar në Fond të Sigurimit Shëndetësor, pra Agjencinë e kam gjetur me marrjen e mandatit në dhjetor 2014 s'e ka pasur të miratuar as Rregulloren e organizimit të brendshëm, është paraparë me ligj aty pas tre muajsh, pas miratimit të ligjit, të bëhet Këshilli përgatitor, i cili sot, e ftoj kryeministrin të kërkoj nga ministri i Shëndetësisë që ta procedojë në Qeveri për këtë Këshill përgatitor ta shndërrojë në bord, sepse me ligjin aktual bordi e udhëheq fondin.

Kemi shkuar tutje në miratimin dhe aprovimin e çdo akti të nevojshëm dhe dokumenti, i cili do të çonte deri te fillimi i mbledhjes së premieeve.



Gjithmonë jemi koordinuar me partnerë, donatorë, investitorë dhe me Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Gjatë tërë procesit të koordinimit me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenien Sociale, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ATK, ARC-në dhe donatorët, pa e anashkuar asnjëherë Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, kemi hasur në probleme që paraqet Ligji aktual i sigurimeve shëndetësore. E kemi zbërthyer ligjin deri në detajet më të imta, sa që ekspertët e ekonomisë dhe ekspertët tjerë, të cilët kanë paraparë situata të caktuara gjatë implementimit të ligjit dhe gjatë ofrimit të shërbimit shëndetësor nga fondi, ato mangësi paraqesin probleme teknike dhe ligjore.

Ne jemi marrë vesh me Komisionin Parlamentar, këtu e kemi edhe ish-kryesuesin e Komisionit, që ligjin ta prezantojmë me procedurë të shpejtë, të bëhet plotësim- ndryshimi i ligjit, sepse aktet e tjera i kishim gati, se i patëm finalizuar në kohën kur veç filloi për rrëzimin e Qeverisë.

Janë 2-3 dokumente, të cilat janë në fazën finale të aprovimit, kanë qenë së paku në fazën finale të aprovimit në periudhën prill, maj, qershor dhe unë uroj që ministri aktual, pasuesi im, ato dokumente t'i shohë ku janë dhe t'i procedojë.

Unë do ta lutja kryeministrin që t'i bëjë pyetje ministrit të Shëndetësisë, pse plotësim-ndryshimi i Ligjit për sigurime shëndetësore është larguar nga plani legjislativ?

Pse nuk e kemi në mbledhjen e sotshme të Kuvendit plotësim-ndryshimin e Ligjit për sigurime shëndetësore? Kur ne jemi marrë vesh dhe punën plotësim-ndryshimin e kemi përfunduar, e kemi kaluar në Qeveri dhe ka mbetur të vijë në Parlament. Është shpërndarë parlamenti, nuk ka mundur të bëhet plotësim- ndryshimi i ligjit, normalisht që nuk ka mundur të shkojë tutje.

Unë lus kryeministrin Haradinaj t'i bëjë pyetje ministrit të Shëndetësisë, pse janë pezulluar shumë procedura të rekrutimit të stafit me ligjin aktual, të cilin sot po duam ta plotësojmë e ta ndryshojmë. Janë lejuar 26 pozita të reja, 24 kanë qenë më herët, që nënkupton deri në fund të vitit është dashur dhe duhet t'i ketë të punësuar fondi 50 vende, 50 pozita.

Unë kam informacion se ministri aktual, me neglizhencën që po tregon ndaj procesit të fondit, nuk ka bërë kërkesë që në Ligjin për Buxhet t'i fusë 25 vende që parashihen në Kornizën afatmesme buxhetore.

Unë shpresoj që kjo të jetë informatë e gabuar, por lus kryeministrin që të ndikojë që ato vende që paralajmëroi ministri i Financave, 25 të jenë për Fondin e sigurimeve shëndetësore, sepse në fund të vitit 2019 Fondi duhet t'i ketë 100 pozita.

Mandej, do të shtoja një tjetër pyetje, të cilës dua t'i japë përgjigje Qeveria aktuale: për çka janë pezulluar edhe po bëhet presion në pezullimin e procedurave të përzgjedhjes së operatorit dhe lidhjes së kontratës për shpërndarjen e hardverit në pjesën jashtë zonës pilot të SISH-it.

Ne kemi këtu edhe parti të tjera që udhëheqin Prishtinën sot dhe e kanë, unë dua ta përmend që ish-drejtori aktual i Shëndetësisë ka folur shumë fjalë të mira bash për pilotimin e SISH-it në Prishtinë, ngjashëm është duke shkuar në disa pjesë në QKUK dhe në zonën e Prizrenit.

Këto janë çështjet të cilat dua t'i ngre edhe e kisha lutur që Qeveria të mos i neglizhojë, sepse rrezikon që përnjëmend në procedurë nëse nuk intervenohet shpejt, ta kthejmë krejt procesin në pikën zero, atëherë nuk mund të flasim për vitin 2018 për sigurime shëndetësore, por ndoshta për disa vite, sepse vonesat shkatërrojnë procese. Ne i kemi ofruar dhe besoj që me pak punë kjo mund të arrihet dhe të bëhet.

Unë e kisha lutur ministrin e Financave që nëse nuk shfrytëzohen 17 milionë euro për sigurime shëndetësore, së paku një pjesë e tyre të mbeten brenda Ministrisë së Shëndetësisë, sepse sot borxhi i Ministrisë së Shëndetësisë është 7 milionë euro për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe një milion e gjysmë milionë euro të parapara për përmirësimin e Buxhetit për barna dhe material harxhues është i pamjaftueshëm, duke shkaktuar edhe vonesat që po bëhen në nënshkrimin e kontratave për procedura të përfunduara, që po vonohen nëpër zyre të Ministrisë së Shëndetësisë, e sipas të gjitha gjasave, edhe në kabinetin e ministrit.

Nëse nuk shtohet Buxheti për barna dhe mëditje, nëse nuk alokohen mjete për ta mbuluar borxhin për trajtimin jashtë institucioneve publike, unë, zoti ministër, ju them që Fondin për sigurime shëndetësore jo që do ta zhvillojë në vitin 2018, por do ta futni në borxh ende pa filluar mirë ta zhvillojë.

Unë uroj që në debatet e tjera të flasim për suksese në Ministrinë e Shëndetësisë, por kjo qasje ndaj fondit, kjo qasje ndaj problemeve që janë aty, e tillë qysh ka filluar unë dyshoj që jo 100 ditë, por edhe 1 000 ditë s'do të bëjnë diçka, së paku as në gjysmë sa kemi bërë ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot në këtë seancë jemi mbledhur ta bëjmë plotësim-ndryshimin e Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Po më befasojnë deputetët që kanë qenë në atë kohë në opozitë, kur po flasin për këtë ligj, ku ne bashkë e kemi votuar atë kohë për vitin 2017. Nuk më befasojnë deputetët e opozitës, po këta të pozitës.

Shoh se është një pasqyrim real i mundësive buxhetore në Ligjin e rishikimit të Buxhetit për vitin 2017, për një gjë të tillë e përgëzoj edhe ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, por edhe të gjitha organizatat buxhetore në Republikën e Kosovës, respektivisht zyrtarët, të cilët kanë qenë të angazhuar në këtë punë. Ne e dimë se jemi shumë të vonuar në rishikimin e Buxhetit, kjo vonesë është e papranueshme për qytetarët e Kosovës, vonesë e cila i ka sjellë pranë falimentimit bizneset në Republikën e Kosovës.

Ne e dimë se bizneset apo ndërmarrjet kanë bërë shërbime, kanë bërë furnizime ndaj organizatave buxhetore dhe organizatat buxhetore nuk kanë mundësi t'i bëjnë pagesat para se ne ta bëjmë këtë rishikim. Edhe ashtu jemi të vonuar, nuk ka ndonjë efekt në procedurat e investimeve kapitale nëse shtojmë ndonjë projekt të ri se janë vetëm edhe dy muaj për të dalë në vitin tjetër. Unë mendoj që të gjithë ata që mendojnë të bëjnë ndonjë projekt më të madh për vendin, apo për zhvillimin ekonomik, është mirë të shikojmë, tash ashtu edhe 10 ditë apo 2 javë Qeveria do ta sjellë Ligjin për Buxhetin e vitit 2018, dhe mendoj se edhe ne si deputetë duhet të fokusohemi aty që ta japim kontributin tonë.

Ne e dimë që kjo vonesë, në bazë të informatave që i kemi si deputetë, po ua krijoni një krizë bizneseve, e ne edhe ashtu me Kushtetutë të Republikës së Kosovës jemi të përcaktuar në ekonominë e lirë të tregut, në vend që të krijojmë një ndihmesë për zhvillimin ekonomik për biznesin, ne po i pengojmë duke pasur parasysh që shumica e bizneseve të Kosovës janë nëpër kredi, kanë over-drafte, apo kanë edhe probleme tjera. Kjo ndikon direkt dhe indirekt në papunësinë në vendin tonë, gjë për të cilën ne për punësim apo për krijimin e vendeve të reja realisht kemi folur gjithë nëpër fushata, po flas këtu pa dallim cila parti.

Ky rishikim, e thashë edhe më herët, edhe ashtu ka pak efekt, kur jemi në fund të vitit. Konsideroj që nuk është e ndershme të luajmë me kategoritë e dala nga lufta, siç është rasti me veteranët e luftës. Ne nuk po u falim asgjë, por po ua kryejmë obligimin tonë si deputetë dhe si institucione. Nëse dikush meriton trajtim dhe respekt në këtë shtet, janë ata dhe familjarët e atyre që e dhanë jetën për liri. Duhet të mos i përziejmë gjërat. Nëse ka falsifikim të certifikatave të veteranëve të luftës, atëherë falsifikimi është vepër penale me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Ata që e thanë, sikur e tha në këtë rast deputeti Lumiri, duhet ta deklarojnë këtë në Prokurori, se nëse ka falsifikim është vepër penale, por edhe nëse ka deklarim të rrejshëm, edhe ajo është vepër penale me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, apo duhet të kërkojë falje që do të thotë ta njollosë dikë.

Pati këtu edhe zërat tjerë që thanë këtu që kemi pasur njerëz që janë deklaruar nga Tirana për UÇK. UÇK-ja në atë kohë e ka kryer punën më të mirë të mundshme falë saj dhe falë angazhimit të brezave ne sot e gëzojmë lirinë, por ata njerëz që janë deklaruar nga Shqipëria, unë flas tash si ish-ushtar i Ushtrisë Çlirimtare, kur kemi pasur deklarata nga Shqipëria, ato na kanë inspiruar për ta kryer punën tonë si ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare, por jam shumë i gëzuar dhe i lumtur që anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, të cilët kanë qenë me punë në Tiranë, nuk kanë bërë deklarata nga Beogradi, por kanë bërë nga Shqipëria, dhe mendoj që ajo na ka jep një kurajë për të ecur përpara.

Nuk është mirë këtu që individë të caktuar ta keqpërdorin sot rishikimin, sepse ne gjithçka folëm sot, nuk folëm vetëm për rishikim të Buxhetit. Asnjë deputet gati nuk tha me shifra, kandidatët të cilët janë në balotazh biseduan qysh do ta fitojnë garën atje, e nuk janë kandidatët që e përcaktojnë, por janë qytetarët e Republikës së Kosovës për secilën komunë, do t'i shikojnë ofertat dhe do ta përkrahin atë që ata mendojnë.

Ne thamë që jemi para Buxhetit të ri, i cili do të vijë nga Qeveria brenda 10 ditësh apo dy javësh. Nuk do të ndalemi shumë tash në rishikim, sepse ky rishikim ka kaluar si Buxhet në atë kohë dhe shkurtimet që u panë këtu që kanë ndodhur, si shkurtime të Buxhetit, ishin kryesisht në dy pozicione: pozicioni i mosrealizimit të mjeteve nga AKP-ja, që ka mbet si neglizhencë e mosplotësim-ndryshimit të Ligjit për AKP-në, u tha edhe një pozicion tjetër, për shembull u fol shumë për sigurimet shëndetësore. Nuk është mirë që ne këtu t'i manipulojmë qytetarët, se të gjithë kemi qenë të interesuar edhe para pesë vjetëve të kemi sigurime shëndetësore në këtë vend. Ka qenë pamundësia apo paaftësia e ministrave të shëndetësisë për ta bërë një gjë të tillë, apo e qeverive përkatëse. Nuk kanë arritur ta bëjnë plotësim-ndryshimin e ligjit, edhe sikur të kishte ndodhur plotësim-ndryshimi sipas agjendës së tyre, nuk do të kishin arritur t'i nxjerrin rregulloret e brendshme apo aktet tjera nënligjore se si të implementohet ai ligj. Në këtë rast, konsideroj se është më shumë se imediate për qytetarët e Republikës së Kosovës të kemi sigurime shëndetësore, por të mos bëjmë këtu projekt-buxhete dhe buxhete politike, por të bëjmë projekt-buxhete dhe buxhete të mundshme për t'u realizuar.

U tha edhe një gjë, që e tha zoti Krasniqi më duket, te kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, përveç mjeteve nga AKP-ja, ne kemi dështuar edhe në marrjen e kredive apo implementimin e marrëveshjeve në këtë Kuvend. E dimë që marrëveshjet është dashur t'i kanë votat e 2/3 të deputetëve, por ne nuk i kemi sjellë as ato këtu.

Edhe u fol shumë për autostradën e Gjilanit. Të gjithë deputetët apo këtu, apo disa prej tyre u bënë shumë ekspertë të procedurave të prokurimit, u bënë ekspertë të OSHP-së, u bënë ekspertë të KRPP-së, por nuk thanë kurrëgjë. Është ministri përkatës, është Qeveria, janë organet përkatëse.

Me Ligjin për menaxhimin e financave publike të Republikës së Kosovës nuk ka të drejtë pa zotim të mjeteve që të ketë projekte edhe asnjë vepër penale nuk është nëse anulohen projekte, të cilat kanë dalë në publik, ose kanë dalë në publikime të shpalljeve publike pa zotim të mjeteve publike. Këto janë shkeljet kryesore, e ne e kemi edhe një pikë më vonë për të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm, e për çdo vit i kemi këto të gjetura, i kemi këto rekomandime dhe nuk kemi as plane të veprimit, e as nuk kemi ndryshime në rekomandime, as në nivel komunave, as në nivel të Qeverisë.

Unë e kam edhe një kërkesë për Qeverinë, respektivisht nga këta dy ministrat që janë këtu, edhe ministri i Financave, edhe i Infrastrukturës, që ta kenë parasysh që në gjithë Kosovën të ndarja e Buxhetit të jetë pak më reale. Të mos jetë kah vjen ministri, se ndoshta në këtë rast fiton komuna ime, nëse shkon ajo, por kërkoj që edhe të kemi fonde më shumë në të gjithë sektorët. Ne flasim çdo ditë për reforma në Administratën Publike, por me këto ndarje buxhetore nuk mund të kemi reformë në Administratën Publike pa pasur fond më të madh për teknologjinë informative. Duhet të investojmë në teknologji informative, duhet të investojmë në kuadro, nëse ne duam reforma administrative.

Duhet të kemi fonde më të mira për shëndetësinë, ta kemi një rregull më të mirë në shëndetësi. Nuk kemi nevojë t'i çojmë 70 milionë të shtetet fqinje. Nëse ato mjete ne i futim këtu, do ta kemi personelin më të mirë të mundshëm të mjekëve që munden t'i kryejnë ato punë.

Mungesa e Buxhetit ka ndikuar edhe te veteranët, ka ndikuar te çdo qytetar, po flas tash pasi u fol për shëndetësinë, sa ishte ministri, edhe te njerëzit që kanë hyrë në punë dhe janë specialistë nëpër spitalet e Kosovës që tre muaj punojnë e nuk kanë marrë rroga në mungesë të Buxhetit. Kemi edhe të tjera, por nuk do të ndalem. Kërkoj që edhe në arsim, edhe në bujqësi, edhe në të gjitha sferat, të kemi më shumë investime, e në veçanti kërkoj prej ministrit të Infrastrukturës, meqë jemi i vetmi qytetet që në infrastrukturë kemi mbetur mbrapa. Nuk kemi një hyrje-dalje në qytet me standarde, nuk kemi një rrugë të ndrequr mirë, apo një projekt që na lidh me autostradën e kombit në Landovicë.

E kemi rrugën që e lidh Komunën e Gjakovës me Junikun, në rreth 22 km është tmerr. Besoj që ministri ka qenë në fushatë atje, prandaj duhet ta shikojmë edhe riparimin, por edhe ndërtimin e ri me trotuare, sikur edhe shumë rrugë të tjera që të gjithë i kanë përmendur, por asnjëherë nuk është vepruar.

Kërkoj që në këtë Buxhet të përfshihen shumë projekte edhe për Komunën e Gjakovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit, Hajdar! Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

E kërkova fjalën më herët, por s'ka dert, se kur na bërtiti kjo pilot-kryetarja e parë për sukseset në Gjakovë, ne të gjithë e dimë që edhe atë aeroport kur e ka pas bërë njëfarë plani Banjsko, a çka ka qenë, ajo ka qenë në Qeveri pak, dhe e kemi parë qysh e ka lënë Gjakovën, në çfarë gjendje. Megjithatë, ajo i di punët e veta.

I kam dy lajme, kryesues, një është i mirë, një është i keq. Këta që po flasin, le ta dinë që nuk është transmetimi drejtpërdrejtë, kështu që të mos harxhojnë shumë kohë. E lajmi i keq është që pas lajmeve do ta vazhdonin prapë transmetimin, kështu që nëse mund t'i bien shkurt do të ishte më mirë.

U fol shumë për veteranët e UÇK-së, dhe duhet thënë publikisht që ai që s'është veteran kurrë s'do të mbetet veteran, ai do të hiqet sot, a nesër, a pasnesër, a kurdo. Bile ne bëjmë thirrje publike që ata të largohen vetë dhe do të ishte më mirë. Për ata që kanë qenë, do t'i gëzojnë të drejtat e veta.

Kemi kategori të shumta që janë kategori të veçanta në Kosovë, u përmend edhe për gratë e dhunuara, është një kategori shumë e ndjeshme pa folur për numra, se është e pandërgjegjshme për mua të flas me numra nëse nuk kam informatë, por gjithsesi që duhet bërë përpjekje për t'i trajtuar si të veçantë, për shkak se duhet vënë pak veten në vend të tyre.

E kemi të njëjtën situatë për të zhdukurit. Është pak problem, sepse familjet akoma nuk e pranojnë fatin që ata mund të mos jenë gjallë, por edhe aty duhet gjetur formën se si të trajtohen.

I dëgjova disa kolegë që folën për infrastrukturën rrugore. Ju e dini shumë mirë që rruga për në Kaçanik, unë i kam rënë para dy javësh, ishte e kryer deri në Kaçanik, rruga për Podujevë-Merdar ishte në përfundim e sipër, rruga për Mitrovicë, Hajdar, ishte duke u kryer, po ta përmendi emrin nëse ke replikë, e nuk bëhet nami nja 700 mijë banorë të perëndimit të Kosovës që të lidhen me katër korsi, se edhe ata e meritojnë. Edhe ata janë kontribuues të Buxhetit të Kosovës, kanë mbetur pak pas dore dhe shpresoj që edhe ministri i Infrastrukturës dhe ai i Financave do t'i kenë në konsideratë kërkesat e tyre.

Ndërsa, për projektet e komunave, ju e dini që secila komunë i ka specifikat e veta, por pajtohem plotësisht që Ferizaj duhet të ketë qasje në autostradë, Vitia duhet të ketë qasje në autostradë, sepse autostrada, në fund të fundit, qëllimin kryesor e ka shërbimin për qytetarët. Edhe nuk është ndonjë kosto e madhe buxhetore për shkak të distancave të afërta, por me siguri ju do të konsultoheni edhe me ekspertë të tjerë.

Për shëndetësinë, e përgëzoj edhe e komplimentoj ministrin e Shëndetësisë që është i vetmi ministër aty që e ka kaluar mandatin pa afera të paktën. Shpresoj që s'del ndonjë gjë ky rasti i

fundit, por gjithsesi e përgëzoj për mandatin që e ka kryer me sukses, duke besuar shumë që ministri i ri ta trajtojë seriozisht këtë problem, sepse të gjithë pajtohemi që gjendja nuk është e mirë. E ka edhe shumë probleme tjera, e unë nuk po e zgjas më shumë, por në total rishikimi i këtij Buxheti nuk e kalon shumën e 8%, që do të thotë ne e trashëgojmë në linja buxhetore të Qeverisë së kaluar, ndërsa totali i devijimit të mjeteve nuk e kalon shumën 8%, që domethënë jemi duke e trashëguar një linjë buxhetore me një 8% dallim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë nuk do të flas shumë se s'do të bëjmë fushatë, ne nuk jemi në balotazh, e kemi kryer atë çka është dashur ta kryejmë, edhe pse do t'i përkrahim ata që e kemi ndërmend.

Edhe pse po e shoh këtu që Buxheti u përmend shumë herë që i ka 400 fletë, ne e kemi këtu vetëm një fletë, e cila është me një rresht për komunitete, dhe ajo është një vlerë, e cila është vetëm 30 mijë euro, që do të investohet në një fshat, një asfaltim i cili do t'i ketë vetëm 100 metra. Hiç më shumë! E shtrohet pyetja: Pse ne votojmë këtu? Më herët e kemi votuar dhe kemi kërkuar që së paku të ndahet një kod për komunitete dhe bash ajo po më brengos diçka, diçka që votohet në Parlamentin e Kosovës është mirë edhe të zbatohet. Të gjithë deputetët e kemi votuar kodin, i cili do të jetë për komunitete dhe të ndahet nga Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve.

Ne këtu para nesh e kemi që në vitin 2017 ka 3 milionë e 160 mijë janë për të kthyerit, më 2018 - 6 milionë e 500 mijë, më 2019 prapë 6 milionë e 500 mijë. Shtrohet pyetja, unë flas për komunitetin tim, të cilin e përfaqësoj, asnjë familje nga komuniteti i ashkalinjve nuk ka nga të kthehet, ata të gjithë jetojnë në Kosovë. 35 mijë anëtarë të komunitetit tim ashkali i kam në Kosovë edhe ata jetojnë në Kosovë. Nëse flitet për komunitetin, i cili është në Diasporë, ata nuk kemi nevojë t'i kthejmë, ata le të punojnë dhe veprojnë atje, por edhe kur të kthehen ata kanë mjete financiare, e rregullojnë jetën vetë.

Por, ne është mirë të mendojmë për këto familje këtu që i kemi dhe t'ua rregullojmë atyre jetën. Ne për çdo Buxhet, është mandati i katërt që jam në Parlamentin e Kosovës, kërkojmë që së paku një vit të ndahen 1 apo 2 milionë euro që t'ua rregullojmë jetën këtyre komuniteteve. Shumë herë flitet se po shkojmë drejt liberalizimit të vizave, por nuk mendoj që mund të shkohet drejt liberalizimit të vizave kur njerëzit vdesin nga uria, nga kafshimi i qenve, jeta e tyre është shumë e vështirë, e thashë edhe në fillim me keqardhje, po e them për të gjithë deputetët që i kemi në Parlamentin e Kosovës. E thashë që nga kjo sëmundje, e cila i ka prekur këtë muaj, i kemi 70 të sëmurë në spital, një ka vdekur, por asnjëri nga deputetët nuk e mori këtë si shqetësim. Shumë normale iu duk dikujt që një fëmijë 15 muajsh ka vdekur, edhe pse me plot vetëdije them që shumë deputetë, së paku 1, 2, apo deri në 5 vota i kanë nga komunitetet.

Në çdo lagje jetojnë komunitetet dhe së paku besoj që e kanë obligim që kur t'i dëgjojnë këto, së paku është mirë të veprohet edhe për komunitetet. I nderuar ministër, edhe pse e kemi tash këtë rishikim të Buxhetit këtu, këta dy muajt e fundit vetëm sa është kryer, mendoj që në vitin e ardhshëm 2018 së paku t'i kemi parasysh kërkesat e tona, sepse me të vërtetë janë kërkesa serioze, të përsëritshme vazhdimisht dhe asnjëherë nuk merren parasysh. Komuniteti jonë ka nevojë që t'u rregullohet jeta e tyre, ka nevojë që ndaj këtij komuniteti të shikohet pak, por jo vazhdimisht që të gjitha komunitetet të futen me një thes. Secili komunitet, edhe me Kushtetutë i kemi të ndara, i ka specifikat e veta, jo të ndahet Buxheti me një ministri dhe të thotë e keni një ministri përkatëse, e cila ndoshta është Ministria e Kthimit. Ata i kanë problemet e veta.

Dhe, unë besoj që secila ministri duhet të ketë obligime ndaj të gjitha komuniteteve dhe ne jemi për atë që t'i ngremë shqetësimet e tyre, por e njëjta ne kur shkojmë atje, edhe nuk kemi të drejtë, nuk kemi të drejtë ministrit të Kthimit për Komunitete t'i kërkojmë asgjë, se këtu thotë vetëm thotë për familjet e kthyer. Prej viteve të kaluara, edhe më herët, vazhdimisht thotë ndahen 3 milionë, 5, 10, 11 milionë për familjet e kthyer, e nuk kemi familje të kthyer, nuk kemi nevojë për komunitetin tim, nuk kemi nga të kthehemi. Ne e dimë që lufta ka përfunduar moti dhe gjithë komunitetin tim ashkali e kam në Kosovë, nuk e kam jashtë Kosovës. Është një numër i madh, mbi 100 mijë, është në Diasporë, në Gjermani, në vendet evropiane, por nuk jemi në kampe që të mendohet vetëm për këto komunitete. Dhe, kur ne shkojmë s'kemi të drejtë, sepse kjo kategori nuk ndahet për këto komunitete, nuk ndahet kjo shumë, e cila vazhdimisht përsëritet.

Dhe, ne e kuptojmë ministrin, që në fund të fundit nuk e ka obligim, se thotë kjo është kolonë e cila duhet për familjet e kthyer. I nderuar ministër, unë mendoj se duhet të zbatohet kodi, të cilin e kemi kërkuar këtu për komunitete, është votuar kodi i veçantë për secilin komunitet, dhe ne kërkojmë që për çdo vit së paku 2 milionë euro të ndahen për ndërtim për rastet sociale. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Liburn Aliu e ka fjalën. Fatmire Kollçaku replikë, a?

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Është një sqarim për deputetin, ne e dimë që është koha kur kemi raste të shtuara të fruthit, një sëmundje që moti nuk janë regjistruar raste në Kosovë dhe rasti i parë ka qenë rast i importuar.

Në komisionin që e kemi mbajtur kur ka qenë i pranishëm ministri, e kam ngrehur këtë çështje si punëtore e preventivës. Kjo është çështje shumë me rëndësi dhe ju e dini që vaksinimi është falas. Por, megjithatë, kemi shumë qytetarë të varfër dhe në disa raste edhe të painformuar rreth vaksinimit, po ashtu ka qenë dhe stigma e kohëve të fundit që fëmijët të mos vaksinohen për shkak të dezinformimeve të ndryshme. E kam ngrehur këtë çështje, duke kërkuar që me një vëmendje shumë të shtuar të përcillet situata me fruthin.



Ne nuk e kemi situatën alarmante, fatkeqësisht ka pasur raste të vdekjes, sepse fëmija ka qenë edhe me komplikim tjetër, mirëpo ka të drejtë që duhet të shtohet vëmendja, duke ndihmuar që të gjithë fëmijët të përfshihen në vaksinim, por megjithatë shërbimi i vaksinimit ndoshta është njëra ndër hallkat më të ndritshme në sektorin e shëndetësisë, por kërkohet mbështetja edhe për repartet infektive, sepse janë dhënë kërkesa për dhoma me presion negativ, që nuk i kemi askund, përveç në QKU, për pajisje shtesë, për ndihmesë edhe reparteve infektive, edhe shërbimeve të vaksinimit, sidomos me vetura, sepse ata vuajnë në mungesë të veturave, ndërsa e dimë që Qeveria vetura ka shtesë që i përdor për shumë destinacione, por jo për ato që janë të nevojshme.

Kjo është vetëm sa për sqarim.

KRYESUESI: Faleminderit që e zëvendësove ministrin për ta sqaruar këtë çështje... Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Së pari, mos m'i merr minutat të lutem, së pari desha të them se çështja e morbileve, pra e fruthit, nuk është çështje e një nacionaliteti dhe ajo i ka atakuar të gjithë, ndoshta më së shumti fëmijët ashkali dhe komunitetin rom, por është e përhapur në tërë Kosovën.

Nuk është e vërtetë gjithashtu që ne deputetët, qoftë komisionit ose jo, nuk jemi interesuar dhe nuk i kemi vizituar këta. Pikërisht jam unë ajo që i kam vizituar dhe e di që ka pasur edhe nga komuna e Ferizajt, nga fshati Greme, ose nga disa fshatra në teritore tjera. Prandaj, të mos japim dezinformata se kjo është vetëm një nacionaliteti.

E dyta, po e shfrytëzoj rastin dhe minutën që të reagoj në lidhje me gratë e dhunuara. Këtu u dhanë shumë dezinformata për përfitime. Dihet saktë, e kam një numër të konsiderueshëm ministër për 1 mijë gra dhe histori të grave të dhunuara, të cilat në çdo moment verifikohen. Prandaj, ky numër është i saktë, e jo parullat politike dhe të paargumentuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti i paraqitur më parë, Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Në lidhje me këtë rishikim të Buxhetit, unë po pajtohem me deklarinimin që e pati pak më herët deputeti Memli Krasniqi në lidhje me traumën.

Është çuditërisht, por unë po pajtohem. Vërtet PDK-ja në përgjithësi dhe qeverisja e PDK-së ka qenë një traumë dhe jeni të traumatizuar dhe janë qytetarët e traumatizuar. Kanë qenë vite të tëra të qeverisjes, e cila ka qenë traumatike dhe vazhdon të jetë e tillë, por tanimë është drejt fundit. Kjo traumë do të jetë një traumë që do të kalojnë gjenerata të tëra edhe nuk ka për t'u

rehabilituar shumë lehtë. Dhe, edhe ky projekt, edhe ky rishikim i Buxhetit, edhe Buxheti në vetvete, edhe ky vetë është traumë. Pra, mënyra se qysh ne sot, çka kemi para nesh në Buxhet, është traumë në vetvete. Edhe ky Buxhet do të kërkojë rehabilitim prej traumave që do të vijnë si pasojë e këtij Buxheti.

Pra, të mos harrojmë që ky Buxhet është i orientuar kryesisht kah profiti i disa kompanive. Buxheti shkon kryesisht në ndërtime, shkon në ndërtime të autostradave prej të cilave Kosovës nuk i kthehet asnjë para. Ju e dini shumë mirë që me mënyrën sesi sot ndërtohen autostradat, kush përfiton nga ato dhe sa përfitojnë qytetarët e Kosovës, pra një numër simbolik i vogël i punëtorëve, të cilëve u kthehet jashtëzakonisht pak nëpërmes rrogave dhe punësimit që aty e kanë, duke qenë edhe vetë të diskriminuar brenda punimeve në atë autostradë në raport me punëtorët e komuniteteve tjera, apo kombeve tjera që vijnë nga jashtë, të diskriminuar në rroga, të diskriminuar në trajtim dhe me një shumë tejet simbolike, që i bie më pak se 1% e parave që futen në autostrada, e që kthehen te qytetarët të cilët punësohen aty dhe një ndër argumentet kryesore të puna e autostradave, të mos harrojmë, ka qenë ka qenë pikërisht punësimi.

Po ashtu, desha të përmend një gjë që mënyra sesi projektohet, është mënyrë totalisht jashtë planeve që i ka vetë plani hapësinor i Kosovës. Të mos harrojmë që krejt ndërtimet, investimet kapitale nga Qeveria, kanë qenë ndërtime pa leje. Ndërtuesi më i madh pa leje në Kosovë nuk janë qytetarët, është Qeveria. Të mos harrojmë që Aeroporti është ndërtuar pa leje, është ndërtuar autostrada pa leje, po ndërtohen sot autostradat pa leje, e Inspektorati nuk shkon t'i ndalë. Të mos harrojmë që autostrada e Shkupit e e ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë planin e Prishtinës, sepse kur është vendosur që ajo autostradë të jetë aty nuk është konsultuar asnjëherë as Komuna e Prishtinës, e as Ministria madje, Ministria e Planifikimit, e cila i ka aprovuar ato plane dhe sot ne duhet që komplet planifikimin e Prishtinës ta rishikojmë e ta rindërtojmë, duke ua përshtatur tash autostradave, të cilat janë bërë totalisht krye më vete dhe me kosto e pa leje fare.

Edhe zgjerimet e rrugëve që po bëhen, janë po ashtu zgjerime për fushata, pa e pasur parasysh fare se çfarë ndodh aty në atë vend. A e dimë ne që në Prishtinë sot duhet të ndërtohet një ndër prioritetet kryesore të qytetit të Prishtinës është të lidhet Lagjja e Spitalit me Lagjen e Kalabrisë. Ajo rrugë do të kalojë pikërisht me këtë zgjerim sot, i cili nuk e ka marrë fare parasysh atë rrugë, që do të ndërtohet. Qysh duam tash ne ta ndërtojmë rrugën që i lidh Lagjen e Spitalit dhe Lagjen e Kalabrisë? A duhet tash ta prishim këtë ndërtim që është kah bëhet, a qysh...? Çka janë ato mure që po hidhen aty dhe nuk merret parasysh fare plani? A është konsultuar ndonjëherë dikush në Komunën e Prishtinës? A është marrë një leje diku për atë ndërtim?

Pra, kjo mënyrë e punës dhe e shpenzimit të parasë dhe të Buxhetit është traumatike. Pra, unë pajtohem me Memli Krasniqin, jo traumatike, po për këto trauma do të kalojnë gjenerata të tëra derisa të shërohem. Pse ka ndodhur kjo kështu? Sepse, këtu njerëzit konsiderojnë që populli,

qytetarët, u kanë borxh këtyre njerëzve. Ky është gabim! Nuk u ka borxh kurrkush? Nuk u ka aspak kurrkush borxh për ta trajtuar Buxhetin e qytetarëve kësisoj.

Prandaj, kjo mënyrë e trajtimit, kjo logjikë, kjo mendësi, po shkon drejt fundit të vet. Po shkon drejt fundit të vet dhe së shpejti do të kemi edhe ndryshime të mëdha në këtë vend, kur Buxheti do të trajtohet asisoj që do të shkojë në dobi të qytetarëve dhe kjo ditë nuk do të jetë shumë larg.

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj që kur ta miratojmë Buxhetin do të kemi edhe projekte, të cilat duhet t'i miratojmë bashkë. Fjalën nga LDK-ja, e ka Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Dua të vazhdoj për një pjesë, e cila ndoshta edhe nuk i zë këta dy muaj të rishikimit, por duhet të shikohet kujdesshëm për pjesën e Buxhetit më 2018.

Ta them të drejtën, u përmendën shumë herë punët e pakryera, të lëna përgjysmë, por nuk ishte as vullnet i kryeministrit Mustafa, as i ministrave që u përmendën këtu, as zotit Abrashi e zotit Rrahmani e të tjerë, për punët të cilat nuk janë kryer. Për këtë çështje mendoj se nuk duhet as më shumë se “tru peshku” për ta përkujtuar se rrugën apo kohën e kësaj qeverisje e ndërpreu një mocion i ngrehur nga njerëz që këtu më së shumti bëjnë zhurmë. Po të ishte vazhduar me punë, zgjedhjet do të ishin më 2018 dhe punët sot do të ishin krejt ndryshe.

Sidoqoftë, unë po fokusohem në çështjet të cilat në vazhdimësi janë preokupim imi. Duke qenë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, sikur në mandatin e kaluar edhe tani, kam shprehur nevojën dhe shqetësimin tim për implementimin e Ligjit për paraplegjikë dhe tetraplegjikë, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2016, por në disa nene të caktuara për shkak të implikimeve financiare ka mbetur që më 2017 të fillojë së aplikuari, kryesisht në pjesën e rishikimit.

Unë dua ta pyes ministrin, i cili ende është këtu, se a do të mendohet që edhe në rishikim, ngase do të jenë obligimet edhe për formën retroaktive të pagesës, që të fillohet me këtë kategori, e cila e meriton kujdesin dhe ndoshta janë kategori që më së tepërmi e duan, apo kanë nevojë për dorën e shteti dhe, së paku, në vijim, mqqë tani jemi në përpilim të Buxhetit 2018.

Po ashtu, ndër interesimet e mia ka qenë edhe implementimi nga plotësim-ndryshimi i Ligjit për veteranë për kategoritë apo personat nga dhuna seksuale e përjetuar në luftë, por meqë u konsumua shumë ajo, po më vjen mirë që është interesim i të gjithëve për të vepruar në këtë drejtim. Por, para së gjithash, është një obligim ligjor ndaj kësaj kategorie, të cilën nuk bën ta shtyjme tutje. Sikur ishte krejt e panevojshme që të hiqet edhe çështja e sigurimeve shëndetësore, si një gjë e cila thelbësisht ka të bëjë me respektimin e të drejtave të njeriut.

Meqë këtu kaloi mjaft kohë duke u përmendur edhe Gjilani si Gjilan, edhe me projektin e autostradës, dua ta them edhe një çështje. Po ashtu, shihet gabim tendenca për t'u kthyer në zero. Në zero nuk mund të kthehemi, se i kemi nxjerrë punë vetes edhe me OSHP-në, por kjo çështje sigurisht do të vazhdojë me procedurën, e cila ligjërisht duhet të ndiqet, por dua të them se është bërë një padrejtësi për qytetarët e Gjilanit.

U përmend si fort emri i kryetarit Lutfi Haziri. Të them të drejtën, ai nuk është se është përzier këtu t'u bëjë të fala atyre që ia përmendën emrin, por qytetarët gjilanas u bëjnë të fala se ata nuk merren me ato që ju u morët gjatë fushatës, për fat të keq edhe me frizurën e Lutfi Hazirit. Ata votojnë për projekte të mira. Prandaj, po më vjen mirë që keni avancuar, e tani po merreni me projektin e Gjilanit, e jo me dukjen e tij, ngase qytetarët e Gjilanit i vlerësojnë pikërisht çështjet e projekteve dhe besoj se në vazhdim ata do të votojnë për t'u vazhduar edhe më tutje këto projekte.

Uroj që krejt këto që janë obligim yni të shikohen me respekt, se fundja është edhe detyrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit nënkryetar, zoti Xhavit Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë dhe kolege deputete,

Zoti ministër dhe ju të pranishëm,

Realisht nuk e pata ndërmend të flas, jo se nuk kemi çka të flasim sot, por duke qenë e vetëdijshme se proceduralisht duhet ta shqyrtojmë rishikimin e Buxhetit, ky debat mendoj se s'ka asnjë efekt tjetër, përveçse fushatë.

Në të njëjtën kohë e mora fjalën e intriguar më shumë nga paraqitja e disa deputetëve, sidomos e një deputeti, i ardhur nga shoqëria civile, që veten e ka vendosur në tregun e partive politike, duke u hamendur se në cilin kamp mund të bëhet figurë. Deputeti i ri, fillestar, amator, i ardhur në një parti politike, siç e thashë nga shoqëria civile, sot doli disa herë në foltore dhe çka tha? Asgjë nga ajo që është pritur, sidomos nga emri i tij dhe nga një komision i rëndësishëm, të cilin e udhëheq, siç është Komisioni i Buxhetit dhe Financave.

Po besoj shumë që është ndjerë sot i zhgënjyer edhe profesori i nderuar Muhamet Mustafa, i cili i ka ndihmuar shumë këtij deputeti që të pozicionohet dhe t'i ndërpresë hamendjet për t'iu bashkuar LDK-së si ekspert i fushës së ekonomisë.

Kërkoj falje nga deputeti, nuk kam asgjë personale me të, vetëm se si fenomen nuk është e pëlqyeshme dhe personalisht kam pritur se do të jetë në valët e emrit të tij, që e kanë pritur edhe të tjerët.

Të nderuar deputetë,

Ta marrësh fuqinë politike nëpërmjet shpifjeve është e barabartë me fuqinë e zjarrit të bërë me kashtë, përveçse është edhe ligësi. Qytetarët e Kosovës janë lodhur më me zhargonin “kriminel”, “i korruptuar”, “hajna”, e tjera, e tjera... Këtu madje pati edhe disa etiketime të tjera në drejtim të ministrit të nderuar, zotit Bedri Hamza, i cili e ka një “background” profesional dhe të punës së tij të përkushtuar, edhe si guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, edhe si ish-ministër i Financave, e që vazhdimisht në kohën kur ka menaxhuar ka pasur rritje ekonomike, ka pasur rritje rrogash, është vlerësuar nga mekanizma seriozë, edhe ndërkombëtarë. Nëse ju jeni të verbuar, e nuk e shihni këtë realitet, por e shihni Bedri Hamzën si kontabilist, sot më vjen keq! I nderuar deputet, ke dalë një valltar i dobët i politikës ditore. Nuk bëhesh figurë, as ti e askush tjetër, me shpifje, vetëm shpifës.

Deputetët s’janë këtu, nuk kemi ardhur këtu për t’i psikologjisur kolegët tanë se çka je ti, e çka jam unë. Këtu nuk jemi as hetues, e as psikologë. Jemi deputetë me besimin e qytetarëve, prandaj duhet t’i dimë fort mirë detyrat tona të punës. Kisha kërkuar për t’i rishikuar fjalimet e tij, sepse LDK ka qenë në qeverisje deri tash dhe siç e përmendi edhe ish-ministri i Financave, tani shef i grupit parlamentar, se ky është një Buxhet i përgatitur më parë dhe si i tillë i rishikuar. Është mirë të koordinohesh shpesh me shefin e grupit.

Tani zoti Hamza, në këtë rishikim nuk janë cenuar projektet kapitale, por kjo nuk është e mjaftueshme. Ne si deputetë, përveçse duhet të kujdesemi nëse është cenuar ndonjë projekt kapital dhe të ndërpritet finalizimi i tij, ne duhet të kujdesemi se sa po zbatohen ato projekte, cili është afati kohor i tyre. Unë po e përmend vetëm një projekt të rëndësishëm, projekti i rrugës Skenderaj - Komoran, që sa vjet është miratuar në letër, por nuk është bërë asnjë hap në qeverisjen e kaluar. Uroj që edhe ky projekt, por edhe të tjerët anekënd Kosovës, të finalizohen, sepse qytetarët e Kosovës më shumë punë presin nga ne sesa fjalë.

Edhe diçka tjetër më lejoni, për fat të keq, Partia Demokratike dhe lideri i saj disave u është bërë fiksion. Uroj të shëroheni nga fiksionet! Është e kuptueshme se disa e kanë edhe detyrë që ta tundin flamurin e shpifjeve. Të tillët e vuajnë edhe deficitin kombëtar, njerëzor e çka jo tjetër, por i nderuari dhe shumë i respektuari, zoti Liburn Aliu, për të cilin kam respekt jashtëzakonisht, për familjen e tij dhe atë personalisht, nuk dëshiroj të jetë në mesin e të tillëve. Kam pritur që ky bashkë me ne ta kërkojë së pari një projektligj për lustracionin, të kërkojmë me radhë t’u shkojmë krimeve të bëra nga BIA, nga UDB-ja, dhe të interesohemi më tutje edhe për të tjerat. Pse jo?

I nderuar deputet, ti e di shumë mirë që “qeni i keq ta sjellë ujkun në torishtë”, prandaj kisha dëshiruar që figura jote, e ndërtuar familjarisht me përkushtim, të mos bjerë në kurthet e politikave ditore. Prita që do të reagosh ndaj fjalimit të një koleges sonë, që tha “është një mik, për të mos thënë një thes me gjithçka partia juaj, ka LKJ-ista, LDK-ista, LPK-ista, PDK-ista...”.

Asnjë reagim nga ana juaj! Andaj, nuk duhet të tejkalohet, të anashkalohet e kaluara e lavdishme historike për përfitime të vogla. Ne jemi këtu të punojmë bashkë, t'i bashkojmë të gjitha ato forca dhe, krejt në fund, personalisht, mua aspak nuk më bën përshtypje se në cilën parti është personi. Së pari i kërkoj vlerat individuale të atij personi, edhe pse jam shumë e bindur se Partia Demokratike e Kosovës është shpresa për qytetarët e Kosovës. Por, sidoqoftë edhe Partisë Demokratike i duhen edhe figurat e mira edhe njerëzit e mirë që të bashkëpunojnë për të mirën e këtij vendi dhe për të mirën e qytetarëve.

Sa i përket rishikimit të Buxhetit, kemi kohë dhe unë vërejtjet dhe sugjerimet e mia do t'i dërgoj në komisionin përkatës, ndonjë amendament në qoftë se do të merret parasysht nga anëtarët e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Berisha! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Sot ne dëgjuam vetëm një pjesë të të bërave dhe të pabërave të përfaqësuesve të subjekteve që kanë qeverisur me Kosovën tani e 18 vjet dhe e kanë sjellë këtë gjendje të mjerueshme në vend, në të gjitha fushat e jetës.

Me gjasë, e vërteta është diku brenda këtyre dy palëve, sepse ata duhet ta dinë më së miri për njëri-tjetrin, edhe për të gjitha ato që i kanë bërë, edhe për akuzat reciproke, sepse kanë qenë bashkë në punë të mira, e jo të mira. Por ato që thonë për njëri-tjetrin, në mënyrë kumulative e përbëjnë të vërtetën e tmerrshme për mjerimin ku gjendet sot Kosova. Fatkeqësi është sërish, edhe një herë më shumë, se nga këto të bëra dhe të pabëra u lëkundën sot eshtrat e dëshmorëve të luftës, u rihapën plagët e invalidëve, u rizgjuan dhembjet shpirtërore të luftëtarëve të lirisë, u shprush dhembja e grave të dhunuara nga soldateska serbe, për shkaqe politike dhe për shkaqe të mashtruesve kriminelë.

Një është e sigurt, se shumë gjenerata do të vuajnë edhe shumë dekada nga traumat e shkaktuara me shkatërrimin politik, ekonomik e shoqëror, të shkaktuar nga këto parti, privatizimi kriminal, decentralizimi etnik, "Zajednica" serbe, dhënia e tokave të Kosovës në emër të demarkacionit, marrëveshjet me Serbinë në dëm të Kosovës e kështu me radhë, e kështu me radhë...

Po ne jse, tash po kalojmë te Buxheti i rishikuar. Ky Buxhet i rishikuar, i ofruar edhe nga Programi qeveritar është goxha në shpërputhje në bazë të zërave buxhetorë që i kemi në këtë dokument. Për shembull, në Programin qeveritar thuhet se promovimi i investimeve të huaja direkte dhe rritja e rolit të Diasporës në zhvillimin ekonomik është një prioritet i lartë i Qeverisë. Unë e shikoj zërin buxhetor, asnjë lëvizje për tre vjetët e ardhshme! Natyrisht, unë e marr me

mend se nuk mund të kërkohet angazhimi i mërgatës dhe mjeteve të saj për investime dhe zhvillim ekonomik të Kosovës vetëm duke i zhvatur ata financiarisht, prej momentit kur hyjnë në kufi e deri në momentin kur dalin. Mërgata jonë nuk ka nevojë për lëmoshën dhe privilegjet, bile as për grante qeveritare. Ajo ka nevojë për shtetin e së drejtës së mirëfilltë, për sigurimin shëndetësor, të cilin nuk e synon ky Program qeveritar, ka nevojë për siguri të përgjithshme ekonomike, ligjore, fizike, për siguri të kapitalit, të cilat po ashtu nuk i synon ky Program qeveritar, sepse ky program ende nuk ka filluar ta sqarojë si të përmirësohet klima për investime të Diasporës. Ky është problemi.

Në lidhje të drejtpërdrejtë me këtë çështje, domethënë është sundimi i ligjit. Se cilat janë synimet programore të kësaj Qeverie dëshmon se ky Buxhet i rishikuar për vitin 2017 dhe për tre vjetët e ardhshme, qëllim kryesor e ka vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve në përgjithësi në fushën e sundimit të ligjit, pa asnjë operacionalizim, pa asnjë konkretizim. Ky është një problem. Mirëpo, për t'i vërtetuar këto, veç shihni zërat buxhetorë për Këshillin Prokurorial për tre vjetët e ardhshme dhe për këtë vit, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe e shihni se ngritjet janë minimale dhe nuk ka kurrjë në këtë drejtim, si mendohet të forcohet sistemi i drejtësisë në këtë vend që vuan prej pasluftës e këndej.

Fushata politike për autostradën e Gjilanit mori fund. Unë jam njëri prej kandidatëve, po ma morën krejt e nuk më lanë kurrjë për të folur. Shumë keq! Sot u diskutua aq shumë dhe doli në shesh qartazi se ajo ka qenë një gënjeshtër e kulluar politike, zgjedhore e Qeverisë së kaluar dhe e udhëheqjes komunale në Gjilan, e kjo fatkeqësisht do të vazhdojë. Por, megjithatë, kurrë nuk u tha se është ndarë Buxheti për autostradën e Gjilanit, po apo jo? Çfarë e kemi, ku e kemi gjendjen? Po ashtu, po përmend edhe dy fakte tjera. Fatkeqësia është se sot askush nuk u mor me akuzën e deputetit Berisha nga komuniteti ashkali apo rom, për shantazh, presion, blerje votash nga personat e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali e egjiptian në disa komuna. Po ashtu, askush nuk desh të shpenzojë më shumë fjalë për vdekjen e fëmijës nga fruthi, një sëmundje që është e shërueshme sot në botë.

Edhe këto janë dëshmi për sistemin e krijuar, edhe të drejtësisë, edhe të shëndetësisë kosovare. Në këto 18 vjetët e fundit këta janë shembujt krejt konkretë, çfarë bëhet në këtë vend që 18 vjet e tani as s'kemi shëndetësi, as s'kemi drejtësi, vendin e fundit në sistemin e PISA-s dhe në çdo lëmi ekonomike, politike e shoqërore. Kjo është fatkeqësia. Ne e dëgjuam vetëm një pjesë të asaj, sigurisht akuzat reciproke ndërmjet partive që kanë qenë në pushtet do të nxjerrin gjëra të tjera në shesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!  
Ministra të nderuar,

Kolegë të nderuar,

Nuk e pata mendjen të flas, por m'u desh të dal për t'i sqaruar ca punë më mirë.

Do të filloj prej autostradës së Gjilanit, atë që e përmendi kolegu Kurteshi në fund. Tash jemi duke u shtyrë po më duket se kush e ka nisur, e kush s'e ka nisur... Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm, nëse shtyhem për parti, LDK-ja e ka nisur. Nëse shtyhem për Qeveri, Qeveria e kaluar. Kështu që LDK-ja e ka nisur autostradën e Gjilanit. A është Buxheti i ndarë? Po! Tabela 3.2, faqe 33, e shihni a është Buxheti i ndarë. Kështu që Buxheti është i ndarë, krejt është në rregull, krejt janë kryer. Ne e kemi nisur.

Vitin e kaluar është bërë projekti, sivjet në fillim të prillit është themeluar Komisioni Ndërmintor për autostradën e Gjilanit, e ka mbajtur mbledhjen e vet të parë dhe e ka shpallur tenderin, ka marrë vendim për ta shpallur tenderin. Fatkeqësisht, në atë mbledhje s'kanë ardhur dy kolegë të mi, që ia kanë humbur atë të drejtën PDK-së për të folur shumë për autostradë, se s'kanë ardhur në momentin kur është dashur veç të marrin vendim për ta shpallur tenderin. Por, megjithatë, ai është projekt i Qeverisë së kaluar, është gjithçka në rregull.

E dyta, prapë për autostradën e Gjilanit nuk do të flisnin kaq shumë, Bilalli, shoku im, s'di ku shkoi, e përmendi, tha "Lutfi Haziri e ka krijuar një armik" dhe prapë dha "e munda atë armik". Nuk e ka krijuar Luta, në realitet kryeministri dhe ministri aktual i Infrastrukturës, edhe ministri i Financave, lanë dilema në deklaratat e tyre, së paku ajo nëpër portale, se a do të ndërtohet apo s'do të ndërtohet, kur gjithçka ka qenë në rregull. Unë këtu publikisht po e lus ministrin, nëse një procedurë nuk është në rregull, le ta ndërpresë. Publikisht po i them, nëse një gabim e ka bërë Lutfi Zharku, le ta ndërpresë, hiç pa kurrfarë problemi. Jemi në gjendje të përballemi me ligjin për çdo gjë. Për çdo gjë që ka probleme me autostradë. Komisioni Ndërmintor në fund të prillit ka marrë vendimin për ta shpallur tenderin, Ministria e Infrastrukturës e ka shpallur tenderin, çështjet tjera janë çështje të të gjitha procedurave dhe Ligjit të prokurimit publik. Nuk është çështje as e imja, por natyrisht as e ministrit aktual, që ta shohë a është bërë a nuk është bërë vlerësimi mirë; kur ka shkuar, a qysh ka shkuar, por nëse ministri dyshon që ka shkelje, natyrisht të gjitha organet janë të hapura për t'i vërtetuar ato shkelje.

Për Mitrovicën, nuk desha... është sqaruar shumë herë. Bekim, nuk desha ta përmend, në fund të vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014 kur janë nënshkruar tri marrëveshje, ekziston neni në marrëveshje që është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Nuk e mohoj që ka mundur të ketë dobësi subjektive, krejt jemi njerëz, por esenca e vonësive është te jokooperimi, jokoordinimi i tre partnerëve që i kanë kontratat, është Banka Islamike, Fondi Saudit dhe Fondi i OPEK-ut për Zhvillim. Ata nga shtatë muaj kurrë nuk janë paraqitur në e-mail-at tonë. A mund ta merrni me mend që ata na kanë thënë se e-maili nuk është dokument zyrtar, por duhet blerë telefaks për të na i dërguar shkresat me të. Domethënë, është ky nivel i bashkëpunimit me ta. Fatmirësisht, krejt janë kryer, janë shpallur tenderët, i kemi kryer krejt,



prandaj unë uroj që ministri aktual të fillojë sa më shpejt. Natyrisht, ishalla edhe i nis punët, të gjithë pajtohemi.

Safetja, ku mbeti, e përmendi që ka pasur shumë projekte të vogla, me shuma të vogla, të keqplanifikuara. Plotësisht po pajtohem, janë 300 projekte. Por, nuk ka kryetar komune që ka ardhur në zyrën time e që ka dalë pa kryer punë. Ato janë kërkesat e kryetarëve të komunave. Rasimi, ja ku është, nuk ka kryetar komune që ka ardhur në zyrën time me kërkesë për rrugë, e që s'i kemi përfshirë ato kërkesa. Njëzetedy udhëzime, njëzetedy memorandume mirëkuptimi i kemi nënshkruar, me të cilat i kemi bartur procedurat e tenderimit te komunat. Ministria e Infrastrukturës nuk është marrë me tenderë, ua kemi bartur të gjitha komunave. Nëse ato kanë dështuar, kanë dështuar kolegët e mi, kanë dështuar kolegët tuaj. Por, unë jam i bindur që puna ime e mirë ka bërë që Gazi të fitojë pa balotazh, ka bërë që Sokoli të fitojë pa balotazh, ka bërë që Ymriu pa balotazh, natyrisht edhe Ramizi pa balotazh, edhe pasuesi i Rasimit pa balotazh. Krejt prej punës sime të mirë, që e kemi bërë në ministri. Sikur, natyrisht që Agim Veliu është 49%, sikur që Lutfi Haziri ka 33%, të mos hyj t'i përmend krejt kandidatët e tjerë. Por nuk ka, edhe Agimi, mirë hajde. Po, nuk ka kryetar komune që nuk i ka përfshirë, nuk ia kemi përfshirë të gjitha projektet një nga një, sipas kërkesës së tyre.

E fundit, prapë po e shoh, po çuditëm Salihu dhe Fatoni po pyesin për kyçje në Ferizaj edhe në Viti.

Dokumenti është publik, Komisioni Ndërmintor ka marrë vendim për t'i bërë dy kyçje. Unë po çuditëm pse po pyetni a ka kyçje? Ju kërkoni prej Qeverisë ta zbatojë vendimin. Unë nuk di për çka pyetet a ka kyçje, kur vendimi është publik, është në web faqe. Vendimi është i protokolluar, e keni pasur nëpër media. Unë nuk po di pse, në vend që t'i thoni ministrit a bën të zbatohet ai vendim, ju po thoni a ka a nuk ka kyçje? Unë nuk po mund t'ju kuptoj, për ata që nuk po mund të na kuptoni, të dytë keni hupur çështjen, se nuk po e shihni punën e mirë që po e bëjmë. Faleminderit, nënkryetar! Më vjen keq për këto punë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lekaj e ka fjalën.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet dhe ish-ministër!

Është e vërtetë që unë në Ministrinë e Infrastrukturës jam munduar të gjej diçka që të dal publikisht dhe të të falënderoj, seriozisht.

Ajo që unë mund të them, është e vërtetë që keni nënshkruar memorandume të mirëkuptimit, por është edhe e vërteta tjetër që kur kam hyrë t'i analizoj me mbështetje financiare, të jeni të bindur, janë diku nja 250 milionë të nënshkruara, por që në Buxhet nuk kanë qenë as 10%. Kjo që mund të them, më 2 gusht është marrë një vendim nga ish-kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës që të ngrihen të gjitha fondet, Buxheti dhe 45 milionë kanë qenë në Thesar të ngrira dhe

asnjë projekt nuk ka mundësuar të zhvillohet. Është e vërtetë, unë e thashë, për gjithçka që ke bërë mirë do të të falënderoj dhe do të jetë në kontinuitet, por një pyetje ministër.

A ka mundësi të tregosh pse në orën 23:00 është nënshkruar kontrata, shtatë operatorët që janë përzgjedhur, ma thuaj këtë, një ditë përpara se të vijmë ne, çka jeni ngutur? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zharku ka kundër-replikë.

LUTFI ZHARKU: Nënkryetar, faleminderit!

Po krejt më kanë përmendur, unë s'kam çka të bëj.

Ministër, çdo memorandum i mirëkuptimit absolut është nënshkruar në përputhje me Buxhetin e ndarë për vitin 2017 dhe projeksionet buxhetore për 2018-2019. Asnjë cent nuk ka në asnjë memorandum mirëkuptimi që është nënshkruar jashtë asaj që është në ligj të Buxhetit, asnjë cent. Memorandumet janë nënshkruar gjatë marsit e prillit.

Për këtë tjetrën që pyetët, po më duket që duhet t'i pyesësh ata, se unë nuk kam qenë aty. Kështu që një muaj përpara e kam lënë, plus është çështje e procedurave, as imja, e as juaja.

KRYESUESI: Salih Salihu, Sami Kurteshi dhe Bilall Sherifi kanë replikë.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Unë tërë ditën prita mos po fol LDK-ja për kyçjen e Vitisë në Gërlicë, po më në fund, e pashë që ish-ministri doli.

Çështjen e kyçjes së Vitisë në Gërlicë e kemi ngritur që një vit dhe as kryeministri, as ministri nuk kanë qenë në gjendje të japin përgjigje për këtë. Tash punimet janë kryer, ne i kemi bërë disa incizime në terren dhe Viti tani për tani nuk ka kyçje.

Është fakt që këta e kishin bërë një vendim, vendim i nënshkruar në prag të zgjedhjeve parlamentare, nga frika se po dënohen zgjedhjet parlamentare, dhe u dënuan.

Çka ka ndodhur me atë vendim? Janë pesë vetë, gjoja se kanë qenë prezentë, i kanë vetëm dy nënshkrime në vendim. Le ta tregojë vendimin, sa vetë e kanë nënshkruar atë vendim dhe, në qoftë se është bërë ai vendim, pse nuk po ekzekutohet puna? Këta kanë pasur mundësi ta ekzekutojnë, punët kanë kaluar. Tash e kemi ministrin, pyetni ministrinë a është parashikuar në Buxhet, a do të rishikohet tash Buxheti për t'u bërë kyçja në Gërlicë.

E keni anashkaluar, në Viti janë 60 mijë banorë, është një komunë në vete, nuk është një fshat. Në shtete të tjera vetëm për një fshat të madh bëhet dalja dhe hyrja në autostradë, këtu e keni lënë një komunë të tërë pa kyçje në autostradë. Janë diku 8 mijë automjete të lehta e të rënda, të

regjistruara në Viti që paguajnë tatim, janë edhe qytetarët që paguajnë tatim dhe ju, komplet LDK-ja, e keni anashkaluar Vitinë.

Zgjedhjet në Viti normal që mund t'i fitoni, sepse keni para, me këtë ministri i keni bërë paratë dhe i keni fituar normalisht. Falë parave dhe keqpërdorimeve që keni bërë, si dhe mashtrime të qytetarëve, normalisht që i fitoni.

Mirëpo, ju Vitinë e keni lënë anash, Vitia nuk ka sistem të ujitjes, Vitia nuk ka kycje në Gërlicë, Vitia s'ka dalje nga Maqedonia, Vitisë ia keni ndarë Kllokotin, Vitinë në një farë mënyre e keni neglizhuar, e keni lënë anash, nuk ka zhvillim ekonomik.

Sot të mos jenë mërgimtarët tanë të na dërgojnë para në Viti të funksionojë sektori i ndërtimit dhe sektori i konsumit, sot Vitia kapitullon komplet nëse mbetet në mbështetjen tuaj.

Pra, këtë kisha për ta thënë, zoti kryesues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ish-ministrit Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Unë, nënkryetar, prapë të njëjtën përgjigje e kam, Vitia nuk ka balotazh.

KRYESUESI: Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Unë e kërkoj dhe ti s'e jep fjalën, çka do të thotë kjo.

KRYESUESI: Fol, pra!

SAMI KURTESHI: Unë nuk e kam ndërmend të flas shumë, veç po dua ta di: Kush është duke rrejtur? Nuk është e mundur në bazë të njëjtë ligj të thirren të dyja palët, të bëhet një punë për të njëjtën çështje, askush askënd të mos e çojë në përgjegjësi, a krejt të kenë të drejtë, e autostradë nuk ka. Kjo është çështja. Kush, jo more për Gjilan nuk ka autostradë. Kush po rren, autostradë nuk ka, nuk ka autostradë, autostrada nuk ekziston, ju po e shihni, një çështje.

E dyta, Buxhet nuk ka, po kërkoj prej dy partive të sqaroni qysh është gjendja, veç këtë desha të kërkoj, jo të replikoj me ta.

KRYESUESI: Unë mendoj që partitë nuk kanë pse të sqarojnë asgjë, sqaron ministri, sqaron Qeveria, partitë bëjnë debat, votojnë ose nuk votojnë, se ne jemi shumë këtu nëpër parti. Po të më pyetni mua, unë nuk di të sqaroj asgjë, kështu që jo partitë. Ja ku është ministri, mund të sqarojë. Zoti ministër, e ke fjalën, ti je për të sqaruar bashkë me zotin Hamza këtu, këta të tjerët janë për të bërë pyetje.

MINISTRI PAL LEKAJ: Për korrektësi, sa u përket kyçjeve nuk ka vija buxhetore, por do t'i kemi në 2018-tën.

Sa i përket autostradës, prapë po e përsëris, do të ketë autostradë që do të fillojë në vitin 2018 dhe do të përfundojë më 2021.

Për procedura të tjera ligjore jemi këtu dhe ne japim llogari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi ka replikë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit!

Sami, merre me qetësi, mos u bëj shumë nervoz.

Thashë të jap edhe një mundësi për replikë, se ka shumë nevojë, njerëz, po kemi nevojë të flasim, ka zgjatur shumë.

Kur unë iu referova zotit Lutfi Haziri, i kisha parasysh të gjitha deklaratat që i kanë dhënë ministrat, zëvendëskryeministri e kryeministri, e të gjithë njerëzit përgjegjës për këtë çështje. Thoni që autostrada do të bëhet, është aty, është në projekt, do të punohet. Pra, unë iu referova asaj dhe e shihja veç Lutën që thoshte nuk është ashtu. Prandaj, thashë, iu ka dashur për fushatë, bile bash në debat me Samiun e ka bërë këtë strategji se 40 minuta ia mori atë natë debatit veç me autostradën. Prandaj, thashë që ai e krijoi në imagjinatë një armik të Gjilanit, i shpalli luftë, luftoi si kuçedër dhe e fitoi, kjo ishte. Doli të nesërmen, po tash tha është autostrada. Mirëpo, kjo tha falë reagimit tim. Tash a është a nuk është autostrada. Luta që tha nuk është, po duhet të bëhet, pastaj doli të nesërmen e tha, po qenka këtu, e kthyen këta sepse unë reagovala. Kjo ishte ajo, unë nuk pata asgjë personale. Tash po dua të di përnjëmend a është a nuk është, se tash u pësjtjell krejt këtu, kush di të tregojë është a nuk është autostrada? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zotërinj deputetë, a doni pauzë ju që po rrini në këmbë? Në qoftë se doni pauzë, marrim pauzë. Zoti Arifi. Zoti Arifi, nuk ke të drejtë të flasësh me deputetë prej atje. Zoti Arifi ose ulu, ose të nxjerr jashtë. Je për të dëgjuar, nuk je të flasësh me deputetë. Mos bëni hajgare, këtu e keni bërë sikur 'lamë pazari'.

Fjalën e ka Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Përsëndetje, të nderuar qytetarë,

Projektligjin për rishikimin unë e kam ndarë në disa pjesë mikrostrukture, pra në taksa, ndërmarrje korporata, TVSH, shpenzime kryesisht dhe në shpenzime kapitale dhe në fund, edhe në deficit.

Trendi i të hyrave në vazhdimësi është rritur, por ashtu edhe projeksioni është në rritje, gjë që është pozitive. Po ky trend i rritjes nuk është në proporcion me rritjen ekonomike, pra i bie që

barrën për rritjen e të hyrave e mbajnë taksapaguesit që bazuar nga kontaktet me bizneset, ata ankohen me të drejtë dhe pagesën e taksave e quajnë si ‘haraç’.

Sa u përket ndërmarrjeve dhe korporatave. Zëri i tatimit në të ardhurat e korporatave në bilanc prej 0,04% e të hyrave të përgjithshme është tregues jo i mirë.

Themi që është tregues jo i mirë, sepse i bie që fitimi i ndërmarrjeve është i vogël, pra ndërmarrjet në Kosovë, një, janë jorentabile apo kanë rentabilitet të vogël ose, dy, deklarimi i tatimit mbi korporatat është joreal.

Sa i përket TVSH-së, të hyra indirekte. Ashtu si zakonisht, por edhe projeksioni për vitet e ardhshme për zërin e TVSH-së, po ta analizosh del se raporti i të hyrave të TVSH-së brenda dhe në kufij është jo i favorshëm për ekonominë e Republikës.

Pra, vazhdon trendi i mbledhjes së TVSH-së në Doganë, e bile ky raport në vend se të zvogëlohet, vazhdon me rritje. Kjo tregon se komplet ekonomia jonë është e bazuar në import të mallrave, fatkeqësisht, ndërkohë që ju po proklamoni në ndihmën apo grantet për prodhim, e kjo ndihmë nuk po reflekton në rritjen e prodhimit vendor.

Shpenzimet. Zëri i mallrave dhe shërbimeve po ashtu vazhdon të ketë rritje. Natyrisht, shikuar në plan të parë, kjo edhe do të duhej të ishte në rregull deri diku, por ama, kur dihet që në këtë zë hyjnë edhe shpenzimet e luksit, i bie që luksin po e rrisin, ndërkohë ekonomia jonë po shkon drejt shkatërrimit.

Shpenzimet kapitale apo tenderomania. Nga të gjitha shpenzimet del që zëri i shpenzimeve kapitale përbën rreth 33% të shpenzimeve totale. Kjo tregon se punëdhënësi kryesor në vend është paraja publike, me fjalë të tjera, kjo sëmundje që ne po vuajmë si Republikë e si institucione, që e kemi quajtur me zë ironik, tenderomani.

Në fund, sipas bilancit del se projeksioni i Buxhetit për vitin 2018 është deficitar dhe deficiti buxhetor i projektuar është 225 milionë. Pyetja që shtroj është: nga do të mbulohet ky deficit?

Po ashtu dëshiroj të vazhdoj edhe disa qasje të kolegëve, të cilët i përmendën.

Për shembull, në Prizren ne e kemi komplet trashëgiminë kulturore dhe historike të shkatërruar dhe në legjislaturën e kaluar ka pasur deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të cilët kanë kërkuar që të ketë linjë buxhetore të dedikuar Komunës së Prizrenit. Në këtë linjë të shkatërrimit të trashëgimisë kulturore dhe historike, e cila është bartur edhe në asambljetë komunale, gjithmonë na është thënë që neve nuk na takon kjo përgjegjësi, me ç’ rast ka humbur jetën edhe një fëmijë i

vogël, dhe në Komunën e Prizrenit, e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës, na është thënë që këtë përgjegjësi e mban ministria përkatëse.

Prandaj, meqenëse nuk është ministri këtu, është mirë të tregojë a e ka kërkuar një projektion të tillë të Buxhetit që ta fusë në këtë rishikim të Buxhetit. Meqenëse është edhe drejtori përkatës, mund të na tregojë a e ka paraparë.

Ne kemi kërkuar atëherë fond 10-milionësh, pra e kam fjalën për legjislacionin e kaluar, për Qendrën historike të Prizrenit, e cila është duke u shkatërruar dhe po vazhdon në pafundësi.

Prandaj, atje duhet dora e shtetit dhe kjo dorë e shtetit nuk duhet të vonohet, sepse më në Prizren nuk do të ketë atë që e quajmë ne trashëgimi kulturore dhe historike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë besoj që jam nga deputetët e fundit që do të flas sonte për këtë pikë të rendit të ditës. Është normale që në këtë pikë të përsëris disa nga evidencat që tashmë janë bërë, edhe pse janë të rëndësishme, por edhe pse ka folur një numër i madh i deputetëve.

Unë dëshiroj të sqaroj se Lidhja Demokratike e Kosovës e konteston rishikimin e Buxhetit si proces dhe s'e mendon si proces ekskluziv. Problemi është se po paraqitet si proces ekskluziv.

Rishikimi i Buxhetit është një proces normal, të cilin Qeveria dhe shumica e përdorin që të korrektojnë mungesat dhe që të hapin mundësi për punë dhe për projekte të reja.

Ne kontestojmë kohën, sepse është shumë vonë. Zakonisht Ligji për Buxhetin rishikohet kah mesi i vitit që të ketë kohë të mjaftueshme. Domethënë, nëse rishikimet bëhen në këtë kohë, hiq detyrimet, të cilat duhet të kryhen, duhet të zgjidhen, rrezikohet që fillojnë projekte të reja dhe pastaj, për mungesë të kohës nuk mund të realizohen. Domethënë ky është problemi dhe ne e dimë që Qeveria ka në dorë që deri në 5% të Buxhetit ta orientojë vetë dhe kemi menduar që pjesa themelore e këtyre problemeve do të mund të zgjidhej nëpërmjet këtij procesi.

E dyta, çështjet ose kategoritë për të cilat ne kemi biseduar sot, së paku deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, prapë nuk kanë ndonjë ekskluzivitet dhe nuk janë problematike, po do të mund të zgjidheshin brenda këtij procesi.

Unë do të flas për ato shumë shkurt, por meqë diskutimet e një pjese të kolegëve, e sidomos të deputetëve të PDK-së, u drejtuan deputetëve tanë fjalë dhe sidomos profilit të tyre, unë besoj që nuk u takon partive të tjera politike, s'u takon kundërshtarëve politikë që të bëjnë profilin e LDK-së, ashtu siç nuk na takon neve.

Se kush jemi, si jemi, si sillemi është tepër e qartë, ne tashmë në Kosovë për këtë organizim politik që është relativisht i ri, ne jemi relativisht të vjetër, sepse jemi më të vjetrit. Kjo do të thotë që s'kemi pse i japim mësim politikë njëri-tjetrit prej nga vijmë, kush jemi, ku shkojmë, si dukemi e të tjerë dhe besoj që, në fund të fundit, edhe politikisht, edhe në kuptimin kolegjial nuk janë korrekte.

Sa u takon çështjeve themelore, për të cilat ne kemi biseduar sot, besoj gjatë gjithë ditës, mendoj që nuk duhet të politizohen, po paradoksalisht ato janë çështje politike, sepse Buxheti i shtetit është dokumenti themelor, ligji themelor politik i një viti qeverisës, i një viti fiskal dhe i një viti të punës.

Unë pranoj që do të flas për çështje për të cilat nuk jam ekspert, por unë kam përvojën time si ish-anëtar i Qeverisë dhe do të përpiqem që edhe mbi atë përvojë dhe meqë, së paku, Ligjin e Buxhetit të këtij viti e njoh relativisht mirë, të them disa fjalë, të jap disa ide.

Lidhja Demokratike e Kosovës s'e konteston në vete rialokimin, as Fondin për sigurime shëndetësore. Kërkesa jonë është tjetër që, nëse jo në tërësisë, së paku një pjesë e atij fondi të ridestinohet brenda fushës së shëndetësisë, qoftë në investime kapitale, qoftë dhe në çështje të tjera, të cilat janë thelbësore dhe ne po bisedojmë gjatë tërë ditës për atë fushë, sepse problemet janë shumë të mëdha dhe kjo do të ndihmonte që të zgjidheshin aty.

Tani kjo po lidhet me çështjen e pagesave, kontributeve për veteranët e luftës së UÇK-së. Nuk është se këto lidhen ekzistencialisht, por ne po marrim nga ky fond dhe po bëjmë këto pagesa. Unë e kam të qartë që këto duhet të bëhen dhe e kam të qartë që kjo është procedura, e kam shumë të qartë se këto punë janë rregulluar me ligj dhe ligji duhet të përmbushet. Po atëherë, pse është kjo problematikë, pse Buxhetit t'i mungojë ato para? Sepse Buxheti nuk është planifikuar mirë apo problemi është me lista. Unë besoj që është i dyti.

Që ta provoj këtë, nuk do t'i referohem asnjë deputeti të opozitës, unë do të citoj saktësisht kryetarin e Kuvendit, që është edhe kryetar i PDK-së, ai tha ka lista të fryra. Kjo është konkluzë dhe kjo e krijon problemin.

Tani, që listat janë të fryra, ne konstatojmë kur jemi në këtë pikë dhe jemi në fund të një procesi. Do të thotë se i gjithë procesi i përzgjedhjes dhe i verifikimit ka qenë me probleme.

Ky nuk është proces që e ka drejtua Qeveria, por komisionet e veçanta që kanë filluar nga frontet e para, që i bie nga frontet në katunde, në zona dhe jemi në këtë pikë.

Para pak ditësh kryeministri Haradinaj i ka dhënë një afat Prokurorisë që të japë përgjigje lidhur me listat. Pse? Sepse listat kanë probleme, atëherë pse është problem kur një deputet, cilido deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës apo i opozitës, apo i PDK-së thotë se listat kanë probleme, sepse kanë. Kjo është çështja.

Tani, natyrisht që kryeministri nuk mund t'i japë afat Prokurorisë, po kryeministri mund të kërkojë që të hetohen dhe unë besoj që kryeministri, si një nga drejtuesit e luftës në Kosovës, së paku të një zone të rëndësishme në Kosovë, së paku të një zone, në cilin numri i njerëzve në lista është shumë i lartë, do të mund të ndihmonte procesin e verifikimit, edhe pse nëse jo ai drejtpërdrejt, një pjesë e bashkëpunëtorëve të tij, e njerëzve të tij kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e ndërtimit të listave dhe mund të shërbejnë dhe për verifikimin e tyre nëse kryeministri e ka seriozisht.

Unë prapë e them për herë të parë e të fundit, sepse unë nuk flas as për biografinë time, as për ndodhitë e historitë e familjes time. Dy herë janë përmendur çështjet që kanë të bëjnë me familjen time nga deputetë të tjerë, si familje që ka qenë gati përgjysmë e përndjekur e burgosur, e tjerë, është çështje tjetër. Unë do të jap një diçka tjetër, unë po e përsërisë për herë të parë dhe për herë të fundit që si ish-ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si pjesëmarrës i betejave të Logjës, si dëshmitar i gjallë i tyre, ne nuk kemi qenë aq sa jemi në listë, nuk kemi qenë. Ne këto duhet t'i themi dhe ky nuk është përcaktim politik, sepse unë këtu nuk jam politikisht, jam përfaqësues i LDK-së, po nuk po e shtroj si problem politik, ky është problemi.

Dhe, sa kanë qenë pjesë e Qeverisë, si zëvendëskryeministër kam pasur mundësi që të ndjek dhe të dëgjoj raportime, qoftë edhe të lexoj raporte të shkruara ndërkombëtare, të cilat listat tona dhe, në fund, të miratuara nga Qeveria e Kosovës, në të cilën kemi qenë edhe ne, janë trajtuar si lista të korrupsionit enorm që duhet të hetohen.

Ne jemi para këtij problemi: ose duhet të flasim seriozisht dhe sinqerisht dhe ta zgjidhim, ose duhet të vazhdojmë më tutje, kështu si është, ta mbajmë nëpër këmbë. Unë besoj që një zgjidhje e përkohshme është edhe kjo, mund të zgjidhet kështu. Ne menjëherë do të kemi në dorë Buxhetin për vitin e ardhshëm, Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe ky problem do të jetë aty, do të përsëritet. Zgjidhja është tjetër: të merremi vërtet me to, të mos dëmtohen ata që vërtet janë veteranë nga ata që nuk janë, sepse keni kujdes, që në atë listë pagat bëhen sipas radhitjes, po supozoj dhe kjo i bie që mund të mos jetë fare veteran dhe është në listë, paguhet, e tjetri mbetet, ose paguhet pjesërisht edhe ata që kanë qenë, edhe ata që nuk kanë qenë.



Tani nuk ka asnjë kuptim që një subjekt politik, qoftë dhe një përfaqësues politik ose edhe kryetari i një subjekti politik t'i dalë zot asaj pune. Askush nuk është pronar i atyre listave, askush s'është pronar i luftës e as i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe vetë ato lista paradoksalisht e provojnë që një pjesë e mirë e rrëfimeve tona për luftën s'janë të vërteta, se vetë s'jemi të vërtetë. E këto ne duhet t'i themi. Nëse s'i themi në Kuvendin e Kosovës, unë nuk e di ku i themi, por duhet të kemi kujdes që të mos etiketojmë askënd, aq më pak deputetët, pak e rëndësishme është a janë të rinj apo të vjetër, deputetët janë këtu që të thonë mendimin e tyre dhe që të përpiqen të japin zgjidhjet. Besoj që gjithë diskutimi i deputetëve tanë ka qenë pak a shumë në këtë frymë dhe unë shpresoj që të ketë qenë i dobishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Saranda Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Sot dua ta ngre çështjen e kërkesës së aktorëve të Teatrit Kombëtar për ngritje të pagave, të cilët tani janë në grevë për shkak të mosshqyrtimit dhe të mosmarrjes me seriozitet të kërkesave të tyre nga Ministria e Kulturës.

Shoqata sindikale e Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe Këshilli drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës kanë dërguar disa herë kërkesë për shqyrtim, për rritje të pagave për krijuesit dhe performuesit e kulturës, si dhe të stafit tekniko-artistik. Kërkesa e tyre është bërë si rezultat i kushteve të rënda të punës dhe paga jo të dinjitetshme. Kjo vlen edhe për stafin tekniko-artistik, gjithashtu vlen edhe për institucionet e tjera të kulturës, siç është Baleti Kombëtar i Kosovës, Filarmonia e Kosovës, si dhe ansambli i këngëve dhe valleve "Shota".

Kërkesa për ministri janë dërguar disa herë. domethënë, në maj, në nëntor, dhjetor të vitit të kaluar, si dhe në mars të këtij viti. Kërkesa e tyre është bërë në bazë të nenit 20 të Rregullores 05/2011, për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesionistë të trashëgimisë kulturore, ku thotë që pas procesit të legalizimit të vendeve të punës në institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mund të nxjerrë rregullore të veçanta për gradime për secilin institucion. Në të njëjtën kohë ekziston edhe një Rregullore 6/2016 për pagesat e honorarëve të artistëve të jashtëm, të angazhuar në Teatrin Kombëtar, që jep mundësinë për honorarë deri në shumën 7 mijë euro, që është komplet në jo në përputhshmëri me pagat që marrin aktorët rezidentë, ku agjenda e tyre dhe puna e tyre është me volum më të lartë.

Gjithashtu, jam e njoftuar për një draft-koncept dokument nga legjislatura e kaluar, që është dorëzuar në Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrisë së Financave. Pyetja ime është se në çfarë procesi është ky dokument dhe çfarë përmban, çfarë propozimesh janë dhënë nga Ministria e

Kulturës dhe cilat do të jenë hapat që do të ndërmarrë ministri i Kulturës për t'i proceduar kërkesat e aktorëve të Teatrit Kombëtar, por edhe për institucionet e tjera që aktorët të mund të kthehen dhe të punojnë në kushte të dinjitetshme dhe të vlerësohet puna e tyre.

Ligji për teatër dhe rregullore të brendshme të Ministrisë së Kulturës kanë shumë mospërputhshmëri me njëra-tjetrën, disa janë edhe diskriminuese ndaj disa nga institucionet e kulturës. Unë tani dua të lexoj një letër që është dërguar nga aktorët e Teatrit Kombëtar që u drejtohen qytetarëve të Republikës së Kosovës, si dhe deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës.

“Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës, pak metra larg jush, po ju drejtohem me këtë letër nga institucioni i parë teatror profesionist në Kosovë, i themeluar në vitin 1946, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, atë botë Teatri Popullor Rajonal. Menjëherë pas përfundimit të luftës në vitin 1999 ndërroi emrin në Teatri Kombëtar i Kosovës, duke u përkufizuar me ligj si institucioni më i lartë kulturor në vend. Që prej vitit 1999 e këndej Teatri Kombëtar i Kosovës është nënvlerësuar, madje shpeshherë është parë edhe si një mbeturinë e ish-sistemit. Gjeneratat e vjetra të aktorëve, të cilët vinin nga sistemi i kaluar, të hutuar krejtësisht në amullinë e pasluftës, disa prej tyre të shtyrë në moshë e duke mos gjetur forcë për t'u përballur me antikulturorët, u dorëzuan plotësisht. Ata arritën në përfundimin e ciklit të jetës dhe karrierës së tyre në një gjendje krejtësisht të brishtë me të ardhura dhe pensione poshtëruese.

Sistemi ynë politik këto dy dekada, jo që nuk arriti të krijojë asnjë vizion kulturor e mundësi zhvillimi për skenën e pavarur kulturore, por nuk arriti ta trajtojë me dinjitet as Teatrin e vetëm Kombëtar, e as ansamblin e tij prej vetëm 26 aktorësh. Karshi skenës së pavarur u veprua sipas disponimit dhe qejfit të ministrave të caktuar, ndërsa ndaj Teatrit Kombëtar u sollën sikur ndaj një patateje të nxehtë, duke hedhur a bartur nga një ministër te tjetri. Pavarësisht premtimeve nga ministra të caktuar apo ministritë, kërkesat tona kanë ngecur në pikën zero. Sot ne, si një gjeneratë më e re aktorësh, kemi vendosur të thyejmë këtë heshtje dhe të veprojmë me këmbëngulje për kërkesat tona, të cilat i konsiderojmë thellësisht të drejta. Ne konsiderojmë që i vetmi opsion që na ka mbetur është futja në grevë të përgjithshme, duke bllokuar dhe pezulluar në tërësi funksionimin e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Ne aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës nuk kemi turp të kërkojmë atë çka na takon, sepse këtë hapësirë e kemi fituar me kualifikim, përkushtim, angazhim dhe përgjegjësi. Ne nuk duam të qëndrojmë kokulur duke kërkuar lëmshë, e as nuk duam që me krenari e mendjemadhësi të tepruar të zgjidhim problemin tonë. Përveç kësaj është vetëm edhe një alternativë tjetër, ta lëmë këtë teatër dhe të ikim. Por, këtë gabim nuk do ta bëjmë, duam të ndryshojmë këtë teatër për veten tonë dhe për ata që vijnë pas nesh. Nuk duam të ikim nga ky teatër dhe nga ky vend për të

gjetur mundësi të tjera, sepse ne jemi të këtij vendi dhe ky teatër është yni. Ne aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës nuk konsiderojmë që jemi pjesë më e veçantë nga qytetarët e tjerë, e as nuk jetojmë në iluzionin nostalgjik të sistemeve të kaluara dhe kuptojmë se teatri nuk është vendi social e as hapësirë ku duhet të zbutet papunësia.

Ne jemi aty të bëjmë teatër, të bëjmë art, të krijojmë, e jo të ngushëllohemi në bufenë e teatrit dhe këtë e kemi dëshmuar. Prej se është rifunksionalizuar ansambli i aktorëve në Teatrin Kombëtar kanë ndryshuar shumë gjëra, volumi i shfaqjeve, reprizat, por edhe publiku është trefishuar. Shfaqjet janë shtuar, oraret janë mbingarkuar dhe gjithë kjo barrë ka rënë mbi aktorët dhe punëtorët e skenës, orari i të cilëve një pjesë më të madhe të muajit fillon në orën 10 mëngjes dhe përfundon në orën 23 të natës, kur përfundojnë shfaqjet që janë në program. Brenda kësaj periudhe ka ndryshuar edhe Buxheti i Ministrisë së Kulturës nga 9 deri në 20 milionë euro. Por, ajo që nuk ka ndryshuar është pagesa e aktorëve. Tash e një kohë ne kemi analizuar dhe reflektuar mbi kërkesën tonë dhe përfundimisht nuk kemi asnjë dilemë në këtë kauzë, madje jemi shumë vonë.

Është për të ardhur keq që kur sheh të ardhurat e kolegëve tanë nëpër teatrot e rajonit e më gjerë, ku jo vetëm teatrot kombëtare, por edhe teatrot e qyteteve paguhen më dinjitetshëm se sa aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës. Prandaj, ne aktorët e Teatrit Kombëtar të Kosovës jemi të vendosur t'i shkojmë deri në fund kauzës sonë për dinjitet. Kërkojmë të trajtohemi seriozisht dhe në mënyrë urgjente, pavarësisht se jemi numër i vogël dhe mund të mos përkthehemi në vota të rëndësishme për ju.

Sinqerisht, aktorët e ansamblit rezident të Teatrit Kombëtar të Kosovës”.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Ne sonte këtu dhe sot gjatë gjithë ditës pamë plot vlerësime dhe qëndrime politike, kryesisht nga pozicionet e barrikaduara politike, por jo ndonjë analizë të thellë të kësaj pune. Fushat, në të cilat u koncentrua debati këtë ditë të sotme ishin kryesisht dy: fusha e parë ishte ajo sociale, që ka të bëjë me pensionet e ish-luftëtarëve të UÇK-së dhe po ashtu, pjesë e saj në aspektin social ishin edhe sigurimet shëndetësore dhe shëndetësia si e tillë në përgjithësi.

Këto probleme u trajtuan nga këndvështrime politike dhe asnjëherë nuk e trajtuan në aspektin teknik dhe praktik. E vërteta është se ka probleme të theksuara dhe u pranua nga të gjitha palët se ka probleme të theksuara me listën e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, po ashtu u pranua nga të gjitha palët se kjo po shkakton probleme për Buxhetin dhe në të njëjtën kohë po shkakton ngarkesa shumë të mëdha dhe probleme për disa zëra të tjerë buxhetorë që kanë të bëjnë me sigurimet shëndetësore dhe shëndetësinë.

Dhe, fusha e dytë, e cila u trajtua këtu sot ishte infrastruktura rrugore dhe kjo nga një këndvështrim më specifik. Një pjesë e pa infrastrukturën rrugore nga këndvështrimi i fushatës elektorale në zonën ku ata pretendojnë të fitojnë territor, duke përmendur fshatin apo qytetin e vet dhe, pjesa tjetër duke parë autostradat virtuale ose duke i kontestuar ekzistencën e tyre. Dhe, këto realisht janë probleme që janë më të ekzagjeruara, duke marrë parasysh që jemi në një fazë zgjedhore dhe janë të kuptueshme. Por çka është problematike dhe që nuk u trajtua këtu hiq është aspekti zhvillimor i Buxhetit. Si ndikon ky Buxhet në zhvillimin e ekonomisë të Kosovës, megjithëse e di që është rishikim buxhetor për një periudhë shumë të shkurtër dymujore dhe plot elemente të tjera, por nuk u trajtua asnjëherë çka me bizneset e vogla, çka me bujqësinë, çka me bizneset e mëdha, sistemin tatimor, lehtësimet doganore, taksat e tjerë, edhe pse po e përsëris, bëhet fjalë për një Buxhet vetëm për 2 muajt e ardhshëm.

Dhe, po ashtu nuk u trajtua asnjëherë çështja e arsimit dhe dy elemente jashtëzakonisht të rëndësishme në kohët moderne, në të cilat po jetojmë: siguria e brendshme dhe e jashtme në Kosovë dhe cilat janë aspektet buxhetore të kësaj çështjeje. Tashmë meqë jemi shumë afër ardhjes Buxhetit të ri, do të kisha kërkuar nga ju, zoti ministër i Financave, që të keni parasysh këto elemente që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, sidomos në aspektin e bizneseve të vogla dhe të mesme, bujqësinë dhe zhvillimin e saj, sistemin tatimor dhe taksat për bizneset e mëdha dhe zhvillimin e tyre dhe po ashtu, sistemin e arsimit, shëndetësisë, mirëqenia sociale veçse është problem, sepse është çështje e fokusuar vetëm në një specifikë karakteristike që janë ish- ushtarë të UÇK-së. Po ta kemi parasysh se problemet sociale nuk janë vetëm aty, problemet sociale janë shumë më të gjera dhe janë probleme shumë më të mëdha.

Dhe, të shohim po ashtu problemet e tjera që kanë të bëjnë me të hyrat e njëhershme, që bëhet fjalë për kreditë, privatizimet që mund të ndodhin me postën apo me ndërmarrjet e tjera që mund të privatizohen dhe si do të realizohen këto dhe si do të paraqiten në Buxhet dhe çfarë efekti do të kenë në ekonomi. Dhe, po ashtu Fondi i Privatizimit dhe Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili duhet të ndryshohet shumë shpejt, në mënyrë që të arrijmë të fusim në Buxhetin e Kosovës një pjesë nga ky fond.

Dhe, mbi të gjitha, duhet të kemi parasysh edhe bilancin tregtar, sa do të ndikojnë këto zhvillime në Buxhetin tonë, sepse ne e dimë që nëpërmjet Buxhetit synojmë ta ndikojmë zhvillimin ekonomik, aktivitetin ekonomik, rritjen e prodhimit vendor, uljen e importit, rritjen mundësisht të eksporteve. Pra t'i kemi parasysh këto elemente dhe të mos kapemi shumë në probleme teknike specifike, sepse të gjithë ne e dimë se problemi i ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është evident, e dimë që lista është e fryrë, e dimë që kjo çështje duhet të trajtohet, e dimë që ka probleme edhe Fondi i sigurimeve shëndetësore, të gjithë e dimë, po duam ta trajtojmë të gjithë politikisht, të dyja problemet po duam t'i trajtojmë politikisht, por të gjithë e dimë që të dyja problemet kanë vërtet shumë nënprobleme të tjera, të cilat duhet të zgjidhen dhe

unë do të isha shumë i lumtur në qoftë se këto në Buxhetin e ri, i cili pritet që të vijë brenda disa javësh, 1 ose 2 javësh, në Kuvendin e Kosovës, të trajtohen dhe të mos lihen pas dore aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social, sepse ju e dini që ne mund të kemi aktivitet të shtuar ekonomik si rezultat i ndërtimit të një autostrade, hyjnë në qarkullim 1 miliard euro, por nuk është zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe nuk ka zhvillim, efekt të qëndrueshëm social.

Pra, t'i kemi parasysh këto elemente dhe të reflektohen në Buxhetin e ardhshëm, sepse sot patëm më shumë beteja specifike për zona të caktuara, por jo betejë të vërtetë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social, për shëndetësi më të mirë, për arsim më cilësor dhe plot elemente të tjera, të cilat duhet të trajtohen edhe në Buxhet dhe duhet të reflektohen në ekonominë e Kosovës. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

KRYETARI: Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, s'e kisha ndërmend të flas, por megjithatë u nxita gjatë debatit. Gjatë gjithë kësaj kohe u fol më shumë për Buxhetin e vitit të ardhshëm, se sa për rishikimin që po bëhet fjalë. U fol aq gjatë për autostradën e Gjilanit, pastaj për sigurimet shëndetësore dhe veteranët, më shumë u bë problem politik edhe një lloj fushate.

Unë e kuptoj Lëvizjen "Vetëvendosje" që po e bëjnë politikën e opozitarizmit, por kolegët e LDK-së s'po i kuptoj në këtë rast, sepse këtë situatë në të cilën po rishikohet Buxheti i Republikës së Kosovës, janë borxhe dhe obligime ndaj kontratave që i ka bërë Qeveria e zotit Isa Mustafa. Prandaj është një veprim normal i shtetit në këtë rast, edhe i Qeverisë që t'i kryejë obligimet që i ka, e jo të kthehen në suficit mjetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Unë mendoj se ky Buxhet, ky rishikim i Buxhetit, duhet të votohet, sepse kemi obligime ndaj operatorëve, kemi obligime ligjore ndaj veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E dëshiroj pak me ministrin Zharku të them diçka, se ma potenco i edhe emrin, jo replikë.

Është e vërtetë që kemi pasur një bashkëpunim të mirë, po ashtu ju rikujtoj që ju i keni pasur katër projekte në Deçan, me nga 100 mijë euro, por që kur kam ardhur në takime, kam thënë që këto projekte nuk mund të zbatohen në Deçan pa i futur edhe disa projekte të tjera, kështu që ke pasur mirëkuptim dhe është lista e rrugëve në dy projekte në Deçan, po ashtu në Strelc edhe në Isniq, që janë futur me insistimin tim që të implementohen. Bile dëshiroj të falënderoj që në rrugën e Strelcit nuk ka qenë rruga që lidh Isniqin me Strelc, ka qenë tenderi i hapur, ke pas mirëkuptim. Dëshiroj të rikujtoj edhe diçka tjetër, kam kërkuar nga ju që të kem përkrahje për rrugën Deçan-Plavë, më keni thënë që nuk ka mjete në ministri, por duhet zoti Isa Mustafa t'i

parashohë, dhe të falënderoj që e ke vendosur kodin për rrugën Deçan - Plavë, nuk e ke mbajtur premtimin për rrugën e qendrës dhe rrugën nga Manastiri dhe rrugën transit, e në takimin që e kam pasur me zotin Isa Mustafa m'ka premtuar 5 milionë, është zotim publik dhe ka mbetur ajo që ju keni premtuar 50 mijë euro për rrugën nacionale Deçan - Plavë, rrugë që i lidh tri shtete: Malin e Zi, Shqipërinë edhe Kosovën. Por, jam i bindur që Qeveria e udhëhequr nga zoti Ramush Haradinaj këto projekte do të trajtojë shumë seriozisht.

Sidoqoftë, të falënderoj për bashkëpunim, por shefi juaj, zoti Isa Mustafa, nuk e ka pasur vullnetin politik për t'i mbështetur projektet që kanë qenë me rëndësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Salih, e ke kryer fjalën, për besë, po më thonë, s'e s'kam qenë në seancë. Salih, në qoftë se kryesuesi e ka të drejtën e interpretimit, në qoftë se ta bëj të padrejtë, e mbaj përgjegjësinë unë, por kryesuesi, po më vjen keq, Salih.

Ganimete Musliu e ka fjalën! Jemi duke shkuar te faza e votimit, i kisha lutur kolegët, ish-ministri, kolegë, se s'e pyeta për replikë, a dëshironi?

GANIMETE MUSLIU: Salih, këtu, kur të jesh në seancë, duhet të jesh me mendje...

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar dhe shumë i respektuar ministër,

Të falënderoj shumë për kontributin që je duke e dhënë, sinqerisht në momentin kur je propozuar dhe je votuar për ministër të Financave, jo që na janë rritur shpresat që do të kalojmë mirë me punën tënde, por shpresat u janë rritur të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, me çka kemi marrë qindra mesazhe, sepse pikërisht në kohën tënde dhe qeverisjen tënde qytetarët e Republikës së Kosovës kanë përfituar më së shumti, kanë ndier dorën e qeverisjes së mirë, prandaj shteti i Kosovës, qytetarët e saj, janë me fat që të kemi ministër.

U fol shumë për Buxhetin, e më së paku u fol për Buxhetin sot në këtë seancë, disa ankoheshin pse po shtrohet ende asfalt, disa ankoheshin pse diku po shkon uji ose pse diku po mënjahen edhe ujërat e zeza. Unë them të vazhdohen këto projekte, sepse këto projekte më së shumti i duhen qytetarit fatkeqësisht edhe në shekullin e 21-të. Dikush këtu në seancë tha se jemi mësuar të flasim vetëm për qeveri të asfaltit, por unë ju them me sinqeritetin më të madh se sot ende kemi fshatra, të cilat rrezikojnë të boshatisen pikërisht nga mungesa e rrugës ose asfaltit, siç po e quajmë ne këtu, e me këtë rast nuk mundem pa i përmendur disa fshatra që sot qytetarët e asaj ane më shkruajnë vazhdimisht për t'i përmendur, që rrezikojnë boshatisjen, janë fshatrat Preten, Magjerë, Dedi, Bataherc, Cerajë, Bistricë e kështu me radhë dhe janë vetëm 11 km rrugë që nuk iu shtruan asnjëherë.

Prandaj, kërkoj që kjo qeveri t'i ketë parasysh dhe ato fshatra t'i bëjë me rrugë dhe t'ua kthejë dinjitetin dhe banorët t'i sigurojë se duhet të jetojnë në ato fshatra, se ato fshatra e kanë vlerën e tyre. Gjatë debatit që po dëgjoj këtu më vjen mirë që pati ministra, ish-ministra, pati deputetë, mirëpo diçka s'mund ta kuptoja. As sot kur po flas ende nuk e kam të qartë se ku qëndron shëndetësia. Jo që s'e kam unë të qartë, por është krijuar një konfuzion. Gjatë kohës kur dëgjoja kolegun, i cili ka ardhur nga shoqëria civile, kur thoshte se shëndetësia është kështu, apo ashtu, u ktheva mbrapa dhe e pyeta ish-ministrin e Shëndetësisë, i cili ka qenë që tre vjet ministër, nja tri herë prej vendit iu drejtova: "Ministër, a je këtu?" Fjala është për Imet Rrahmanin, i cili u arsyetua që s'ka ditur të kërkojë fjalën, ose s'ka ditur si kërkohet fjala teknikisht, sepse s'ka ditur ta përdorë teknikën, është gjithçka normale. Dhe, thjesht, kur dëgjoja duke folur për hartimin e këtij Buxheti dhe në anën tjetër, dëgjoja Avdullah Hotin duke dhënë sqarime se si ishte bërë ky Buxhet, se si e ka bërë ai këtë Buxhet dhe ka qenë gjithçka i gatshëm, prapë lind pyetja se çka është duke ndodhur me grupin tuaj parlamentar, sepse e shoh që komunikimin e keni zero.

E di që keni probleme dhe inate kjo gjenerata e re dhe konflikti me gjeneratën e vjetër as s'po mund ta përmbani, këtë e shfaqni në çdo kohë dhe në çdo moment, por ju kisha lutur shumë, është mirë të mos dalim qesharak dhe të mos harrojmë që janë tre vjet të qeverisjes suaj që nuk keni bërë asgjë.

Luta doli edhe shumë fjalë të mira tha për qeverisjen e tij, ndërsa ne kemi shumë rrugë të filluara qysh në kohën e ish-kryeministrit, e tani presidentit Hashim Thaçi, që prej shkuarjes së tij nuk është shtruar jo as 1 metër, por 1 cm asfalt, këtë e them me shembullin konkret, është rruga ose zgjerimi i rrugës Skenderaj - Komoran, që besoj shumë mirë e di edhe zoti Lutfi Zharku.

Pastaj, nuk është keq të ruhet kontinuiteti i mandateve qeverisëse, aq më tepër nuk është keq nga ne si deputetë që jemi, thjesht edhe sot e kësaj dite kur po flasim këtu, rrugët që kanë filluar qysh atëherë, në kohën e presidentit Thaçi, ende nuk kanë përfunduar dhe ende nuk shihet dritë, sepse keni lënë shumë borxhe, keni bërë shumë memorandume, të cilat nuk kanë asnjë vlerë dhe thjesht ministri i Financave vërtet nuk e ka absolutisht të lehtë që ta kthjellë këtë Buxhet dhe thjesht qytetarëve të Kosovës dhe institucioneve të vendit t'ua kthejë shpresën.

Më vjen mirë, ministër, që në ditët e para keni premtuar rritje pagash. Fjala është tjetër, për veteranët e luftës u fol sot shumë këtu. More, jo 60 mijë, por edhe 100 mijë nëse janë, ata do t'i marrin pagat. Janë apo nuk janë listat e fryra, ata duhet t'i marrin pagat, sepse sikur të mos ishin ata veteranë dikush tjetër do të fliste ndryshe sot në Kuvend, e ndoshta do t'i vinte më ëmbël ajo "ndryshe" që do të fliste.

U fol këtu se shumëkush, se shumë deputetë, kanë edhe trauma, trauma prej PDK-së. Kjo është e ditur, këto trauma disa që janë këtu në sallë, e edhe disa kolegë të tyre, i kanë prej vitit 1998 e këndeje. Po, s'kemi çka të bëjmë! Unë mendoj që nuk ka traumë më të madhe për qytetarët e

Republikës së Kosovës se sa kur bëjmë politika manipuluese dhe ne e dimë shumë mirë se kush janë ata që kanë manipuluar me qytetarin që sa vjet. Këto zgjedhjet e fundit që i patëm, e që ende s'kanë përfunduar si proces, manipuluesit e morën mesazhin. E morën mesazhin shumë të qartë, që besa, se ky vend duhet të stabilizohet dhe të ecën përpara.

Prandaj, mirë andej, mirë këndej, Arben... E them këtë për arsye se qytetarët e Republikës së Kosovës nuk pranuan të jenë pre e manipulimeve, nuk pranuan të jenë pre e dezinformatave.

U fol shumë këtu për fushatë elektorale sot, u akuzuan prej presidentit e teposhtë, por unë u isha lutur atyre që bëjnë akuza të kursehen për balotazh, sepse kudo që kanë marrë pjesë ata nëpër fushata i kanë nxjerrë kryetarët e atyre komunave të dështuar. E dini për kë e kam fjalën dhe ku keni qenë gjatë fushatës.

Partia Demokratike e Kosovës e ka shënuar suksesin më të madh në këto zgjedhje dhe më vjen keq që dikush nuk mund ta pranojë, por ky është realiteti. Realitet, i cili do të zgjasë për shumë vjet, prandaj ju kisha lutur që të shkoni diku, të rehabilitoheni, t'i hiqni traumat, ta hiqni frikën, të vlerësoni sukseset, sepse qytetarët e Republikës së Kosovës nuk kanë përfituar asnjëherë më shumë të mira e benefite, sesa me qeverisjen e Partisë Demokratike të Kosovës. Për tre vjet zero rritje të pagave, qoftë në Shëndetësi, qoftë në Arsim, qoftë Policia e Kosovës, qoftë Forca e Sigurisë së Kosovës, të mos hyj tash që t'i përmend të gjitha me radhe dhe t'jua rikujtoj.

Prandaj, qytetari i Republikës së Kosovës më mirë se kush diti ta vlerësojë qeverisjen e mirë dhe në këto zgjedhje e dha mesazhin. E dha mesazhin e qartë dhe thjesht nuk ka të traumatizuar apo të patraumatizuar që do ta ndalë qeverisjen e Partisë Demokratike të Kosovës. Të gjithë ju që keni aversion ndaj ushtarëve dhe ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, veteranëve, invalidëve... më vjen shumë keq, por deshët apo nuk deshët, nuk do të lejojmë asnjëherë të jemi pjesë e qeverisjes dhe atyre njerëzve t'u mohohet e drejta e tyre. Thjesht, nuk do të mund ta ndalni pagesën për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës sot dhe asnjëherë tjetër.

Kështu që unë i falënderoj dhe i përgëzoj veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët me të vërtetë e kanë pasur durimin më të madh sesa duhet, me gjithë përbuzjen që u është bërë nga Qeveria e kaluar dhe tentohet që edhe sot të njolloset nga disa individë që janë sot këtu dhe nuk e dinë rëndësinë e asaj se për çka janë dhe çka duhet të flasin. Faleminderit!

**KRYETARI:** Sali Salihu e ka fjalën. Jemi në përfundim. S'ka diskutues të tjerë.

**SALI SALIHU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Unë po dua të flas sot për sektorin e Bujqësisë, i cili sektor në secilën qeveri është shkruar se është "sektor strategjik", ndërkaq sa i përket mbështetjes buxhetore nuk është përfillur fare.



Për mua, vetëm 2,5% e Buxhetit të gjithmbarshëm për bujqësi tregon se sa ky sektor neglizhohet apo lihet anash nga të gjitha qeveritë. Me 45 milionë grante dhe subvencion, e që shkojnë direkt për fermerin është e pamundur që fermeri i Kosovës t'u bëjë ballë produkteve të importuara nga shtetet fqinja.

Paramendoni, merreni shembull vetëm Maqedoninë, e cila i ka diku rreth 130 milionë euro buxhet për grante dhe subvencione, ku e subvencionon çdo pëllëmbë të tokës dhe çdo kulturë bujqësore, madje subvencion edhe çdo kilogram të produktit të eksportuar. Ndërkaq, Kosova i ka gjithsej 45 milionë dhe krejt inputet, siç është plehu, fara, preparatet kimike dhe nafta janë produkte që fermerët e Kosovës duhet t'i blejnë, ndërkaq fermeri i Maqedonisë i ka, domethënë i prodhon brendapërbrenda shtetit të vet.

Pra, a mund t'i bëjë ballë fermeri i Kosovës fermerit të Maqedonisë? Se ku duhet të investojë, a të investojë në Bujqësi apo të investojë në infrastrukturë, këtë më së miri e tregojnë për shembull rrugët hyrëse në pikat doganore. Ju kisha lutur të gjithëve, shkoni nëpër pika doganore, shikoni rrugët, e shihni që traseja që vjen, që ka hyrje për në Kosovë, është e shkatërruar nga transporti i rëndë i mallrave, ndërkaq traseja që del nga Kosova për në shtetin tjetër e shihni që nuk është fare e dëmtuar. Ky është treguesi më i mirë se ku duhet të investojmë ne.

Qysh mund për shembull vetëm 2,5% të Buxhetit ta investojmë në bujqësi, ndërkaq rreth 30%-40% të Buxhetit ta çojmë në infrastrukturë. Në vend që të investohet në sisteme të ujitjes, të investohet në industrinë ushqimore për ta rritur prodhimin vendor, ne investojmë vetëm në asfalt dhe kjo tregon se ky Buxhet nuk është në funksion të bujqësisë, që është degë e ekonomisë, nuk është në funksion të zhvillimit të ekonomisë së gjithmbarshme, por është në funksion të zhvatjes, në funksion të keqpërdorimit, pikërisht nga këta njerëz që dje i kemi pasur në krye dhe sot janë të tjerët që po i zëvendësojnë ata. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit për korrektësinë! Ndërkohë u lajmërua edhe një deputete, po më thonë që s'e ka marrë fjalën. Fitore Pacolli-Dalipi.

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kjo është një përgjigje deputetes Ganimete Musliu, e cila thotë se kemi frikë nga deputetët e PDK-së, se na kanë traumatizuar. Po, Ganimete, e keni traumatizuar popullin. Nën shtatzëna na vdesin në Spitalin e Prishtinës, ku është përgjegjëse Ministria e Shëndetësisë. Po, Ganimete, sot na vdesin fëmijët për shkak se u bie fruthi. Është e pakuptueshme që në këtë shekull të të vdesë fëmija për shkak se e merr fruthin.

Ganimete, na vdesin fëmijët nga leukemia. Sheshi është përplot me njerëz që kërkojnë ndihmë, kërkojnë para që të shkojnë të shërohen jashtë vendit, ndërsa Qeveria nuk u ndihmon dhe i ka

keqpërdorur. Shtatë-tetë 8 milionë të Buxhetit janë keqpërdorur me dërgimin e pacientëve për shërim jashtë vendit.

Po, Ganimete, ne sot nëpër shkolla nuk kemi kushte të mjaftueshme që t'i edukojmë fëmijët që nevojiten dhe gjeneratat e reja nuk kanë mundësi të garojnë me gjeneratat e reja në Evropë. Po, Ganimete, në raportet e Bashkimit Evropian dhe në të gjitha raportet e organizatave ndërkombëtare, Kosova konsiderohet si njëra ndër vendet më të korruptuara në botë e në Evropë. Pra, edhe kjo është një traumë, dhe Ganimete njëqindmijë qytetarë tashmë kërkuar të largohen nga Kosova, shumë prej tyre e lanë Kosovën për shkak se ju i traumatizuat.

Prandaj, po, e keni traumatizuar popullin, po vazhdoni ta traumatizoni popullin dhe këtu kemi rezultat, se vetëdijesimi i popullit ka filluar dhe vota për Lëvizjen “Vetëvendosje” është një përgjigje ndaj PDK-së, ndaj traumave të cilat ia keni shkaktuar popullit, ndaj prapambetjes në të cilën e keni lënë këtë popull. Pra, ka mbetur në mëshirën dhe në lëmoshën që i ofron Qeveria. Ndërsa ju keni ndërtuar qindra shtëpi, keni blerë xhipa, keni bërë pasuri marramendëse në kurriz të këtij populli, në kurriz të njerëzve dhe sot bëni hajgare se e keni traumatizuar. Po, është e vërtetë, e keni traumatizuar popullin.

KRYETARI: Ganimete, do të reagosh apo lëre... replikë!

GANIMETE MUSLIU: Po, Fitore! Unë veç një herë do të them: po, Fitore!

Gropa e Kolovicës, nënës që iu mbytën fëmijët, a i jeni përgjigjur ndonjëherë? Fitore, nja 70 dosje që i pati futur Isa Mustafa hipotekë, duhet t'u përgjigjeni tash, se ua kemi kthyer dhe i keni në gjykata, mos i harroni! Fitore, meqë jeni shumë të traumatizuar, do t'ju blejmë shtëpia në Shëngjin me rrogat e pensionistëve, do të ju vozisim me jaht dhe do t'ju japim edhe 'coka cola' zero. E për autobusë, i kemi paguar vetë me taksat tona. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk, nuk ta ka përmendur emrin, mund të betohem. Ja, Fitorja e ka kundër-replikë. Veçse, mos... S'ka të drejtë? Veç pak, unë e përcaktoj a ka të drejtë a s'ka të drejtë, ju ankohuni! Po, Fitore, rreth traumave edhe pak!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Rreth traumave, të cilat po ia shkakton Qeveria e tanishme dhe Qeveria e kaluar, në krye së pari me ju, zoti Kadri Veseli, dhe me Ganimeten si deputete e këtij Kuvendi.

Pra, a i jemi përgjigjur asaj se çfarë ka ndodhur në Prishtinë, po! Kemi dhënë përgjegjësi morale, kemi dhënë përgjegjësi për rastin që ka ndodhur. Kush ka blerë shtëpi në Shëngjin me paratë e popullit, kjo nuk është e vërtetë. Dil përpara, dil me fakte! Ju keni fakte marramendëse për pasurinë që u është shtuar. Nëse e marrim dhe e shohim mënyrën para se ju të vini në Kuvendin e

Republikës së Kosovës, shumica e deputetëve të PDK-së, pra e shohim shumë qartë se pasuria juaj është shumëfishuar, jo dyfishuar, është shumëfishuar.

Ndërsa, deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, drejtorët...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Përgatituni për votim! Vetëm pak! Jo, jo, do ta qetësoj, do ta qetësojmë pak, se ashtu kështu kemi abuzuar... Në bazë të Rregullores, përfaqësuesi i Qeverisë, nëse e kërkon fjalën. E ka kërkuar fjalën. Kështu është Rregullorja.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Fillimisht dëshiroj t’i falënderoj në këtë paraqitjen time të fundit të gjithë deputetët për kontributin e tyre, për diskutimet përmbajtjesore.

Sigurisht se Buxheti është një temë që gjithmonë nxit debate, nxit diskutime, ka mendime të ndryshme, që janë krejt të pranueshme. Ka qenë rishikim më se i domosdoshëm, për shkak se çështjet që janë përfshirë në këtë rishikim nuk kanë mundur për arsye të caktuara të adresohen në bazë të Ligjit të Buxhetit, neni 16. Është arritur që të ruhet qëndrueshmëria makro-fiskale, është arritur të ruhet deficitin buxhetor brenda rregullës fiskale dhe është arritur të ruhet niveli i pranueshëm i bilancit bankar.

Ne jemi në fazën finale të përgatitjes së draft-buxhetit për vitin e ardhshëm, draft-buxhet i cili do t’i reflektojë prioritetet e Qeverisë, do të reflektojë rendin dhe ligjin, do të ketë më shumë pozita edhe në Prokurori, edhe në gjyqësi, do të ketë paga më të larta dhe masë më të madhe të pagave për këtë sektor dhe do të ketë në pozicionin e mallrave dhe shërbimeve më tepër. Do të reflektohet edhe në Shëndetësi, edhe te barnat esenciale, edhe te mallrat dhe shërbimet, edhe te investimet kapitale. Gjithashtu do të reflektohet edhe te sektori i Arsimit. Megjithëse do të ketë rritje të Buxhetit për këta sektorë, prapë jemi të vetëdijshëm se gjithmonë ka vend për më shumë investime. Gjithashtu, vendin më të madh në Buxhetin e vitit të ardhshëm do ta zënë investimet kapitale.

Dhe, krejt në fund, duke ju falënderuar edhe një herë për kontributin e juaj, nuk do t’i anashkalojmë çështjet sociale dhe nga viti i ardhshëm të gjithë të punësuarit që realizojnë paga nëpërmjet Buxhetit të Kosovës do të realizojnë paga me rritje dhe do t’i trajtojmë edhe çështjet sociale, që familjet në asistencë sociale nga viti i ardhshëm do të kenë pagesa. Ne jemi të interesuar që t’i zvogëlojmë këto skema dhe ata të kalojnë në punësim, por do të ketë pagesa 20% më shumë se sa ky vit.

Gjithçka që është e mundur me e rregullua brenda dy leximeve, ne do të jemi në dispozicion. Gjithçka tjetër do të jemi të gatshëm ta rregullojmë mbi bazën e nenit 16, të Ligjit të Buxhetit,

gjithmonë po flas brenda mundësive reale buxhetore dhe brenda infrastrukturës ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lus kolegët, kërkoj falje Milaim, po duam t'i përmbahemi strikt Rregulloren, kështu më korrekt për të gjithë. Lus kolegët deputetë, regjia le t'i bjerë ziles, presim edhe 30 sekonda dhe përgatitemi për votim.

Kolegë deputetë,  
Përgatitemi për votim! Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë, kemi 57 deputetë që kanë votuar për në mënyrë elektronike, 0 abstenim, 0 kundër edhe 3 me dorë. Cila është vota e treve me dorë? Është për. Janë 60 deputetë, por nuk kemi vendimmarrje në bazë të Rregullores së Kuvendit pa i pasur 61 deputetë.

Thërras grupet parlamentare, duhet të jenë 61 deputetë.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Në rrethana të tilla mund të futemi edhe një herë në votim, në qoftë se dëshironi. Po të ishit ju opozita, pesë herë do të më kishit detyruar, po lëreni tash pse, se kurrë s'ka kaluar.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Kolegë deputetë,  
E kemi një situatë kur kemi prani, e nuk kemi votim. S'kemi vendimmarrje. I kemi dy mundësi. Në qoftë se nuk votojmë, ne mund ta thërrasim nesër përsëri seancën. 60 deputetë kanë votuar.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Dëgjo, unë i dëgjoj vetëm ata! Unë nuk i numëroj, për çdo rast mund ta votojmë prapë e kush do t'i numërojë le t'i numërojë.

Edhe një herë, Administrata e përcakton më qartë se sa janë. Që t'i numëroj as ti, as unë, Arben numëroji ti! Deputetë, uluni edhe një herë të votojmë, ta shohim sa jemi, se mua Administrata po më thotë 60, Arbeni 59... A po uleni pra, votoni edhe një herë, përndryshe në qoftë se nuk votohet, jemi të detyruar që nesër ta vazhdojmë seancën, se nuk kemi vendimmarrje. Sikur të ishte kundër, do të ishte ndryshe, ose për..., po kjo s'ka vendimmarrje.

Jemi 60, ose ta them edhe 59, por prapë nuk po mbushet 61-shi. S'ka vendimmarrje. Po hyjmë edhe një herë në votim. Administrata, të lutem, ka një shqetësim më herët nga nënkryetari i

Kuvendit, Kujtimi, vetëm ta kemi parasysh. Ma tha, po të interpretoj, Kujtim, si nënkryetar: e pati shqetësim se ka dy herë votim, një herë me kartelë, dhe një herë me dorë. Unë paraprakisht do të kërkoj se kush është pa kartelë, e ngre dorën para votimit. Tre janë pa kartelë. Me dorë... A shkojmë me votim me dorë, a dëshironi? Njëjtë është. Atëherë kështu, kolegë deputetë, përgatitemi për votim. Votojmë me dorë tani!

Kush është për? Vetëm kush është për? Mbajeni dorën më gjatë, ju lutem! Nënkryetar, 60 qenkan. Edhe me elektronikë, edhe me dorë. Administrata është shumë profesionale dhe e paanshme, është prej se është themeluar Kuvendi.

A të votojmë kush është kundër? Veç ta keni parasysh, vota e juaj njihet, po ju paralajmëroj. Unë jam korrekt, e kam detyrim. Kundër, a ka? Nuk lajmërohet askush. Abstenim, a ka? Nuk lajmërohet askush.

Seanca vazhdon nesër në orën dhjetë.

\* \* \*

*E enjte, më 26 tetor 2017*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 25 tetor 2017*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, filluar më 25 tetor 2017.

Në sallë janë të pranishëm 90 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

***5. Votimi i Projektligjit numër 06/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017***

Të nderuar deputetë,

Diskutimet kanë përfunduar.

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

A ka mundësi të dimë sa deputetë janë pa kartelë? Katër deputetë pa kartelë. A votojmë me dorë, më lehtë, pasi disa janë me kartelë. Po votojmë me dorë.

Aktualisht në sallë janë 99 deputetë.

Kush është për, e ngrit dorën? Ju lutem, mbani ngritur duart derisa të bëhet numërimi.

Kush është kundër? Nuk ka. A ka abstenim? As abstenim.

Me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës për vitin 2017.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe Komisioni Parlamentar që ta shqyrtojnë projektligjit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Zoti Isufi ndërkohë ka kërkuar fjalën, kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së. Urdhëroni!

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e kemi një propozim për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Të nderuar deputetë,

Pas miratimit në shqyrtim të parë propozoj që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 të bëhet me procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 57, paragrafët 3, 5, 8 dhe 9 dhe nenin 64, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

1. Amendamentet eventuale për rishikimin e buxhetit mund t'i adresohen Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa deri më 27.10.2017.
2. Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa deri më 30 tetor 2017 duhet të shqyrtojë projektligjin dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë komisioneve të përhershme.
3. Komisionet e përhershme deri më 30 tetor 2017 duhet ta shqyrtojnë projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.
4. Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa deri më 30 tetor 2017 duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare, dhe
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 të bëhet në seancë plenare më 31.10.2017, në orën 10:00.

Faleminderit!

Unë e nxjerr në propozim për votim, në mënyrë që të shkojmë në procedurë të përshpejtuar.

KRYETARI: Kemi një propozim, është mocion procedural.

Kërkohet deklarimi i grupeve parlamentare. Më lejoni të theksoj Rregulloren çka thotë.

“Për t’iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare”.

Urdhëro, Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, fjala për ju.

GLAUK KONJUFCA: Lëvizja “Vetëvendosje” është kundër procedurave të përshpejtuara për ta rishqyrtuar këtë propozim të ndryshimit të buxhetit, për shkak që, ashtu sikurse u pa edhe dje gjatë diskutimeve, interesi i Qeverisë është që ky buxhet të kalojë sa më shpejt, me disa ndryshime shumë të dëmshme.

Të mos harrojmë, këtu pak më parë u votua një buxhet, për të cilën Kosova detyrohet t'u paguajë grupeve kriminale, të cilat përmes aferave korruptive e kanë dëmtuar Republikën e Kosovës. Ju sa po i ngritët duart tuaja për t'ua dhënë 6 milionë grupeve kriminale, të cilët e kanë dëmtuar Republikën e Kosovës dhe shumë afera të tjera korruptive.

Prandaj, ne nuk kemi se si të bëhemi pjesë e këtyre punëve të ndyta, të cilat prej Qeverisë së kaluar po i vazhdon edhe kjo Qeveri e tashme.

KRYETARI: Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, të gjitha grupet parlamentare.

Lidhja Demokratike e Kosovës, të lutem, regjia.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Të nderuar deputetë,  
Ne nuk e përkrahim kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së për procedura të përsheptuara për këtë rishikim të buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh që edhe ashtu rishikimi i buxhetit ka ardhur dhe është miratuar me goxha vonesë dhe ka nevojë të kalojë sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që agjencitë buxhetore të kenë mundësi për të bërë rirregullimet që do të kalojnë në leximin e dytë.

Ne e mbështesim kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të AAK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Lista serbe!

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste podržava predlog šefa Parlamentarne grupe AAK da naredna sednica za izglasavanje budžeta u drugom čitanju bude 31 ovog meseca.

KRYETARI: Zoti Shala nga "Nisma".

HAXHI SHALA: Po, zoti kryetar, ne e mbështesim kërkesën e Aleancës për shumë arsye, sepse edhe veteranët që dy muaj nuk kanë marrë rroga, sa më shpejt që është e mundur të kryhet kjo procedurë e rishikimit të buxhetit, edhe ashtu s'kanë mbetur edhe dy muaj. Faleminderit!



KRYETARI: “6+”, zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për shmangie të rregullores. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë jemi në deklarinimin me votim, që shqyrtimi i dytë i rishikimit të buxhetit për vitin 2017 të bëhet me procedurë të përsheptuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit. Propozimi është ai i cili e dha kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Lus deputetët të përgatiten për votim, katër deputetë i kemi prapë me dorë? Edhe një herë, sa deputetë janë pa kartelë? Tre, Daut, a je edhe t’i pa kartelë. Urdhëro, zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Kryesues, në shumicën e rasteve këtu nuk po deklarohet a po jepet vota a nuk po jepet vota. E kam paralajmëruar edhe dje në mëngjes që ka pasur problem teknika. Edhe unë e kam hequr kartelën komplet kur kam votuar që disa raste dhe nuk është e vërtetë se jam pa kartelë. Problemi është që nuk po e dimë a po votohet a nuk po votohet, edhe unë nuk jam këtu teknik i teknologjisë, po veç të prek po jo. Kështu që, cilën të duash kryetar, me dorë a pa dorë. Albulenë, edhe për ty vlen.

KRYETARI: Me dorë, katër deputetë janë me dorë, Dauti përfshihet me dorë. Shkojmë atëherë me votim elektronik një herë, e pastaj me dorë në fund i marrim deklarinimet e tyre.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Edhe katër deputetë me dorë, kush është për? Edhe katër vota janë për, 89 deputetë kanë votuar: 61 për, 28 kundër, abstenime. Administrata, vetëm të llogaritet 2/3, të jemi më korrekt, çdo herë në votim e merr përgjegjësinë Kuvendi, administrata, për t’i ikur politizimit nga interpretimi i kryetarit të Kuvendit ose kryesuesit.

Atëherë ka kaluar mocioni procedural. 89 deputetë kanë votuar, 61 për, 2/3, kush merret me matematikë, le ta kalkulojë, Administrata e Kuvendit thotë se ka kaluar me 61, ta kemi parasysh.

Shqyrtimi i dytë i rishikimit të buxhetit për vitin 2017 bëhet me procedurë të përsheptuar, në bazë të propozimit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me ato terma.

## **6. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016**

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj Auditorin e Përgjithshëm, zotin Besnik Osmani, që para deputetëve të Kuvendin ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor të auditimit për vitin 2016.

Zoti Osmani, mund të vini në foltore.

AUDITOR I PËRGJITHSHËM, BESNIK OSMANI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që të paraqes para jush raportin vjetor të auditimit për vitin fiskal 2016, të cilin e kemi hartuar dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës brenda afatit të paraparë me ligj.

Raporti përfshin opinionin, gjetjet kryesore dhe rekomandimet tona.

Për ta përfunduar këtë raport, ne paraprakisht kemi audituar dhe publikuar 105 raporte të auditimit, për 92 organizata buxhetore, 4 ndërmarrje publike, 2 projekte të donatorëve dhe 7 auditime të performancës.

Në këto raporte ne kemi dhënë 96 opinione të auditimit lidhur me pasqyrat vjetore individuale të organizatave buxhetore dhe opinionin për raportin financiar vjetor të Qeverisë.

Prej tyre kemi dhënë: 25 opinione të pakualifikuara, 58 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes, 5 opinione të kualifikuara, 7 opinione të kualifikuara me theksim të çështjes dhe 2 opinione të kundërta.

Nga totali i opinioneve, 85% të opinioneve janë të pastra, pozitive, 15% janë opinione të modifikuara, negative.

Në raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës kemi dhënë opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes.

Si theksim të çështjes për të tërhequr vëmendjen e lexuesve dhe të Qeverisë, por pa kualifikuar raportin, kemi përmendur katër çështje të rëndësishme, me sa vijon:

1. Keqklasifikimin e shpenzimeve në shumë prej 14 milionë e 640 mijë e 98 euro, të cilat janë buxhetuar për investime kapitale. Ndërsa janë shpenzuar për mallra e shërbime si dhe për subvencione e transfere.

2. Kemi gjetur pasqyrë të pasaktë të shpalosjes të organizatave te niveli qendror në vlerën mbi 1000 euro. Mospërputhja në mes të raportit vjetor financiar dhe raporteve individuale të organizatave është rreth 8,8 milionë euro.

Nuk është prezantuar borxhi publik. Vlera e përgjithshme e tij është 853 milionë euro.

Nuk janë barazuar llogaritë e arkëtueshme në raportin financiar vjetor që janë prezantuar në shumë prej 550 milionë e 999 mijë e 50 euro, kurse sipas raporteve individuale të auditimit rezultojnë të jenë: 548 milionë e 963 e 60 euro. Pra, ekziston një nënvlerësim i llogarive për 32 milionë e 973 e 10 centë.

Të nderuar deputetë,

Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit paraprak nuk është e kënaqshme. Në raportet individuale të auditimit kemi dhënë 1 300 rekomandime, 900 me prioritet të lartë dhe 400 me prioritet të mesëm.

Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 numri i rekomandimeve është rritur për 13% nga ana e Auditorit të Përgjithshëm.

Janë zbatuar më pak rekomandime se në vitin paraprak. Vetëm  $\frac{1}{4}$ , apo vetëm 26% janë zbatuar plotësisht, 36 pjesërisht dhe 38 nuk janë zbatuar fare.

Vlerësimi ynë është që mungesa e zhvillimit të proceseve formale për monitorimin sistematik të planti të veprimit për zbatimin e rekomandimeve mund të jetë një prej shkaktarëve për adresimin e shkallës së ulët të implementimit të rekomandimeve.

Për këtë arsye Zyra Kombëtare e Auditimit ka rekomanduar Qeverinë të zbatojë një proces sistematik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin vjetor 2016.

Të kërkojë nga të gjitha organizatat buxhetore të zbatojnë rekomandimet e Auditorit, të raportojnë për progresin lidhur me adresimin e këtyre rekomandimeve që i kemi dhënë në raportet individuale.

Me gjithë ngecjet dhe mangësitë e evidentuara në fushën e qeverisjes kanë ndodhur disa zhvillime pozitive, prej të cilave do të veçoja: janë rritur të hyrat për 70 milionë e 534 mijë, apo 4%.

Është rritur efikasiteti në ekzekutimin e buxhetit dhe është arritur në shkallën prej 95%.

Rritja nominale e shpenzimeve është bërë për 9%, që tregon për një rritje të fuqisë blerëse.

Janë zvogëluar llogaritë e arkëtueshme për 140 milionë. Rritja e pjesëmarrjes në investime kapitale në tortën e përgjithshme të buxhetit ka arritur në kufirin prej 26% të buxhetit shtetëror.

Kemi një përmirësim të regjistrimit të pagesave nga palët e treta. Kemi një mbajtje të kufirit të deficitit buxhetor në pajtueshmëri me kërkesa ligjore.

Ky Kuvend ka aprovuar me ligj 1.6 të bruto produktit të përgjithshëm vendor, ndërsa është realizuar 0,9, që është brenda këtij kufiri.

Kemi një vendosje të platformës së E-prokurimit, ndonëse ende jo me zbatim të plotë dhe kryesisht të një numri i kufizuar dhe i institucioneve të pavarura.

Kemi për herë të parë hartimin nga ana e Qeverisë të planit për zbatimin e rekomandimeve dhe kemi një definim të procedurave, kritereve nëpërmjet një rregulloreje unike për të gjitha institucionet për menaxhimin e subvencioneve.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të shpalos më tutje disa nga gjetjet kryesore në disa fusha:

E para, por më e rëndësishmja, është prokurimi publik.

Në vitin 2016 institucionet kanë nënshkruar 1015 kontrata nëpërmjet prokurimit në shumën prej 425 milionë euro, apo ¼ së buxhetit të përgjithshëm të Kosovës.

Një numër i këtyre proceseve që janë aplikuar nga organizata buxhetore nuk janë në pajtim të plotë me kornizën e Ligjit të prokurimit publik.

Disa prej mangësive kryesore janë: dobësi në vlerësimin e nevojave, dështim në zbatimin e procedurave të hapura dhe aplikim mjaft i përhapur në procedura me kuotim të çmimeve, hyrja në kontrata pa zotime paraprake, pagesa jo në pajtim me çmimet kontraktuese, dobësinë e certifikimi në pagesave, pagesa për punë të pakryera.

Mbikëqyrje e dobët e punimeve nga ana mbikëqyrëse, monitorim i dobët i kontratave dhe vonesa në realizimin e projekteve dhe kur ka ndodhur të tilla për mosaplikim të ndëshkimeve.

Dy, lidhur me regjistrimin e pasurive vazhdon të mbeten një ndër sfidat më të mëdha të Qeverisë dhe të institucioneve të tjera.

Shumë nga organizatat buxhetore nuk kanë arritur të përfundojnë regjistrimin e pasurive. Në nivel qendror janë regjistruar në total 2.4 miliardë euro pasuri, në nivel lokal janë regjistruar 5.6 miliardë euro pasuri.

Deri më tani pasuria kombëtare e Republikës së Kosovës në vlerën e aseteve arrin prej 8.1 miliardëve, megjithëse kemi evidentuar se shumë pasuri të tjera nuk janë të regjistruara.

Përveç mungesës së regjistrimeve, ka dobësi të shumta në fushën e inventarizimit vjetor të pasurive dhe stoqeve të fundvitit. Në mungesë të regjistrimeve kontabël dhe mosbarazimeve të fund vitit, nuk është e mundur një menaxhim i mirë dhe mundësia e keqpërdorimit mbetet e hapur.

Tre, vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2016 është 260 milionë euro, një shumë kjo e rritur për 8.4 milionë krahasuar me vitin 2015. Nga kjo shumë, rreth 15 milionë euro janë obligime të komunave.

Rritje e obligimeve ka tek organizatat te niveli qendror mbi 180 milionë, që kryesisht lidhen me procesin e shpronësimeve.

Llogaritë e arkëtueshme, përkundër faljes së tyre në shumën prej 188 milionë euro me ligj nga ky Kuvend, llogaritë e arkëtueshme vazhdojnë të mbesin në nivel të lartë. Sipas raporteve individuale të auditimit në nivelin qendror kalojnë shumën prej 391 milionë eurosh, ndërsa të arkëtueshme të pambledhura në nivelin lokal kalojnë shumë prej 157 milionë euro. Pra gjithsej të arkëtueshme të paarkëtuara te institucionet publike janë 548 milionë euro, apo përafërsisht 1/3 e të hyrave të buxhetit për një vit.

Ndërmarrjet publike. Në vitin 2016 për herë të parë kemi bërë edhe auditimin e katër ndërmarrjeve publike, siç jeni në dijeni, ndërmarrje publike përdorin metodën e akualit të kontabilitetit, për dallim nga organizatat e tjera publike që përdorin metodën e parasë së gatshme.

Gjetjet kryesore të auditimit në këto ndërmarrje janë: raportim i dobët në katër ndërmarrje të audituara që kanë marrë opinione negative të auditimit.

Katër kompani punojnë me humbje, që në total arrin vlerën prej 1,5 milion euro.

Shuma e detyrimeve të këtyre katër ndërmarrjeve që i kemi pasur në auditim arrin vlerën prej 8,2 milionë eurosh, prej të cilave 6,2 milionë euro janë detyrime afatshkurtra dhe 2 milionë euro janë detyrime afatgjate.

Në vazhdim më lejoni edhe 2-3 minuta lidhur me fushat me rëndësi të veçanta pa auditime të performancës.

Gjatë vitit 2016 ne kemi kryer 7 auditime të performancës. Trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore, mbrojtjen e mjedisit, rishikimin e teksteve shkollore, procesin e prokurimit publik për mirëmbajtjen e rrugëve, kontratat e ndërtimeve, investimet kapitale në ndërmarrje publike, fondin zhvillimor për katër komunat veriore, i themeluar si rezultat i marrëveshjes së Brukselit.

Këto auditime kanë nxjerrë në pah:

1. Qytetarët nuk marrin shërbime mjekësore cilësore, për më shumë, programi për trajtimin e pacientëve jashtë vendit nuk administrohet mirë.
2. Kemi një vëmendje të pamjaftueshme që u kushtohen masave për mbrojtjen e mjedisit.
3. Rishikimi i teksteve shkollore, si proces i domosdoshëm, nuk i ka arritur qëllimet e synuara për ngritjen e cilësisë në arsim, përmirësimi i teksteve ka qenë i vogël dhe rishikimi ka shtuar kostot pa marrë përfitimet.
4. Procesi për mirëmbajtjen e rrugëve është përcjellë me dobësi edhe në nivelin qendror, edhe në nivelin lokal dhe synimet e realizuara janë arritur pjesërisht.
5. Autoritetet përgjegjëse ende nuk kanë arritur të kenë një menaxhim efektiv të kontratave të ndërtimit.

Sa i përket investimeve të Qeverisë të kryera në ndërmarrjet publike mund të konstatojmë se ato nuk kanë kontribuar në masën e nevojshme në ngritjen e cilësisë dhe shërbimeve publike, derisa rekomandojmë që të ketë një monitorim më të shtuar të Qeverisë karshi këtyre ndërmarrjeve.

Fondi zhvillimor, e fundit, nuk menaxhohet plotësisht në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka një realizim të ulët të buxhetit të projekteve, duke ndikuar negativisht në arritjen e qëllimeve të synuara për zhvillim ekonomik dhe social në katër komunat.

Të nderuar deputetë,

Në fund, më lejoni të vlerësoj lart angazhimin profesional të Zyrës Kombëtare të Auditimit si një servis i Parlamentit të Kosovës. Ne mbesim në dispozicion të Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare dhe të secilit deputet për çdo informatë shtesë dhe vazhdojmë të konsiderojmë rolin e Kuvendit në rritjen e llogaridhënies karshi Qeverisë si shumë të rëndësishëm dhe nga kjo foltore, në kapacitetin e Auditorit të Përgjithshëm i bëj ftesë Qeverisë së Kosovës që të miratojë planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve që i kemi dhënë në raportin vjetor për buxhetin e shtetit të vitit 2016. Faleminderit!

*Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Për Lëvizjen “Vetëvendosje” është paraqitur zoti Topalli.

Duhet të flasë përfaqësuesi i Komisionit, më fal...!

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, bazuar në nenin 47 pika 1 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, mbi të cilën përcaktohet se Zyra Kombëtare e Auditimit është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë për përfshirjen e ekzaminimit dhe vlerësimit të pasqyrave vjetore.

Raporti vjetor i auditimit për vitin 2016, sipas afateve të përcaktuara ligjore, të përcaktuara me Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në mbledhjen e mbajtur më 17 tetor 2017, e shqyrtoi raportin vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe vendosi që të njëjtin ta adresojë për seancën parlamentare me këto rekomandime:

- të miratohen rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit së bashku me raportin vjetor të auditimit për vitin 2016,
- Qeveria e Republikës së Kosovës në afat prej 30 ditëve ta dorëzojë në Kuvend planin e veprimit me adresimin e rekomandimeve të ZKA-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash e ke fjalën...

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Auditor,

Raporti aktual, edhe pse vetëm me theks të çështjes, nxjerr në pah shumë parregullsi në punën e ministrive dhe organizatave të tjera buxhetore, duke filluar nga një papërgjegjësi totale për implementimin e rekomandimeve, respektivisht përmirësimit të qeverisjes, keqpërdorimeve nëpërmjet prokurimit, fshehjes së borxheve në ligjin kryesor, pra në Ligjin për Buxhetin, e deri te kontrolli i mangët i financave publike dhe keqpërdorimi i tyre.

Edhe pse regjistrimi i pasurisë është një obligim ligjor, deri më tani janë regjistruar pasuri në vlerë prej 8,2 miliardë euro, edhe pse dihet që pasuria aktuale është shumë më e madhe dhe aty ku nuk ka regjistrim të pasurisë, aty ka keqpërdorim të pasurisë. Në anën tjetër, borxhi aktual i Qeverisë është 215 milionë euro, një shumë e lartë e cila i dëmton palët, sidomos pjesën, e cila duhet t'i pranojë këto mjete.

Njëkohësisht, duhet theksuar që borxhi publik është rreth 850 milionë euro, pra gjithashtu një shumë tepër e lartë. Qeveria, jo vetëm që e ka futur shumicën e qytetarëve në borxhe nëpërmjet ngecjeve ekonomike, por po e kthen edhe Republikën e Kosovës në një borxhli të madh. Në Buxhetin e Kosovës, ajo nuk e ka evidentuar askund borxhin publik prej 850 milionë eurove. Tendenca e fshehjes së borxheve para ligjit më të rëndësishëm brenda një viti flet se sa e papërgjegjshme është Qeveria dhe cili është potenciali i saj mashtrues. Ajo që është themelore në Ligjin për Buxhetin është që duhet t'i dimë të ardhurat, duhet t'i dimë të dalat, por duhet t'i dimë edhe borxhet që ne i kemi si Republikë e Kosovës.

Prokurimi publik vazhdon të mbetet njëri nga tri problemet kryesore të qeverisjes. Sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm, shkeljet kryesore në prokurim janë favorizimi i operatorëve, trajtimi i pabarabartë i operatorëve, diskriminimi i operatorëve ekonomikë, mungesa e transparencës, problemet rreth specifikimeve teknike, vlerësimi dhe krahasimi i padrejtë i tenderëve dhe kriteret e papërcaktuara. Pikërisht për shkak të arsyeve të lartpërmendura, në OSHP i kemi 481 ankesa, prej të cilave 158 të bazuara, ndërsa 198 raste janë kthyer në vlerësim. Kjo tregon që prej 481 ankesave, 356 janë me bazë, e kjo tregon se kemi shkelje jashtëzakonisht të mëdha në fushën e prokurimit.

Në fakt, me ankesat e paraqitura në OSHP do të duhej të merrej Prokuroria, sepse shkeljet nuk janë pasojë e gabimeve teknike dhe mungesë e njohurive profesionale, por pasojë e keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Për këto keqpërdorime të qëllimshme, kur një operator favorizohet karshi operatorit tjetër, kur drejtësia për njërin operator është njerë dhe për tjetrin është nënë, do të duhej të përgjigjej edhe Qeveria, e cila ka krijuar kushte të favorshme për shkelje dhe trajtim diskriminues ndaj një numri të caktuar të operatorëve. Në këtë frymë duhet shikuar pra edhe shkeljet e platformës së prokurimit elektronik. Qeveria e ka sjellë një vendim që prokurimi elektronik të fillojë në shtator të vitit 2016, ndërsa nga janari i vitit 2017 të jetë i obliguar. Megjithatë këtë, gjatë vitit 2016, vetëm 16% e ministrive e kanë përdorur, ndërsa vetëm 26% e ministrive e kanë përdorur në disa raste.



Pra, 5-8% nuk e kanë planifikuar fare këtë. Pra, vetë Qeveria, e cila ka sjellë vendim për implementimin e prokurimit elektronik është ajo e cila vetë i shkel këto vendime. Kjo nuk është qeverisje, kjo është anarki. Edhe pse Auditori është një instrument shumë i mirë në shërbim të qeverisjes së mirë, ai vazhdon të injorohet nga Qeveria dhe organizatat buxhetore, të cilat me gjithë rekomandimet, të cilat jepen vit pas viti, nuk implementohen në praktikë. Implementimi i rekomandimeve prej vitit në vit është shumë i rrallë, më shumë se 30%. Në vitin 2015 janë implementuar vetëm 26% e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, 37% janë implementuar pjesërisht, ndërsa 38% nuk janë implementuar fare. Këtë vit, numri i rekomandimeve arrin shifrën 1 314, që është një shifër shumë e lartë. Pra, kemi 1 314 probleme gjatë qeverisjes.

915 prej rekomandimeve janë me prioritet të lartë. Praktika e deritashme lë për të dyshuar që edhe rekomandimet e vitit 2016 do të mbeten pa u implementuar. Arsyeja e mosimplementimit të rekomandimeve ka të bëjë me faktin se Auditori i Përgjithshëm nuk e ka asnjë instrument për ta detyruar Qeverinë dhe organizatat tjera buxhetore që t'i implementojnë rekomandimet e dhëna nga Auditori. Kuvendi i Kosovës ka mundësi për ta detyruar Qeverinë për implementimin e rekomandimeve, por këtë funksion nuk e ka ushtruar asnjëherë. Shumë raporte skandaloze, të cilat flasin për keqpërdorime materiale, për menaxhim të dobët, për mungesë të kontrollit të financave publike mbeten larg Kuvendit dhe nuk bëhen asnjëherë temë.

Pse ndodh kjo? Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka për detyrë që raportet e këqija për qeverisje t'ia paraqesë Kuvendit. Ky komision udhëhiqet nga opozita, por nuk përbëhet nga shumica e tij. Përfaqësuesit e partive në pozitë votojnë gati rregullisht kundër dërgimit të raporteve në seanca dhe në këtë mënyrë e pengojnë Kuvendin që të debatojë për qeverisjen e keqe dhe implementimin e rekomandimeve. Në këtë mënyrë, ata do të bëhen avokatë të qeverisjes së keqe dhe i japin krah kësaj qeverisjeje. Për ta ndryshuar këtë gjendje duhet të krijohen mekanizmat e nevojshëm që në njërin anë mundësojnë, respektivisht lehtësojnë që raportet e këqija të debatohen në Kuvend dhe, në anën tjetër, të krijohen mekanizma, të cilët kur mjetet keqpërdorin në forma të ndryshme, organizatat buxhetore, pra ministritë, komunat, institucionet e pavarura, të ndëshkohen me shkurtrim të buxhetit. Kuvendi i Kosovës në shërbim të qeverisjes së mirë do të duhej që Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike t'ia japë mundësinë që të përbëhet me shumicën e tij nga pjesëtarët e opozitës.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta miratojë raportin e Auditorit të Përgjithshëm, duke kërkuar nga Kuvendi që ta detyrojë Qeverinë dhe institucionet e pavarura të raportojnë para Kuvendit në bazë tremujore për implementimin e rekomandimeve, ashtu siç ka rekomanduar Auditori i Përgjithshëm.

Pra, rekomandimet e Auditorit duhet të kthehen në vendim të Kuvendit për Qeverinë dhe organizatat buxhetore, në tërësi. Karshi kësaj do të duhej të merreshin vesh në Kuvend për

ndëshkimin e organizatave buxhetore nëpërmjet shkurtimit të Buxhetit për shkak të mosimplementimit të rekomandimeve të Auditorit. Nga Auditori i Përgjithshëm presim që në raportet e ardhshme të na japë shënime shtesë se sa është dëmi i Republikës së Kosovës për shkak të shtyrjes së prokurimit, keqpërdorimeve gjatë prokurimit. Sa është lartësia e shumës së mjeteve, e cila është përdorur keq për shkak të mosspecifikimit të tenderëve, ta zëmë në pesë vjetët e fundit? Sa janë humbjet e Republikës së Kosovës në proceset e humbura gjyqësore gjatë pesë vjetëve të fundit? Cili është trendi i punësimit me kontrata mbi vepër gjatë pesë vjetëve të kaluara? Cilat janë rekomandimet e Auditorit që janë përsëritur nga viti në vit?

Por, ajo që do të donim do të ishin analizat, respektivisht trendët e zhvillimit në fusha të ndryshme ndër vite.

Krejt në fund do të dëshironim që të ketë një bashkëpunim edhe më të ngushtë ndërmjet Prokurorisë dhe Auditorit të Përgjithshëm. Auditori i Përgjithshëm, në të gjitha rastet ku vërehet se ka dyshime për vepër penale ta informojë Prokurorinë për dyshimin. Në fund të vitit, Auditori t'i raportojë Kuvendit se sa në raste është shprehur dyshimi për vepra penale. Vetëm duke marrë masa konkrete, Kuvendi mund ta obligojë Qeverinë për t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për një qeverisje të mirë.

Më lejoni krejt në fund që ta falënderoj Auditorin e Përgjithshëm për punën e mirë që ka bërë dhe të gjithë auditorët dhe auditoret që janë angazhuar që ta kemi një raport çfarë ne e kemi sot, i cili tregon që kemi probleme jashtëzakonisht të mëdha në qeverisje, e të cilat mjerisht të gjitha qeveritë e deritashme i kanë injoruar edhe për faktin që Kuvendi nuk e ka kryer punën e vet.

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i LDK-së, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar Auditor i Përgjithshëm,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së të ju përgëzoj për reformën që keni bërë nga marrja e mandatit tuaj në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Prej se ju jeni vendosur në atë zyrë është rritur kredibiliteti i punës që bën zyra juaj dhe dhjetëra auditorë në auditimet që kryejnë në të gjitha institucionet publike të Kosovës.

Në veçanti dua ta theksoj eliminimin e çfarëdo animi në opinione të auditimit që zyra juaj lëshon për institucione publike në Kosovë, gjë të cilën nuk mund ta themi edhe për të kaluarën e këtij institucioni. Sigurisht se reformat që kemi ndërmarrë në Qeverinë e kaluar në menaxhimin e financave publike kanë mundësuar një situatë shumë më të shëndoshë me financat publike, e rrjedhimisht edhe raportet dhe puna juaj është shumë më e lehtë. Këtu po përmend në veçanti

prokurimin elektronik, pastaj lidhjen e KRPP-së me organizata buxhetore për të mos lejuar krijimin e obligimeve pa mbulesë, planifikime shumë më të mirë të të hyrave dhe të sakta të të hyrave dhe të shpenzimeve, në veçanti planifikimin pesëshifror që do të eliminojë mundësitë e gabimeve të tilla në të ardhmen.

Rekomandimet që ju i keni dhënë duhet të merren seriozisht nga Qeveria dhe të gjitha institucionet e involvuara. Grupi ynë parlamentar mbështet plotësisht rekomandimet që ka dhënë Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike në këtë seancë plenare lidhur me raportin e Auditorit, në veçanti kërkesa që i drejtohet Qeverisë që brenda 30 dite ta paraqesë planin për adresimin e rekomandimeve që janë të dhëna në raportin vjetor të auditimit për vitin 2016.

Ne presim që raporti dhe rekomandimet e komisionit të miratohen nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe pastaj komisioni ta mbikëqyrë realizimin e rekomandimeve tuaja të dhëna në raport nga Qeveria dhe të gjitha institucioneve tjera të involvuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e PDK-së, kush është? Zoti Lushtaku. Zoti Hoti, unë mendoj se prokurimi elektronik është i dështuar, nuk po funksionon në Kosovë. Nuk janë duke e përdorur dhe nuk e di ku është fajti. Ju e keni marrë vendimin shumë mirë, por nuk është duke funksionuar në Kosovë dhe ti e di këtë shumë mirë.

Zoti Hoti, veç një sekondë nëse do zoti Hoti të na sqarojë.

AVDULLAH HOTI: Vendimi për zbatimin e prokurimit elektronik nuk është marrë nga viti 2011, kur ka ekzistuar baza ligjore. Në momentin që ne kemi ardhur në Qeveri, me mbështetje të Komisionit Evropian dhe të partnerëve tanë ndërkombëtar ne e kemi filluar zhvillimin dhe finalizimin e platformës për prokurim elektronik, e cila ka filluar nga viti 2016. Nga 1 janari i këtij viti është e obligueshme për të gjitha institucionet publike. Nëse doni që të bëni komente të tilla, zoti kryesues merreni fjalën si deputet, ose dilni në foltore. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë të falënderoj për informatën, këtë e kemi pasur disa herë në Kuvend, por po them që s'po funksionon në Kosovë. Zoti Lushtaku e ka fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Auditor,

Të nderuar qytetarë,

Ne si Grup Parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për vitin 2016.

Më lejoni të theksoj se auditimi si instrument i funksionimit më të mirë të shtetit duhet të mbështetet edhe më tutje për ta rritur menaxhimin më të mirë të financave publike dhe për menaxhimin më të mirë të performansës së qeverisjes së vendit. Karshi kësaj, në raportin financiar vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 nga Zyra Kombëtare e Auditimit është dhënë opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes për shkak të mosshpalosjes adekuate të informatave sa u përket shënimeve shpjeguese.

Vlera totale e shpenzimeve kapitale, e prezantuar, është e mbivlerësuar dhe nuk mund të konsiderohet e saktë për shkak të nënvlerësimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe subvencione. Në disa raste, pasuritë nuk janë prezantuar të plota dhe në mënyrë të saktë, që si rrjedhojë i vështirësojnë proceset e vendimmarrjes në lidhje me ndarjet buxhetore. Njëkohësisht, sipas të dhënave borxhi publik nuk është i prezantuar, e që mund të ndikojë negativisht në procesin e vendimmarrjes. Ndër të gjeturat tjera kisha theksuar menaxhimin e subvencioneve, që vazhdon të mbetet sfidë, sepse praktika aktuale nuk ofron siguri të mjaftueshme se ato po shfrytëzohen për qëllime të dedikuara dhe nëse po arrihet rezultat i pritur.

Ndër mangësitë e identifikuara në këtë proces janë: mangësitë e politikave të shkruara apo kornizës ligjore për dhënien dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara, mosrespektimi i kritereve të vendosura për subvencionim me rastin e ndarjes së subvencioneve, si dhe mosraportimi nga përfituesit e subvencioneve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, prandaj edhe ka nevojë për të konfirmuar se mjetet janë shfrytëzuar për qëllimet e dhëna.

Gjithashtu, krahasuar me vitin paraprak kemi pasur rritje të obligimet e papaguara në fund të vitit, dhe kjo ka ardhur si rezultat i hyrjes në obligime pa mbulesë të mjaftueshme për financimin e tyre, apo edhe vonesës së pranimit edhe procesimit të faturave. Një situatë e tillë ka ndikim negativ në menaxhimin e Buxhetit dhe do ta ngarkojë Buxhetin e vitit vijues që mund të pamundësojë dhe arritjen e objektivave të planifikuara. Në raste të ndryshme, moskryerja e obligimeve me kohë ka shkaktuar procedura gjyqësore të kushtetueshme, duke rezultuar edhe me shpenzime shtesë të Buxhetit.

Raportet individuale të auditimit gjithashtu kanë treguar se ende ka nevojë për përmirësimin e menaxhimit të prokurimit, duke identifikuar çështjet kryesore, si në vijim: vonesa në realizimin e projekteve kapitale, vërehet mungesa e monitorimit të efektit të zbatimit të kontratave, nuk është bërë harmonizimi i kërkesave për rrjedhjen e parasë të fondeve në dispozicion, mosrespektimi i kërkesave të Ligjit të Prokurimit publik.

Dobësitë kanë ndodhur për shkak të anashkalimit të procedurave të prokurimit, duke rezultuar me zhvillimin e procedurave të prokurimit jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Natyrisht, në këtë proces duhet të punohet edhe më tutje në funksionalizimin e plotë të platformës elektronike për prokurimin publik.

Sistemi i kontrollit të brendshëm, me gjithë përmirësimet nga viti i kaluar, ende nuk është në nivelin e kënaqshëm dhe gjithashtu duhet një fokus i shtuar në këtë drejtim. Në përgjithësi, sa i përket zbatimit të rekomandimeve në bazë të të dhënave kemi ngecje, sepse vetëm 26% e tyre janë zbatuar në tërësi. Ndërsa, pjesërisht janë zbatuar 37%. Prandaj, duhet punuar në moderimin e sistemit sistematik të planifikimit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe rritjen e mbikëqyrjes efikase nga Qeveria dhe organet mbikëqyrëse për nivelin e zbatimit dhe rekomandimeve, si dhe eliminimin e rasteve që ndikojnë në përsëritjen e rekomandimeve, ndërsa në nivelin e auditimeve individuale shumica e organizatave buxhetore nuk i zbatojnë proceset sistematike për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

Ne presim nga Qeveria që ta dorëzojë në Kuvend planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Konform rekomandimeve nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe këtij plani t'i kushtohet vëmendje e veçantë dhe të raportohet për progresin e arritur, në mënyrë që të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit të mos na përsëriten nga viti në vit dhe këto ngecje të ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe shfaqjes sistematike të parregullsive nga viti në vit.

Ne jemi për aprovimin e raportit vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar Lista serbe. Zonja Verica Qeraniq.

VERICA ČERANIĆ: Poštovani,  
Parlamentarna grupa Srpska lista razmatrala je godišnji izveštaj revizije za 2016. godinu ispred Nacionalne kancelarije revizora i načelno podržava izveštaj generalnog revizora. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe konsiderojmë se krahasuar me të kaluarën ka një performansë shumë më të mirë dhe vërehet një ndryshim sa i përket edhe përgatitjes së raportit, por edhe një kontrolli më të madh të agjencive buxhetore, të cilat kanë pasur në të kaluarën shumë mungesa ose të dhëna të mjaftueshme.

Prandaj, duke mos hyrë në detaje, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të votojë pro këtij raporti, sepse konsideron që është një nga raportet më të mira që deri më tani i kanë ardhur Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Auditor, zoti Besnik, do të mirë të ishte edhe Qeveria këtu. Faleminderit dhe respekt për punën tuaj, për Zyrën e Auditorit Kombëtar për raportin që e ka paraqitur.

Grupi Parlamentar “Nisma” e ka trajtuar dhe e ka shqyrtuar raportin e Auditorit dhe sigurisht ju përkrahim dhe ju mbështesim plotësisht për punën e mirë që e keni bërë. Te realizimi i të ardhurave të Buxhetit 2016, Auditori ka hasur në pengesa, sidomos në të hyrat vetjake të komunave, në financimin nga huamarrja e jashtme, të hyrat nga AKP-ja dhe të hyrat nga dividendat. Janë çështje të cilat nuk janë realizuar sipas planifikimeve. Po ashtu, Auditori ka gjetur mangësi edhe në shpenzimin e investimeve kapitale në të dy nivelet: edhe në nivelin qendror, edhe në nivelin lokal.

Në nivelin qendror këto investime kapitale nuk janë realizuar më tepër sesa në masën 89%, ndërsa në nivelin lokal këto investime kapitale janë arritur në nivelin 75% dhe këtë nivel e kanë ulur Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Prizrenit, të cilat për vitin 2016 në investimet kapitale kanë realizuar në masën vetëm 58%, ndërsa e Komuna e Prizrenit në masën 54%.

Auditori ka gjetur edhe mangësi në obligimet e papaguara dhe atë në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe në Ministrinë e Bujqësisë. Po ashtu, Auditori ka gjetur mangësi edhe në procesin e prokurimit, në të tri fazat, edhe në fazën e planifikimit, edhe në fazën e zhvillimit të procedurat, e në veçanti në menaxhimin e kontratave dhe besoj që kjo po përsëritet vit pas viti dhe nuk duhet të lejohet edhe më tutje që sistemi i prokurimit të përcillet me vështirësi të tilla. Auditori ka hasur në mangësinë e trajtimit të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike, duke mos i trajtuar njëjtë, shpeshherë duke mos e trajtuar fare kërkesat e tyre, të cilat kanë qenë shumë të rëndësishme.

Ndërmarrjet publike, po ashtu Auditori i Përgjithshëm ka konstatuar se punojnë me humbje. Ende janë bëjnë punësime enorme dhe janë larg qeverisjes së mirë, prandaj me të vërtetë këtu mendojmë se Qeveria dhe Parlamenti duhet t’i marrin masat adekuate që të mos vazhdohet më tutje funksionimi i tillë i ndërmarrjeve publike. Ne si grup parlamentar i mbështetim edhe rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje Financiare, edhe gjithë punën që e ka bërë në këtë raport vjetor të Zyrës së Auditorit Kombëtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “6+” nuk është askush. Vazhdojmë me përfaqësuesin e Qeverisë. Nuk është. Vazhdojmë me paraqitjen e deputetëve sipas radhës, fjalën e ka zonja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Do të ishte mirë të ishte Qeveria aktuale këtu që t'i dëgjonte vërejtjet që jepen për mënyrën e qeverisjes, përkatësisht menaxhimit të parasë publike nga Qeveria e kaluar, së cilës i dedikohet ky raport, dhe ndoshta do të mësonin që disa nga gabimet dhe keqmenaxhimin nuk do t'i përsëritnin.

Tani unë nuk dua të lëshohem në detaje të raportit, sepse raporti flet mjaft dhe e përgëzoj Zyrën e Auditorit për këtë, por unë i kam disa probleme me mënyrën se si ne e trajtojmë raportin dhe, mbi të gjitha, çfarë ndodh? Cilat janë pasojat për njerëzit, në këtë rast zyrtarët qeveritarë, të cilët kanë bërë edhe keqmenaxhim, por mbi të gjitha kanë bërë keqpërdorim. Tani për keqmenaxhim, pasi e dëgjuam Auditorin e Përgjithshëm, ky Kuvend do të duhej ta merrte vendimin për ta shkarkuar Qeverinë, por tashmë Qeveria është shkarkuar, ndonëse kjo nuk ka qenë arsyeja, por menjëherë pas kësaj mendoj që Auditori duhet t'i fillojë hetimet për keqpërdorimet që janë bërë.

Edhe në këtë rast, ka pasur raste të tilla, në bazë të raportit të Auditorit, në Komunën e Klinës konkretisht, Lëvizja “Vetëvendosje” ka ushtruar kallëzim penal kundër kryetarit të atëhershëm Bashota dhe në bazë të këtij kallëzimi Prokuroria ka ngrehur aktpadi për keqpërdorim të parasë publike.

Por, çfarë ndodh më tutje është se një javë para se të përfundojë afati për certifikimin e kandidatëve, një prokuror tjetër, e në këtë rast rastësisht ndodh që ky prokuror të jetë Sylë Hoxha, e hedh poshtë aktakuzën, aktpadinë e ngrehur nga një prokuror tjetër, të cilit unë nuk ia di emrin. Tash këtu, ne si shoqëri, si Kuvend, si shtet, e kemi një problem: ose ka gabuar Zyra e Auditorit, kur ka thënë se në këtë rast konkretisht në Komunën e Klinës ka pasur keqpërdorim të parasë publike dhe të njëjtin gabim e ka përsëritur prokurori i çështjes, të cilit sërish nuk ia di emrin kur ka thënë se po Auditori ka të drejtë, në Komunën e Klinës ka pasur keqpërdorim të parasë publike, ose Sylë Hoxha ka gabuar kur e ka hedhur poshtë atë aktakuzë. Kështu që këtu dikush duhet të japë llogari, ose duhet të japë llogari Zyra e Auditorit dhe kryeprokurori i parë që e ka trajtuar çështjen, ose duhet të japin llogari Sylë Hoxha dhe Sokol Bashota, të cilët për mendimin tim, të dytë, e kanë pasur gabim dhe ka pasur keqpërdorime.

Tani raporti i vitit 2016 thotë se rekomandimet e dhëna janë rritur për 13%, që do të thotë që nuk ka pas përmirësim të mënyrës së menaxhimit të parasë publike, por përkundrazi, sepse rekomandimet zakonisht jepen kur nuk është menaxhuar mirë me paranë publike. Tjetra, që për mua është shqetësuese dhe ky Kuvend duhet ta trajtojë është një e dhënë që na e prezantoi Auditori i Përgjithshëm. Ai tha se në procesin e auditimit ka gjetur raste kur janë bërë pagesa për punë të pakryera. Ky raport pra flet për vitin 2016. Imagjinojeni çfarë raporti do të kemi vitin tjetër kur do të auditohet mënyra e menaxhimit të parasë në vitin 2017, i cili ka qenë vit zgjedhor. Atëherë, çfarë do të bëjë ky Kuvend? Cilat janë masat që ne duhet t'i ndërmarrim ndaj këtyre keqmenaxhuesve dhe, mbi të gjitha, keqpërdoruesve të parasë publike, apo do të mbetemi

në nivelin e diskutimeve, në nivelin e rekomandimeve, në nivelin e komplimenteve ndaj Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe me kaq të mbarojë? Ata që kanë keqmenaxhuar vazhdojnë të keqmenaxhojnë dhe keqpërdoruesit vazhdojnë të keqpërdorin.

Prandaj, unë i dëgjova të paktën dy grupe parlamentare, po më duket njëjtë edhe LDK-ja, që kërkuan që Qeveria në çdo tre muaj të japë raport për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit. Por, ajo çka unë do të kërkoj është përgjegjësi, dikush duhet të japë përgjegjësi dhe llogari për gjithë këtë keqpërdorim të parasë publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hajdar Beqaj e ka fjalën.

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përsëritje për të gjithë kolegët deputetë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës!

Ne sot po e shqyrtojmë raportin e Auditorit të Zyrës Kombëtare për vitin 2016. Është një raport i mirë. Është për t'u vlerësuar puna e Auditorit dhe auditorëve që kanë punuar në këtë raport. Përveçse është një raport më cilësor ndoshta edhe se vitet e kaluara, është zgjeruar edhe fushëveprimtaria e Auditorit, siç e tha edhe Auditori, dhe shkruan edhe në raport, dhe në disa ndërmarrje publike, gjë që është për t'u përgëzuar.

Por, unë do të ndalem te disa të gjetura, siç tha edhe Auditori, flas në bazë të Auditorit në këtë rast, që janë me theksim të çështjes: keqklasifikimi i shpenzimeve, e kjo po përcillet nga viti në vit. Gati në të gjitha organizatat buxhetore, edhe në nivelin qendror, edhe në nivelin lokal, po kemi probleme të njëjta me klasifikimin e shpenzimeve. Nuk është prezantuar borxhi publik. Edhe kjo është një e gjetur, që mendoj se është serioze dhe është përgjegjësi, meqë institucionet përkatëse është dashur ta bëjnë prezantimin e borxhit publik, që është interes të të gjithë qytetarëve që ta dinë se sa është borxh Republika e Kosovës.

Moszbatimi i rekomandimeve është një shqetësim. Ne çdo vit këtu e lexojmë të njëjtin raport, me të njëjtat të gjetura në të gjitha fushat, por nuk kemi ndërmarrë masa adekuate, nuk kemi plan konkret. Qeveria duhet ta ketë një plan konkret të kontrollit, në këtë rast të zbatimit të veprimeve për rekomandimet. Nëse bazohemi në këtë raport të Auditorit, kemi rritje të rekomandimeve nga Auditori, kurse kemi ulje të zbatimit të rekomandimeve paraprake. Kjo nuk tregon ndonjë cilësi, apo një menaxhim të mirë, që po e bëjmë ne.

U tha që s'kemi plan të qartë të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Gjetje shqetësuese në të gjitha nivelet, në të gjitha komunat, edhe në ministritë përkatëse, është fusha e prokurimit publik. Ne e thamë që prokurimi elektronik ende nuk po funksionon në Republikë të Kosovës, që e kemi konsideruar në bazë të ekspertëve, në momentin kur ta kemi të zbatueshëm prokurimin publik pamundësohen shkelësit e ligjit, domethënë zvogëlohet mundësia për ta shkelur ligjin. Te prokurimi publik kemi shumë shqetësime. Nuk ka plane të mira të prokurimit publik. Kemi disa



herë përsëritje të procedurave, e kemi një lëndë që për shembull mund të shkojë deri në 2 vjet, e nuk di ku është interesi publik. Për shembull, që dy vjet gati është Spitali i Ferizajt, po e marr veç një shembull, herë shkon në ministri, herë shkon në OSHP, dhe aty mendoj që më shumë këso rastesh ka punë Prokuroria sesa institucionet tjera.

Mendoj që është me shumë interes për Kuvendin që nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike ta kontrollojë pasurinë publike, sepse qytetarët e Republikës së Kosovës janë të interesuar ta dinë se ku shkon djersa e tyre, qysh menaxhohet pasuria publike.

E kemi problemi që është duke u përsëritur çdo vit, regjistrimi i pasurive edhe në nivelin lokal, edhe nivelin qendror. Të gjitha komunat kanë problem që nuk e dinë sa kanë asete, nuk e dinë cilat janë pronat e komunave, nuk dinë cilat janë asetet e komunave dhe ky është një shqetësim, meqë duhet të bëhet identifikimi i aseteve shtetërore, që është interes kombëtar.

U tha edhe nga Auditori, ne duhet ta kemi një strategji kombëtare për zbatimin e rekomandimeve, por duhet ta kemi edhe një strategji kombëtare për regjistrimin e aseteve. U tha këtu që te katër ndërmarrje publike, që Auditori i ka bërë auditimet, se është raportim i dobët. Këtu duhet pasur përgjegjësi pse ka raportim të dobët? A kanë ato ndërmarrje borde? Kush është aksionari? Qeveria është aksionari. Duhet të rritet kontrolli, sepse është në interes të shtetit, sepse ne paskemi zgjedhur borde joprofesionale, sepse atje paskemi menaxhment joprofesional. Nëse kemi të gjetura - raportim i dobët, do të thotë që është një përgjegjësi e ulët e punës atje.

Thuhet se katër kompani punojnë me humbje. Ne e dimë që kompanitë publike kanë specifika, janë disa kompani që e kanë problem për shembull të punojnë me fitim, për shembull kompanitë që kanë të bëjnë me ujitje, jo me ujë të pijes, ato kanë më problem të dalin te fitimi.

Auditori tha auditimi i performansës, çdo vit po përsëritet, që mendoj se duhet të jetë te tekstet shkollore. Te tekstet shkollore, ministri i Arsimit duhet ta ketë një vëmendje të veçantë, edhe nga cilësia e teksteve, por edhe nga përmbajtja. Ne kemi pasur vërejtje prej shkollave nga viti në vit, se nëpër libra ka shkrime të pakuptueshme për nxënësit apo joadekuate për moshën që kanë ata, apo shembuj me fotografi të ilustruara, që prapë nuk kanë qenë adekuate. Mendoj që edhe këtu ne duhet të përkushtohemi si Qeveri, ta rritim kontrollin.

Te mirëmbajtja e rrugëve, u tha keqmenaxhimit i kontratave të ndërtimit. Ne çdoherë kemi problem me keqmenaxhim të kontratave. Kur ka keqmenaxhim të kontratave, kur nuk realizohet plani dinamik me të cilin ka fituar kompania në fjalë, operatori e ka fituar kontratën, ndoshta pikë kryesore ka marrë te plani dinamik, por nëse e ka pasur planin ta kryejë për 60 ditë, kemi plot kontrata në Republikën e Kosovës që janë lidhur për 60 ditë, e janë ndoshta 3 vjet që nuk kanë përfunduar. Edhe këtu duhet të rritet niveli i përgjegjësisë, se nuk është në interes të vendit

që ne t'i zvarritim këto çështje, dhe ndoshta kalojnë edhe kufijtë e kontrollit, ndoshta del deri te puna e organeve të drejtësisë, nëse kemi shkelje të tilla.

Unë kërkoj nga Qeveria që ta rrisë nivelin e kontrollit. Kërkoj që të ketë një plan konkret të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit, në këtë rast vetë Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave, i cili i ka mbështetur rekomandimet e Auditorit. Të kemi raport këtu në Kuvend, ashtu siç thuhet, sepse ne nuk po kemi raport për zbatimin, as s'po kemi plan të qartë, por as s'po kemi raportim nga Qeveria, deri më tani s'e kemi pasur një raportim konkret për zbatimin e rekomandimeve, gjë që është me interes të veçantë që këto rekomandime të zbatohen nëse duam t'i përmirësojmë me këtë fushat e përgjithshme të menaxhimit të shtetit, por edhe nëse duam që një paraja publike të qeveriset mirë ashtu siç duan edhe qytetarët e Republikës së Kosovës dhe qysh është në interes të qytetarëve.

Unë e mbështes këtë raport si deputet dhe konsideroj që ky raport duhet të përkrahet si i tillë nga të gjithë kolegët, por të njëjtën kohë duhet të punohet më shumë nga organizatat buxhetore në përmirësimin e procedurave atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ne sot po e shqyrtojmë raportin vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe gjatë leximit të këtij raporti, normalisht ato që u përmendën edhe në fjalën e Auditorit të Përgjithshëm, që vërtet ashtu siç e theksuan edhe kolegët deputetë, unë e përgëzoj Auditorin, njëkohësisht edhe vetë Zyrën, personalin që ka punuar në këtë raport, i cili paraqet një gjendje reale, por shqetësuese mbetet ajo që rekomandimet nuk zbatohen, ashtu sikur është shqetësuese shumë herë edhe raporti i Avokatit të Popullit dhe raporte tjera të institucioneve të pavarura.

Unë sot e kam marrë për shkak se kam hyrë në detaje, për t'u ndalë te ky raport, e në veçanti te komunat, dhe tani jam ndalë pak më tepër për ta shikuar raportin e auditimit në Komunën e Gjakovës, nga se dje deputetja Mimoza Kusari-Lila doli në foltore të Kuvendit dhe me shumë pompozitet foli për të arriturat. Unë para qytetarëve, para deputetëve, flas se për të gjitha ato që kanë ndodhur në qeverisjen e zonjës Kusari-Lila e kemi vetëm një raport. Ka shumë raporte të tjera, por ashtu siç ajo vetëm di të flasë dhe absolutisht asnjëherë nuk ka punë efektive, po i theksoj disa çështje më me rëndësi të konkluzionet e përgjithshme mbi qeverisjen, që thuhet në raport: zbatimi i dobët i rekomandimeve, një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të Auditorit, pasi kjo tregon se menaxhmenti nuk është duke i zhvilluar mjaftueshëm proceset ekzistuese dhe kontrollet. Pra, vetëm katër nga 18 rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm janë marrë parasysh nga qeverisja e zonjës Kusari-Lila.

Te zbatimi i rekomandimeve të gjetura nga viti paraprak, Komuna kishte adresuar vetëm një numër të vogël të rekomandimeve, kjo për arsye se nuk është zbatuar ndonjë proces rishikimi në veprimet e parapara me planin e veprimit dhe po zbatohen brenda afateve kohore dhe nga personat e ngarkuar për zbatimin e këtij plani. Rreziku: Disa rekomandime po përsëriten nga viti në vit dhe kjo tregon për vazhdimin e dobësive të njëjta të kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare, që kanë rezultuar në veçanti me keqklasifikim të shpenzimeve. Po flasim pra për zonjën Kusari-Lila, që do të ishte të jetë këtu, dhe regjistrim jo i plotë i pasurive.

Tutje, te pyetësi i vetëvlerësimit, që është me shumë rëndësi, këtë që di më së miri ta bëjë zonja Kusari-Lila, pra te pyetësi i vetëvlerësimit zonja Kusari-Lila ka punuar për ta vlerësuar veten me notën maksimale, e këtë e thekson në veçanti ky raport. Komuna nuk ishte vetëkritike dhe mjaft objektive në plotësimin e pyetësorit në vetëvlerësim. Në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e prokurimit janë identifikuar shumë dobësi, ndërsa përgjigjja në vetëvlerësim lidhur me procesin e prokurimit ishte vlerësuar me notë të lartë. Kjo i bie që ia ka vënë vetes notën dhjetëshe. Vetes!

Tjetra, tek rreziku, vlerësimi i proceseve, duke mos i përshkruar edhe dobësitë shqetësuese, krijon një pasqyrim të pasaktë në cilësinë e menaxhmentin të përgjithshëm të financave dhe efektivitetin e kontrollit dhe rrit rrezikun që menaxhmenti të mos i pranojë lëshimet nga mangësitë ekzistuese, ndërkohë që situata faktike është ndryshe.

Vlerësimet joobjektive, siç kanë ndodhur, pra siç i ka bërë Kusari-Lila, të proceseve shpijnë edhe në vendimmarrje të gabuar. Te raporti menaxherial dhe llogaridhënës, dobësi në kontrollet menaxheriale, prioritet i lartë. E gjetura: rishikimi ynë, pra thotë Auditori, i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të Komunës ka nxjerrë në pah një raport joefektiv financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat të menaxhmenti i lartë, si dhe analizat e pakompletuara. Rrjedhimisht, draft-pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me pasaktësi dhe gabime. Fushat kryesore në të cilat kërkohet përmirësim janë: planifikimi i projekteve kapitale; menaxhimi i borxheve dhe të hyrave. Te rreziku, mosraportimi dhe aktivitetet të menaxhmenti i lartë redukton aftësitë e menaxhimit për t'i menaxhuar aktivitetet e Komunës në mënyrë proaktive, si dhe ul efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo, gjithashtu, mund të ndikojë që të hyrat të mos alokohen siç pritet. Ngjashëm ka qenë edhe në vitin paraprak.

Më lejoni, ky është pra një fakt, për të treguar që në fund të këtij raporti është një letërkonfirmim, që zonja Kusari-Lila si ish-kryetare, e cila kishte marrë një dush të ftohtë, ashtu siç e kishte pranuar më 11 qershor, vetë kishte thënë që “Komuna e Gjakovës ma dha një dush të ftohtë”, sepse e kishte vlerësuar me një numër të votave shumë pak, ngase ishte kryetare, por për fat kishte hyrë në ombrellën e LDK-së dhe e zuri karrigen e deputetes, përndryshe asnjëherë nuk do të vinte në shprehje.

Në fund, letërkonfirmimi, në atë letërkonfirmim që janë tri pika, e unë po e lexoj vetëm një, pra pika e tretë thotë “brenda tridhjetë ditëve nga pranimi i raportit final të Auditorit, do të ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do t’i përfshijë aktet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre”. Në fakt, kjo që ka ndodhur, që është shkruar, nuk është realizuar kurrë. Ka edhe shumë e shumë të gjetura të Auditorit, që e pasqyrojnë një realitet të menaxhimit të Komunës nga zonja Kusari-Lila, e cila nuk jetoi kurrë në Gjakovë, por jetoi në Prishtinë dhe tanimë do të konfirmohet edhe më 19 nëntor.

Dhe, në fund, për tre vjet rresht, unë do t’ia bëj një pyetje parlamentare ministrit të Pushtetit Lokal, tre vjet rresht nuk punon ueb-faqja e Komunës sonë. Tre vjet rresht! Dhe, përderisa zonja Kusari-Lila ka thënë që problemi është në ministri, unë, meqë nuk e kemi ministrin këtu, do ta parashtroj një pyetje parlamentare për ta parë se si është e mundur që një komunë shumë e madhe si Gjakova për tre vjet rresht të mos i funksionojë ueb-faqja e saj? Atëherë, për çfarë transparence flasim, për çka flasim këtu, përderisa qytetari nuk ka qasje në ueb-faqen e Komunës.

Prandaj, unë edhe një herë kisha thënë që Kuvendi dhe foltorja të përdoret sinqerisht për pikat e rendit të ditës, të cilat na vijnë përpara, por në fakt përderisa dje zonja Kusari-Lila e përdori foltoren, unë i them që 19 nëntori do të tregojë edhe një herë që qeverisja do të udhëhiqet nga Ardian Gjini, sepse është më parimor, është më konkret dhe nuk flet shumë, por punon shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Auditori i Përgjithshëm nga viti në vit konstaton shkelje të mëdha që ndodhin në institucionet e dy niveleve, por edhe në agjencitë e pavarura. Në vazhdimësi Auditori ka konstatuar shkelje, por çka është për t’u theksuar dhe shqetësuese është se askush nuk ka dhënë përgjegjësi. Në një të kaluar të afërt na ka rastisur të shohim në mënyrë pompoze raportin e Auditorit duke iu drejtuar kryeprokurorit të shtetit, i cili me gjasë tash, sipas dyshimeve, po del falsifikator, dhe vërtet raporti i Auditorit, përpos shqyrtimit në Kuvend, duhet të jetë në duart e prokurorëve, sepse ka shumë punë.

Ne nuk duhet ta kërkojmë ujkun sipas fërkemit, po ta kërkojmë aty ku është dhe ujku, sipas këtij zhargoni popullor, po dihet që është në institucione te keqpërdoruesit, që tashmë janë të zgjedhur politikë, por edhe shërbyes civilë.

Tabelat e prezantuara në këtë raport tregojnë për ngritje të papërgjegjesisë në institucione, sepse rekomandimet e pazbatueshme, për shembull, në rast se kanë qenë 403 më 2014, më 2015 kanë kaluar në 439. Nuk ka ndodhur ajo që duhet të ndodhë, por ka pasur ngritje të papërgjegjesisë në

institucione të zyrtarëve të caktuar, të cilat po i konstaton edhe Auditori. Midis institucioneve që nuk po i zbatojnë rekomandimet, për fat të keq janë edhe Kuvendi dhe Qeveria, për të cilët ka nga tri rekomandime të pazbatueshme, që s'i kanë zbatuar dhe tjerat që pjesërisht i kanë zbatuar dhe kjo është një sinjal edhe për këtë Qeveri të re dhe për këtë Legjislaturë të Kuvendit se megjithatë duhet të mësohemi t'i respektojmë ne të parët rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm, e pastaj të kërkojmë edhe nga të tjerët.

Ajo që është më shqetësuese dhe që faktikisht e ka dëmtuar imazhin edhe të Kosovës dhe reputacionin e shtetit të ri, domethënë edhe karshi miqve ndërkombëtarë, janë të gjeturat në prokurimin publik. Në rast se Auditori si kontroll i brendshëm konstaton se ka lidhje të kontratave financiare pa zotime, këtu ka punë prokurori i shtetit dhe për këtë unë publikisht shpreh shqetësimin për neglizhencën e organeve të drejtësisë në raport me të gjeturat e Auditorit dhe mosmarrjen seriozisht me këto të gjetura.

Në prokurimin publik tashmë është fenomen në të gjitha njësitë buxhetore kryerja e pagesave pa u kryer ende kontratat, ose pa u kryer punimet. Rasti eklatant është në Komunën e Prizrenit, ku për shembull Shtëpia e Kulturës në Zhur është e papërfunduar, ndërsa mjetet financiare janë derdhur te kompania e papërgjegjshme.

Ajo që na ra ta dëgjojmë edhe nga Auditori i Përgjithshëm se ka kompani publike të cilat punojnë me humbje, dhe prandaj shtrohet pyetja, si ka mundësi të vazhdojnë të punojnë me humbje dhe a ekziston mundësia që të rishikohen të gjitha bordet që zgjidhen dhe që i japin përgjegjësi edhe Kuvendit, por edhe Qeverisë, që faktikisht ato borde të papërgjegjshme që i kanë çuar kompanitë në humbje nga moskontrolli i duhur, të zëvendësohen për rritjen e përgjegjësisë?

Auditori i Përgjithshëm nga viti në vit ka gjetur shkelje nëpër njësi buxhetore dhe unë mendoj se shkeljet, si në qeverisjen lokale, si në qeverisjen qendrore, nëpër ministri dhe agjenci të tjera buxhetore, duhet të merren seriozisht edhe nga Kuvendi, por veçanërisht nga organet përgjegjëse që janë të thirrura për t'i ndjekur keqpërdoruesit e taksave të qytetarëve. Natyrisht, Auditori në vazhdimësi konstaton edhe shkelje të tjera ligjore, për shembull lidhja e kontratave mbi vepër, siç është rasti në Prizren me 120 kontrata, prej të cilave tashmë dihet se bëhen për fushata elektorale, kur punësohen militantë politikë të partive të caktuara. Dhe, një fenomen tjetër që është konstatuar nga Auditori i Përgjithshëm është se lidhja e kontratave nën 10 mijë euro me klientët e parapolitikës së partive që qeverisin njësitë buxhetore, ose organizatat e caktuara buxhetore.

Të gjitha këto e përbëjnë një gamë të problemeve, me të cilat përballohet shoqëria jonë dhe shteti i Kosovës, prandaj unë edhe një herë i ftoj publikisht, kuptohet nëse ka mbetur ndërgjegje, organet e drejtësisë që të merren seriozisht me të gjeturat e Auditorit dhe njëherë e përgjithmonë

shkelësit e ligjit, e veçanërisht keqpërdoruesit e parasë publike, të japin përgjegjësi me idenë dhe qëllimin e mirë që kjo të mos përsëritet nga viti në vit, sepse raportet e Auditorit, jo vetëm, siç tha zoti Hoti për zotin Besnik Osmani, se edhe në të kaluarën ka pasur raporte dhe të gjetura korrekte, por që qeveritë dhe organet tjera nuk janë marrë seriozisht me këto të gjetura. Unë i dëshiroj sukses Auditorit të Përgjithshëm edhe në të ardhmen, por besoj që trysnia ndaj keqpërdoruesve duhet të jetë në nivelin më të lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Në raportin e Auditorit theksohet një çështje, që besoj se është me e ndjeshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ai thotë, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës kanë të drejtë për trajtim të barabartë mjekësor, por faktet qëndrojnë ndryshe. Auditori, me të drejtë thekson që ka dështuar komplet monitorimi i zbatimit të programit për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Tashmë është e qartë që jo vetëm se nuk ofrohet cilësi e duhur nëpër institucionet shëndetësore publike, por edhe nuk ka, disa shërbime është e pamundur dhe nuk ofrohen aty. Prandaj, pacientët janë të detyruar që këto shërbime t'i kërkojnë edhe nëpër institucione private, po në të shumtën e rasteve në institucionet jashtë vendit.

Auditori me të drejtë thekson se Ministria e Shëndetësisë ka dështuar që ta instalojë një program kompjuterik, ku do të shihej qartë se si administrohen aplikacionet sipas renditjes dhe sipas prioritetit të sëmundjeve, sepse është shumë e qartë që nuk ka nevojë që të gjitha sëmundjet të trajtohen jashtë vendit. Kjo ka ndodhur normalisht me mundësi të ndryshme që njerëzit kanë depërtuar aty dhe kanë përfituar nga fondet që fare nuk u kanë takuar. Do të thotë, pamundësia e përcjelljes së të dhënave, mungesa e një programi adekuat, e ne e dimë se SISH-i është në përgjithësi hallka më e dobët në sistemin shëndetësor, domethënë nuk kemi të dhëna, e sidomos është e ndjeshme aty ku kërkesa është shumë e madhe dhe pastaj përgjigjja është e vogël.

Prej 1 859 kërkesave, 512 aplikacione nuk janë shqyrtuar fare, mirëpo Ministria e Shëndetësisë nuk ka ofruar përgjigje të saktë se përse janë refuzuar këta aplikues. Po ashtu, Ministria e Shëndetësisë, siç thekson Auditori, nuk ka ofruar një monitorim të saktë të mjeteve financiare dhe ka mbetur plotësisht e pamonitoruar pjesa e financave, do të thotë nuk dihet qartë se ku kanë shkuar këto mjete.

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Ne e dimë se të gjithë i kemi dy zgjidhje. Qysh dje u debatua këtu shumë për shëndetësi, në veçanti për Ligjin për sigurime shëndetësore dhe tanimë dihet se së paku deri në vitin 2019 ky ligj nuk ka gjasa që të implementohet. Dhe, sot ne kemi monopolin e sigurimeve private

shëndetësore, të cilët normalisht se në këtë situatë do të përfitojnë, por janë të paktë ata qytetarë që kanë nevojë për trajtim jashtë vendit, e që kanë mundësi t'u drejtohen këtyre kompanive, që edhe ashtu janë shumë jokorrekte, sepse ofrojnë polisa njëvjeçare, nuk i marrin fare për bazë njerëzit që janë mbi moshën 65-vjeçare kur kanë nevojë për trajtim dhe zakonisht ndodh që ata që sëmuren gjatë asaj periudhe njëvjeçare të mos u vazhdohet polisa.

Pra, kjo mundësi, që është vetëm një përqindje tepër e vogël e qytetarëve, që faktikisht nuk kanë mundësi t'i marrin disa shërbime në vend, atëherë duhet t'i drejtohen Ministrisë së Shëndetësisë për të aplikuar për familjarët e vet për këto shërbime jashtë vendit, e fatkeqësisht tash e 18 vjet nuk kemi arritur t'u sigurojmë shumë shërbime që ka qenë e mundur, për shkak të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit edhe të atyre mjeteve financiare që i ka pasur në disponim Ministria e Shëndetësisë, jo vetëm nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, por edhe nga shumë donacione që i ka marrë Ministria e Shëndetësisë.

Trajtimi i pacientëve jashtë vendit do të mbetet një sfidë. Unë ju siguroj që kërkesat do të rriten, sepse edhe nëse dyfishohet Buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë do të jetë e pamundur pa një strategji të mençur që të ketë rritje të gamës së shërbimeve shëndetësore në vend. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka paraparë në programin e vet bashkëpunimin me Republikën e Shqipërisë. Do të ishte shumë mirë që shumë mjete që derdhen jashtë vendit të orientohen në një program mbarëkombëtar, duke menduar për qendra referente, sepse e dimë që shërbimet që më së shumti kërkohen për trajtim jashtë vendit janë ato që kanë të bëjnë...

**KRYESUESI:** Ju lus për qetësi ju Grupin Parlamentar të LDK-së!

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Po me vjen keq, qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, përderisa ne flasim këtu për shëndetësi, zakonisht në Kuvendin e Republikës, le ta dinë të gjithë, nuk ka disponim të dëgjohet për shëndetësinë, e pastaj trumbetojnë se e kanë prioritet. Më vjen keq, kjo është përvoja ime edhe në mandatin e kaluar, por edhe tani, që shumë deputetë kur flasim për këto tema të ndjeshme kanë tema ndërmjet tyre që t'i bisedojnë, ndërsa unë po flas për një segment tepër të ndjeshëm, që ju kur të dilni në Prishtinë, në qendër të qytetit, po jo vetëm në Prishtinë, do të shihni fëmijë që kërkojnë fonde, fëmijë të tjerë të sëmurë nga sëmundjet malinje, duke kërkuar fonde për trajtim jashtë, jo vetëm që nuk po i ndërtojnë këto shërbime në vend, por edhe nuk po u mundësojnë trajtimin jashtë vendit. Do të thotë, nuk kemi qasje si po menaxhohen fondet për këtë trajtim, se nuk i ka afruar ministria, Auditori thekson qartë tani e dy vjet është kërkuar të aplikohet një program kompjuterik, ku do të kemi të qartë si po shpenzohen mjetet, ku po destinohen këto mjete, a po shqyrtohen aplikacionet me renditje siç është aplikuar dhe me prioritet sipas sëmundjeve.

Më së shumti ka kërkesa për trajtim të sëmundjeve të zemrës, do të thotë, për kardiokirurgji dhe për sëmundje onkologjike, do të thotë për sëmundje malinje.

Prandaj, siç e ceka, në takime që do t'i ketë Qeveria me Republikën e Shqipërisë duhet të trajtohet me një vëmendje të theksuar çështja e qendrave referente dhe së paku fondet që i destinojmë për jashtë vendit këta pacientë t'i drejtojnë fillimisht në Republikën e Shqipërisë, ku në të ardhmen do të mendonin për qendra referente për onkologji dhe kardiokirurgji, ku njëra mund të fokusohet në Republikën e Kosovës, e tjetra në Republikën e Shqipërisë. Së paku, këto fonde të mos na shkojnë, të dinë cilat janë qendrat, ku drejtohen autobusët me pacientët tanë hallexhinj që nuk po gjejnë fatkeqësisht shërim në vend.

Unë mendoj që jo vetëm ky segment, do të thotë vetëm programi i trajtimit të pacientëve në gjashtë institucione të shërbimeve publike ka nevojë për një auditim, por edhe të gjitha departamentet e Ministrisë së Shëndetësisë për keqmenaxhim dhe keqpërdorim të fondeve publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Do të mundohem të jem shumë e shkurtër. Më kujtohet, bazuar nga përvoja ime kur kemi filluar ngritjen e kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, kemi pasur disa vjet konsideratë për organizatat buxhetore, për të cilat Auditori ka raportuar për të gjeturat në keqmenaxhim, ka pasur edhe në keqpërdorim të gjetura, por ne kemi bërë arsyetimin se na mungojnë kapacitetet e mjaftueshme të organizatave buxhetore.

Po sot, nuk ka më asnjë arsye që organizatat buxhetore të kenë rekomandime të kualifikuara apo rekomandime, të cilat përsëriten prej viti në vit.

Ne si Kuvend, kur e shqyrtojmë raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, japim vlerësimin për vetë Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Ndërsa, për shkelje të cilat ne i theksojmë këtu, unë konsideroj se tashmë shteti ynë është i konsoliduar dhe ka organe të drejtësisë, në këtë rast Prokurorinë, e për të gjitha rekomandimet e kualifikuara duhet të merret Prokuroria.

Dhe, me theks të veçantë, për të na kursyer ne si deputetë nga subjektiviteti ynë politik, e që ndonjëherë dalim edhe në banalitet, duke marrë këtu shembull njërin kundërshtar politik se si i ka dalë auditimi, duke e harruar atë zyrtarin tonë që e kemi përkrah, ndoshta edhe nuk e shikojmë, pra nuk jemi korrektë.

Në qoftë se ne si Kuvend duhet ta vlerësojmë vetë Zyrën Kombëtare të Auditorit, atëherë unë personalisht e vlerësoj lart këtë institucion dhe më vjen shumë mirë që ky institucion punon relativisht i pavarur dhe profesionalisht tashmë është i konsoliduar dhe i përgatitur.



Më vjen mirë që opinionin në Kosovë dhe ne si deputetë i besojmë më shumë këtij institucioni se sa auditorëve të jashtëm, qoftë edhe atyre ndërkombëtarë.

Bazuar në këtë çka thashë dhe në realitetin në shtetin tonë, unë mendoj se kemi nevojë t'i amendamentojmë disa ligje që auditimi të jetë më efektiv. Për shembull, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit ka obligim të auditojë çdo organizatë buxhetore, të cilat funksionojnë nëpërmjet apo me paranë publike. Raste konkrete që nuk janë të përfshira për t'u audituar nga kjo zyrë kemi RTK-në dhe BQK-në, pra Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të cilat organizata buxhetore janë përjashtuar me ligj që të mos auditohen nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Ne nuk kemi rast më konkret se sa RTK-në, institucion që na i bie raportet e Auditorit të jashtëm apo ndërkombëtar dhe, sipas këtyre auditiveve çdo gjë në RTK është në rregull. Por, realitetin ne të gjithë e dimë se në Radiotelevizionin e Kosovës ka probleme edhe të performansës, ka probleme edhe buxhetore.

Prandaj, unë konsideroj se ne si deputetë urgjentisht duhet të ndryshojmë Ligjin e RTK-së dhe ta respektojmë Kushtetutën dhe falë profesionalizmit dhe pavarësisë të auditimit tonë, pra të Zyrës Kombëtare të Auditimit, Auditori ta kryejë punën edhe në këtë organizatë buxhetore që është tërësisht publike.

Njëkohësisht kemi rastin edhe me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, një institucion shumë i rëndësishëm për vendin, i cili përjashtohet nga auditimi.

Unë konsideroj se ne duhet të merremi me këto çështje, duhet të kemi parasysh legjislacionin aktual, ku ne duhet të bëjmë ndryshme, duhet t'ia mundësojmë Auditorit të punojë më lehtë, më korrekt dhe më drejtpërdrejt dhe njëkohësisht të insistojmë që çdo organizatë apo çdo para publike të jetë audituar dhe raportuar nga ky institucion shtetëror. Mendoj se si Kuvend kemi përgjegjësi dhe obligim dhe në qoftë se ne duam të japim shembull qoftë Auditorit, qoftë Prokurorisë si deputetë që ata duhet të jenë korrektë, në radhë të parë duhet të jemi vetë. Nuk mund të shndërrojmë çdo temë këtu në çështje politike, fushate, sepse është vërtetë ndonjëherë shumë e ulët e ndonjëherë edhe banale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Në radhë të parë unë si deputet i ri po e shoh një shqetësim të jashtëzakonshëm dhe një bindje tanimë absolute të krijuar që ky krim i keqpërdorimit të parasë publike që është tani i faktuar, i

dokumentuar nga të gjitha qeveritë e kaluara, bazën e vet dhe strehën e vet e ka brenda Parlamentit të Kosovës.

Pse e them këtë? Sepse deputetë këtu, të majtë e të djathtë, të qeverive të kaluara kanë bërë regrutimin tamam si në shtetet policore të anëtarëve të bordeve. Nuk kanë dashur këta të dërgojnë anëtarë të bordeve nëpër ndërmarrje publike që kontrollojnë keqpërdorimin dhe hajninë e parasë publike, por kanë dashur të dërgojnë anëtarë nëpër borde që t'i mbulojnë hajnitë e këtyre, që këta i kanë bërë në bashkëpunim me drejtorët e përzgjedhur të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të ndryshme.

Do të thotë, këtu është fillesa e krimit të organizuar të keqpërdorimit dhe të hajnisë të parasë publike dhe kjo është përgjegjësia kryesore, sepse për të qenë absurdi edhe më i madh, ish-zonja presidente e vendit, Atifete Jahjaga, në vend që ta mbështesë Auditorin e Përgjithshëm dhe institucionin brilant, shkon për qejfin e institucioneve ndërkombëtare, vetëm sa për sy e faqe e formon një task-forcë për luftimin e korrupsionit.

Atëherë lind pyetja: cili ka qenë rezultati i kësaj task-force? Çka ka bërë kjo task-forcë në krye me Atifete Jahjagën? Asgjë, vetëm kanë bërë keqpërdorimin e parasë publike, vetëm kanë marrë fondacione të ndryshme. Do të thotë, përgjegjësia bie drejtpërdrejt në radhë të parë mbi deputetë të ndryshëm që kanë bërë regrutimin e njerëzve të cilët kanë shkuar qëllimisht, me porosi të qëllimshme për të kontrolluar dhe për ta keqpërdorur paratë publike.

Po kaloj në sektorin e shëndetësisë që e nderuara deputete e tha me shumë vend, sepse krimi më i madh që është bërë në palcën kurrizore të qytetarëve të Kosovës është pikërisht shëndetësia.

Po e përmend me emër dhe mbiemër, një doktor shumë të respektuar që zonja edhe mund ta njohë, doktor Agron Lumnjanin, në Gjermani, që është në ajkën e mjekëve më të njohur gjermanë radiologë. Ky njeri i ka sjellë donacion Qendrës Spitalore katër milionë falas aparate të radiologjisë dhe nuk ia ka pranuar Ministria e Shëndetësisë. A e dini pse? Sepse duhet këta të shpallin tender dhe të vjedhin 20%-shin, këtu ka qenë hilja.

2. Me keqardhje e them, e kam një vërtetje te Zyra e Auditorit. Si ka mundësi që e kalon pa auditim piramidën e krejt krimit të organizuar ekonomik në Kosovës, që është Postë-Telekomi i Kosovës.

Kjo është e habitshme, domethënë e bën Auditori auditimin e ndërmarrjeve të bërlllokut dhe nuk e bën auditimin e piramidës së krimit në Kosovë, sepse kjo piramidë, përpos që i ka shkatërruar të gjithë ata punëtorë atje, ka një milion fakte për keqpërdorime milionëshe që i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës dhe taksapaguesve të Kosovës.

Kjo, të nderuar deputetë, duhet t'ju lë përshtypje kjo vërejtja ime në raportin e Auditorit, sepse të gjithë drejtorët, të cilët kanë qenë në Postë-Telekomin e Kosovës, kanë qenë të emëruar drejtpërdrejt nga Partia Demokratike e Kosovës. Edhe drejtori aktual, i cili fillimisht e ka shkatërruar aeroportin, e pastaj prej aeroportit ka ardhur në Postë-Telekomin e Kosovës. Së pari i ka sjellë nja 20-30 vetë me listë për t'i punësuar në Radiotelevizion të Kosovës, me listë dhe me urdhër. Pasi i ka punësuar dhe i ka rehatuar këta njerëz dhe pasi e ka vendosur vëllain e vet drejtor financiar në Radiotelevizion të Kosovës, ka shkuar për ta shkatërrua Postë-Telekomin e Kosovës, ku nëpërmjet parasë publike i shantazhon dhe i blen jo vetëm gazetarët, por edhe njerëzit e ndryshëm brenda Policisë, brenda Prokurorisë, brenda institucioneve politike.

Tani, po kaloj te Radiotelevizioni i Kosovës. Pse po them, pse po them që fillesa e zinxhirit të krimit buron nga Parlamenti. Sepse ju, të nderuar deputetë, e keni lejuar Radiotelevizionin e Kosovës që të mos e pranojë Zyrën e Auditorit Kombëtar. Radiotelevizioni i Kosovës e ka Auditorin, të cilin e ka caktuar vetë dhe në bashkëpunim me të bëjnë kontrollin e financave të veta bash qysh të donë dhe nuk janë pak para, të cilat dedikohen për Radiotelevizionin publik.

Në qoftë se ne vazhdojmë të lejojmë që ata të sillen sikur këto para të jenë të xhepave të tyre, dy-trembëdhjetë milionë, dhe të trajtohen Radiotelevizioni i Kosovës dhe Postë-Telekomi i Kosovës si prona private, të nderuar deputetë, këto nuk janë ndërmarrje publike dhe këtë e dokumentoj dhe e argumentoj me një milion fakte para cilido prokuror të Kosovës.

Po e përmend një letër, të cilën e kam pranuar nga punëtorët brenda Postë-Telekomit të Kosovës.

Ju lutem, ju lutem, deputetë të nderuar, kërkoj ta krijojmë një komision hetimor për ndërmarrjet publike. Shkoni dhe pyetni drejtorin e Postë-Telekomit të Kosovës si ka mundësi që e ka caktuar Zyrën ligjore të shokëve të vet për ta mbrojtur në kontestin e arbitrazhit me Z-mobile, kur Postë-Telekomi i Kosovës e ka zyrën brendapërbrenda, Zyrën ligjore.

Po shkojmë te Agjencia për Zhvillim Bujqësor. A e dini, të nderuar deputetë, që aq shumë ka keqpërdorime në këtë agjenci me subvencionet e bujqve, sa që një traktor është shënuar tri herë te bujq të ndryshëm dhe a e dini cili është çmimi i këtij traktori: 46 mijë euro, sikur të ishte Porsche, jo traktor.

Prandaj, unë për këtë do të flisja nja 10 orë, po ta dini që Ligji i prokurimit është caktuar me qëllim për të vjedhur, sepse hajnia fillon te drejtori i prokurimit, kalon te sekretari permanent i ministrive dhe prej sekretarit permanent kalon te ministri. Po, kur vjen puna te burgu, ministri thotë: "Unë gjë nuk di", sekretari permanent i ministrisë thotë: "Unë gjë nuk di", e ha ai i shkreti, ai drejtori i Zyrës së Prokurimit, i cili nuk bën asnjë veprim pa e pyetur ministrin dhe sekretarin permanent. Kjo është 100%, e dokumenton ministri atje, se ai nuk ka vjedhur ende, ai mund të

flasë, se nuk e kam gjetur që është hajn. Ata ministra që janë hajna, ata nuk guxojnë të flasin, ata që nuk janë hajna, dalin këtu dhe thonë: “Ajo është më se e vërtetë”.

Dhe, në fund, e kam një propozim: nuk ka nevojë ne me task-forca, po e ftoj Prokurorinë e vendit të marrë për bazë Auditorin e Përgjithshëm dhe këtë raport dhe të fillojë hetimet në të gjitha ndërmarrjet publike, në Qeveri dhe në institucionet e tjera shtetërore. Faleminderit, zoti kryesues, faleminderit deputetë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Sot po e shqyrtojmë një raport të Auditorit, ku kemi parë shumë vërejtje, edhe pse ne të gjithë kishim dyshime në këtë qeverisje që kaloi, mirëpo këto dyshimet u dokumentuan nga ky raport.

Po filloj me vërejtjet në reformën e administratës publike. Edhe përkundër aprovimeve të sistemit të ri të pagave, në këtë raport nuk gjetën zbatim, domethënë u vërejt që nuk u gjet zbatim në praktikë.

Besojmë që kjo dukuri është për shkak të favorizimeve të njerëzve të afërt me pushtetin, edhe pse të punësuarit e kryejnë punën e njëjtë, po në institucione të ndryshme kanë dallim të madh në paga.

Gjithashtu, në këtë raport janë cekur edhe favorizimet e operatorëve tenderues, siç thanë edhe parafolësit e mi, domethënë për një mostransparencë të tenderëve dhe kjo dihet pse është bërë.

Paraprakisht, kjo është bërë për shkak se këta janë edhe financues të pushtetarëve.

Vërejtje tjetër kemi në shërbimin mjekësor, ku ceket saktë se qytetarët marrin shërbime shëndetësore jocilësore.

Gjithashtu edhe në aspektin shëndetësor vërejtje kemi sa i përket trajtimit të pacientëve jashtë vendit, për shkak se është ndarë një shumë e madhe prej 7,8 milionë eurosh dhe në këtë program fatkeqësisht nuk kanë përfituar pacientët që kanë pasur nevojë, mirëpo e keqja më e madhe se prej 512 rasteve, këtu kanë përfituar vetëm disa raste, e fatkeqësisht edhe në shërim po kërkojnë lidhje partiake.

Vërejtje kemi edhe te mbrojtja e mjedisit, edhe pse nuk u kushtohet vëmendje shumë rasteve, domethënë vëmendje të veçantë, një rast të tillë kemi edhe në komunën e Prizrenit, te deponia e

mbeturinave në Landovicë, edhe pse të gjithë qytetarët kanë dhënë shumë vërejtje, ato asnjëherë nuk janë marrë parasysh.

Dua të cek edhe një gjë shumë shqetësuese nga fondi i zhvillimit, i cili krijohet nga të hyrat e doganave dhe atë të dy pikave në veri të Kosovës që realisht ky fond duhet të menaxhohet nga bordi që përbëhet nga ministri dhe përfaqësuesi i BE-së, e që është shqetësuese, se investimet në atë pjesë po bëhen pa u pyetur fare ky bord.

Edhe pse janë paraqitur një numër i madh i rekomandimeve, ne shpresojmë që do të merren parasysh, mirëpo shqetësimet i thanë po thuaj se të gjithë kolegët tanë këtu, por ajo çka është kryesore, vërejtje u dhanë se po bëhet politikë. Po, po bëhet politikë, sepse ky vend është vend ku zhvillohet politika, mirëpo fushata duhet të bëhet jashtë Kuvendit, jo brenda Kuvendit, kur dihet parasysh që të gjithë këta që po ngatërrohen mes veti kanë harruar që për një periudhë të caktuar herë një subjekt politik e herë tjetri kanë qenë në bashkëqeverisje dhe kur dihet që të gjitha këto keqpërdorime i kanë bërë duke qenë në bashkëqeverisje herë me njërin subjekt e herë me tjetrin.

Mirëpo, atë që jemi më kureshtarë ne, kur i shohim gjatë vitit 2016 gjithë këto vërejtje dhe kur e dimë që kanë qenë dy subjektet më të mëdha në qeverisje, çka mund të presim në periudhën 2017, kur e dimë që janë një numër i konsiderueshëm i subjekteve në bashkëqeverisje, e kur e dimë që janë me një numër shumë të vogël, por me apetite shumë të mëdha sa i përket hajnisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

**GLAUK KONJUFCA:** Po flas, Arben, se ka lidhje edhe me juve pak.

Nëse kushdo prej jush thotë që ky raport i Zyrës së Auditorit është korrekt dhe profesional, atëherë në të njëjtën kohë ka thënë që qeverisja e kaluar paska qenë katastrofë, për arsye se nëse e lexoni përmbajtjen e këtij Auditori, atëherë gjetjet janë me të vërtetë shqetësuese dhe brengosëse për shtetin e Kosovës.

Auditori thotë që nuk është monitoruar fondi për trajtimin mjekësor të pacientëve jashtë vendit, por pacientët janë trajtuar jo cili ka më shumë nevojë, po cili ka intervenuar te ministri.

Qeveria nuk ka marrë masa të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, sa i përket shkatërrimit dhe ndotjes, duke filluar që nga uji e deri te ajri.

Çantat e nxënësve nuk janë lehtësuar fare dhe nuk ka pasur kurrfarë projekti për këtë gjë dhe tekstet shkollore nuk janë rishikuar për t'u përmirësuar.

Ka dështuar prokurimi, tenderimi dhe kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve.

Ky konsiderohet si njëra prej fushave dhe aspekti më i sigurt i aferave korruptive. Pra, vetëm hetoni këtu, do ta ftojme Prokurorinë që të hetojë më shumë, se këtu ka korrupsion sa të duash.

Tjetra, njëjtë ndodh, thotë Auditori, edhe me kontratat e ndërtimeve.

Pastaj nuk ka mbikëqyrje dhe monitorim të investimeve kapitale në ndërmarrjet publike. Prandaj, çka po më çudit mua? Mua po më çudit kur në mandatin e kaluar “Vetëvendosja” i thoshte të njëjtat, e ju që sot po e lavdëroni Auditorin raportin e tij, na kundërshtonit dhe na kritikonit. Të njëjtat po i thotë Auditori që opozita i ka thënë në mandatin e kaluar. Krejt këto keqpërdorime, të cilat kanë ndodhur.

Tash, çka ka problem Auditori i Përgjithshëm? Auditori i Përgjithshëm është dashur t’i ketë së paku trefishin e kapaciteteve me të cilat operon aktualisht.

Mendoj që po të kishte pasur Auditori edhe më shumë resurse njerëzore, edhe më shumë mbështetje financiare, unë mendoj që do të kishim pasur gjetje të shkeljeve edhe më të shumta, sa i përket performancës së organizatave buxhetore.

Shtrohet pyetja pse Auditori i Përgjithshëm kurrë nuk është përkrahur ashtu qysh duhet prej qeverive të Kosovës? Përgjigjja është shumë e thjeshtë. Qeveri të cilat e bazojnë konceptin e tyre në afëra korruptive dhe që donë të veprojnë qysh t’ua marrë mendja vetë dhe qysh u konvenon, e jo sipas ligjit, atyre nuk u konvenon fort auditimi, nuk kanë qejf shumë që Auditori të jetë i fuqishëm e profesional. Atyre u konvenon një auditor sa më i dobët, dhe jo veç kjo. Na shqetëson edhe më shumë fakti që vetëm 26% e rekomandimeve të Auditorit zbatohen.

Çka i bie kjo? Kjo i bie që ne e kemi një Auditor jo për t’i realizuar rekomandimet e tij, por e kemi një Auditor, i cili mjaftohet të shkruajë raporte. Kjo është brenga e vërtetë e këtij shteti.

Pra, zotin Besnik Osmani e paskemi aty si një shkruar të mirë të raporteve. Neve na vjen raporti në Kuvend, edhe punë e madhe, e votojmë apo nuk e votojmë, kaq ka konsekuenca kjo puna e Auditorit.

Tash, Auditori nuk është për të shkruar raporte, Auditori është që rekomandimet të cilat i jep, e ju po e shihni, 1 300 rekomandime paskan qenë, ato janë për t’u zbatuar.

Tash dua të flas edhe për ato anekset, të cilat nuk i gjeni në këtë raport, mirëpo janë në ueb-faqe, të cilat këta i kanë botuar.

Dua të flas sidomos për pjesën e veriut të Kosovës, katër komunat e veriut të Kosovës.

Komunat në pjesën e veriut të Kosovës e kanë një problem të madh, ato nuk i sjellin Kosovës asnjë cent në buxhet. Për shembull, në këto komuna nuk zbatohet fare Ligji i tatimit në pronë, si dhe i lejeve të ndërtimit. Po të zbatoheshin këto dy koncepte, edhe po të funksiononte ligji në veri të Kosovës, qysh po na gënjejnë të gjitha qeveritë pa përjashtim, atëherë do të zbatoheshin këto ligje dhe komunat do të vilnin të hyra shumë të nevojshme, të cilat edhe do ta lehtësonin në masë të madhe buxhetin e Republikës së Kosovës.

Leposaviqi, Zveçani, Zubin-Potoku dhe Mitrovica e Veriut i marrin, siç e dini ju, nja pesë milionë euro të gatshme prej këtij Fondit për Zhvillim, që u pati krijuar e që ne e patëm kundërshtuar, sepse është edhe një farë lloj autonomie e veriut ajo, që ata të marrin para drejtpërdrejt prej doganave.

Mirëpo, çka po ndodh këtu? Zubin Potoku, merreni me mend, njëra prej komunave me territorin më të madh në Kosovë, ka të hyra, realizon të hyra 2000 euro në vit, merreni me mend, 2000 euro në vit një komunë e Kosovës!

Auditorët kanë identifikuar, unë kam biseduar edhe me disa prej tyre, të cilët kanë shkuar dhe kanë bërë disa auditime në këtë pjesë, sidomos në Komunën e Mitrovicës së Veriut dhe atje auditorët kanë parë që në veri, në pjesën e veriut të Kosovës ekzistojnë edhe zyrat e Serbisë për pagesë të tatimit në pronë. Kaq sa i përket kësaj shuarjes së strukturave të paligjshme të Edita Tahirit. Pra, atje i keni krejt institucionet e Serbisë që funksionojë dhe askush nuk jep llogari për këto. Kjo i bie që edhe Serbia mbledh para në Republikën e Kosovës, kurse Kosova u jep para të gatshme këtyre komunave, që me qëllim nuk e vjelin asnjë të hyrë, sepse i marrin paratë e gatshme nga Fondi i Zhvillimit.

Auditori ka gjetur, për shembull, që në këtë komunë, për të cilën fola, pa kurrfarë llogarie një organizatë joqeveritare i janë dhënë 300 mijë euro, merreni me mend 300 mijë euro një OJQ-je dhe nuk tregohet aty, nuk ka shpjegim as kujt, as pse, as qysh? Pra, kështu ndodh në Republikën e Kosovës, nëpër komuna, veçanërisht në katër komunat e pjesës veriore të Kosovës.

Në anën tjetër, sipas Auditorit ka mospërputhje në mes të nevojave financiare dhe shpenzimeve të organizatave buxhetore.

Disa organizatave u teprojnë shumë para, e disa të tjerave nuk u mjaftojnë, ka deficit.

Tjetra, nuk është prezantuar rritja e borxheve publike. Borxhi publik po thonë është rreth 873 milionë euro dhe dihet mirë që sipas rregullave standarde mikrofiskale pjesëmarrja e borxhit publik në raport me buxhetin shtetëror nëse e kapërcen 30%-shin, atëherë rrezikohet seriozisht

përmbushja e nevojave dhe e projeksioneve. Kurse në Kosovë tash ky raport, siç po e shihni ju, ka arritur 46%, 46% e buxhetit tonë shtetëror janë borxhe publike.

Pra, borxhi publik faktikisht Kosovën po e fut në atë zonën e rrezikshme të shpërputhjes mes obligimeve dhe mundësive që kemi për t'i kthyer këto obligime.

Pra, buxheti në vend që të shërbejë për planifikimin e drejtë të shpenzimeve në interes të qytetarëve, po shërben edhe si platformë e mashtrimit elektoral. Pse po e them këtë? Sepse në buxhet ka të hyra për vitin 2016, 200 milionë më pak se projeksionet. Atëherë, çka i bie kjo? Kjo i bie që kemi pasur të bëjmë me një buxhet mashtrues. A nuk është mashtrim, mashtrimi është elektoral, janë vendosur 55 projekte, të cilat as që kanë filluar. Pse janë vendosur, kur të shkojnë këta nëpër fshatra të ndryshme nëpër fushatë elektorale t'u thonë aty fshatarëve që ja kanalizimi juaj, a po e shihni zërin buxhetor, e keni këtu, edhe kanalizimi, edhe ujësjellësi janë të gatshme. Ato barten vit pas viti, nuk realizohen as në vitin 2016, as në vitin 2017, as kurrë.

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi ka replikë.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Zoti Konjufca, me që ma përmende emrin.

Si duket e përmendi emrin tim për të shtuar vëmendjen, nuk e di çka, megjithatë unë të dëgjova me vëmendje. Zakonisht më pëlqen në diskutimet tua, por sot mendoj se ke pasur disa gabime jashtëzakonisht të rënda në konceptin e referimit gjeografik që shpesh e konsideroj si referim politik.

Veriu i Kosovës, çka definoni ju si veri të Kosovës? Unë mendoj se është gabim jashtëzakonisht i rëndë politik në qoftë se i referohesh një pjese të territorit të vendit si veriu i Kosovës, sepse ju e dini që ka një tendencë të vazhdueshme prej përfundimit të luftës së Kosovës që të krijohet një rajon politik i quajtur “veri i Kosovës” nëpërmjet Asociacionit të komunave me shumicë serbe, lidhjes vertikale të komunave me shumicë serbe dhe ky referim, mendoj se te ju mund të jetë gabim zhargonit, në shprehje, por është politikisht gabim, administrativisht nuk ekziston derisa nuk është formuar Asociacioni i komunave me shumicë serbe dhe teknikisht është i papranueshëm.

Pra, mendoj se duhet të jemi më të kujdesshëm kur u referohemi pjesëve gjeografike të vendit, të mos ketë konotacione politike, sidomos nëse i përdorim këto fjalë në Kuvendin e Kosovës.

Unë e di se kjo lloj reference është përdorur në të shkuarën dhe po ashtu ka raste ku përdoret edhe në dokumente të caktuara që prodhohen nga institucionet e Kosovës.



Prandaj, si vërejtje dhe sugjerim që të mos përdoret një diçka e tillë, sepse është e dëmshme për interesin nacional të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Arben, unë mendoj që sidomos në këtë temë jam shumë i kujdesshëm dhe kurrë nuk e përdor termin “Kosova veriore”. Po ta përdorja termin “Kosova veriore”, do të ishte term politik, ama veriu i Kosovës, pjesa e veriut të Kosovës është vetëm term gjeografik.

Pra, po të thosha Kosova veriore, ajo bëhet term i rrezikshëm politik njëmend, ama veriu i Kosovës është vetëm term gjeografik. Në atë pjesë gjenden katër komunat, të cilat unë i përmenda dhe nuk ka kurrfarë konotacioni politik. Po të doni të bëjmë politikë, politike është “Zajednica”, ama nënshkrimin aty e ka Isa Mustafa. Aty kryeministri yt i kaluar e ka nënshkrimin, po mos u frikëso, sepse nuk do ta lejojmë të ndodhë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kam fatin të flas pas një interpretimi relativisht të çuditshëm të raportit të Auditorit, strukturimi i tij, funksioni i tij dhe qëllimit të tij.

Meqë kam një përvojë të punës në Qeveri dhe të leximit të teksteve të tilla, do të përpiqem të shpjegoj sa më saktë dhe më shkurt, po pa pretendimin që ky të kthehet në mësim për kolegët.

Së pari, unë mendoj që Arbeni ka të drejtë, semantikisht Kosovë e veriut - veri i Kosovës është e njëjta gjë, nëse ne pastaj e kthejmë në nuanca politike, domethënë varet se si pozicionohemi dhe të kemi parasysh Asociacioni i Komunave u formua a s’u formua, kurdo që do të formohet, nuk do të jetë për një pjesë të Kosovës dhe sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese, do të lejojë mundësinë që pjesë e tij të jenë edhe të tjerët, por ne s’po flasim sot për atë çështje.

Tani për punën e Auditorit, së paku në tre vjet sa kam arritur ta ndjek unë, besoj që ka një hap cilësor, sepse auditori vërtet na vlerëson ne, vlerëson punën e Qeverisë, të organizatave buxhetore, por edhe ne kemi shansin që të vlerësojmë punën e auditorit, derisa e shohim se si raporton për ne. Dhe, unë besoj që sidomos prej që ne kemi një ekip të ri në krye të Zyrës Kombëtare të Auditorit, ka edhe një performansë, rezultate dhe punë pak më ndryshe, pa ngjyrimë politike, është profesionale, duket teknike, por ndihmon edhe politikisht. Tani unë besoj që kjo vjen edhe për shkak të përvojës që po e krijojnë ekipet e auditimit në qeveri, në të gjitha organizatat buxhetore. Sipas tekstit që kemi dhe sipas disa raporteve për dikasterë dhe organizata buxhetore, të cilat mua më kanë interesuar dhe i njoh besoj relativisht mirë, vlerësimi

për Qeverinë është i mirë, është evidentuar edhe përparimi, ka evidenca, të cilat lidhen me probleme që kanë të bëjnë me organizatat buxhetore dhe është normale.

Në këtë pikë ne vijmë te çështja themelore, pse auditohet, çka auditohet, çfarë na duhet ajo. Keni parasysh, nuk mund të diskutohet këtu për punën e Auditorit si për punën e një zyre të Prokurorisë ose si për një prokuror. Në esencë, Auditori, Zyra Kombëtare, ekipet e tij, e gjithë puna në organizatat buxhetore ka të bëjë me auditimin, me verifikimin e pasqyrave financiare. Duhet të shihni që vlerësimi për organizatat buxhetore kryesisht është i këtij tipi, që pasqyrat financiare janë të sakta. Çka do të thotë kjo? Që institucionet bashkëpunojnë, që institucionet nuk tentojnë të manipulojnë informacionin dhe që pasqyrat financiare janë të sakta, i bie që institucionet punojnë përbrenda asaj që përcakton korniza ligjore. Por saktësia e pasqyrave financiare duhet të shoqërohet me një evidencë ose me një vetëdije, nuk mbyllet këtu dhe unë e kam parasysh, domethënë vlerësimi nuk mbyllet këtu.

Po, pse është e rëndësishme të theksohet? Sepse, saktësia e pasqyrave financiare lejon që ne t'i evidentojmë mungesat dhe këto janë mungesa që kanë të bëjnë me punën, me menaxhimin e financave, me administrimin e tyre, edhe me keqmenaxhimin, por kryesisht me keqklasifikimin që janë probleme më shumë të natyrës teknike. Tash unë kam parë që ekipet e auditimit, përpos kësaj, shkojnë edhe një hap më tutje dhe merren edhe me interpretimet të legjislacionit. Kjo duket normale, por unë kam vërejtur që ka një mungesë përvojë të ekipeve në këtë rrafsh dhe unë do të sugjeroja që të plotësohej, nëse kam të drejtë të kërkoj këtë si deputet.

Është element i ri që vlerësohet performansa, që do të thotë, vlerësohet efekti i punës, efekti i ekzekutimit të buxhetit që s'e kemi pasur më parë në raportet e Auditorit dhe unë kam një vërejtje thelbësore pastaj, kur Auditori sugjeron politika për organizata buxhetore specifike. Sepse për çështje të tilla unë besoj dhe, edhe kreu i Zyrës Kombëtare të Auditimit e ka të qartë që duhet të ketë ekipe më të specializuara dhe duhet të ketë ekipe që duhet të kenë eksperiencë në ato fusha. Tani patjetër që ky raport përfshin të gjitha organizatat buxhetore, patjetër që kjo është një përmbledhje që të kuptojmë situatën të plotë dhe nëse duam ta shpjegojmë vërtet qoftë edhe teknikisht apo politikisht duhet të kthehemi dhe të shohim një pjesë të madhe të teksteve të auditimit, të vlerësimeve, përfshirë edhe komunat, përfshirë dhe Komunën e Prishtinës, sepse brenda pasqyrave financiare element themelor është ekzekutimi i buxhetit, pse është dhe ky kthehet në element politik, sepse buxheti nëse nuk ekzekutohet saktë ose s'është planifikuar saktë ose punët që janë bërë janë shumë më pak se sa buxheti, siç ka ndodhur në Komunën e Prishtinës, sepse kështu krijohet suficit. Besoj pajtoheni për këtë dhe unë as s'po e them si kritikë, as s'po e evidentojë si akuzë, sepse në esencë gjithçka çka auditohet, auditohet që ai që është në krye të institucionit ta ketë pasqyrën e qartë të punës së institucionit të tij ose të dikasterit dhe të organizatave buxhetore, të institucioneve vartëse dhe elementi tjetër i rëndësishëm i raportit, së paku i raporteve detaje është sugjerimi që kërkon pastaj që organizatat buxhetore të deklarohen dhe për një dinamikë pune, e cila do të përmirësonte këtë.

Merrini raportet e auditimit për dikaster të veçantë së qeverisë në tre vjetët e fundit dhe ju do të shihni që ka përmirësime të dukshme, nuk mjaftojnë se ky është proces menaxhimi dhe gjithmonë ka mungesa, por do të vëreni që një çështje e dorës së dhjetë te raporti para tre vjetëve bëhet çështje e dorës së parë te raporti i vitit 2016, e pse kështu? Sepse çështjet themelore problematike janë zgjidhur. Unë dëshiroj të përgëzoj edhe një herë Zyrën Kombëtare të Auditimit, kreun e saj, normalisht si përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës i jap mbështetje të plotë në punën e tij të pavarur, sepse puna e tij do të ndihmojë, do të rrisë, do të përmirësojë performansën e institucioneve tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Shala! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës për fjalën e dhënë.

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Kabineti qeveritar paska ikur,

I nderuar Auditor i Përgjithshëm,

Unë e falënderoj Auditorin për raportin e dorëzuar në Kuvend për diskutim dhe shqyrtim.

Se sa është i rëndësishëm Auditori i Përgjithshëm dhe sa është vlera e tij dëshmon mungesa e gjithë Kabinetit qeveritar, ndërsa ky raport ka të bëjë kryesisht me nivelin qeveritar. Kjo vetëm sa për ta vënë në dukje si është gjendja e përgjegjesisë. Me gjithë mangësitë dhe vërejtjet e dhëna edhe nga parafolësit, edhe mangësitë e aty-këtushme të natyrës teknike, për shembull te përqindja e rekomandimeve në faqen 5 dalin 101%. Në aspektin metodologjik unë kam kërkesën për Auditorin, për sqarimin e metodës së auditimit. Pyetja ime është: a janë audituar të gjitha dokumentet e nevojshme të organizatave buxhetore, apo është bërë vetëm auditimi selektiv, sipas parimit të rastësisë? Unë kam bindjen se ka edhe më shumë shkelje që mbeten të pazbuluara, por kjo ka të bëjë sigurisht me mungesën e stafit të mjaftueshëm në këtë institucion, kjo është e qartë.

Ne kemi një raport për vitin 2016, i cili nxjerr në pah një varg jashtëzakonisht të madh mangësish, keqpërdorimesh, shkeljesh e mospërfilljes së pasurisë publike. Sfidë mbetet edhe niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm që e ka cekur Auditori. Jashtëzakonisht shqetësues është që organizatat buxhetore tani e 18 vjet nuk arrijnë të bëjnë regjistrimin e pasurisë. Sa u përket veprimeve konkrete që janë ndërmarrë në lidhje me menaxhimin e rreziqeve vërehet një gjendje shqetësuese sipas Auditorit, pasi pak organizata e kanë trajtuar seriozisht menaxhimin e rrezikut.

Nga 1 300 rekomandime, veç 26% implementohen, për këto të tjerat s'po flas. Si problem kryesor edhe të Auditorit del mirëmbajtja e rrugëve, ato veprimet kryesore dhe ndërtimet. E këto janë fushat ku vërehen shkeljet dhe mangësitë më të mëdha, përveç mosregjistrimit të pasurive dhe regjistrimit të gabuar të pasurive të paluajshme dhe po dihet ku janë përfitimet më të mëdha.

Unë po kthehem pak në Gjilan, çka konstaton Auditori. Thotë: “Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial”. Auditimi i vitit të kaluar ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar është tejte i ulët, janë zbatuar nga 18, vetëm dy rekomandime. Tani po kthehem te pjesa kryesore e raportit. Qeverisja e mirë, këtë e thekson edhe Auditori, ka për qëllim të kontribuojë në rritjen e llogaridhënies, transparencës, përmirësimin e performansës në sektorin publik dhe luftimin e korrupsionit. Të ndërmarrë të gjitha masat adekuate administrative në pajtim me kuadrin ligjor është i obliguar, domethënë çdo institucion kur organet kompetente dështojnë në zbatimin e rekomandimeve.

Po çka të bëhet më tej? Kjo është pyetja që lind pas dëgjimit dhe shqyrtimit të raportit të Auditorit dhe shumë agjencive të tjera të pavarura kontrolluese. Cilat janë mekanizmat ligjorë për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave adekuate ligjore kundër shkeljeve dhe shkelësve që identifikohen? Nuk ka! krijimi i shumë agjencive, institucioneve, nënsistemeve të ndryshme pa mekanizma adekuatë ligjorë për nxjerrjen para ligjit të shkelësve, janë vetëm shpenzime të kota. Unë kam një propozim krejt konkret që do të ndihmonte për t'i identifikuar shkelësit, që në gjuhën ligjore do të konsideroheshin keqpërdorues të mjeteve publike dhe të funksionit publik, do të ishte krijimi i mekanizmit ligjor që krijon lidhjen e drejtpërdrejtë, në këtë rast të Zyrës së Auditorit me Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe të dyja këto drejtpërdrejt të lidhen me prokurorin publik.

Unë e kuptoj mosbesimin e qytetarëve dhe të vetë deputetëve të krijuar nga informatat dhe gjetjet e shumta të rrezikshme: prokurori falsifikator, kryetari i Gjykatës Kushtetuese falsifikator, kryetari i Gjykatës së Apelit i korruptuar, prokurorë e gjyqtarë të ndryshëm të zgjedhur me telefon, por gjithsesi të korruptuar dhe falsifikatorë të dënuar. Megjithatë, ky Kuvend duhet të krijojë mekanizmin ligjor për trajtimin ligjor të gjetjeve të Auditorit dhe agjencive të tjera të pavarura sipas ligjeve në fuqi. Rekomandimet nuk duhet të mbeten vetëm në mëshirën e shkelësve.

Prandaj, propozoj që Kuvendi të ndërmarrë iniciativën për krijimin e mekanizmit ligjor që obligon implementimin e rekomandimeve të agjencive të pavarura që kanë për detyrë gjetjen e shkeljeve të detyrës zyrtare dhe të pasurive publike. Pra, një ligj që përcakton përgjegjësinë ligjore dhe pasojat për shkeljet, kjo domethënë lidhje e drejtpërdrejtë ligjore e agjencive të pavarura me karakter kontrollues dhe prokurorit publik, me prioritet trajtimin e shkeljeve të identifikuara. Pra, ky Kuvend duhet të sigurojë një mekanizëm ligjor për përgjegjësinë e personave publikë, të cilët në çfarëdo mënyre janë përgjegjës për shkeljet e gjetura.

Pastaj, po ashtu kërkoj që raportet e agjencive me karakter kontrollues, e në këtë rast edhe i Auditorit të Përgjithshëm, që i dorëzohen Kuvendit, të mos votohen, sepse kjo nuk ka asnjë kuptim dhe është kundër standardeve ndërkombëtare. Por ato duhet të shqyrtohen, të diskutohen,

të gjeturat të trajtohen sipas ligjit, kurse Kuvendi e ka për obligim të obligojë Qeverinë për krijimin e mekanizmit për implementimin e rekomandimeve të këtyre agjencive. Sepse, nëse votohet kundër tyre, kryesisht për shkaqe krejtësisht politike dhe jo përmbajtjesore, atëherë kjo domethënë se gjetjet janë të pavlefshme. Kjo domethënë se për politikën dhe konkretisht për Kuvendin, faktikja është e pavlefshme. Po ashtu, unë kërkoj që Auditori dhe raportuesve të agjencive kontrolluese t'u jepet mundësia e përgjigjeve në pyetjet e shtruara nga deputetët gjatë shqyrtimit dhe trajtimit të raportit. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë i tërë ky angazhim i këtyre agjencive të pavarura kontrolluese i bie se është vetëm punësim i jaranëve për të marrë rrogë dhe sa për të kaluarën kohën nëpër ulëset tona. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, Sami! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Në këtë raport të auditimit dua t'i theksoj tri çështje përkitazi me kohën e përcaktuar, e të cilat na duken me interes për t'u theksuar edhe si probleme, por edhe si shqetësime.

1. Shqetësuese mbetet shkalla e ulët e realizimit të planit të financimit nga borxhi ndërkombëtar, arsyeja e ngecjes së huazimeve nga IFN është moszbatimi i projekteve në përputhje me parashikimin buxhetor, e kjo si pasojë e vonësive në ratifikimin e marrëveshjeve financiare, negociimit të vonuar të marrëveshjeve financiare, si dhe me zbatuesit e projekteve. Gjashtë marrëveshjet e aprovuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës në sektorë të arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës rrugore dhe hekurudhave dhe që kanë të bëjnë me rehabilitimin e rrugës hekurudhore, projekti për përmirësimin e sistemit të arsimit, projekti i rrugëve rajonale, modernizimi i shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën e Klinikës Universitare të Kosovës dhe projekti për masat e energjisë efçiente në ndërtesat publike nëpër Kosovë. Ngecjet në këto projekte janë alarmuese dhe sipas raportit të auditimit kanë të bëjnë nga niveli i ulët i realizimit të financimit nga huamarrja ndërkombëtare. Gjithashtu, pos të tjerave, ngecjet janë shënuar në zbatimin e disa projekteve krahasuar me parashikimin buxhetor në Ministrinë e Infrastrukturës, Zhvillimit Ekonomik dhe Shëndetësisë.

2. Në këtë raport theksohen me shqetësim edhe obligimet e papaguara, të cilat janë rritur deri në fund të vitit 2016, e që janë 215 420 000, e cila është rritur për 8 420 000 krahasuar me vitin 2015 dhe këto rritje janë të organizatave qendrore, të cilat janë alarmante.

3. Në këtë dokument mbetet pakrahasimisht shqetësuese fusha e prokurimit publik, ku në këtë dokument potencohet planifikimi jo i mirë i prokurimit, mungesë e plotësisht të kërkesave ligjore, të cilat shkaktojnë që këto projekte të mos realizohen me kohë, dobësi në procesin e vlerësimit të tenderëve nga ana e komisioneve vlerësuese, favorizime potenciale ose diskriminuese nga OEV-e dhe vlerë të dobët për para apo dështim për t'i marrë shërbimet e caktuara, mungesa e përgjegjësisë dhe e kontrolleve të mjaftueshme nga nivelet më të larta të

menaxhmentit, mangësi në monitorimin e zbatimit të kontratave dhe kryerjen e punëve, si nga aspektet e kohës, ashtu edhe nga ndikimet e kushteve të tjera.

Ndërsa, dua të theksoj edhe dy çështje, të cilat kanë të bëjnë me dy deponi, të cilat përmenden në këtë raport. E para, ka të bëjë me deponinë në Zhurin e Ri, e cila theksohet si modernizim i deponisë në Sharr, e që përmban, do të duhej, në fakt, të përmbante mbeturina inerte, por aty kundërmon dhe se në të ardhmen Qeveria do të duhej të parashihte mjete që ta ruajë edhe ambientin, edhe qytetarin nga sëmundjet, të cilat shkaktohen nga ky kundërmim. Po ashtu, në këtë gjendje po ashtu të njëjtë, madje tepër alarmante, sepse shpeshherë edhe në Landovicë, të shkaktuar nga deponia e Landovicës, domethënë janë shkaktuar raste të cilat kanë të bëjnë me aspektet e ndryshme shëndetësore dhe se qytetarët e këtij fshati shpeshherë kanë alarmuar në të gjitha anët, pra në të gjitha institucionet për rrezikun që u vjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Auditor i Përgjithshëm, së pari dua t'ju përgëzoj juve dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit për raportin vjetor të auditimit për vitin 2016, njëherësh kërkoj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të bëjmë punën tonë si deputetë që t'ju krijojmë mundësi reale për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme të Zyrës Kombëtare të Auditorit dhe të Auditorit të Përgjithshëm në përgjithësi, që konsideroj që janë të nevojshme për këtë institucion të pavarur dhe shumë të rëndësishëm, të një rëndësie të madhe, si i vetmi institucion i pavarur i auditimit të buxhetit dhe të shpenzimit të parasë publike, si dhe t'i ndihmojmë këtij institucioni për vlerësimin e saktë të shpenzimit të parasë publike nga organizatat buxhetore.

Kur diskutojmë për raportet e institucioneve të pavarura të këtij niveli, duhet të jemi të përgjegjshëm, të kujdesshëm dhe të kemi vlerësime reale. Të lëmë anash për pak çaste fushatën elektorale, fyerjet, kualifikimet, adresimet personale dhe të fokusohemi në rolin tonë si të zgjedhur të qytetarëve që vërtet shkeljet t'i quajmë shkelje, të zezës t'i themi e zezë, të bardhës e bardhë, keqpërdorimin e parasë publike ta dënojmë, ta denoncojmë, si dhe rekomandimet dhe kualifikimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit t'i mbështesim si vlerësime profesionale nga një institucion i pavarur dhe organizatave buxhetore, të cilat kanë keqmenaxhuar paratë e taksapaguesve të Kosovës, t'u themi troç që kanë abuzuar me financat publike dhe të kërkojmë nga institucionet kompetente që ta bëjnë punën e vet.

Andaj, njëherë e përgjithmonë, pa marrë parasysh kush ka menaxhuar me një dikaster, me një komunë, me një ministri të linjës apo edhe me ndërmarrjet publike, ku vërtetë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka konstatuar shkelje enorme, duhet t'i adresojmë dhe të kërkojmë nga institucionet kompetente ta bëjnë punën e vet. Andaj, për fund, e inkurajoj Zyrën Kombëtare të

Auditimit dhe Auditorin e Përgjithshëm që të kërkojë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si institucioni i vetëm që i raporton, që t'i adresojë kërkesat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve dhe uroj që në raportin e ardhshëm të auditimit thjesht të zbatohen rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe vërejtjet për të gjitha organizatat buxhetore, pa marrë parasysh në cilin dikaster qofshin ato, të respektohen në plotësi, sepse kështu i shërbejmë edhe menaxhimit më të mirë të parasë publike dhe shpenzimit racional të buxhetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Sipas raportit të Auditorit të shtetit në vendin tonë pikërisht në dikasteret që menaxhojnë me buxhetin e Kosovës, ku si rezultat i këtij raporti del që buxheti i Kosovës jo që është menaxhuar keq, por ai edhe është keqpërdorur nga institucionet tona, pa dashur të përmend me emra një nga një, ato i kemi në raportin e Auditorit të Përgjithshëm.

Ajo që është shqetësuese për mua edhe kolegët deputetë, si dhe për qytetarët e Kosovës, duke filluar nga të gjitha qeveritë e Kosovës, Thaçi, Mustafa, si dhe institucionet që duhet të merren me ndjekjen e keqpërdoruesve të buxhetit të Kosovës, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës, pikërisht kryeministri dhe ministrat e tij nëpërmjet sekretarëve të përgjithshëm është dashur të merren masat që ne sot të mos kemi një raport siç është ky. Po konstatoj se qeveria e kaluar ka qenë direkt e involvuar në korrupsion. Për këtë arsye, edhe sot e kemi kriter për liberalizimin e vizave korrupsionin, sepse duhet të dini ju qeveritarët se ndërkombëtarët lexojnë, ata i lexojnë çdoherë raportet e Auditorit dhe nuk janë si qeveritarët tanë që raportet i lënë në sirtarë.

Deri më sot nuk kemi dëgjuar që Prokuroria e ka marrë seriozisht raportin e Auditorit si dëshmi për të ndjekur të keqen e vendit, e ai është korrupsioni. Më të vlefshme për Prokurorinë tonë janë lajmet e rrejshme nga gazetarët tanë, se sa raporti më i lartë i shtetit tonë, siç është raporti i Auditorit.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Ne si Parlament kemi përgjegjësi për shumë agjenci, ku nga Parlamenti janë emëruar shumë borde, të cilat sipas raportit të Auditorit lëre më që kanë qenë borde joprofesionale, por ato janë pjesë e korrupsionit në vend, apo mbyllja e syve të tyre para së keqes së vendit, apo kanë qenë shërbëtorë të shefave të tyre, ku kërkoj urgjentisht shkarkimin e të gjitha bordeve të zgjedhura në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Njëkohësisht kërkoj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të nxjerrë një rezolutë, me të cilën obligohen Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organizatat buxhetore, si dhe të gjitha institucionet që t'i respektojnë të gjeturat e raportit të Auditorit ose Zyrës Kombëtare të Auditorit dhe t'i rekomandojë këtij Parlamenti për masat që i ka marrë

lidhur me këtë raport. Deri më sot nuk kemi asnjë raport nga Auditori i jashtëm në Kuvendin e Kosovës në fund vit, të dimë me të vërtetë se çfarë masash ka marrë Qeveria ndaj raportit, të cilin sot edhe e kemi në tavolinë. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli e keni fjalën.

FITORE PACOLLI: Faleminderit!

Raporti i Auditorit fokusohet në dy çështje, të cilat kanë shumë rëndësi dhe kanë ndikim direkt në jetën e qytetarëve dhe të cilat janë keqpërdorur dhe injoruar nga Qeveria.

E para, ka të bëjë me trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike, ku konstatimi i raportit është i thjeshtë, real dhe shumë i qartë se qytetarëve të Republikës së Kosovës nuk u ofrohen shërbime cilësore shëndetësore nga institucionet shëndetësore publike dhe nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas raportit të Auditorit, nuk ka të dhëna të sakta, të cilat dëshmojnë se menaxhimi i fondit prej 7,8 milionë eurosh për vitin 2015 është bërë në mënyrë të drejtë.

Në vitin 2015 janë pranuar 1 859 kërkesa, janë shqyrtuar 1 347, ndërsa 512 nuk janë shqyrtuar fare dhe nuk ka arsytim pse nuk janë shqyrtuar. Leukemia, e cila konsiderohet sëmundje që kërkon reagim të shpejtë dhe për shkak të kësaj sëmundje kemi pasur një numër të madh të fëmijëve, të cilët kanë humbur jetën, është konsideruar me prioritet jo shumë të lartë, për shkak se 28,6% të rasteve nuk janë shqyrtuar fare.

Auditori gjen se regjistrimi i kërkesave të realizuara dhe atyre të refuzuara bëhet në program Excel, në të cilat ka mangësi të mëdha. Për vitin 2015 konstaton se ka pasur përmirësim, pra në lista tani shkruhet emri dhe mbiemri i pacientit, data e aplikimit, lloji i sëmundjeve, datën e aprovimit apo të refuzimit, kaq ka të dhëna, të cilat kishin munguar në vitin 2014. As në vitin 2015 nuk jepen arsye të sakta për aprovim apo refuzim të kërkesës, si dhe keqpërdorimet pra, kalimi i radhëve të pritjes në trajtim janë shumë të mundshme për shkak të mungesës së këtij programi adekuat.

Pacientit, të cilit i refuzohet trajtimi, nuk merr përgjigje me shkrim dhe, si rrjedhojë, pacientit i pamundësohet e drejta e ankesës apo gjetja e formave të tjera për mbulimin e shpenzimeve për trajtim mjekësor. Auditori gjen se nëse edhe jepet përgjigjja negative, ajo është e mangët dhe e paqartë. Pra, thjesht në përgjigje shkruhet: “Kërkesa refuzohet bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 10/2013”, pra duke lënë pacientin në pamundësi që të kuptojë arsyen pse në të vërtetë është refuzuar. Ndërsa, në rastet kur aprovohet kërkesa, në asnjë formë pacienti nuk obligohet të sjellë faturat, Auditori i kishte kërkuar këto dëshmi, por këto nuk janë siguruar. Pra, kjo lë shumë hapësirë për keqpërdorim dhe për dërgim të pacientëve me prioritet, të cilët këta i kanë të afërm të tyre, apo në lidhje me ministrin.



Vërejtjet e njëjta janë përsëritur qysh në fillim të këtij programi dhe jo vetëm nga Auditori, por edhe nga Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian. Të gjitha këto japin material i bollshëm për hetim që duhet të nisë urgjentisht nga Prokuroria. Keqpërdorimet me fondet e këtij programi janë të mëdha, asnjëherë nuk u trajtuan seriozisht investimet në shëndetësi publike, në mënyrë që shumica e sëmundjeve të trajtohen në vend, në institucione publike. Nuk është se neve na mungojnë kuadro mjekësore, kurse interesi primar vazhdon të jetë pasurimi i qeveritarëve në kurriz të qytetarit të varfër e të lënë anash. Sot neve na vdesin edhe pacientët nga fruthi, si dhe nga krimet me gazin që do të duhej t'u ndihmonte pacientëve dhe jo t'i helmonte. Prokuroria duhet të fillojë menjëherë hetimet rreth menaxhimit të këtij fondi dhe të japë përgjegjësi për rastet, të cilat përfunduan me vdekje të pacientëve në mungesë të mbështetjes dhe në pritje të gjata për fondet nga ministria për trajtim jashtë vendit.

E dyta, çështja e cila lidhet shumë me çështjen e parë dhe si rezultat i kësaj çështje shumë pacientë vdesin dhe kanë nevojë për ndihmë urgjente mjekësore, është ndotja e ambientit. Pra, auditimi fokusohet në masat kombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe nga rezultatet e matjeve që bëhen nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, si dhe matjet që bëjnë Komuna e Prishtinës del se kualiteti i ajrit në vend është shumë i keq dhe, në të shumtën e rasteve, normat e lejuara të ndotjes tejkalohen. Përveç Prishtinës, e cila ka ndërmarrë disa masa imediate me reformën në trafikun urban dhe shtimin e hapësirave të gjelbra, në nivel qendror, edhe pse tejkalohen nivelet e lejuara, nuk është ndërmarrë asgjë për të adresuar rritjen e ndotjes.

Pra, vetëm konstatimi se niveli i ndotjes është i lartë nuk mjafton, qeveria duhet të jetë në gjendje të ndërmarrë masa adekuata në kohë reale për të ulur nivelin e ndotjes. Raporti i Auditorit thekson se legjislacioni mjedisor thuhet se është konsoliduar, por mungojnë rezultate konkrete sa i përket aplikimit të masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit dhe se objektivat e vendosura në planin kombëtar për veprim në mjedis nuk janë të qëndrueshme, pasi që burimet për realizimin e tyre janë të kufizuara.

Nuk ka qenë prioritet për qeverinë e kaluar që të mbikëqyrë ndotësit e mëdhenj, aplikimin e parimit 'ndotësi paguan', si dhe stimulimet për të investuar në teknologji të pastër, në energji të ripërtëritshme dhe energji eficiente. Sipas raportit, nuk ka një sistem efektiv të informimit për çështje mjedisore dhe rreth ndikimit të çështjeve mjedisore në shëndetin e qytetarëve. Mekanizmat e brendshëm për zbatim, monitorim dhe koordinim të projekteve mjedisore ende nuk janë funksionalizuar. Raporti thekson se ka munguar qasja sistematike institucionale për të adresuar çështjet mjedisore. Njëjtë konstatohet edhe në Raportin e Progresit të vitit 2016, i cili thekson nevojën për të zbatuar legjislacionin që është në fuqi dhe konsideron nivelin e lartë të ndotjes së ajrit si kërcënim serioz.

Niveli i lartë i ndotjes shkaktohet nga disa faktorë, por në pamundësi për t'i prekur të gjithë, do të fokusohem vetëm tek çështja e transportit. Pra, në këtë drejtim nuk ka asnjë planifikim, nuk ka

pasur as nga qeveritë e kaluar dhe as nga kjo qeveri për të investuar në forma të tjera të transportit, pra në investimin në transport modern urban, të qasshëm dhe të përballueshëm për të gjithë, në politika për shtimin e sigurisë në rrugë dhe promovimin e udhëtimit me biçikletë, në ndalimin e importit të veturave të vjetra që emetojnë gazra të dëmshme, si dhe më e rëndësishmja dhe e cila mund të aplikohet menjëherë, janë kontrollet e rrepta në lloje të karburanteve që shiten dhe përdoren në vend.

Të përkujtojmë lëndën djegëse që ishte përdorur për ngrohje në shkollat e Prishtinës deri në vitin 2014, kur edhe Komuna e Prishtinës vërtetoi se në bashkëpunim edhe me agjencitë edhe jashtë vendit se niveli i sulfurit në të ishte 70 herë më i lartë se sa niveli i lejuar. Kjo lëndë, e cila ishte përdorur në Prishtinë, në vendet evropiane përdoret vetëm në industrinë e anijeve dhe jo për ngrohje në shkolla. Një lëndë djegëse e tillë nuk është hiq larg mendsh që përdoret edhe sot si karburant për veturat, po këtu Qeveria po i mbyll sytë. Asnjë analizë nuk u bë pas asaj që konstatoam në Prishtinë në karburantet që përdoren për ngrohje në komunat e tjera. Ne e ndalëm në Prishtinë, por në komunat e tjera ndodh të përdoret e njëjta lëndë djegëse dhe kjo lëndë djegëse shkakton kancer te qytetarët.

Sikur Qeveria e kaluar e cila nuk kishte ndërmarrë asnjë masë konkrete për të ulur nivelin e ndotjes, nuk ka shpresë se do të ketë ndonjë hap pozitiv nga Qeveria e ardhshme dhe se rekomandimet rreth marrjes së masave konkrete në raportin e Auditorit dhe raportet tjera nga organizatat ndërkombëtare do të vazhdojnë të mbeten pjesë edhe në të ardhmen.

Deri më sot nuk kemi parë asnjë planifikim konkret nga kjo Qeveri rreth masave që do të aplikohen për ta parandaluar ndotjen e ajrit, gjë që shihet edhe nga Buxheti i ndarë, si dhe nga Programi qeverisës. Edhe kjo Qeveri nuk e ka prioritet zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë, por është e interesuar vetëm në rezultate të shpejta, në mënyrë që të lavdërohet për arritjet brenda mandatit të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Thaçi-Dragusha e ka fjalën.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm,

Faleminderit shumë për raportin, i cili e jep një pasqyrim të saktë të gjendjes së institucioneve tona në periudhën e raportimit.

Unë u koncentrova më shumë kur flitej për komunat dhe një problem i përbashkët i të gjitha komunave, si duket, janë pasuritë e tyre. Gjatë vitit 2016, komunat nuk kanë arritur ta sigurojnë

një sistem efektiv të regjistrimit dhe të menaxhimit të pasurive, duke rezultuar në theksim të çështjes për pasuritë pothuajse në të gjitha komunat.

Tek pika 2.2, opinionet e pamodifikuara në theksim të çështjes, problemet më të theksuara në mbi 90% të komunave kanë të bëjnë me mosregjistrim të pasurisë, mosregjistrim kontabël të pasurisë, mosregjistrim të plotë apo të pjesshëm, nënvlerësim apo mbivlerësim të pasurisë, prezantim jo i saktë i pasurisë nën dhe mbi vlerën njëmijë euro, mosregjistrim i pasurisë së financuar nga donatorët, regjistrim i gabuar, mospërfshirje e plotë e pasurisë në regjistrin e pasurive dhe probleme të tjera që lidhen me këtë çështje. Pra, mangësi të evidentuara janë numërimi fizik, vlerësimi i pasurisë, raportet jo të përfunduara të inventarizimi i pasurisë, kategorizimi joadekuat, zhvlerësimi, tjetërsimi dhe klasifikimi jo i drejtë i investimeve të papërfunduara.

Meqenëse, ky problem paraqitet në shumicën absolute të komunave dhe si duket është paraqitur edhe në raportet e viteve të mëhershme, për shkak të rëndësisë që ka regjistrimi i plotë dhe i saktë i pasurisë, unë do të doja të di pse po ndodh kjo? Pse nuk janë marrë parasysh rekomandimet e mëhershme? A është në pyetje neglizhenca e udhëheqësve të komunave apo ndonjë problem, i cili, në fund të fundit, do të mund të ndihmohej edhe nga organet qendrore, sepse kjo çështje është kompetencë e Komunës. Pra, çka mund të bëjmë në zgjidhjen e kësaj çështjeje, e cila është mjaft me rëndësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përsëritje për të gjithë!

I nderuar drejtor i Zyrës Kombëtare të Auditimit, zoti Osmani, diskutimin tim po e filloj me një propozim. Duke pasur parasysh rëndësinë e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe zyrave komunale, propozoj që udhëheqësit, duke filluar nga drejtori i Zyrës Kombëtare, por edhe të angazhuarit e tjerë në zyrat e auditimit, qoftë të nivelit kombëtar, qoftë të nivelit komunal, të mos lejohen të jenë anëtarë të subjekteve politike, ashtu siç ndodh në Polici, në Ushtri, në gjykata, e të tjera, sepse ata vërtet gjatë punës së tyre duhet të jenë të pandikuar dhe edhe kur formalisht nuk janë anëtar, megjithatë kjo ndikon.

Sa unë jam i informuar, këta të gjithë, duke filluar prej zotit Osmani e të tjerët, janë në subjekte politike LDK, PDK e të tjera. Këtë nuk po e them për t'i akuzuar, por po e them se do të ishte shumë më mirë që këta njerëz të mos jenë pjesë e subjekteve politike.

Nën dy, dëshiroj ta përkrah propozimin e deputetit Zeka, i cili kërkoi që të krijohet një komision parlamentar për hetimin e ndërmarrjeve publike, të cilat operojnë me fonde publike, por e kanë

një autonomi tepër të gjerë dhe nuk përgjigjen ashtu siç do të duhej të përgjigjeshin para institucioneve të shtetit.

Sa i përket raportit aktual të auditimit, duke pasur parasysh volumin e shkeljeve të mëdha që ndodhin në këtë vend, ky raport është tepër i kufizuar. Prandaj pres dhe propozoj që në të ardhmen raporti të jetë shumë më voluminoz, natyrisht duke e rritur edhe numrin e atyre që angazhohen në Zyrën Kombëtare dhe në zyrat e tjera të auditimit në vend, sepse ashtu do të shpenzohet pak më shumë para për pagat e edhe të disa zyrtarëve, por do të parandaloheshin shumë keqpërdorime që po ndodhin brenda vendit.

Kur e lexojmë këtë raport, vërtet ka shumë arsye për t'u shqetësuar, por unë jam fokusuar në dy-tri çështje, në të cilat në mënyrën më të mirë pasqyrohet papërgjegjësia e Qeverisë dhe e institucioneve të tjera, që si pasojë i sjellin vendit dëme të mëdha financiare. Unë po i përmend vetëm pak shembuj: në faqen 18 prezantohet mosrealizimi i projekteve me financim nga huamarrja ndërkombëtare në nivel të ministrive dhe përmenden këta shembuj. Për shembull, projekti financiar për energji, energjia e ripërtërishme në kuadër të MZHE-së; planifikimi financiar nga Banka Botërore në vlerë prej 4 060 000 eurove, nuk janë ndarë fonde për arsye të mosdistributimeve të fondeve sipas parashikimit në Buxhetin e vitit 2016. Janë vonesat në finalizimin e procedurave të prokurimit. Duke qenë e pakënaqur me procedurat e prokurimit, të kryera nga ministria, Banka Botërore ka vendosur të mos e financojë këtë projekt dhe kështu praktikisht kanë mbetur të pashfrytëzuara mbi 4 milionë euro dhe për këtë, sa dihet, askush nuk është përgjigjur.

Një shembull tjetër është zgjerimi i rrugës kryesore N-2 Milloshevë - Mitrovicë, në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, i planifikuar të financohet në vlerë prej 14 700 000 euro dhe për shkak të ngecjeve disamujore vetëm për procesin e bartjes së mjeteve financiare ky projekt është zvarritur tepër gjatë dhe një pjesë e këtyre mjeteve nuk është shfrytëzuar.

Projekti i Ministrisë së Shëndetësisë për aparaturë dhe pajisje tjera mjekësore, të cilat janë në mungesë të madhe në këtë vend dhe shkaktojnë shumë probleme për pacientët tanë me buxhet të planifikuar në vlerë prej 2 600 000 eurove, i cili është realizuar pastaj me vonesë me 2 100 000 euro, prapë të gjitha këto janë bërë për shkak të neglizhencës së drejtpërdrejtë të Qeverisë së Kosovës.

Po kaloj në një çështje tjetër, që prapë ka të bëjë me Qeverinë, për Fondin Zhvillimor. Fondi Zhvillimor është themeluar, siç e dimë, në bazë të marrëveshjes së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës në vitin 2013. Edhe atëherë kur është formuar është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, po përveç kësaj ky fond absolutisht nuk kontrollon nga askush. Ky fond krijohet nga të hyrat doganore në dy pikat kufitare në veri të Republikës së Kosovës dhe ka

për qëllim promovimin e zhvillimit social-ekonomik të komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin-Potok dhe Leposaviq.

Bordi menaxhues është vonuar në shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve dhe si rrjedhojë komunat i kanë nënshkruar disa kontrata pa aprovimin paraprak të Bordit. Komunat përfituese nuk kanë raportuar për ecurinë e këtyre projekteve, që do të thotë se edhe janë bërë pa lejen e Bordit dhe nuk dihet ku kanë shkuar këto të holla. Në lidhje me këtë fond edhe një çështje: Mjetet për fondin janë ndarë vetëm në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale, ndërsa disa projekte kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime, e në disa raste edhe me subvencione, që është keqpërdorim total dhe papërgjegjësi e Qeverisë së Kosovës, që së paku t'i kontrollojë këto mjete që po ndahen në mënyrë të padrejtë.

Po kaloj krejt në fund, te disa ndërmarrje publike. Këtu janë dhënë vetëm disa shembuj të disa ndërmarrjeve, që kur e kemi parasysh se kemi ndërmarrje shumë më të mëdha, atëherë mund ta marrim me mend se çfarë ndodh me to. Janë përmendur Hekurudhat e Kosovës, ku thuhet se nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të të gjitha aspekteve materiale. Janë përmendur kompanitë për menaxhimin e deponive, kompania rajonale e mbeturinave, të cilat po ashtu nuk e paraqesin gjendjen reale. E në fund, ajo që më së shumti i mungon këtij projekti është se këtu nuk janë përfshirë as 10% e shkeljeve që ndodhin në Kosovë dhe mendoj se ky Kuvend duhet të merret seriozisht me rikonstruktimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe zyrave komunale të auditimit, në mënyrë që nëse nuk funksionojnë prokuroritë dhe gjyqësitë, së paku qytetarët le ta dinë se çfarë po ndodh me Buxhetin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Auditor i Përgjithshëm,

Nga shumica e kolegëve të mi deputetë u vlerësua faktikisht puna e Auditorit të Përgjithshëm si një punë që ka bërë të mirë dhe ky raport i auditimit që e kemi këtu para vetes si një raport korrekt.

Edhe unë pajtohem me këtë, por fatkeqësisht Qeveria dhe institucionet tona nuk po i marrin parasysh rekomandimet e Auditorit dhe paraja e taksapaguesve tanë po keqpërdoret në vazhdimësi, gjë të cilën në vazhdimësi Lëvizja “Vetëvendosje” e ka theksuar, e që u tha edhe nga kolegët e mi deputetë. Të gjeturat në Ministrinë e Shëndetësisë nga Auditori i Përgjithshëm sa i përket trajtimit të pacientëve jashtë vendit janë shqetësim. U dhanë sqarime nga deputetja Fatmire Kollçaku dhe Fitore Pacolli.

Ajo që nuk e pashë në këtë raport është mosauditimi i mjeteve të shpenzuara për sistemin informativ shëndetësor, kur dihet se janë dhënë miliona euro donacion nga Qeveria e Luksemburgut dhe nga Qeveria jonë qysh nga viti 2009 e deri më sot, kurë jemi në vitin 2017, e implementimi i sistemit informativ shëndetësor është në pikën zero.

Unë e kam një pyetje për Auditorin e Përgjithshëm, besoj se është ende këtu: Duke pasur parasysh se në mandatin e kaluar ne e kemi pasur një interpelancë, në të cilën është thirrur kryeministri Isa Mustafa sa u përket sigurimeve shëndetësore, përkatësisht edhe sistemit informativ shëndetësor dhe nga ajo interpelancë ne e kemi miratuar si Kuvend një rezolutë, pika e parë e së cilës e obligon faktikisht Auditorin e Përgjithshëm apo Zyrën Kombëtare të Auditimit që të bëjë auditim të përgjithshëm të fondeve të ndara për sistemin e informimit shëndetësor, prej fillimit të implementimit të projektit deri në fund të muajit dhjetor. Për këtë duhet të përgatisë raport me shkrim për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Prandaj, një gjë të tillë unë në detaje këtu nuk e pashë dhe kërkoj nga ai që të na japë një përgjigje se çfarë është bërë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë,

I nderuar Auditor,

Edhe unë fillimisht e përgëzoj punën e bërë nga Zyra Kombëtare e Auditimit, edhe pse sikur e përmendi edhe Besa dhe kolegët tjerë, është mjaft shqetësuese të shohim që jo vetëm se ka shkelje të shumta, keqmenaxhim të Buxhetit dhe të parasë publike, por edhe se rekomandimet nga viti i kaluar janë marrë fare pak parasysh, përkatësisht vetëm 26% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, 37% pjesërisht dhe 38% prej tyre nuk janë zbatuar fare.

Nëse shohim se për sivjet janë dhënë 1 314 rekomandime, e 914 prej tyre me prioritet të lartë, atëherë pritet që vërtet të jemi shumë këmbëngulës dhe të gjitha institucionet kompetente përgjegjëse për ta përcjellë implementimin apo për t'i monitoruar shkeljet të jenë shumë aktive në këtë drejtim. Po ashtu, një gjë është shumë shqetësuese për mua. Nga ajo që pashë në raport, shihet se ka një shkallë shumë të ulët të realizimit të Buxhetit nga donatorët. Pra, për vitin fiskal 2016 vetëm 57% e Buxhetit që është përfituar nga donatorë të ndryshëm është shfrytëzuar dhe këto fonde nuk janë menaxhuar mirë, gjë që përpos që paraqet lëshim dhe pamundësi për të ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve rrit edhe rrezikun e zvogëlimit të granteve nga donatorët në të ardhmen.

Derisa në anën tjetër shihet se borxhi publik në fund të vitit 2016 ka arritur shumën 872 730 000 euro dhe në krahasim me vitin 2015 ka pasur rritje për 113 780 000 euro, apo për 15%. Pra, në

bazë të këtyre gjetjeve shihet se, në njërin anë, nuk janë shpenzuar donacionet dhe, në anën tjetër, është rritur borxhi publik, gjë që tregon asgjë tjetër, përveç se ka pasur keqmenaxhim, apo edhe më keq, keqpërdorim të Buxhetit publik.

Unë dua të fokusohem sot te një gjetje e Auditorit sa i përket rishikimit të teksteve shkollore. Edhe pse tashmë është e ditur për rëndësinë e edukimit cilësor dhe po ashtu është e ditur se sivjet kurrikula e re ka filluar të implementohet në të gjitha shkollat, është evidente se implementimi i kurrikulës në shkollat gjithandej në Republikën e Kosovës po përcillet me sfida të jashtëzakonshme në secilën nga këto shkolla. E një çështje shumë e rëndësishme, që ndikon në vështirësinë e implementimit të suksesshëm të kurrikulës së re, është edhe mungesa e teksteve shkollore, përkatësisht mangësitë e mëdha që i kanë tekstet ekzistuese në përmbajtje, si në aspektin teknik, ashtu edhe në atë pedagogjik dhe në vetë përmbajtjen.

Në vitin 2015, MASHT-i e kishte iniciuar procesin e rishikimit të teksteve shkollore me qëllim të përmirësimit të tyre dhe për këtë u angazhua edhe Këshilli i Ekspertëve për programe dhe tekste shkollore. Por ajo që ndodhi, në fakt, rezultoi të ishte një çështje krejtësisht joprofesionale, pasi u morën kryesisht me çështje të natyrës teknike, apo siç e kanë thënë shpesh zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, ka ndodhur vetëm një pastrim teknik i teksteve shkollore, pra vetëm janë larguar disa gabime faktike.

Për më tepër, nuk është arritur as të lehtësohen çantat e nxënësve dhe përsëri edhe për këtë ishte marrë një vendim nga ministria, që edhe vitin e kaluar të botohet i gjithë tirazhi i teksteve shkollore, gjë që ka shmangur edhe kursimet apo, thënë më mirë, ka pasur shpenzime të jashtëzakonshme, pasi në një numër të madh të shkollave gjithandej ka stoqe të tëra të teksteve shkollore, shumë prej tyre të pashfrytëzuara, me gjithë udhëzimin administrativ që e kishte aprovuar vetë ministria, që në fund të vitit shkollor tekstet të grumbullohen dhe t'u përcillen gjeneratave vijuese të nxënësve, ata kanë vazhduar të blejnë libra të rinj dhe tekstet të shpërndahen për të gjithë nxënësit, duke krijuar kështu shumë shpesh një numër të madh të teksteve që fare nuk shfrytëzohen, apo krijojnë deponi të shumta të teksteve shkollore.

Pra, akoma edhe sot tekstet shkollore kanë shumë gabime dhe pasaktësi, çantat e nxënësve nuk janë lehtësuar aspak dhe nuk është arritur të kursethet aspak Buxheti në këtë drejtim. Madje vlen të përmendet që edhe pse ishin paguar mjetet, viti i kaluar shkollor ka përfunduar pa u sjellë fare tekstet e gjuhës angleze për nxënësit gjithandej nëpër shkollat tona. Akoma edhe sot pra MASHT-i nuk po arrin t'i krijojë parakushtet themelore për një arsim cilësor dhe, edhe pse Ligji për tekstet shkollore kishte filluar të punohet prej vitit të kaluar, edhe në këtë ministri u pa që sivjet, së paku për këtë sezon, nuk e ka të paraparë në programin e tyre legjislativ këtë tekst, gjë që nuk lë asnjë shpresë për punën konkrete të ministrisë në përmirësim të cilësisë së arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, a thua mund të kthehen këta deputetët, që të shohim nëse kemi kuorum, që të mos e shtyjme votimin për seancën tjetër. Ka përfunduar diskutimi.

Urdhëro Sami, për procedurë a për çka?

SAMI KURTESHI: Zoti kryesues!

Unë përsëri po e marr fjalën dhe po kërkoj që të shqyrtohet kërkesa. Nëse vërtet kërkoni nga përbërja e Kuvendit që të votohet për raportin, kjo nuk ka kuptim dhe është kundër standardeve ndërkombëtare.

Ne mund të votojmë dhe ta obligojmë Qeverinë që ajo të marrë parasysht dhe të krijojë një mekanizëm ligjor, që do të raportonte për implementimin e raporteve të Auditorit të Përgjithshëm dhe të gjitha agjencive të pavarura kontrolluese në Republikën e Kosovës, sepse nëse ne tash votojmë, edhe për arsye politike nuk e votojmë raportin, cilat janë pasojat? Kurse, në raport ne kemi fakte... Faleminderit!

KRYESUESI: Sami, e mora vesh... Unë nuk mund ta ndryshoj as Rregulloren, as rregullat që i kemi të instaluar në Kuvend. Është e hapur mundësia për ta ndryshuar. Deri sot unë s'e kam atë të drejtë t'i ndjek procedurat që po kërkoni. Rregullorja s'ma lejon.

Tani, ka a s'ka kuorum? Po presim dy minuta, më mirë e votojmë, kush do të votojë e voton...

\* \* \*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Po e vazhdojmë takimin, respektivisht jemi në procesin e votimit. Ju kisha lutur që t'i zini vendet tuaja për të pasur mundësi që të votojmë? Vazhdojmë me votimin e raportit me rekomandimet e Komisionit Funkcional lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2016.

Përgatitemi për votim! Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar... a ka dikush pa kartelë që do të votojë?

I kemi 73 që kanë votuar me kartelë, 2 pa kartelë, bëjnë 75. Për janë 70 deputetë, kundër asnjë, kanë abstenuar 3, pa kartelë janë 2 deputetë, që do të thotë 72 vota janë për dhe 3 abstenime.



Konstatohet që Kuvendi e miratoi raportin vjetor të auditimit për vitin 2016 së bashku me rekomandimet e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

I kemi dy kërkesa, një të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe një kërkesë të Grupit Parlamentar “6+” për emërimin, ose ndryshimin e vendeve të anëtarëve të grupit parlamentar për komisione. Deputeti Ali Lajçi e ka fjalën.

ALI LAJÇI: Është votuar me kartelën e Fatonit, në emër të kartelës së tij kemi votuar, për shkak të mungesës.

KRYESUESI: Në rregull, le të evidentohet në procesverbal.

**- Njoftimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për ndryshimin e anëtarëve në komisionet parlamentare**

KRYESUESI: Propozimi është që deputeti Liburn Aliu të bëhet anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. Deputeti Driton Çausi tërhiqet nga Komisioni për Integritet Evropian dhe zëvendësohet me deputeten, zonjën Fatmire Kollçaku. Deputeti Ali Lajçi tërhiqet nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe zëvendësohet me deputetin Driton Çausi. Deputeti Ali Lajçi bëhet anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Kjo është kërkesa, ose më mirë të themi është vendim i partisë dhe i grupit parlamentar.

**- Njoftimi i Grupit Parlamentar të Grupit “6+” për ndryshimin e anëtarëve në komisionet parlamentare**

KRYESUESI: Ju njoftoj se nga Grupi Parlamentar “6+”, deputetja Myfera Shinik është anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Bëhet zëvendësimi, në vend të deputetes Myfera Shinik do të jetë deputeti Fikrim Damka, anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

T’i votojmë me një votim formal të dyja këto propozime. Konstatohet se është miratuar.

Me kaq e mbyll seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*